

17
Ferhat Cakaj

PËRMENDORJA

roman

RJH-31

C16

Ferhat
Cakaj

PËRMENDORJA

roman

33630

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

KAPITULLI I PARË

Ai kishte ca që priste në peron. Sytë i mbante nga hyrja. Bënte ca lëvizje nervoze. Dukej se njeriu që priste nuk po i vinte. Njerëzit vërshonin të zinin vendet, ndërsa ora e nisjes po afronte. Ai pa dikë në hyrje dhe i bëri shenjë me dorë. Një djalë dhe një vajzë po vinin me nxitim. Djali mbante në dorë një valixhe të rëndë dhe ishte djersitur. Ajo mbante një valixhe të vogël prej lëkure të zezë. Diç i thoshin njëri-tjetrit dhe qeshnin.

— Na prite shumë? — e pyeti djali. — U vonuam ca se isha në shërbim të kësaj. — Djali tregoi me dorë vajzën.

— Tani na gjeni ju të dy vende, — tha djali i nervozuar.

— As që më shkoi mendja për vendet, — tha djali dhe buzëqeshi si fajtor.

— Rrimë edhe në këmbë, — tha vajza. Ajo ishte trupgjatë e flokëverdhë. Djemtë nuk folën, por shpejtuan të futeshin në vagonin e parë aty afër. Kaluan në vagonin tjetër dhe gjetën një vend për vajzën. Ajo shikoi si me gaz e si me të lutur ata të dy, sikur t'u thoshte: Do të rrimë kështu për fajin tim. Ata të dy ecën tutje që të gjenin vende të lira, por u kthyen përsëri aty. Vajza po bisedonte me dy gra që kishte përballë. Ata nuk i folën, por qëndruan në korridor. Tej dritares kalonin fushat e zhuritura pas të korrave. Diku kishin futur traktorët dhe po plugonin.

Ata të dy, ndonëse shikonin peizazhin e verdhë, as që e kishin mendjen aty.

— Bes, — tha ai që kishte pritur në peron, — takova rastësisht shefin e madh. E pyeta për ty. E di sa mirë më foli? Më duket ta kanë qëndisur karakteristikën më mirë se ne, kur të nisëm këtej. — Tjetri e shikoi i menduar dhe pa qejf.

— E di çfarë, Andrea? Unë nuk dua të iki nga uzina. Ja kështu është puna...

— S'ma merr mendja të të lëvizin, — tha Andrea. — Por, po të lëvizën, veç mirë do të shkosh. Ja, do ta shikosh...

— Seç më djeg këtu për konvertet, — tjetri i tregoi me dorë zemrën. — E keqja është se, t'ia thuash kujt, ta merr për hipokrizi. Po unë i dua shumë. U rrita aty. Ti, Andrea, sa vjeç ishe kur hyre në uzinë?

— Njëzet e dy, — tha tjetri dhe qeshi.

— Kurse unë kam hyrë pesëmbëdhjetë vjeç, — i ktheu shpinën dritares që të mbrohej nga era dhe vazhdoi i frymëzuar me sytë e ndritur që i shkëlqenin. — Fëmijë, fëmijë! Eh, sa gurë theva në anglomerat, derisa më sollën ndër konverte. Është e çuditshme jeta e njeriut, por atëherë unë ëndërroja të bëhesha biraç. Kurse sot pas kaq vjetësh konvertet më janë bërë shtëpi e dytë. — Futi dorën në xhep, nxori paketën dhe ia zgjati Andreas.

— Në fund të fundit, ti e di, Besim, po e nise një rrugë, duhet shkuar deri në fund. Nejëse, e lëmë këtë muhabet. Mos e vrit mendjen, se e kemi vetë në dorë. Mor, po pa më thuaj, si e ke punën me këtë veterineren? A të foli gjë për viçat e fermës?... — Andrea qeshi me djallëzi dhe lëvizi i tëri. Trupi i tij mesatar lëvizi shkathtësisht.

Besimi e shikoi ngultas.

— Për viçat, — tha dhe qeshën të dy duke shikuar vajzën. Ajo i pa dhe u tundi kokën. U ngrit dhe doli nga kupeja.

— Më duket se po komplotoni.... — tha ajo.

— Jo, — tha Andrea, — po tregonim ëndrrat që kemi parë mbrëmë. Ky nuk i tregon të tija.

— Më duket se flisnīt për zhgjëndrrat, — tha vajza dhe u skuq. Ajo e shikoi Besimin, sikur t'i thoshte: Apo s'është kështu? Ti s'më gënjen dot. Po Besimi hodhi sytë mbi fushë. Fusha digjej nën diellin përvlues. Andrea e pyeti vajzën për provimet pasuniversitare dhe asaj iu zgjidh gjuha. Besimi shikoi sytë e kaltër që shkëndijonin plot gaz. Andrea e dëgjonte me respekt. Vajza kishte marrë provimin e gjuhës së huaj dhe mbrëmjen e kaluar e kishin festuar të dy. Ishte shumë e gëzuar dhe i tha: «Besim, është e para herë që festoj një mbrëmje të tillë në Tiranë. Këtë s'do ta harroj kurrë, kurrë...» Ajo sikur deshi t'i thoshte edhe diçka tjetër, po nuk vazhdoi, ndonëse dihej prej të dyve që kishin kaluar edhe mbrëmje të tjera bashkë. Kur Besimi ia kujtoi këtë gjë, ajo nguli këmbë se kjo ishte e veçantë. «Ku është e veçanta?» — e pyeti Besimi. Ajo e shikoi ngultas, uli kokën e nuk foli....

— A dini çfarë? — tha Andrea. — Ju të dy shikoni fushën. Më duket, këtu afër, Skënderbeu ka fituar një betejë kundër sulltanit. Unë po shkoj të vizitoj ca bufenë...

Andrea u largua. Ata e ndoqën me sy derisa ai humbi mes njerëzve në fund të korridorit.

— Njeri i çuditshëm, — tha vajza. — Më duket e bëri me kast.

Të dy ishin kthyer e po shikonin fushën.

Dielli derdhte pa kursim ngrohtësi. Fijet e barit buzë kanaleve ujitëse ngrinin kokën, sikur shkundeshin e shpiheshin plot gjallëri e dëshirë për ta mbushur fushën me ngjyrën e blertë.

Vajza i ishte afruar pranë dhe ai ndiente supin e brishtë që e prekte lehtë. Era lodronte me krelat e verdha pranë tëmthave.

— Është gjë e madhe që njeriu të jetë i sjellshëm si Andrea, — tha ajo.

— Kështu sillet vetëm me ty, — tha Besimi. —

Si duket, i ke hyrë në zemër. Ai shkeli syrin me djallëzi.

Vajza u kthye drejt tij dhe era ia prishi floknajën e verdhë.

— Atë ditë që të kërkova në shkollë, e gjeta te porta. Sesi m'u duk. Ta gjej unë Besin, më tha. Kishte diçka që të bënte për vete dhe ndieje sikur njiheshe prej kohësh me të. Në ato pak minuta që ndenja me të, më detyroi si me të qeshur t'i thosha se quhem Diana Kukaj e jam bijë e Kallushan Kukajt, se punoj veterinerë në fermë. Shyqyr që s'më pyeti edhe për ty. Po ta lëmë Andrean. Më thuaj ç'do të bëjmë nesër?

— Nesër është e diel. Ti nuk do të ngjitesh lart në Pllajë?

— Jo. Nesër nuk do të shkoj.

— Ty sikur të tremb qyteti ynë i vogël...

— Ah, Bes, Bes! — Diana ishte kthyer drejt tij dhe po e shikonte në sy. — Nuk di si t'ia bëj. Jam ca larg atje në pllajë. Tani e ndiej më shumë këtë gjë. Ë, si thua, përse më ndodh kështu? Ai e shikoi dhe i buzëqeshi.

Ndërkohë u duk Andrea shend e verë, u tha se në bufe nuk kishte qofte dhe u nxori karamele «Zana».

— Merrni, — tha. — Këto janë më të mirat për vogëlushët.

Diana e pyeti për fëmijët. Ai tha se kishte dy djem dhe se ia kishte thënë nuses një fjalë në vesh e nuk e dinte sa do të kishte deri në fund të pesëvjeçarit. Diana qeshi, por e mbuloi të kuqtë.

Treni lëshoi një fishkëllimë dhe ata panë se po hynin në stacion. Andrea e ndërroi bisedën për fëmijët. — Tani na fillon udhëtimi, — tha ai.

— Vërtet, — tha ajo, — rrugën e kemi të gjatë. Po Besimi nuk e ndiente rrugën dhe do të dëshironte që ajo të mos mbaronte. Ai do të ishte edhe në autobus tok me Dianën, jo rastësisht ai kishte gjetur dy bileta nga rezervat, kurse Andrea e kishte nga mesi. Le të ishte rruga e gjatë. E kuptonte që edhe Diana kot ankohej për rrugën.

Treni qëndroi. Ata morën bagazhet dhe shkuan tek autobusi i linjës. Te hyrja ishin grumbulluar pasagjerët, po shoferi nuk e hapte derën, se po pastronte. Mes turmës shtynte një njeri i gjatë fytyrëflashkët, me ballë të lartë të rrudhur, veshur me një kostum të hirtë. Ai mbante ndër duar dy valixhe të mëdha ngjyrë portokalli. Thërriste me zë të lartë e kërkonte t'i hapnin rrugën «profesorit». Profeshori ishte po aq i gjatë, veshur me sqimë. Kishte vënë buzën në gaz nga e keqja dhe i thoshte lehtë: Epo prit, de, prit! Shulaku fytyrëflashkët nuk e dëgjonte dhe çau deri tek Andrea. Pa Dianën dhe i tha: «Oh, më fal, shoqja Dianë!» La valixhet përtokë dhe i zgjati dorën. Ajo i dha dorën dhe u kthye shpejt nga Andrea.

— «Shoqja Dianë»? Që kur kështu? — e pyeti Andrea. — Unë pothuaj kam harruar të të them «shoqja Dianë».

— Do të më thuash nesër, — qeshi Diana. — E njeh atë person?

— As në ëndërr s'e kam parë. Por, me sa shoh, ai e di mirë ç'është respekti për profesorë dhe profesoresha...

— Më fort respekton motrën time të vogël sesa mua, — tha ajo.

Besimi pa se vajza u vrenjt dhe një shqetësim i zymtë lëshoi hije mbi ballë. «Si i ka hallet me motrën e vogël? — tha me vete Besimi. — Ndoshta punë fejeje dhe mes tyre është ajo zilia e zakonshme mes motrave. Apo ndonjë gjë tjetër?»

— Hape derën, or ti niri! A s'e sheh se po plas edhe thiu në diell! — i thirri me zë të lartë i njohuri i Dianës shoferit. Po shoferi vazhdonte të pastronte.

— Prosor, vapë, jo shaka, — iu kthye profesorit, po as ai nuk iu përgjigj. Shulaku dukej i bezdisshëm, kishte shumë llafe.

Dera e autobusit u hap. Andrea i doli përpara shulakut dhe thirri:

— Të kalojnë shoqet, pastaj të tjerët. — Diana u ngjit. Besimi mbante valixhen e saj të rëndë. Pas Dianës

u ngjit një grua me një foshnjë. Andrea vazhdonte të mbante rregullin. Shulaku vazhdonte të grindej me të tjerë që t'i lëshonin rrugën profesorit. Si zunë vendet, Andrea erdhi pranë tyre te ndenjëset e para dhe u tha: — Tani e kalofshi mirë! Ti, Dianë, foli ca këtij shokut për rendimentin e qumështit. Unë kam punë me atë... — ai tregoi me kokë mesin e autobusit ku ishin ulur pranë e pranë profesori dhe i njohuri i Dianës. — Shikoni ç'fat! Aty afër kam ata çunat e ekspeditës gjeologjike. Atje do të kemi qyfyre. I shikoni ato dy valixhet e verdha mbi kokën e tyre? Aty në sergjen s'e kanë të gjatë, po ju të dy kini durim.

— Andrea, ma ki kujdes Sojllin, — qeshi Diana.

— Për hatrin tim, kuptohet.

— Po ti më pe që i lëshova rrugën, — tha ai dhe u largua. Besimi shikoi andej. Sojlliu po fliste me zë të lartë. Profesori i përgjigjej ftohtë i bezdisur.

Autobusi mori drejtimin e veriut. Pas mbetën lagjet e reja të Laçit, oxhaqet e larta të fabrikave. Hynë në grykën e rrjedhës së Matit. Ajo shikonte vazhdimisht përpara dhe diç mendonte. Besimi nuk e shqetësoi. Herë-herë kthente kokën; shiheshin ndër sy, vinte buzën në gaz dhe përsëri shikonte korijet që vishnin bregoret anës lumit.

— Ktheje pak kokën anash dhe liroje gushën, — i tha Besimi.

— Bën shaka? Apo mos kam ndonjë shenjë? — Ajo u skuq dhe ngriti jakën e fustanit. — Mos më shiko kështu, se më duket sikur me të vërtetë diku më ka mbetur ndonjë gjurmë...

— Sytë s'njohin komandë. Se ku e kam dëgjuar që sytë dhe shpirti i njeriut nuk njohin komandë. Më duket i quajnë dritare, dritare të shpirtit. Ndoshta e kam dëgjuar, ndoshta e kam lexuar, por kjo më duket e vërtetë.

Nga mesi i autobusit shpërtheu e qeshura e të rinjve. Andrea e kishte kurdisur Sojlliun dhe ai fliste me zë të lartë për martesën e një eunuku dhe dashurinë e zogjve. Herë-herë i drejtohej profesorit «apo jo, prosor?». Profeshori tundte kokën buzagaz dhe nuk i kundërshtonte. Diana u afrua dhe i tha se ai njeri quhej Behar Sojlliu, bir i fisit të madh të Sojllinjve nga fshati i vogël Mrinë, se ishte tridhjetë e pesë vjeç, se kishte kryer një kurs dhe ishte përgjegjës i një vatre kulture në Mrinë apo diku aty afër. Ishte dhe valltar popullor, pjesëmarrës në festivalet folklorike. Tani, siç flitej, merrej me histori, sidomos me prejardhjen e fiseve të krahinës, madje edhe të Kukajve. Kishte zënë miqësi të ngushtë me gjyshin e Dianës, Brah Kukajn, dhe kishte kërkuar për grua motrën e vogël të Dianës, Vjedën, që sapo kishte mbushur të nëntëmbëdhjetë vjetët.

— Fjalën ia ka dhënë gjyshi, — tha Diana, — po nuk e kuptoj si e pranoi babai këtë punë, ndonëse, ende nuk ka marrë fund. Ky njeri është bërë mollë sherri dhe në fisin tonë tani nuk ka qetësi.

— Po jot motër e do? — e pyeti Besimi.

— Vjeda?! As që do ta shikojë... — Ajo u bë gati të thoshte diçka, po u përmbajt. — Nuk e do. Jam e sigurt që nuk e do.

— Po ti, Dianë, ç'ke bërë për motrën? — Besimit i doli zëri i trashë e i mbytur. Ajo u kthye me vrull dhe e shikoi ngultas, pastaj vuri buzën në gaz.

— Ç'kam bërë unë? Të kam dashur ty. Këtë kam bërë. Për time motër asgjë. Në fisin tonë s'mund të çash aq lehtë... Ndosht në jetë që njeriu ka energji, forca të çajë më këmbë edhe lumin e rrëmbyer e të dalë matanë, por, kur ulet të marrë frymë, i ndodh të mbytet edhe me një pikë ujë. Fisi ynë... Të mos të gënjejë mendja se iu hoq ndryshku, jo. Aty te ne mbahen palë shiltetë e dikurshme dhe shtrohen, pasi të largohen tavolinat e karriget për të «kuvenduar rrafsh»....

— Kaq të shqetëson puna e fisit?

— Bes, të ne çdo gjë bëhet sipas rre-gu-lla-ve të fisit, kurse në formë, sipas kohës. Mos kujton se është e thjeshtë puna e Vjedës? Apo takimi e shëtitja jonë në qytezë?

— Puna e Vjedës është fare e thjeshtë. Derisa ajo nuk e do, kupohet që është e thjeshtë. Po kështu edhe jona.

— Ajo nuk e do, por do gjyshi Brah. Ai ka dhënë fjalën pa pyetur askënd. Ai është si perëndi në fis. Po e dha fjalën ai, hajde prishe pastaj. S'ka ndodhur t'ia prishë kush atij deri më sot. Prandaj, babai, siç tha vetë, ndonëse nuk e ka dashur këtë fejesë, më duket e ka pranuar përfundimisht, se «nuk do ta çojë në varr plakun për një cucë».

Besimi e dëgjonte në heshtje. «Si është e mundur? — thoshte me vete. — Kallushan Kukaj duket njeri i kohës.» Ai e kishte parë Kallushanin disa herë me raste festash që sillej atje përpara tribunës dhe merrej me rregullin, duke u treguar njerëzve vendin sipas ndër-marrjeve.

— Po ti mos u shqetëso, — buzëqeshi Diana, — mua nuk më fejon dot gjyshi Brah. Mua më kanë lënë në harresë... Mos më shiko kështu, të lutem, — tha ajo si me dhembje. — Afrohu një çikë të mbështetem. Ti e di që më pëlqen të mbështetem te ti, Bes, jo te fisi...

Ajo u mbështet lehtë. Shoferi frenoi. Përpara tyre kishte qëndruar një «Zuk». Nga karrocera gjysmë e hapur dukej një arkivol i vogël, veshur me beze të kuqe. Një plak me flokët borë të bardhë po bënte shenjë me dorë. Ai u afrua te shoferi dhe i tha se po sillnin eshtrat e dëshmor Hasit nga një rreth i largët e se «Zuku» nuk e kishte mirë pompën e ajrit, kështu që do të ecte përpara autobusit që ta kishte ndihmën të sigurt, po t'i ndodhte gjë. Shoferi i tha të vinte në autobus dhe plaku u ngjiti, përshëndeti dhe ul te vendi i fatorinos. E gjithë kjo u zhvillua mes heshtjes mpirëse. Besimi dhe Diana shikonin ngjymes heshtjes mbi karrocerinë e Zukut dhe nuk shkëm-

benin asnjë fjalë. Pas ca autobusi u gjallërua. Andrea e ngacmoi përsëri Behar Sojlliun dhe Behari tha duke iu drejtuar profesorit:

— Gruas së keqe ruaju gjithë vitin, korbit çdo natë.

Të rinjtë qeshën me zë të lartë.

— E njeh Bacën? — e pyeti Diana, pa i hequr sytë nga «Zuku».

— E kam parë vetëm në ditët e festës së brigadës.

Ajo i tha se të gjithë e thërrisnin Bacë, po emrin e kishte Bektash Sella, se ishte caktuar nga komiteti i veteranëve për të sjellë në rreth eshtrat e dëshmorëve. Ai dinte vendet se ku kishte rënë secili, se kishte qenë një ndër partizanët e parë të rrethit.

«Zuku» ecte përpara me shpejtësi. Era i ngrinte lehtë fletën e mbulesës dhe arkivoli i vogël me kuroren shkëlqenin, sapo u binte dielli.

— Ç'gjë e rëndë të mbartësh eshtrat e shokëve!
— tha Besimi.

— Vërtet, — tha ajo, — unë nuk do të mundja ta bëja këtë gjë, nuk do të mundja.

Nga mesi i autobusit përsëri qeshnin me Beharin. Besimi shikoi andej dhe pa profesorin që sodiste greminat anës rrugës. Mbi kokën e tij qëndronin dy valixhet e mëdha ngjyrë portokalli si dy binjake «Si thua, prosor, a kam të drejtë»? «Përse?» — e pyeti profesori i mërzitur. «Për virgjëreshat, pra, si përse!» Profesori përsëri vuri buzën në gaz dhe përsëri e tërhoqën honet e anës perëndimore.

— Behari po e torturon arkeologun, — tha Diana.

— Pse, arkeolog është profesori? — pyeti Besimi.

— Arkeolog. Studion kafkat që zbulohen nëpër tumat ilire.

— Interesante është puna e tij. Ë, si thua, Dianë? Ja, unë merrem me bakrin, ti me mishin dhe qumësh-tin, ai me kafkat ilire dhe lashtësinë...

— Kurse dikush do të merret me fisin, — qeshi ajo. Besimi e shikoi në dritën e syrit, po atje kishte gaz

dhe çiltërsi. «Përsëri me fisin?» — tha ai me vete. Fisi qëndronte diku, larg tyre, si një re në horizontin e largët, që na afrohet ngadalë, e papritur dhe e padëshiruar. «Po ti, Dianë, çfarë ke nga fisi? — mendoj, po asaj nuk i tha gjë, iu duk se do ta lëndonte. — Kjo se ç'ka një brengë që i lind dhe i zhduket sapo përmend fisin. Enigmë është fisi... Apo jo? Çerdhe grerëzash është, jo enigmë, — tha ai me vete. Ai shikoi Dianën dhe iu duk e gëzuar. — Jo, — tha me vete, — nuk do ta ngacmoj për fisin.» Ajo, sikur ta kuptonte, u mbështet përsëri te supi i tij.

— Ti, Bes, diç mendon, — tha ajo me gaz. — Diç mendon dhe nuk do të ma thuash. Është e vërtetë?

— Dua të njihem sa më parë me Kukajt e tu, — tha ai.

— Mos më thuaj kështu: «Kukajt e tu.» Më duket sikur më largon nga supi, kurse mua më pëlqen shumë të mbështetem këtu. Megjithëse... unë nuk fyhem, se ata të mitë janë, po ti sesi e thua.

— Pikërisht se ata janë të tutë, unë dua të njihem me ta.

— Do t'i njohësh. Kështu janë njerëz të mirë. Bëjnë shumë për njëri-tjetrin, ndoshta pak më shumë sesa duhet bërë... Në shoqëri janë edhe parimorë, por, që t'i njohësh mirë ti, Bes, duhet të hysh në oborrin tonë, mes muresh, në odat tona, duhet të jesh i «brendshëm» si të them, që të marrësh pjesë në kuvendet pasdarke, kur te ne grumbullohen të gjithë xhaxhallarët, kushërinjtë. Në ato kuvende fisi zbulohet vërtet, por në to janë veç tanët...

— Dianë, nuk të pyeta, ende nuk janë ngjitur në qytetin e ri të tutë?

— Jo, megjithëse babai është edhe në komisionin e strehimit.

Po përse nuk kanë marrë shtëpi deri tani, qoftë edhe veç e veç?

— Këtu është çështja. Duan të jenë tok, afër, në një godinë të gjitha kurorat. Kështu që në pasdarkat të jenë bashkë...

— Bëheni shumë kurorë?

— Si të them... nja pesëmbëdhjetë familje.

— Po në qytezën e vjetër sa shtëpi keni? Mua më duket sikur vetëm tri përdhese keni brenda mureve të oborrit.

Diana qeshi.

— Do ta shikosh vetë, — tha. — E lëmë këtë bisedë. Folmë diçka tjetër.

— Ty sikur nuk të pëlqen të bisedojmë për fisin, është e vërtetë?

— Si puna e atij njeriut që nuk i pëlqen të veshë rrobën e vjetër, por e vesh dhe e mban nga halli. Edhe unë kështu. I shikoj gjërat siç janë, jetoj me ta, por shpesh e ndiej se jam e pafuqishme t'i ndryshoj.

— Kjo është dobësi.

— Hë pra, — tha ajo me një ndjenjë keqardhjeje për veten. — Ç'të bëj? Ja, kështu jam unë, Bes. — Ajo lëvizi dhe e shikoi në ninëz të syrit.

— Vërtet kështu je dhe unë të dua kështu siç je, — tha Besimi.

— Kjo më mjafton, — tha Diana. — Kjo dhe këto orë që të kam kështu pranë.

Nga mesi i autobusit vinte zëri i zvargur i Beharit: *Moj nëpërka lara-lara, me kë ishe më përpara?»* Hë, pa m'thoni, pse a dalë kanga? Hë!» Zëri i Andreas: «Lavdinë dhe pasurinë ta jep gruaja. Burrat kanë nevojë për të tria... se burrat janë ca si budallenj...» Besimi ktheu kokën dhe pa se profesori po qeshte tok me të rinjtë pa atë hijen që kishte në fillim.

Në ngjitjen e qafës «Zuku» kishte qëndruar anës rrugës. Era e malit tundte e lëkundte majat e pishave dhe derdhej në rrahjet e kodrave e të shpateve, vinte e valëviste fletën e mbulesës së «Zukut» ku skuqnin e shkëlqenin arkivoli dhe lulet e kurorës. Shoferi i autobusit qëndroi dhe pyeti, po tjetri tha se nuk kishte gjë. Hyri në kabinë e nisi autobusin.

Në qiell kishin mbetur vetëm ca re të lehta të bardha, të largëta që ende kuqëlonin në pjesën e sipërme të tyre. Nën to ngjyra kaltëroshe po thellohej

në një blu të errët. Majat e maleve dukeshin të hirta. Faqet e veshura me pyje humbnin si të përgjurmura në muzg. Gryka zhytej në muzg të thellë. Aty kishte rënë nata.

Shoferi ndezi dritat e kabinës dhe projektorët çanin përpara nëpër kthesat. Njerëzit, të lodhur nga rruga e gjatë, flisnin me zë të ulët. Edhe Sojlliu ishte lodhur. Tani po i afroheshin qytezës së vjetër. Diana zgjati dorën dhe ia shtrëngoi Besimit. «Sa pak drita,» — mendoi Besimi duke parë ndriçimin e dobët e të zbehtë të qytezës së vjetër. Diana i tha se lagjet periferike ishin shembur. Ndriçimi i rrugëve ishte hequr. Një lla mbë e vetmuar qëndronte te shtylla e urës mbi lumë. Ai ndriçim i paktë ishte i klubeve dhe i pjesës së pashembur.

— Erdhëm, Bes, — tha ajo dhe përsëri i shtrëngoi dorën. — Seç kam një ndjenjë sikur do të të humbas...

— Ç'flet kështu?

— Kur do të takohemi përsëri?

Ai pa se ajo ishte e shqetësuar si nën shtypjen e një ankthi.

— Kur të duash, takohemi. Ke frikë?

— Frikë s'kam, por prapëseprapë qyteza jonë me tri mijë e pesëqind banorë nuk është Tirana.

— Nesër unë do të vij këtu poshtë të shikoj ç'bëhet. Paradite nga ora nëntë. Kam gjithë këta muaj që nuk kam qenë këtu, dua të shikoj ç'ndodh.

— Mirë, — tha Diana, — të pres në orën nëntë.

Përpara tyre kishin qëndruar dy vetura dhe «Zuku». Në dritën e projektorëve ata dalluan pranë makinave sekretarin e Komitetit të Partisë, Vasil Kush-tën. Pranë «Zukut», dy malësorë dhe një plakë. Ata kërkuan Bacën. Bektash Sella u ngrit dhe zbriti ngadalë. Hipi në veturën e Vasilit dhe u nisën pas «Zukut». Dikush tha se ceremonia e pritjes së eshtrave të dëshmor Hasit do të zhvillohej në sallën e madhe të komitetit ekzekutiv, lart në qytetin e ri.

— Sa shumë njerëz e presin autobusin e linjës te ne, — tha Diana. — Tamam si në një rit.

Kuptohej, ajo donte që aty të mos kishte njerëz, ata të kishin mundësi të ecnin apo të rrinin edhe ca tok. Po kjo s'ishte e mundur të bëhej.

Autobusi qëndroi mes turmës laramane në gjysmerrësirë, përpara berrarisë. Dikush e ftoi shoferin në klub dhe ai tha që pasagjerët e qytetit të ri të prisnin pak, sa të pushonin nja një çerek ore. Një pjesë e pasagjerëve u ngritën. Sojlliu me dy valixhet zbriti përpara profesorit. Besimi i ndoqi me sy dhe pa se në trotuar profesorin e priti drejtori i muzeut dhe dy arkeologë të një ekspedite. Ndërsa Behari po takohej me të gjithë, profesori shikonte me shqetësim valixhet sikur në to të kishte mina. Ai mori njëren, e peshoi dhe e la përsëri. Behari i tha se do ta ndihmonte deri në hotel, po njëri nga arkeologët i tregoi makinën e ekspeditës. Kur Behari u nis me valixhen e vet, profesori e peshoi edhe një herë valixhen që mbeti. Andrea me të rinjtë e gjeologjisë hynë në berrari. Nga trotuari i errët u afrua Drita. Pas saj Besimi pa trupin e gjatë të skulptor Jeton Druvarit.

— Dianë, më erdhi motra. Ma njeh motrën?

Ajo pohoi me kokë dhe i buzëqeshi Dritës. Pa Jetonin dhe i thirri:

— Kushëri, eja, mor kushëri. Pa eja, se kam nevojë për ty. Sa mirë që qenka Jetoni këtu, të më mbajë këtë valixhen deri në shtëpi.

Drita ishte e emocionuar, por më e përmbajtur nga ç'e njihte i vëllai. Fliste shpejt dhe Besimi e mori vesh në pak minuta si ishin pleqtë, si ishte i vëllai, dy fëmijët e vegjël, nipi dhe mbesa, si shkonin punët me shembjen e qytezës së vjetër. Jetoni e shikonte si me një ndjenjë faji.

— Si të shkon puna me grupin skulpturor? — e pyeti Diana. Jetoni tha se ishte në fillim. Thithi cigaren dhe uli kokën.

— Ç'është ky grup? — e pyeti Besimi.

— Kam një plan-ide për një monument, por jam në fillim të punës. Kot ta zëmë me gojë.

— Foli, foli, — e nxiti Drita. — Unë e di... Kam

dëgjuar për grupin skulpturor. Bes, ky do të nxjerrë madhësitinë e qytetit të ri që po ngremë. Si një monument ose... diçka që unë s'e them dot...

— Vërtet po përgatitni grup skulpturor? — e pyeti Besimi.

— Vetëm një ide, — tha Jetoni i turbulluar. — Dua të pasqyroj atë që ndodh sot me ne përpara syve tanë, por jam larg. Aq larg, sa realizimi i saj më duket ëndërr.

— Kushëri, — i tha Diana, — asgjë në botë nuk është bërë realitet, pa qenë në fillim një ëndërr. Besim, ne jemi kushërinj me Jetonin, kushërinj të tretë e të katërt, nuk ka rëndësi. Tani si kushëri që të kam, do të më ndihmohet ta çoj këtë valixhe në shtëpi, se, si e shikon vetë, je i vetmi nga fisi ynë që më dole përpara. — Diana fliste e gëzuar. Jetoni pa Dritën, si për t'i marrë një mendim, ndeshi vështrimin e vëmendshëm të Besimit dhe u skuq.

— Valixhen? — tha i turbulluar. — Posi! Me gjithë qejf. E pse jo? — Ai vuri buzën në gaz dhe u përkul mbi valixhen e madhe. Drita po e ndiqte me sy, ndërsa Besimit nuk i shpëtonte asgjë. Ai e kapi kur e motra e hoqi vështrimin andej si me frikë. Diana i dha dorën Besimit dhe i tha:

— Tani mirupafshim! Dritë, ju nesër keni punë, apo jo?

— Nesër kemi punë e çfarë pune. Do të shembim me aksion lagjen lindore dhe disa karakteratina të qendrës. Thuaji bacës Kallush se po ju afron edhe juve shembja.

— Nesër nga ora nëntë do të dukem aty, — tha Diana. Ajo zbriti pas Jetonit dhe pas pak humbën në errësirën e rrugës. Tani ishte Drita që po hetonte vështrimin e kujdesshëm të të vëllait.

— Lum motra, e di sa do të gëzohet nëna, kur të të shikojë. E di sa e ka marrë malli? U bënë gjithë këta muaj... — tha.

Besimi e shikoi i turbulluar.

— Po, he, pa na thuaj si të shkon puna? Gjithnjë me shembjen je?

— Me shembjen. Punë e halle sa të duash. Ka njerëz që ende nuk besojnë se këto brigje do të mbyten nga liqeni. Presin t'u vijë uji te dera, pastaj të binden. Një ditë isha me shokun Vaso, kur ai nisi dy instruktorë me shërbim për këtë punë. Kaq kokëngjeshur janë ca, naa! Shpresojnë që të marrin përsëri prodhimin e fundit edhe këtë vjeshtë nga toka e bregut.

Po, tani ai po shikonte Dritën e rrëmbyer, Dritën e zakonshme që nuk përmbahej dhe i pëlqente vend e pa vend të merrej me probleme serioze ja me shokun Vasil, me shpërnguljen, me detyrat e instruktorëve. E pse jo? Edhe detyra e saj për shembjen ishte një detyrë partie. Kështu kishte qenë e motra që e vogël, i pëlqente dikur të merrej me problemet e mëdha të shtëpisë dhe papritur i kthente në lodër, sa qeshnin të gjithë. Po atëherë ajo ishte e vogël, edhe ca e përkëdhelur, kurse tani... Tani ishte rritur. Ishte teknike ndërtimi dhe drejtonte punimet komunale për shembjen e qytezës së vjetër. Jo, tani nuk ishte më ajo çamarrokja, e me gjithë këtë shpirti i saj i papërmbajtur përsëri shpërthente si dikur. «Halle! Po çfarë hallesh ke ti, moj motërz?» — mendoi ai dhe, duke parë seriozitetin me të cilin ajo po i fliste, u përmbajtur që të mos qeshte. Një ndjenjë e vakët si një dritë e brendshme po i zgjohej dhe e pushtonte papritur. Ishte një ndjenjë shqetësimi e dhimbjeje të gëzuar që ai nuk e përcaktonte dot që i lindi që në çastet e para, kur ajo i erdhi me Jetonin.

— Pse, mor Bes, shaka të duket të shpërngulësh një qytet?! Po fshatrat e reja? A e di që njerëzit nuk shkulen nga kullat? Po hallet e thatësirës? Me çfarë do të mbushet liqeni? Turbina e parë duhet të fillojë deri në festa... Beso, ti i ke mësuar punët në shkollën e partisë dhe i di mirë, po mos mendo se jam një copë teknike ndërtimi dhe nuk marr vesh se ç'bëhet...

Besimi e shikoi tërë gaz. Kjo ishte Drita e rrëmbyer dhe e vullnetshme, Drita e singertë, e pastër dhe

e ndershme. Besimi ishte i sigurt se, po ta pyeste tani për Jetonin, ajo mund t'ia pohonte dashurinë e saj pa frikë, pa druajtje. Po ai nuk do ta ngacmonte. Ai nuk do ta prekte motrën e vogël në atë pikë, nuk do t'i tregonte atë ndjenjë që i pushtoi shpirtin, sapo pa ndryshimet në fytyrat e tyre. «Jo, — tha me vete. — Unë nuk do ta bëj atë marrëzi.»

Pas pak ai pa siluetën e Jetonit që shpejtonte në trotuarin e errët.

— Jetonin nuk e paskan mbajtur Kukajt për darkë, — tha.

— Më mirë, — tha Drita.

— Përse «më mirë»?

— Sepse... kot. — Ajo ktheu kokën sikur po shikonte diçka matanë dhe tha: — Mos më pyet kështu, se s'të flas hiç.

Besimi qeshi, po e ndërpre në bisedën, se Jetoni hyri me vrull në autobus dhe u ul pranë tyre. Ai ishte i vrenjtur. Besimi e pyeti dhe ai u tha se sikur nuk i kishte pëlqyer klima atje, ndonëse kishin festë. E kishin ftuar t'u shkonte të nesërmen për një «ziafet».

— Nesër ata shpallin fejesën e Vjedës, motrës së vogël të Dianës. Do të shkoj, megjithëse nuk më pëlqen, të them të drejtën... — Jetoni kishte djersitur. Drita po e hetonte me kujdes lëvizjen e dorës së tij tek fshinte ballin me shami.

— Jeton, ju e keni mbiemrin Druvari, ç'ju lidh me Kukajt? Unë s'e dija që ju kishit lidhje me ta.

— Sot ne jemi Druvari, por dikur kemi qenë Kukaj. Fisi ynë Kukaj dikur më ka përzënë gjyshin dhe e detyroi të merrte rrugët e qyteteve. Ai u katandis pa tokë, pa shtëpi, pa katandi. «Me pre dru!». Rrugët si druvar ndoqi edhe im atë deri në Çlirim. Vonë u bë murator. Pas Çlirimit. Këtu erdhi si mjeshtër. Vetëm se kishte humbur mbiemrin e vjetër tok me fisin. Po kjo nuk na shqetësoi kurrë. Ja, erdhi koha dhe baca Kallush na njuh për Kukaj... Më ftoi të shkoj nesër për fejesë. Edhe sikur të mos më ftonte, unë mund të

shkoja vetë me Emirin, vëllanë e Dianës që është mësues. Atë e kam edhe shok, jo vetëm kushëri.

Kuptohej, Jetoni ishte larguar shumë nga Kukajt, nuk i pëlqenin «ziafetet» e tyre, por kishte respekt për Dianën dhe Emirin.

— E pastaj?! Do të shkosh të pish kafe në Kukajt?! — u hakërrye Drita. Fjalët e fundit ajo i shqiptoi gati me përbuzje të hapur.

— Do të vete, dua të shikoj ç'bëhet atje, — tha Jetoni dhe uli sytë.

— Po ti, Dritë, ç'ke me ta? — e pyeti Besimi.

— Me ta? E si të mos kem punë me ta? U ngrit gjithë qyteti lart, vetëm Kukajt nuk lëvizin. A e kupton, mor Beso, ç'do të thotë në këtë situatë që asnjëri prej Kukajve të mos lëvizë këtej? Ke parë ti... Prit, thonë, se ka kohë. Le të ikin të tjerët një herë, thonë. Po unë e di ku e kanë hallin. Duan të mbeten në histori! Do të gjendet ndonjë kalemxhi që do të shkruajë: «Kukajt ishin të parët që e bënë këtë qytet, Kukajt janë të fundit që po ikin nga ky qytet.» Ja këtë duan ata, prandaj nuk lëvizin. E di unë...

Besimi e dëgjonte të motrën me ëndje.

— Marrëzira, — tha Jetoni. — Marrëzira! Ja, sa t'u vijë radha, pa do t'i shikosh si do t'i marrin lekat. Fajin e keni ju të shembjes që nuk i shpejtoni punimet, pa... — Jetoni po qeshte duke shikuar Dritën me bisht të syrit.

Besimi pa motrën. Ajo përplasi me gaz qerpikët sikur ta pyeste: Përse më shikon ashtu? Po nuk i tha asnjë fjalë.

KAPITULLI I DYTË

Ajo priste të birin. E kishte djegur malli dhe ditët e fundit vetëm tek ai e kishte mendjen. Ndonjëherë i shtohet dhemshuria dhe ajo qortonte veten. I dukej se diçka e fshehtë, e padukshme brenda atij malli i ndillte fatkeqësi. I biri i kishte ardhur me leje për Vitin e Ri, pastaj... Ja, u mbushën gjashtë muaj që ajo s'e kishte parë. Tani e priste dhe nuk e dinte me saktësi ditën që do t'i vinte. Mendonte se u plak dhe nuk duronte dot më e se malli e shqetësimi ishin të natyrshëm për zemrën e saj. Ajo ishte mësuar ta kishte gjithnjë pranë. Pranë çdo natë, kur s'kishte turn të tretë. Kurse në këta dy vjet... Këta dy vjet ishin bërë për të një jetë e tërë. Ndryshe ishte puna me djalin e saj të madh, Bashkimin. Atë e shihte sa herë të donte. Ja ku e kishte!

I shoqi i tha se djali do të vinte të shtunën e parë të korrikut. Ajo punoi dy të diela në repartin e para-fabrikateve që t'i merrte pushim kur t'i vinte djali. Kështu që atë të premte ajo nuk shkoi në repart, u mor me punët e shtëpisë. Lau perdet, çarçafët dhe vuri çdo gjë në vendin e vet. Të nesërmen kishte punë në dhomën e të birit.

Atje humbi gjithë paraditen me raftet e librave. I hiqte librat pak e nga pak që të mos ia ngatërronte, u fshinte pluhurin, i vendoste me kujdes e me dorë të dridhur dhe mendjen e kishte tek ai. Ai do ta gjente çdo gjë të pastër dhe në vendin e vet.

Ja, i biri do të vinte!

Ajo do ta dallonte nga hapat. Hapin e tij ajo e njih-
te, e dallonte nga të gjithë. Do ta ndiente dhe do t'i
dilte përpara, më përpara sesa ai t'i binte ziles. Ai
hapi i tij... Ajo vazhdonte të fshinte raftin në atë pje-
sën përpara librave dhe nuk i kujtohej se e kishte
fshirë edhe më parë. «Lumenjtë dhe malet mund t'i
ndërrosh lehtë, por njeriun është vështirë,» — mendon.
E kujton të birin fare të vogël, filiz të njomë, kur
ende s'i kishte mbushur tre vjeç. Vraponte me këmb-
kat e tulta nga dhoma në kuzhinë.

Pastaj hapi iu bë më i vullshëm. I kërcente shka-
llët dy e nga dy dhe ajo thërriste dhe e qortonte nga
lart se mos ai rrëzohej e vritej. Kur hyri në tetëvje-
çare, nisi të merrej me sport. Atëherë gjëmonin shka-
llët dhe ankoheshin fqinjët, se i biri ulej tok me sho-
kët me aq vrull, sa dilnin plakat të shikonin ç'bëhej.
Kur mbaroi klasën e tetë, i ati piu nga gëzimi. «Dëgjo,
Vashë, — tha ai. — Më jep shishen. Sonte dua të pi.
Shyqyr që na u bë ky i hajrit dhe po vazhdon shko-
llën.» I vëllai, Bashkimi, kishte hyrë në punë.

Kur ishte në të parën e së mesmes, një mbrëmje
kishte ardhur në shtëpi me një vullangë të zezë pranë
syrit të majtë. Ajo iu enjt menjëherë. Djemtë e lagjes
erdhën me të. Ai ecte mes tyre ngadalë. Kur nëna
nisi qortimet, ai heshtte. Shokët ia vunë fajin dikujt
tjetër. Po kush ishte ai tjetri? «Zuku shau gruan e
Talit, prandaj Besi i dha ca partalla të mira,» — tha
njëri nga djemtë e lagjes. Atë natë ajo mezi ia hoqi
nga duart të shoqit. Të nesërmen erdhën në shtëpi
ata të komitetit të rinisë dhe thanë se i biri nuk kishte
asnjë faj, por ta kishin kujdes, se punët nuk ndreqe-
shin me grushte. Ajo u qetësua, por i shoqi nuk i
dha fytyrë djalit për shumë ditë më vonë.

Në dimër, i biri solli notat, e la atë fletëzën mbi
tavolinë dhe tha: «Nuk shkoj më. Unë kam mbetur.»
I ati u nxeh, thirri sa gjëmoi shtëpia, u zemërua ke-
qas, nuk e preku me dorë, po përplasi grushtin në
tavolinë mbi fletëzën e bardhë ku ishin notat dhe i
tha: «Mjaft më! Parazit! Nuk e shikon se më kaloi

jeta në konvertet e uzinës? Nuk e shikon tët ëmë që u robëtua në llaçin e parafabrikateve? E përse? Që të të rritim ty... Që nesër shko në këshill dhe merr fletëvendosjen...» Besimi ziente nga brenda, por u përmbajt. U afrua me hap të ngadalshëm pranë t'et, me sytë ulur dhe i tha: «Ti, baba, ke shumë të drejtë.» Vetëm kaq. Asnjë fjalë më shumë. Këto fjalë e vranë edhe më shumë zemrën e plakut. Kur mbetën vetëm, ai i tha Vashës: «Thuaji të marrë librat e të përgatitet për shkollë.» Kur nëna hyri në dhomë, e gjeti të birin pranë dritares tek mendohej. Ajo iu afrua qetësisht, ndonëse zemra i rrihte me rrëmbim, e tërhoqi dhe u ulën pranë krevatit. I shprishi flokët, i foli fjalë të ëmbla. I biri i tha: «Nënë, babai ka të drejtë. Unë nesër do të marr fletëvendosjen. Vërtet unë me këto nota s'jam veç një parazit. Kjo punë ka marrë fund.» Dhe nëna e dinte se i biri, po të vendoste, do ta bënte atë që thoshte. Edhe tani asaj po i përfitohej zëri pak i trashë i djalit që kishte filluar të burrohej. Drithërohej duke shikuar dhomën plot me libra.

Kujtoi me sa kujdes ecte i biri në dhomë në orët e vona, që të mos kërciste parketi e të mos ngrihej nëna. Po nëna ia ndiente hapin, hap që u bë më i rëndë, kur ai punonte në aglomerat, kur kthehej nga shkolla mekanike e natës. Ai kthehej i lodhur nga puna dhe e zinte gjumi mbi libra.

Kishte ndërruar i biri. Tani ai i fliste gjithnjë me ca fjalë që nënës i hynin në shpirt, nuk harronte ta përshëndeste kurrë që te dera. Edhe me të motrën sillej me dashuri. Blinte vazhdimisht libra dhe, si u mbush rafti i parë, ai bleu raftin tjetër. Ca kohë ia ndërprente shkollën mekanike të natës, se e dërguan në kurs për metalurg në Rubik. Ai fitoi kursin dhe dha provimet e shkollës me korrespondencë. Në uzinë e kishin bërë komunist dhe nisi punën në konverte si biraç.

Njëherë i biri po kthehej nga turni i dytë. Ishte ajo orë e vonë gati para mesnate, kur ka qetësi të madhe. Nëna e priste. Ajo ia njohu hapin që nga shkallët e katit të dytë. U ngrit dhe hapi derën. Mendoj se mos ai

ishte tok me t'atin, por ai ishte vetëm. «Nënë, këtu më ke pritur?» — tha. Qeshi dhe e shikoi gjatë nënën. Ai i preku lehtë flokët dhe asaj i rrahu zemra. Pastaj u ul në tavolinë dhe nxori pagën. «Kjo është paga! Këto janë për tejkalim të planit!» Edhe qindarkat ai i dorëzonte te nëna. E nëna hiqte ca qindëshe dhe ia jepte t'i kishte në xhep. Por ai i thoshte se do t'i merrte kur të shkonte në punë dhe nëna nuk harronte t'i linte diçka në xhep të rrobave të punës, sa herë që i gjente bosh. Vetëm kur dilnin libra të rinj, ai i thoshte: «Nënë, sot më duhen kaq lekë për libra.» Në darkë ajo e shikonte të gëzuar të shfletonte librat e rinj të porsablerë. Nëna gëzohej, kur e shikonte kështu, dhe shkonte tek i shoqi e i thoshte me zë të ulët: «Po lexon!» «Lëre, — i përgjigjej i shoqi, — lëre djalin të punojë.»

Kështu u rrit e u bë burrë i biri. Kështu erdhi ajo ditë që e caktuan për të shkuar në shkollën e lartë të partisë në Tiranë. I pari njeri që ia tha këtë nënës, ishte i shoqi. «Është shkollë e gjatë?» — e pyeti Vasha. «Dy vjet», — tha ai. «Ç'del andej?» — e pyeti nëna me zë të dridhur, po hallin nuk e kishte se çfarë do dilte, sesa tek ajo që i biri do të qëndronte larg shtëpisë. «Ç'del? Njeri del. E ç'mund të dalë tjetër nga shkolla?! Edhe ti bën ca pyetje», — i ishte përgjigjur i shoqi.

Tani ai do të kthehej. E kishte mbaruar shkollën. Ca fjalë ia turbulluan mendjen. Ca thoshin se ata të uzinës nuk do ta lëshonin biraçin e tyre, ca të tjerë thoshin se Besim Përdrini e ka vendin tjetërkund tani që mbaroi shkollën e partisë. Nëna nuk i kuptonte mirë këto punë, po një gjë ia donte shpirti: i biri të kthehej sa më parë, se e kishte përvëlur malli. Të kthehej dhe le të bënte çdo punë, veç të kthehej dhe të mblidheshin të gjithë tok, ta shihte shtëpinë plot. Po sa për punë, le ta caktonin ku të donin. E dinte ajo se ç'duar e ç'zëmër kishte i biri. Veç të vinte. Ah, po kur vjen urbani?

KAPITULLI I TRETË

Lagjja punëtoje shkëlqente nga ndriçimi mbrëmësor i neoneve të rrugës. Shkëlqimi i tyre i lëbyrte sytë dhe atë e pushtuan malli e dashuria që ka njeriu për vendlindjen ku çdo gjë i duket e veçantë dhe e afërt. Kjo ishte lagjja e tij, lagjja e parë, ku shumica ishin familje metalurgësh e minatorësh. Mes zhurmave të mbrëmjes ai ndjeu uturimën e largët të kompresorëve të uzinës. Hodhi sytë padashur dhe pa ndriçimin e kuqërremtë që zmbrapste natën në shpatet e thikta të mallit. «Tani po derdhet skorja,» — mendoi. Ndjeu t'i rrihte zemra nga gëzimi. Vërtet e kishte marrë malli.

— Ditë për ditë nëna te ti e ka pasur mendjen, — tha Drita. — Sidomos, Besi, kur kishim ëmbëlsira dhe ndante pjesë edhe për ty... Po kuptohet unë nuk e lija ta ndiente mungesën tënde.

Kur ngjitën shkallët e katit të katërt, ajo iu lut:

— Shpirt i motrës, prit! Prit. Ec mënjanë! Hajt pra, lëviz... — e tërhoqi Besimin dhe u afrua te dera.

— Baçi e di që vij sonte? — e pyeti ai.

— Mos bëj zhurmë, pra! Kurrkujt s'i kam thënë. As nëna s'është e sigurt. Shst! — Ajo u zgjat dhe i ra ziles. — Qëndro tutje, pra, mos më rri si buf... — Ajo e shtyu mënjanë, kur nëna hapi derën.

— Nënë, e di ç'të kam sjellë? — tha Drita dhe u përpoq t'ia zinte derën me trupin e vet të imët.

— Hë, ia nise pa hyrë mirë... — nëna u zgjat, pa të birin dhe thirri tërë mall: — Oh, oh, lum nëna! Oh, sokoli i nënës! Pëllumbi i nënës! Erdhe ti? Oh,

sa më ka zhuritur malli! — Ajo i kishte hedhur duart në qafë dhe e puthi në ballë.

— Nënë! Nënë! — tha Besniku, pa ditur ç't'i thoshte. Ajo i ishte ngjitur në gjoks. Ai ia mori lehtësisht duart nga supet e tij, e largoi pak dhe ia puthi. Duart e nënës, duart e dashura, të ngrohta, të plasaritura si gjithnjë në parafabrikate.

— Kam thënë unë, ti, nënë, Besin e do më shumë se mua, — tha Drita. Nëna e shikoi si me qortim. — Posi, posi. Pa më lironi rrugën, — vazhdoi vajza. — Mua, as që e mbaj mend, kur më ke përqaf... Hajt! — Drita tërhoqi valixhen. Nëtë e bir i shkuan pas për në kuzhinë.

— Babai në turn? — e pyeti Besimi nënën.

— Jo, bir. Tani vjen. Ja, sikur ka ardhur.

Drita la valixhen dhe shkoi në dhomën e saj të ndërrrohej. Që andej fliste me zë të lartë dhe i thoshte nënë Vashës të gatuante petulla, meqë kishte ardhur Besimi. Nga zëri ai e kuptonte se edhe motra nuk përmbahet nga gëzimi, po e shfaqte ndryshe, me shaka e me llastime, si vite më parë kur ishte e vogël.

Nëna u ngrit. U fut në aneks, doli në kuzhinë, pa bërë asgjë. Ishte e hutuar dhe nuk ngopej duke parë të birin.

— Bes, bir i nënës, mos ma vër re. U plaka dhe sesi më duket..., por ti mos ma vër re, — tha me pamje të përmalluar.

— Nënë, po ti ulu, ulu një herë, apo vërtet je nën urdhrin e Dritës? — ai e tërhoqi pranë në divan. Ajo i preku lehtë flokët, lehtë, me një kujdes të veçantë. Ishte ajo dorë ku ai mbështeste faqen dhe e zinte gjumi, ishte dora që ai e kujtonte gjithnjë kur ishte larg. E pyeti për Bashkimin, për Sokolin dhe Arsinën e vogël (Besimi i donte shumë dy çamarrokët e të vëllait), e pyeti për shëndetin e babait. Nëna iu përgjigj me zë të ulët, si e menduar dhe e merakosur.

— Keq s'është, mor bir. Po edhe mirë nuk është. — Ajo ngriti kokën dhe e shikoi të birin drejt e në sy. — Në dyzet vjeç forcat të lënë një ditë nga viti

në vit, në pesëdhjetë vjeç nga muaji në muaj dhe në gjashtëdhjetë nga dita në ditë... Ja, kështu a të keqen nëna! Ai gazi i uzinës thonë se do të bëhet acid. Po derisa të bëhet ai acid, plaku ka dalë në pension.

— Do të bëhet, nënë.

— Të pastë nëna! Unë e di që do të bëhet, po yt atë e ndien shumë. — Hyri Drita. Deshi të thoshte diçka, po e pa nënën të vrenjtur dhe ndërroi mendim. I kujtoi përsëri petullat.

— Ik, marroqe! — tha nëna me gaz. — Ti s'di punë tjetër, veç të përmbysësh ato gërmadhat e bajraktarit e të tregtarëve dhe petullat...

Drita e shikoi me djallëzi, iu afrua pranë dhe i tha:

— Moj nënë, edhe tani që na erdhi Besi, ti bën gabime ideologjike. A të kam thënë që në dimër se kullat e bajraktarit atje në qytetin e vjetër i ka ndërtuar Met Druvari me shokë? Bajraktari s'ka vënë një gur. Hë, mor Bes, fol, aman. Në fund të fundit unë zbattoj kontratën me bacën Met. Unë shemb atje poshtë, ai ndërton edhe një pallat këtu lart, kurse nëna ime...

— po fjala i mbeti në gojë, se ndeshi vështrimin e mprehtë të Besimit. Padashur i kishte folur më shumë zemra se arsyeja. U kthye, sikur u kujtua për diçka, dhe u fut në aneks.

— Moj, lëri ato ti, — ia ktheu Vasha, — burgun bajraktari e ndërtoi. Apo jo, Bes?

— Kush ta ka thënë këtë, nënë? — pyeti Drita pa qejf nga aneksi.

— Sali shkrimtari! Ma tha atëherë kur shkroi për ne të parafabrikateve në gazetë.

— A e dëgjon, Besi? Nëna ka lidhje me shkrimtarë... — qeshte Drita.

Besimi i tha së motrës t'i sillte valixhen. Nxori andej dy copa stofi dhe ua la ndër duar. Një shishe raki e la mbi tavolinë.

— Rrofsh, mor bir! — tha nëna.

— Ku i ke karamelet e mia? Po çokollatën? Hajt, fute dorën te xhepi i vogël. — Drita po sillej me të si

dhjetë vjet më parë. U afrua, e përqafoi dhe e puthi të vëllanë në faqe. Besimit iu kujtua një ditë e largët, po kur, ndoshta kur Drita ishte pesë vjeç, ndoshta kur ishte dhjetë vjeç. Ai sapo ishte kthyer nga shtëpia e pushimit e pionierëve. Drita sillej po kështu me të, ndërsa nëna qeshte.

— Kur të vijnë Sokoli me Arsinën, — i tha Besimi. Drita shtrembëroi fytyrën, pastaj ia plasi gazit dhe iu hodh në qafë.

— Shpirt i motrës! S'dua gjë unë, jo! Mjafton diploma jote. Tani po shkoj të thërras Baçin, nusen dhe të marr carrokët.

Plaku u kollit te dera. Besimi u ngrit dhe e priti në këmbë. Trupi i gjatë i t'et ishte përkulur më shumë përpara. U takuan në heshtje. Hekurani po e shikonte të birin i emocionuar.

— Erdhe, bir? Hë, mirë, ë?

Besimi nxori dokumentin dhe ia dha në dorë. Plaku u ul në divan, e hapi me kujdes dhe tha me zërin e trashë e si të ngjirur:

— Tani po. Përdrinët prodhojnë blister. Me nder, bir, me nder! Vashë (ai e theksonte gjithnjë e-në) sonte na gostit, se na erdhi djali nga shkolla.

— E, Besi, e shikon? Edhe babai për ty... Si nuk e shtruan një herë për mua... — tha Drita. Plaku vuri buzën në gaz. Ai vetë e kishte llastuar që të vogël, që atëherë kur u thoshte: Unë kam tre djem, Baçin, Besin dhe Dritën. I treti ishte përherë Drita dhe në një radhë me të vëllezërit.

— Kur të shembësh xhaminë e qytezës, atëherë, — qeshi plaku.

— Besoj se do të vish kur të shembet, — tha Drita dhe doli të thërriste Bashkimin dhe fëmijët, Hekurani u ngrit, hyri në aneks, pa tavolinën e mbushur me meze. Shishja e rakisë, që i kishte sjellë i biri, ishte si mënjanë. «S'më paska harruar edhe mua për darovë,» — tha me vete. Vasha kishte vënë në mes të tavolinës dy shishe me verë «Kallmet» që plaku e pëlqente dhe një shishe të vogël raki, nga ajo që e mban-

te për miq. U kthye dhe nisi të bisedonte me të birin si me një shokun e vet. Vendburimet e reja të bakrit, minierat e reja që sapo kishin filluar nga shfrytëzimi, uzina, miniera e vjetër e bakrit, prodhimi dhe plani për pesëvjeçarin, të gjitha këto donin të thoshin se ai ishte i kënaqur si asnjëherë nga i biri. Tani vërtet e quante shok, një shok prej të cilit pret mendim. Ashtu si rrasëisht plaku iu hap Besimit:

— Ata të minierës u nderuan me flamur për 1 Maj, kurse ne jemi ca prapa me plan. Na vjen nganjëherë mineral i varfër. Po kushedi, ndoshta s'është edhe kë-shtu. Ata i kanë në majë të gjuhës justifikimet.

— Po Baçi ç'thotë? — e pyeti Besimi.

— Baçi?! Baçi si të tjerët...

— Ndoshta s'kanë faj.

— Ndoshta, — tha plaku i menduar.

«Paska plasur puna e mineralit mes këtyre, — mendoj Besimi. — Mos janë grindur dhe Bashkimi nuk na vjen sontë? Po nuk erdhi ai, as fëmijët nuk vijnë. Po të mos vijnë, tha me vete, do të shkoj t'i marr vetë. Ata dhe Baçin...»

Pas pak plaku hapi televizorin. Dhoma u mbush me tinguj. Pastaj nisi një skeç që plakut nuk i pëlqeu. «I zgjasin shumë këto marifetet,» — tha. Erdhi Bashkimi me nusen dhe fëmijët. I vëllai ishte i gjatë si Besimi, po më i hollë nga trupi dhe më i hequr në fytyrë. Bashkimi i ngjante më shumë t'et nga pamja, ishte edhe ca kokëfortë si ai. Besimi e priti të vëllanë në këmbë duke i liruuar vendin pranë babait. Bashkimi qëndroi një çast në këmbë përballë të vëllait, e mati nga koka te këmbët dhe pastaj e përqafoi.

— Duhet të kthehesh menjëherë në konvert, se genke bërë një trashalug që s'e ke shokun, — tha Bashkimi. Pas tij qëndronte Bardha, e shëndetshme dhe e mbajtur, babaxhane dhe e urtë. Besimi nuk mund ta mendonte të kumatën pa një foshnjë ndër duar. Ajo u përfal me zë të ulët e me shumë mirësi. Dy fëmijët qëndronin si mëdyshas pas saj dhe Besimi ende nuk i shihte. Si u shkëput nga Bardha, i mori të dy fëmi-

jët në krahë, u soll nëpër shtëpi dhe u ul tok me ta në divanin e veçuar.

Pas pak u ngrit e hapi valixhen. Arsinës i dha një kukull dhe një fustan. Sokolit i vuri përpara një bluzë trikotazhi me viza të kaltra.

— Vëlla, — tha Bardha, — ç'qënke shpenzuar kë-shtu? — ajo shikoi Bashkimin, po i shoqi nuk ia vuri veshin. Ai po bisedonte me Hekuranin. Nëna doli nga aneksi. Fytyra e saj e gëzuar ishte djersitur. Fëmijët nisën të cicëronin me zë të lartë. Besimi ishte më i gëzuar se ata. «Çfarë s'do të jepte njeriu për një gëzim të tillë fëmijësh,» — mendoi.

— Çokollatën! — tha Drita.

— Carrokun, Bes, — qeshi nëna, — e paske harruar carrokun?

Arsina e ndau çokollatën e vet dhe iu afrua Dritës.

— E shikoni? — tha Vasha. — Fëmija ka trupin të vogël, po shpirtin e ka të madh. — Ajo e kishte shtruar tavolinën. Tani të gjithë pritnin Hekuranin që të thoshte një fjalë. Plaku mori gotën.

— Erdhi dita që edhe nga Përdrinët u bë njëri me shkollë të lartë. Rrofsh, mor bir, se na gëzove! — ata trokitën gotat.

Televizori jepte numra cirku. Një gjimnast nisi të fluturonte në arenë, ndërsa të tjerët e ndiqnin me njëfarë shqetësimi.

— Po tani? — e theu heshtjen e cirkut Bashkimi.

— Çfarë tani? — Besimi ishte hutuar.

— Të kanë thënë gjë ku do të të emërojnë? Zakonisht pas shkollës vjen emërimi... — Në zërin e të vëllait Besimi dalloi një dozë ironie që nuk i pëlqeu, sikur t'i thoshte: Pas shkollës vjen diku një karrige. Plaku Hekuran që e ndiqte me vëmendje bisedën, e kuptoi që Besimi as e kishte vrarë mendjen për këtë punë. I tha:

— Tani që mbarove shkollën, mor bir, edhe ti si të tjerët. Ec ku të të dërgojnë. Veç, po u var gjë nga ti, po të pyetën, ta kam fjalën, bëj ç'të bësh, po nga uzina mos m'u largo. Zemra ma do të të kem atje.

Plaku shikoi nënë Vashën dhe sytë e tij sikur gjetën prehje tek ajo, sikur deshi t'i thoshte diçka më shumë, po nuk doli. Takoi gotën me të dhe piu. U koll dhe fytyra iu ndez flakë. Besimi pa ndryshimet në fytyrën e hajthme e si të rreshkur dhe uli sytë. «Rrugë e gjatë, — tha me vete. — Rrugë të gjatë ke bërë për të ardhur gjer këtu, baba. Po përse merakoseni kështu për punën time?» Bashkimi, që e ndiqte të vëllanë, e pyeti:

— Ke ndonjë çikë pushime, apo do të nisësh menjëherë në konvert?

— Jo. Të hënën unë duhet të nis praktikën. Do të shkoj në komitet. Ata do të na caktojnë vendin se ku do të bëjë praktikën secili. — tha Besimi, po në zemër i peshonte si gur ajo «puna e karriges» që i vëllai ia tha me mënyrën e vet. Ai pa se Sokolit të vogël gjashtëvjeçar po i mbylleshin sytë. Bardha e mori, e mbështolli me batanije dhe ishte gati të nisej për në shtëpi, po Drita ia mori nga duart dhe i tha me zhurmë:

— Je në vete?! Pse këtu s'jeni në shtëpi? — dhe i tha nënë Vashës të sillte ëmbëlsirën. — Unë për atë ëmbëlsirë kam shembur gjithë ato furriqe pulash në qytetin e vjetër...

— Naa, moj! Në dorën tënde kanë mbetur punët e qeverisë.

— Vërtet që dorën e kam të vogël, — qeshi Drita, duke mbajtur në krahë Sokolin e përgjumur, — po pa këtë dorë asnjë ndërtesë nuk hidhet përtokë atje poshtë.

Ora ishte njëzet e tre. Shtëpia si zemrat ishte plot dritë.

Jeton Druvari vetëm në studion e tij po shikonte portretin e Besim Përdrinit. E kishte skicuar në disa raste dhe tani kishte përpara gati një album skicash

të ndryshme. Në njërin Jetoni e kishte skicuar në këmbë, po ishte përqendruar në fytyrë, sidomos te sytë, te goja. Besimi qeshte. Gazi ishte i brendshëm me ndjenjën e vetëpërmbajtjes, vështrimi i thellë, i mprehtë. Në skicën tjetër kishte punuar më shumë te goja. Në gjendjen e lirë të buzëve ai kishte dashur të shprehte fisnikërinë, por tani që po e studionte punën e tij, i dukej se shprehte naivitët. Në të tretën e kishte skicuar në një gjendje të tendosur me shufrën e çeliktë në duar në konvert. Lëvizja shprehte një furi fizike. Ishte një lëvizje e mudimshme dhe e fuqishme. Edhe këtu kishte hyrë në studim të fytyrës së tendosur, në muskujt, në vetullat e ngritura. Jetoni e la dhe mori një skicë tjetër po në këtë pozicion dhe pa se edhe në të kishte nxjerrë në pah më shumë muskujt. Në njërin nga portretet fytyra mbulohej e gjitha nga drita. Atij iu duk se evidencimi i forcës i jepte njëfarë vetëbesimi dhe fodullëku figurës.

«Jo, — tha me vete. — Ky nuk është Besimi, as ajo që më duhet. Po ta bëja kështu figurën, kjo do të ishte rënia e tij. Kurse mua më duhet ngritja, jo rënia. Po ku është shqetësimi i këtij njeriu, ku është përpjekja, mundimi? Apo i kam derdhur pikë-pikë në secilën dhe tani më duhet t'i mbledh ashtu si i kam hedhur?».

Shfletoi përsëri. Gjete një skicë që i tërhoqi vëmendjen. «Këtu nuk kam vetëm Besimin, — tha me vete. — Në këto tipare ka diçka nga ai besim i patundur në të ardhmen që e shikoj te Vasil Kushta. Kjo shprehet më mirë këtu... — mendoi dhe studioi përsëri grimasat rreth syve. — Këtu në ballë ka një mendim të rënduar. Po këtë unë e kam parë edhe diku tjetër. Ku?» Iu kujtua njeriu shtatlartë, veshur me kostumin gjysmushtarak e gjysmëcivil, pensionisti Nikolla Bushi.

«Te Besimi po më shkrihen tiparet e Vasilit dhe të Nikolla Bushit. Ndoshta këtu kam atë gjë që më duhet. — E mori skicën me gëzim, pa ia hequr sytë, dhe e la mënjanë. — Besim, ti do të jesh në konvert, në llogoren tënde, por jo vetëm!» — mendoi me gëzim.

U largua andej dhe shkoi te tavolina e vogël ku kishte vajzën me libër. E shikoi skicën dhe i erdhi keq. Në skicë dilte Drita në çdo nerv. Në fytyrë ajo kishte një nënqeshje prej fëmije. Ishte një gaz lozonjar që e shkonte çdo ditë. «Jo — tha me vete. — E ç'më thotë kjo pranë metalurgut? — Figura e dashur e vajzës tani iu duk e ftohtë, e largët dhe pak ironike. — Jo, jo, — mendoj. — Këtu mungon diçka ose... unë e kam vështirë të shkëputem prej saj. Gaz, shaka, nanurisje, dashuri... Jo! Kjo vlen vetëm për në dhomë, jo për ta vënë në qytet.»

U ul në kënd i mërzitur dhe ndezi një cigare. Aty kishte portretin e babait. I ati e shikonte dhe buzëqeshte. Jetoni mori një fletë dhe nisi të skiconte. Dorën me mistri ia ngriti më lart, paralel me kokën. I ruhej ndjenjës së vetëkënaqësisë dhe u përpoq ta mbante figurën në një çast pune. «Nga lartësitë baca Met Druvari! — mendoj dhe e mori gazi. Këto fraza i lexonte vazhdimisht në gazetën lokale. — Ti, baca im, nga lartësitë e një qyteti shikon kullën tënde, timen. Jo, tënden, atë të pambaruarën, kullën e Druvarëve! — tha me vete. — Për atë kullë më ka folur shpesh babai, kur isha i vogël. Po edhe nëna më ka folur. Është histori plot muzg, natë që vjen tek unë nga thellësi e viteve... Dhe unë e kujtoj shpesh e ata të dy nuk i ngacmoj me kujtimet e hidhura.

Fshati im! Ç'më djeg malli kështu për fshatin? Shtëpiza, oborri. Një bajame përballë dritares. Plemja e lopës. Lëmi i të gjithëve. Në lëmë dërrasat e gurta, të bardha, shumë të bardha që farfurijnë nën diell sa të marrin sytë. Pak më larg kopshti i qepëve, më lart vreshtëza. Dhe pranë shtëpizës themelet e asaj kulle që nuk u bë kurrë kullë. Babai më ka thënë njëherë se gjyshi punoi disa vjet me mbledhjen e gurëve të qerrestesë dhe të djegies së furrave të gëlqeres. Ndoshta duke parë fuqitë që i soseshin, ëndërronte të ngrinte me çdo kusht katin përdhes. Ç'stinë fatzezë ka qenë ajo kur vdiq gjyshi! Gjyshja me babanë tim atëherë të vogël, jetuan shumë kohë në një plevicë tok me bagëtinë... Im atë, kur u rrit, e vazhdoi ca murin, po nuk bëri gjë, se nuk e lanë ha-

llet. Babai i ka marrë rrugët e halleve herët. Një sëpatë dhe një sharrë krahëve rrugëve të Tiranës. Me to nuk kishte më nevojë as për tokë, as për kullë, as për bagëti, as për katandi në fshat. Babai i di mirë rrugët dhe rrugicat e Tiranës: «Dru me pre! Hajde, dru me pre! Dru me...»

Zëri i t'et ishte i largët, plot dhimbje, pasiguri, ankth dhe uri në ditët e ftohta. «Kështu u end im atë, ndërsa unë, nëna dhe gjyshja e pritnim, e pritnim. Unë i mbaja sytë te kulla, tek ato themele tërë lëmshk dhe ëndërrroja që ajo të ngrihej e të lartohej. Po ajo mbeti... Vetëm në gjumë, në ëndërr unë e shikoja nganjëherë të ngritur dhe të bardhë, shumë të bardhë, që shkëlqente. Unë dhe kulla e pritnim babanë, kurse ai s'po vinte. Ndoshta kjo ka qenë koha kur babai humbi mbiemrin. Mbiemri Kukaj u tret diku rrugëve të Tiranës. Druvar, eja këtu! Druvar, peja ke na! Druvar, peja peja! Druvar, a po na i çan një metër? Or ti probe, or ti Met Druvari! Met Druvari!... Kur u bënë regjistrimet e para pas Çlirimit, im atë ndodhej rrugëve të Tiranës. Të gjithë e njihnin Met Druvari dhe kështu e regjistruan.

Babai u kthye në fshat me pasaportën e re, me mbiemrin e ri. Mori nënën dhe mua, gjyshja kishte vdekur, dhe na çoi në një kantier ndërtimi. Në cilin? Unë isha foshnjë dhe kemi ndërruar aq shumë kantiere, sa nuk i mbaj mend.

U bë murator im atë, më vonë mjeshtër ndërtimi. Mori kredi nga shteti dhe ndërtoi jo kullën, por një shtëpi dykatëshe me katër dhoma, korridore, dritare të mëdha. Ajo u bë shtëpia më e bukur e fshatit. Po ne nuk ndenjëm shumë, veç një vit. Shtëpinë ia lamë këshillit popullor dhe u bë kopsht fëmijësh e çerdhe. Por në të ka mbetur, skalitur në gur, shënimi: «MET BARDHYL DRUVARI — 1956» Kjo gjë e tërboi gjithë fisin, po nuk guxoi kush të hapë gojë. Edhe sot të gjithë thonë: Shtëpia e Met Druvarit! Askush nuk i zë në gojë Kukajt, ndonëse kullat e Ramë Metës, të Idriz Metës aty janë, aty afër. Ndoshta emri ynë bëri që ata të Ramës e të Idrizit atje të harronin mbiemrin Kukaj, edhe ata mo-

rën mbiemrin Meta. Kukaj quhen vetëm këta të qytezës.

Tre breza me ty, o kullë! Tre breza për të dhe s'e gëzuan.»

Jeton Druvari hodhi sytë te tavolina e punës me baltë dhe pa dy figurina. U ngrit. Studioja ishte plot tym duhani. Hapi dritaren, ajri i bollshëm, i freskët vërshoi brenda. Ai mori frymë thellë dhe u shpi. Një qiell i kaltër plot yje që qeshnin, qëndronte lart mbi qytetin e ndriçuar ëmbël nga drita e bardhë prej neoni. Ndjeu lodhje. Shoi cigaren dhe e hodhi. U afrua te tavolina e punës me baltë. Mori një leckë, e lagu dhe ia vuri sipër figurës, pa ia hequr sytë skicës së Dritës.

«Nesër kam punë me ty,» — mendoi.

KAPITULLI I KATËRT

Nata e së shtunës e kishte mbretërinë e vet në qytezën e vjetër që po shembej. Hijet e natës, heshtja e thellë, kënga e një bulkthi në barin e përvëlur të lulishtes, klithma zëçjerrëse e një kukuvajke që shkëputet nga pullazi i hotelit katërkatësh, ecja e lehtë, e frikësuar, e hallakatur si e një fantazme, e një njeriu drejt postë-telegrafit të kujtonin qytezën ca ditë pas Çlirimit.

Diku tej pjesës së rrafshuar të qytezës, aty ku nxinin një grumbull ndërtesash përdhese me një oborr të rrethuar me mur të lartë guri, si një sy që digjet nga ethet, i verdhë e i zbehtë, gjallonte një llambë. Ajo ishte montuar nën strehën e portës së madhe të drunjte të oborrit. Porta e vjetër, nxjerrë nga dru pishe, ishte brejtur keqas vende-vende nga krimbi, me copëza të gërryera e të rëna, të riparuarra dosido me listela, dukej sikur bënte përpjekjen e fundit për t'ia zgjatur jetën vetes goftë edhe një ditë. Po të vije veshin pranë saj, do të dëgjoje gërricjen e krimbit që vazhdonte punën e vet, punë që e kishte nisur, ndoshta që atë ditë kur dërrasat e kësaj porte kishin pasur nusërinë e vet të bujshme këtu. Skërmitja ishte e pandalshme e, kuptohej, nuk do të kalonte shumë që edhe krimbi do të largohej prej saj, se gjithçka kishte mbaruar. Ndoshta do të shkonte në ndonjë portë tjetër të tillë diku.

Edhe brava prej tunxhi kishte ndërruar ngjyrë. As nuk punonte më si dikur. Se çelësi kishte humbur, ehu, nuk mbahej mend, por të zotët e kishin ruajtur bravën si një ogur të mirë. Menteshat e mëdha ishin ndryshkur aq tepër, thua se ishin bërë njësh me pjesën e drunjte.

Ishte porta e fisit Kukaj. Prej saj hyje në oborrthin e rrethuar me mur guri të lartë. Brinjë më brinjë oborrthit, mureve ngjiteshin si vemje katër përdhese me mur tulle dhe katër barakëza të drunjta, mbuluar me eter-nite, që shërbenin si kuzhina. Nën secilën përdhese kishte nga një bodrum të thellë një e tetëdhjetë.

Kuzhinat e drunjta ishin të vogla si kotec, të nxira nga bloza e përhershme, por të mira për të tymosur nga agu i mëngjesit deri në mesin e natës. Bodrumet shërbenin si oda dimri për pleqtë e oda verore për nipat, por më shpesh si oda grash, kur fisi ziente nga ziafeti.

Mes oborrthit ishte çezma. Çezma e ngratë, e vetmja pronë e përbashkët, kishte hallet e saj. Nuk kujdesej kush për të. Uji i saj derdhej ditë e natë, që nga ajo ditë kur këshilli vendosi t'ua sillte ujin në oborr. Ajo e kishte shtuar presionin kohët e fundit, sepse dy të tretat e qytezës ishin shembur e rrafshuar. Megjithëse dëgjonin zhurmën shurdhuese të saj, askush nuk e merrte mundimin ta mbyllte, sepse pritnin që këtë shërbim të padenjë ta bënte ai me më pak rëndësi, por në fis edhe maçoku sylarmë e quante veten person me rëndësi, derisa i lante sytë mbi legen në odën e babës Brah.

Tani në odat, kuzhinat, bodrumet të gjithë flinin, me përjashtim të dy vetave që dëgjonin zemërimin e çezmës. I pari ishte stërgjyshi Ibrahim Kukaj, Him Kukaj apo veç Brah, siç e thërrasin gjatë tridhjetë vjetëve të fundit. Është mbi njëqind vjeç — ka kohë që nuk ia numëron kush, — po ende i fortë, lëviz vetë deri në oborr për ndonjë shërbim të domosdoshëm, kuvendon çdo pasdarke dhe ha ende vetë. Mendja i punon jo keq, sidomos për ambicie, të cilat i ka pëmbushur rrugë e pa rrugë gjatë gjithë jetës së vet. Nuk fle. Nuk e merr gjumi, jo për gjë, por ende e vret mendjen se ka një si shqetësim, si të keq brenda, ashtu... Kishte dhënë fjalën për mbesën e vogël, Vjedën dhe kjo nuk ishte pritur mirë prej njerëzve të fisit. Mirë burrat po kishte folur edhe e mbesa, Diana. Sa kishte ardhur prej Tirane ajo, kishte plasur sherri mes saj dhe t'et, Kallushit. Eh, plaku i kishte dëgjuar mirë ata, po nuk e kishte bërë

veten. Kishte bërë sikur s'kishte dëgjuar. E pra, fejesa te Sojllinjte do të bëhej, se pastaj... E nëse vërtet do të prishej fejesa, kjo do të thoshte se fisin e mori lumi me Brahën gjallë. Po kjo nuk do të ndodhë. S'duhet! Plaku nuk fle...

I dyti njeri i pagjumë është Vjeda, motra e vogël e Dianës. Është nëntëmbëdhjetë vjeç, në lule të moshës e plot shëndet. Rinia bujon me rrëmbim, vrullshëm në çdo qelizë të trupit. Është tepër e mërzhitur, sepse edhe babai që në fillim bërtiti, u tërbua, prapëseprapë nuk ia bëri fjalën dy gjyshit. E pranoi këtë fejesë si një fatkeqësi që bie nga qielli. «Si është jeta!» — mendon vajza. Po ajo nuk di një gjë të thjeshtë: vetë ajo ka mësuar fare pak nga jeta. Ja, një fjalë tha gjyshi, duke pirë raki, dhe ajo po rri pa gjumë. Kjo natë gdhin e diel. Të dielën këmbehen shenjzat. Kur kishte ardhur Diana në darkë, zemra i kishte rrahur me rrëmbim, i ishte hedhur motrës në qafë dhe ia kishte lagur gushën me lot malli e shprese. Diana i kishte thënë se nuk do të bëhej. Ishte zënë me nënën Sanije, sa e kishte bërë të qante. Ishte zënë me babanë aq keq, sa Vjeda kishte kujtuar se do të bëhej hataja. Grindja kishte zgjatur shumë dhe Diana ishte larguar me urbanin e orës njëzet e dy. Kishte shkuar tek Emiri, lart në qytetin e ri. Kur ishin ndarë, ajo kishte thënë: «Ti, Vjedë, mos u shqetëso!» Kaq dhe kishte ikur. Tani Vjeda është fillikat në kthinën e ngushtë, ngjitur me odën e prindërve, dhe ndien nevojën e një njeriu. Sikur të kishte një njeri! Këmisha i është bërë ujë në djersë, jastëku ujë nga lotët. Kthina është tepër e ngushtë sikur të merr frymën. Po vajza e ngushëllon veten. Mendon: Në fund të fundit, nga kjo kthinë ka dalë Skifteri, vëllai i madh që tani është oficer në Bajram Curr, ka dalë Bora që ka shtatë fëmijë atje në Like të Bardhë, ka dalë Emiri, profesori, që tani jeton lart, në qytetin e ri me dy fëmijë dhe nusen, ka dalë Agroni (Agroni është vëllai i vogël, dy vjet më i madh se Vjeda. Ajo e do shumë atë, më shumë se këdo tjetër). Tani ajo kujton se, kur e nisën Agronin për në hidrocentral, në fis flitej sikur

po e nisnin në një minierë ari, ku ai po shkonte që të joshte grykësinë e secilit. Po Vjeda e di se Agroni nuk është i tillë. Eh, sa e njeh Vjeda të vëllanë! Sa vite kanë fjetur bashkë në këtë kthinë! «Po sikur të ishte Goni nesër? — mendon. — Ndoshta, kushedi... Ç'do të bënte Goni, po të ishte këtu nesër?» Ajo ka dëgjuar fjalë shumë të mira për të. Goni është zjarrmëtar i dalluar. Goni ia dëgjojnë fjalën. Goni mund të bëhet me pozitë... Oh, si flitet në fis për Gonin!

Një shpresë shpërthen si një shkëndijë në fundin e një pusi, ndizet si fishekzjarr mes resh dhe ndriçon një çast trurin e ndezur. Hedh tutje jorganin dhe ngrihet ndenjtur. E ndien veten fare të mjerë e të humbur. Zerra i rreh me rrëmbim. Gjoksi i ngrihet lart si tallaz dhe ajo e ndien se duhet t'i lirojë gjinjtë. Në vesh i vjen zëri i zvargur i gjyshes Rashë: «Hajt bij-o, janë derë e madhe Sojllinjte. Kanë rreth të gjanë miqasor...» Po ç'i duhet Vjedës derë e madhe e derë e vogël? Ajo e ka parë disa herë atë Sojlliun faqepetull. Një send i gjatë, bajat, si dreq. Yyy, ç'gjë e pështirë! Vjeda ka një ndjenjë mes neverisë dhe urrejtjes. E përfytyron atë tek e prek. I shkojnë të rrëqethura dhe e mbulojnë mornica. «Jo, — thotë me vete, — kurrë! Ngordh si qen, por jo...» Ajo kujton se si ai Behari i gjatë e flokëverdhë kishte ardhur përpara dy javësh me nja dy pleq. Ecte shuk-shuk pas pleqve. Vjeda i shikonte nga dritarja, që prapa perdes, edhe kur hynë, edhe kur dolën.

«E mjera unë! — mendon. — E prita këtë të diel duke shikuar lumin çdo ditë, kurse gjithë bota pret liqenin që të gëzohet. Agroni!» Vajza merr një vendim të papritur. Hap valixhen. Bubrron aty dhe gjen letrat e tij. Në zarf është adresa e saktë e Agronit. Vesh fustanin dhe zarfin e fut në gji. Në oborr çezma derdhet me furi. Era e natës është e freskët. Nga bregu i lumit vjen zhurma llokoçitëse e valëve mbi zall e mbi shelgjishtë. Te porta u kujtohet se fleta kërciste me piskamë. E tërheq ngadalë-ngadalë, vetëm pak, pak, sa t'i nxijë trupin dhe del. Rrugica drejt qendrës është e errët, e frikshme. Nata pa hënë duket si e skëtërrshme, sidomos

mes gërmadhash gjysmë të shembura. «Si u bë ky qyteti ynë kështu!» — mendon e tmerruar. As që e kupton se po vrapon. Ka arritur në qendër. Ndien hapat e saj dhe i duken të huaj. Gjunjët i priten. Hedh sytë mos shikojë policin e shërbimit. Arrin te posta. Hyn me vrull dhe shkallinat e drunjta gjëmojnë. Te sporteli centralistja zgurdullon sytë. «Merret vesh, në këtë orë pas mesnate ka veç raste vdekjesh,» — mendon vajza. Po centralistja largon kufjet dhe shkund flokët. Vjeda stepet. Si t'i thotë? Të dyja shikohen të hutuara.

— Si e ke hallin, Vjedë? — e pyet centralistja.

— Dua të flas me Agronin, vëllanë që kam në hidrocentral...

— Ç'ju ka ndodhur? Mos gjyshi Brah...

— Jo, jo. Kështu e kam hallin, — Vjeda nuk përmbahet dot. Dhembja i shtrembëron fytyrën. Tiparet e bukura, të freskëta vajzërore i çregullohen.

— Ç'ndodh aty në fisin tuaj?! — tha me zemërim centralistja.

— Të lutem, shoqja Verë! Më jep Gonin shpejt... Aman, se më kallën flakën! S'duroj dot. S'kam rrugë tjetër, veç lumit... — Vjeda nxjerr zarfin me adresën e të vëllait. I tregon një shënim me adresën e fjetores.

— Ndoshta ka pushim turni dhe e gjej. Këta të mitë kanë kurdisur fejesën time me një... me një...

— Budallaqë, po a për këtë bën kështu ti?! Unë kujtova se ç'u bë. Thuaju «nuk e dua» dhe s'ka burrë aty në Kukaj që të të prekë as fijen e flokut e jo të të... çojnë si berr në thes.

— Ah moj shoqja Verë, ju i njihni tanët nga jashtë, nuk dini ç'ndodh brenda avllisë.

Vera u lidh me hidrocentralin. Kërkoi fjetoren. Nisi të thërriste se, siç kuptohej, ata nuk donin ta zgjonin nga gjumi. Vjedës i erdhi keq për të vëllanë. Ishte gati të tërhiqej. Le të flinte Goni. Po Vera kishte kërkuar sekretarin e partisë. Pas pak ajo u çel në fytyrë.

— Kush je, Agron Kukaj? Mos u shqetëso. Jam Vera këtu në kabinë. Vjeda do të bisedojë me ty. Foli! — Vera i bëri me kokë vajzës të hynte në kabinë.

— Gon... — Vjedën e mbyti gulshi. «Vjedë, fol, Vjedë. Ç'ka ndodhur?» — zëri i të vëllait ishte i shqetësuar, i largët.

— Gon, shpirt i motrës... ajo puna e fejesës sime që të shkruaja është e vërtetë. Nesër... shenjat nesër... Të lutem, Gon, shpirti i motrës, eja! Për hatrin tim, eja! S'më ka mbetur tjetër veç ti dhe... lumi.

Agroni e pyeti për babanë.

— Ai më tha: «Po ma drodhe, të këpus kokën.» Edhe Miri u zu me babanë. Edhe Diana erdhi sonte nga Tirana dhe u bë sherr i madh, po asgjë. Kurr gjë s'u bë. Nesër ndërrohet shenja. Gon; zemra e motrës, nesër mbaron çdo gjë. «Asgjë nuk mbaron nesër! — tha Agroni. — Po të pyetën, thuaju «jo!», asnjë fjalë më shumë. Unë nesër jam aty gjallë a vdekur... Do të bëhet si ta do zemra ty. Mirë? Shko tani në shtëpi dhe më prit. Shko në shtëpi! Mirë të gjëtsha!»

Ajo deshi t'i thoshte përsëri edhe diçka, t'i shpjegonte se ndoshta nuk ia kishte thënë mirë punët, po ai e mbylli aparatën. Ajo nuk e përfytyronte dot se nga vinte zëri i të vëllait. Aq i largët ishte dhe ajo e dëgjonte sikur ta kishte pranë. «Si janë punët... — tha me vete. — Flet njeriu në telefon dhe e dëgjon zërin sikur vjen nga një botë tjetër.» A do të vinte dot Goni deri nesër? A do ta mbante fjalën? «Gjallë a vdekur,» — tha ai. Do të arrinte përpara shenjtit? Me se do të vinte? Më këmbë, me kalë, me makinë? Zemra i thoshte se ai do të vinte, do të vinte tok me erën e lumit. Do të vinte derisa i dha fjalën. Nesër ishte dita e saj. O këtë radhë, o kurrë! O në këmbë, o në kalë, o... Do të vinte. E po të mos vinte, veç lumi... Vjeda përfytyron trupin e saj pa jetë, nxjerrë nga lumi mbi zallishtë. «Oh, jo!» — klith e ngurorur me receptor në dorë. Vera e zuri për krahu.

— Pa eja! Eja këtu ti, Vjeda e vogël që nuk merr vesh ç'bëhet, veç di të endësh sixhade tetë orë. Eja këtu! — e tërhoqi jashtë kabinës. — Flije mendjen se asgjë s'ka për të ndodhur, nëse nuk do ti. Të vëlla këtu e ke pas pesë-gjashtë orësh. Kjo punë nuk do të bëhet,

ta thotë Vera ty, nuk do bëhet. Flije mendjen, budallaçkë? Këtu do të jemi, do ta shohësh.

— Aman, mos i thuaj kujt! E zeza unë! — U kujtua për paratë e bisedës. Preku fustanin. — Pagesën nesër... si erdha kështu, e mjera unë!

Vera qeshi. Ajo e kuptoi se vajza po e merrte veten. E përcolli deri te shkallët. Vjeda doli në rrugë. Mendjen e kishte tek Agroni. Kur u fut te porta, pa se në odën e bábës Brah kishte dritë. Hyri në kthinën e ngushtë dhe priti mos e kishte hetuar kush. Jo, askush nuk ndihej i gjallë, veç kollës së babës Brah. Një zhurmë filxhanësh. Zëri i gjyshes Rashë. Vjeda ra në shtresa dhe u përpoq të dëgjonte bisedën tek oda e gjyshit, po nuk fliste kush. Vetëm çezma vazhdonte të rridhte në oborr sikur i thërriste të zgjoheshin. «Si e kalon gjithë natën ky gjyshi pa mbyllur sy? — mendoj vajza. — Mos do të katranosë edhe Dianën si mua?»

Brah Kukaj e kishte mendjen tjetërkund. Dikur ai thirrej Ibrahim, dukej madhështor, i fryrë si një gjel-deti, por, me kalimin e kohës, rrokjet ranë njëra pas tjetrës, ashtu si bien puplat e gjelit të detit, dhe nga ai i pari mbeti vetëm një. Nuk i thotë më kush as Ibrahim, as Him, veç Brah... Ai merakosej për pjesët e humbura, por ama krenohej se ende ishte i pari i fisit. Djetëm të ia dëgjonin fjalën, edhe atëherë kur nuk u pëlqente, e kjo përmblihte gjithë kuptimin e jetës së tij. Po në trurin e tij jeta e gjerë, e begatshme dhe e paanë ishte treguar e kursyer. Pak gjurmë kishte lënë në njëqind e ca vjetët e tij. Ai dinte vetëm ato që kishte bërë vetë, ato që kishte dëgjuar dhe ca fragmente të shkëputura nga bibla, kurani e kanuni. Këto të fundit ai i përziante e i merrte për norma të shenjta që duheshin zbatuar. Po askush nuk mund të vinte dorën në zjarr për të dhe të thoshte në e besonte me të vërtetë Muhamet Aliun. Orë e çast përsëriste si një refren «Perëndi e madhe!

Perëndi e madhel!» që sipas tij ishte perëndia baba. Pastaj, me sa merrej vesh nga ato që thoshte, vinte perëndia nënë, më pak e rëndësishme. E vargu vazhdonte me perënditë bij, bija, nipa e mbesa, e varg e varg. Në njëfarë mënyre Braha e kuptonte grigjën e perëndive si punën e fisit, ja kështu si Kukajt.

Vetë ai me plakën Rashë ishin në fis perënditë, baba e nënë. Pas vinin Kallushani, Ibishi, Kurtishi e Memishi me djemtë e tyre dhe djemtë e djemve e me radhë. Pastaj radhiste Kukajt e fshatit që mbanin mbiemrin Meta: Ramë Meta, Idriz Meta, Zozjo Meta e me radhë. Mënjandë ishin të lanetisurit e fisit, Druvarët. Zinxhiri ishte i gjatë dhe plaku nuk lodhej t'u mbante mend emrat. Ndonjë martesë apo ndonjë vdekje ia fiksonte ca kohë një emër, pastaj edhe ai mbytej në mjegull.

Kishte pasur dikur një ëndërr ky njeri, një ëndërr të ethshme, të egër. Donte të ishte i pari në fshat dhe të bënte ligjin në të. Me finokërinë e tij ngatërroi dynjanë atje sa i ngjitën nofkën «Merimanga». Po nuk ia arriti qëllimit, se në fshat njëri ishte më kokëkrisur se tjetri. Ai nuk ia arriti të bënte ligjin. Mbeti i parë mes të parëve, i barabartë mes të barabartëve. Pastaj i ndërroi vetë, apo ia dërguan, këtë as sot e kësaj dite Braha nuk e di. Po ajo duhej të ishte punë e ndonjë finoku më të rafinuar sesa Braha. Çbania e dreqit shkoi e bujarriti në vend, e gjeti një kalemxhi e i shkroi atë letrën që e di gjithë nahija, ku e fyente në burrëri: «Or ti, Brah Kukaj, selam të ban Çbane Trashamania. Me atë pushkën tande mos i dil hasmit përpara, se, sa të jesh gjallë, gjakin e babës s'ke me e marrë.

Edhe niherë selam... Çbane Trashamania». Mirë që e shkroi, po përse ta përfliste kudo që shkonte. E Braha e kujton me turp atë bisedë qoshe më qoshe të odës së vet. «Oj Trashe, po kam ftohtë, hej ti.» «Merre ende një jorgan.» «S'po kena tjetër, hej ti...» «Ani...» E pastaj kur u ndanë në mëngjes, Braha nuk mundi ta shikonte më në sy Trashen e as t'i thotë: Duku përsëri. Braha

zgjodhi rrugën më të mirë. Mori mbiemrin dhe iku prej fshati. Rama me Idrizin morën mbiemrin nga i ati, u thirrën Meta. Po këtë Braha vetë nuk ia zë kujt me gojë e nuk pranon t'ia thotë kush.

Ëndrra e vjetër sikur i buzëqeshi ca kohë në qytet. U ndez si një flakë e papërmbajtur, ushqyer nga era e fortë, pastaj u shua me aq shpejtësi si të ishte prej kashete. Qëlloi që për pak kohë Kallushin e bënë nënkryetar të këshillit popullor. Brenda një viti njëri pas tjetrit u vunë nëpër aksione ca Kukaj, ca dhëndurë e ca miq të afërt e të largët, saqë ranë në sy menjëherë dhe, pa i ngrohur mirë duart Braha në zjarrin e ndezur, u hoq Kallushi, u hoqën edhe disa të tjerë që s'e meritonin. Braha e kuptonte. Nuk mund të bëhej si dikur. Kishin ndryshuar kohët. Ëndrra e Brah Kukajt u tulat, u mbloodh kutullaç, fshehu kokën në trupin e vet, duke pritur një stinë kur të zgjohej përsëri si një dëshirë e fshehtë e netëve të gjata. Nuk ishte punë të merrje komandën e të bëje ligjin në një qytet. Braha e kuptonte mirë, paçka se s'i pëlqente.

Nganjëherë ai numëronte familjet e fisit. Dëshironte që ato të ishin shumë, sa më shumë. Po numri i tyre ka një kufi. E kufiri mbaron te Bardhyl Kukaj e Met Druvari. Këtu filli i këputej. «Të lanetisurit e fisit!» — mendonte dhe pështynte tri herë të keqen.

Sa herë që mendon për Met Druvarin, i kujtohet Kaini. Në këto çaste ai humb si në një botë tjetër, botë-ëndërr, botë-klapi. Mërmërit, shqipton fjalë, fraza që i gjen e nuk i gjen në bibël, po mund t'i gjesh në kuran ose në kanun.

«Ani qetash, — thotë me vete, — puna e don me folë pak e me heshtë. Me nigjue xhit po thojnë qerët. Po ama fisi u rrit ene a i fortë, veç duhet mbajtë, duhet ruejtë, ani pse Druvarët quhen Druvarë e qerët Meta q'atje në katund. Druvarët i ndjek mallkimi em, kurse në fis, shyqyr, mretnon bindja e urtia. Pa ta shofim ç'ka me u ba qetash. Mos po don me u da secili në zjarrm të vet. Mos po don me u ba lanet ndonjeni? Cilli e ka radhën pas Kainit? Gjer sot, shyqyr, i pata tok, nji

grusht. Ene Ramë Metën, ene Idriz Metën, ene q'at Zojzon e Idrizit q'atje në katund... Ani, po qetash? Po ba me u da kokrra-kokrra në atë kazanë e re? Sa ish Muhameti, shteti arab eci përpara. Kur vdiq, bijtë e bane çorap dreqi. Me ba me u da, qysh i vete filli fisit? Po u ba, erdh fundi. Vjen përmytja e Nuhit. Jo, përmytja eme. Ene e fisit tem... Brah, bre!...»

Plakut Brah, shtrirë ndër shtresa, i shkuan të rrëqethura. Përmytjen sikur e ndjeu mbi trupin e tij. Ajo po i shtrëngonte gjoksin e po i merrte frymën. U ngrit përgjysmë tërë tmerr dhe ia ngjiti sytë derës së odës së madhe. Ditët e fundit të gjithë flisnin se lumit i kishin zënë grykën. Ai po fryhej dhe liqeni po përmytje brigjet. Gjëma e qytetit do të vinte nga ura. Në fillim do të mbushte shtratin e lumit, pastaj fushën dhe do të hynte tërë frushkullimë në oborr. Do të zbriste vrullshëm shkallëve të bodrumeve, pastaj...

Kishte disa net që vetëm dremiste. E brente meraku i përmytjes, por më fort i shpërndarjes së fisit. «Secili në zjarrm e në bukë të vet, secili nja qese...» — grindej me vete. Kjo e tundonte shumë dhe as që e kuptonte se po ia shkurtonte ditët vetes.

I biri, Kallushi, i kishte thënë një ditë se do të merrnin aq shtëpi, sa kurora ishin. Do t'ua jepte pushteti falas. Po nuk duhej të binin në sy. Njeriu e shikon botën me ngjyrën e syzave që ka. Edhe Braha. «Diça fshihet qetu, — tha me vete, — Kallush, e drodhe ene kët radhë.» Ai mendonte se do të ishte si punë vjedhjeje, derisa Kallushi thoshte të mos binin në sy. Përndryshe, derisa u jepeshin falas, përse të fshiheshin? Braha e shikoi Kallushin siç shikojmë xixëllonjën në një natë xët kur udhëtojmë në fushë të hapur. E pyeti të birin vetëm për vetëm dhe Kallushani i tha se kishte një plan për ta futur gjithë fisin në një pallat. Nën një bina, nën një strehë, nën një tym, me një qese! Plaku u çel në fytyrë. Po përse nuk duhej të binin në sy? Dikush tjetër kishte zënë në gojë punë ligjesh. «O perëni e madhe», — kishte thënë Braha, — tok qe tu, tok q'atje nën një strehë. Nji strehë, nji qese... Mos e dhantë allahi e me u përda...»

Në këtë bisedë kishin ardhur ishin mbledhur të gjithë. Kallushani ua kishte hapur. U kishte treguar se sa do të merrte secili. Po Braha kishte vënë re se ata e kishin parë të birin të vrenjtur e të pakënaqur. Në atë heshtje nervoze e pakënaqësie Kallushani u kishte thënë se përndryshe do të shpërndaheshin lagje më lagje e secili do të interesohej për vete. Plaku Brah që zakonisht ankohej se nuk dëgjonte, këto i kishte dëgjuar pipërr. U tha: «Perëni e madhe, mos e përda fisin, pa marrë mue. Merrmë mue një herë, pastaj.» Po i iknin djemtë së gjalli. Nuk do t'i shikonte dot çdo mbrëmje. Nuk do t'u kërkonte dot llogari, nuk do të kishte më një qese.

«Lundra e Noes a binaja e madhe, — u tha plaku. Të gjithë menduan përmbytjen e bib... jo, të qytezës. — Ajo perëni e madhe ma çoi enjëllin...» Ai e kishte fjalën për Behar Sojlliun që merrej me gjenealogjinë e fisit Kukaj. Behari do të rriste lavdinë e fisit Kukaj. Behari ishte fati i fisit. Behari po e përziante gjakun me fisin Kukaj. Kjo ishte veç punë e perëndisë së madhe. E ku mund t'i shkonte mendja plakut Brah se qerratai Behar ia kishte vënë syrin më fort qytetit të ri sesa Vjedës. Brah Kukaj i thithur i gjithi nga ethet e fisit, as që shikonte anën tjetër të medaljes. Behari ngrihej mes djemve si i dërguar i profetit. Braha me zemër në dorë ia premtoi Vjedën e Kallushit. Le të bëhej Behari gjaku i gjakut. Le të shumohej Sojlli me gjakun Kukaj. Le të rregullohej Behari në qytetin e ri. Le të kujdesej Kallushi e ta rregullonte me punë në qytet.

Brah Kuka, i lodhur nga nata, mbështetur në jastëk, lëviz me mundim. Merr xhezven, po rrëzon një filxhan. Plaka Rashë diç thotë: Nata e lodhshme s'po gdhin.

Hijet e natës të së shtunës po terratisen brigjeve të lumit. Era e lehtë nanuritëse futet rrëzë shelgjishteve ku mugullon bari gjelbërosh që i ka shpëtuar avullit përvëlues të stinës së nxehtë.

KAPITULLI I PESTË

Lugina dukej sikur avullonte. Malet përreth dukeshin hijerënda e të largëta. Ishte një vapë përvëluese që sjell zakonisht shiun. Në horizontin e maleve në perëndim të qytezës së vjetër ca re të holla si një vello e tejdukshme qëndronin pezull, të palëvizura, duke prekur lehtë majat e larta të kreshtave që mezi shquheshin.

Besimi priti ca në stacion. Urbanët s'po dukeshin. Dy blloqet e para të lagjes nr. 5 me rreth një mijë e pesëqind banorë ishin derdhur aty dhe u nisën në këmbë. Një kolonë tjetër doli nga varrezat e dëshmorëve. Kishte marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të eshtrave të dëshmor Hasit. Kolona u zhduk tej kodrës për në qytezën e vjetër.

Një grup skodash të ndërmarrjes së ndërtimit erdhën e qëndruan në stacion. Vullnetarët që ishin aty u hodhën mbi karroceri. Besimi zuri vend në njërën prej tyre. Pas dy-tri minutash skodat ishin plot e përplot dhe shoferët kontrollonin e thërritnin, duke prekur spondet. Pranë Besimit u ngjesh një vajzë e re bojalleshë dhe e bukur, që i hodhi një vështrim të ngrohtë. Si u panë një çast, ajo u skuq pakëz dhe buzëqeshi lehtë. Buzët i kishte të thara e të ashpra e binin erë mjaltë. Cullufja e flokëve gështenjë i binte mënjanë.

— Më fal, Bes! — tha ajo. Ishte vajza e kompresorëve, Delina, që Besimi e njihte që kur i kishte vdekur i ati dhe e kishin futur në uzinë punëtore te kompresorët. Besimi i buzëqeshi dhe u përpoq të shtynte e të

hapte vend për të, po nuk qe e mundur. Trupi i Delinës mbeti ngjeshur pas tij.

— U bëmë sardele, — tha ajo me gaz. — As në mbrëmje vallëzimi nuk të kam pasur kështu. Të kujtohet? Kemi kërcyer njëherë bashkë...

Besimi e shikoi dhe pa se sytë e Delinës ishin të butë si kadife. Ata u ulën qetësisht.

— Do të kërcejmë përsëri, — tha. — Unë e mbarova shkollën, Delinë.

— E di, — tha vajza. — Nëna më ka pyetur vazhdimisht për ty. Edhe në uzinë kam dëgjuar se flitet shpesh. Ty të duan të gjithë te ne në uzinë.

Makinat qëndruan në hyrje të qytezës së vjetër, aty ku kishte qenë xhamia dhe tregu i gjësë së gjallë. Besimi zbriti. Priti që të afrohej Delina dhe i dha dorën të zbriste. Ajo u hodh dhe ai u detyrua ta priste. Turma qëndroi në të dy anët e rrugës. Këshilltarët popullorë thërritnin dhe grumbullonin banorët për t'i çuar në frontet e punës.

— Do të vish në uzinë? — e pyeti Delina, ndërsa po i shtrëngonte dorën.

— Do të vij, si joi, — i tha Besimi dhe pa se në sytë e butë si kadife ndriçoi një ndjenjë gëzimi. U ndanë dhe ajo shkoi te banorët e bllokut të vet.

Në qytezë po punohej për shembjen e ndërtesave, tërheqjen e lëndës së drurit, të gurëve, tullave, tjegullave. Motosharrat po pritnin plepat, panjat dhe akaciet e sheshit kryesor. Të tjerë, me ndihmën e një «Zisi» dhe të një Karkaleci çrrenjosnin pishat me dheun e rrënjëve dhe i ngarkonin e i nisnin për në qytetin e ri. Aty-këtu grumbuj kureshtarësh rrinin e vështronin si punonin të tjerët.

Besimi u soll ca mes gjithë kësaj që po ndodhte përpara tij me një mendim që i rëndonte në kokë: kjo qytezë mori fund! Rrugëza përpara shkollës ishte zhveshur. Plepat ishin prerë dhe transportuar, pishat ishin shkukur. Në vend të tyre kishin mbetur gropa si gjurmë bombash dhe dheu e gurët ishin hedhur pa rregull sa andej-këtej. Edhe më lakuriq dhe e mjerë dukej rru-

ga nga kishin qenë dyqankat e dikurshme të privatëve. Lakuriqësia e saj kishte diçka të neveritshme dhe ai u largua menjëherë.

Kërkoi edhe ca mos shikonte Dritën ose Dianën. Po as brigadat e komunales dhe as Diana nuk dukeshin kund. Në oborrin e shkollës tetëvjeçare mani i madh ishte copëtuar dhe një teknik u tregonte përmasat punëtorëve. Druri i manit do të nisej për në një punishte artistike. Në anë të shkollës kishin prerë pa rregull mollët. Atij iu kujtua mësuesja plakë, e vetmja mësuese në të gjithë krahinën përpara Çlirimit. Dy mësues të rinj, ai i historisë dhe ai i letërsisë sillnin fidanet aty te gropa, Besimi dhe një vajzë mbanin fidanin drejt, kurse mësuesja e vjetër hidhte grushtin e parë të dheut. Kjo gjë shkaktonte gaz dhe ata qeshnin të gjithë. Mësuesja nuk jetonte më. Mësuesit e tjerë ishin larguar që andej. Besimin e pushtoi një ndjenjë dhimbjeje. Ndoshta ishte malli i largët për fëmijërinë.

U largua andej dhe doli në qendër. Pranë bustit të Skënderbeut ishte një grumbull i madh njerëzish. Ai dëgjoi zërin e zemëruar të lartë të së motrës. Aty afër saj dalloi trupin e gjatë të Jeton Druvarit. Pak më tutje ishte drejtori i përpunim-drurit.

— Mos guxoni të prekni asnjë pemë këtu, pa larguar bustin, — thirri Drita. — Do ta filmojnë, pastaj...

Besimi dalloi mes grumbullit shumë nga punëtorët e komunales që kishin lënë punën dhe po merreshin me bustin e bimët e zbukurimit. «Lëre lëre, — mendoj, — po e paska seriozisht këtë punë kjo motra ime!» Punëtorët e komunales, që i rrinin pranë, e mbështetnin, flitnin e kërcënonin jo më pak se ajo.

— Po s'e bëjnë sot këtë punë, i bëftë mirë komunales, — tha njëri nga sharrëtarët dhe iu afrua trugut të plepit aty afër.

— Mos! — thirri Drita. Zëri i doli si një klithmë. Vrapoi atje dhe e shtyu punëtorin që ishte përkulur e po i vendoste sharrën afër rrënjës. Tre veta nga ata të komunales, sa hap e mbyll sytë, ia rrëmbyen atij moto-sharrën nga duart, ende pa u ngritur nga trotuari.

— Lërini marrëzirat, — tha drejtori i përpunimdrurit i mërzitur. — Pa largohuni ju tanët! Ku janë ata të filmit? Po ata që do të tërheqin bustin? Djalli e mori punën, ç'po bëhet kështu?

Sharrëtarë që shtyu Drita, po turfullonte. Ai ishte tepër i dobët dhe zemërak i madh. Ishte zverdhur dhe këputi ca të shara.

— Ti i ke fajet, — i tha drejtori Jetonit. — Ku dreqin i ke ata kineastët e tu? Hë! Deri kur do t'i presim?!

Ishte e qartë. Drita merrte pjesë në atë sherr për Jetonin. «Hajde, motër, hajde, — tha me vete Besimi, — ti interesohesh për bustet e gjalla...»

— Tërheqja e busteve është lënë për në orën një, — i tha Jetoni drejtorit. — Para orës një të mos pritën as plepat, as panjat.

Ashtu u bë.

Emiri qëndronte ndenjtur, mbështetur mbi të dy bërrylat. Diana në këmbë, pranë raftit. Karrigia e Kallushanit kërciste nga pesha, sa herë që ai fliste. Kup-tohej se edhe vetë nuk e kishte për zemër fejesën, po nuk tërhiqej, si njeriu që e pranon fatkeqësinë dhe mësohet me të.

— Baba, po e patë të arsyeshme, dal unë në stacion dhe u them Sojllinjve nga majat thembrat, — tha Emiri. Kallushani shikoi ballin e madh e të lartë të të birit dhe tha me zë të ulët e lutës:

— Në asnjë mënyrë! Nuk lëpihet ajo që pështymë. Pastaj, mendohu edhe vetë, bir. Kjo do ta çonte babën Brah në varr...

— Asgjë nuk ndodh, baba, asgjë! — tha Diana.

— Ti rri aty, mos m'i zgjo dreqërit.

— Po kjo është jeta e Vjedës, baba, nuk është lojë goglash. Këtu nuk është thjesht fjala e babës Brah sesa sedra e fisit... Për sedrën e fisit ne sakrifikojmë Vjedën...

— Kallushanit i hipi gjaku në kokë, pastaj erdhi e u

bë dyllë i verdhë. Shtrëngoi grushtin që mbante mbi tavolinë, u stërmundua që të fliste me zë sa më të ulët.

— Edhe mbrëmë kështu më fole, — i tha Dianës. — Ç'e pandeh ti sedrën e fisit? Dashuricëkat janë më mirë? Prandaj më mbete si dopiogjashta në derë. Na u bërë njëzet e gjashtë vjeç me këtë dinjitetin tënd... Apo... — ai u ngrit, u afrua te garderoba, ndërsa Diana, bërë shafan në fytyrë nga fyerja, qëndronte me mundim, ndonëse gjunjët po i pritëshin. — Apo u prish radha? Mos duhej të të fejoja ty me atë artistin e Sojllinjve?! — Kallushani shqeu sytë si përpara dritës dhe iu kthye Emirit. Ky ishte ngritur në këmbë, truplantë e i drejtë, mbuluar nga djersët e bërë prush në fytyrë.

— Përse e fyen Dianën, baba? — i tha me zë të qetë. — Këto nuk i meriton Diana... — Ai u afrua pranë motrës dhe i vuri dorën në sup. Ndjeu se ajo dridhej. Buzët i ishin holluar, tharë e tendosur, tek i kafshonte lehtë, ndërsa sytë i shkëndijonin, por nuk qante.

— Unë nuk e kam fjalën për veten, po për Vjedën. Vjeda është motra ime dhe kam të drejtë ta them fjalën. Unë nuk e kam hallin e radhës. Për radhë, për hair i qoftë! Le ta marrë. Unë jam e një mendjeje me ju. — U shkëput me rrëmbim dhe doli nga dhoma. Nga pas ajo dëgjoi zërin e Emirit që po grindej me t'anë.

Tringëlliu zilja e kecape te porta e oborrit. U dëgjuan thirrje të gëzuara fëmijësh: «Krushqit! Erdhën krushqit!» Lëvizja që e madhe, përfshiu çdo nerv të fisit. Po vinin Sojllinjët! Në odën e madhe u liruan vendet. Të gjithë pritnin në këmbë, me përjashtim të plakut Brah që veç mbushi llullën dhe Memishit që tha: «Send apo gja, erdhën domethanë.» Ai përpëliti sytë nën ballin e tultë dhe bëri një mundim të madh derisa u ngrit. Dy veta e ndihmuan që të qëndronte. Ai hapi këmbët e trasha dhe tha me gaz përsëri: «Send apo gja, jam njëqind e shtatëmbëdhjetë, jo shaka.» Përpara printe një plak shkurtaq, tepër i shkathët për moshën, veshur me tirq

dhe këpuçë të reja. Pas tij dy burra të gjatë, vrarë lie, me fytyra të rreshkura nga era e nga dielli. Të dy nuk dukeshin më shumë se dyzet e pesë-pesëdhjetë vjeç. Fill pas tyre vinte Behari, veshur me kostumin e hirtë prej teritali. Ishte i gëzuar sa i ndrinte fytyra e flashkët. Ai shtrëngonte në duar një valixhe të madhe ngjyrë portokalli, ku ishin ngjitur sytë e tërë fisit.

— Marhaba! Marhaba! Marhaba! A je, Brah Kukaj?

— Si je, Sojlli?

Sojlliu i shkretër, mbledhur si arrë gungë, nuk e pati të vështirë të përkulej e t'i merrte dorën eshtake plakut Brah. Pastaj zuri qoshen përballë. Sytë e Brahës u gjallëruan ca, pastaj u fshehën përsëri. Beteja e parë ishte për Kukajt. Nën atë gjallëri sysh si të futur në kafkë lexohej: Peja, Sojlli, peja! «Dhe tjetri: «Për moshë e për emën po të përkulem. Mos u ço, mos lëviz!» «Për emën e për moshë! Për emën e për moshë...» «Ani!» «Liromë rrugë, burrë, mos diskuto. Sojllinj quheni, jo Kukë.» «Sojllinj, Sojllinj,» flakëruan sytë e njerit nga të dy burrat që po i dukej vetja kreshnik, lindur mes zanave. «Dreqi ua vu atë emën. Ne vërtet Kukë quhna, po pej nesh a stisë ky ven qi perënia e madhe po e dënon me përmytje.» «Ju jo! Jo ju. Veg emnin keni Kukë, asgja ma shumë. Shkretë e keni emnin. Sa Kukë e magjarë buzëbardhë qi ka...» «M'ke ra n'tym. S'po e baj tërkuzë. Zene, zene venin qi t'takon, se qe tu zot shpie jam veta.» «E di. Qe tu m'ke zanë.» «Aherna, me qi t'kam zanë, rri pra, se gjithnji kam pasë t'drejtë...»

Këto nuk u thanë mes Brahës e Sojlliu, por u ndien nga të dyja palët. Sidomos dy burrat vrarë lie, të cilëve veç pushkët u mungonin që të besojë se po ktheheshin nga gjëma e gjakmarrjes. Rrinin e dëgjonin pranë shkurtaqit dhe vinin dorën në zemër për cigaret që u hidheshin nga të katër anët. Para secilit u bë një piring cigaresh të të gjitha markave. Vetëm Behari shikonte me bisht të syrit valixhën ngjyrë portokalli aty afër. Jo rastësisht ajo ishte lënë mbi sepetin e nxirë nga koha të plakës Rashë te këndi, pas shpinës së Memishit. Behari kishte qëndruar në fund, se kështu e donte rregulli. Kjo donte

të thoshte se dhëndri po pastronte një pleh prej shtëpisë. Prandaj, atje në fund të odës sa më afër opingave.

Erdhën pijet. Gotat ishin mbushur sa nuk mbanin më. Derdhja e tyre në faqen e tabakasë ishte shenjë bereqeti, pavarësisht se në Kukaj nuk mbillej e nuk korrej prej kushedi sa vjetësh. Përsëri u shpërnda një sërë cigaresh, por tani nga Sojllinjët. Në fillim plakushi, pastaj njëri nga kapadainjtë që rrinte tërë sy e veshë se mos e thumbonte kush me ndonjë bendë. Pastaj i treti, trimi. Behari nuk shpërndau cigare, se nuk e lanë.

Po bisedohej vetëm me plakushin. Dy «kreshnikëve» më të rrallë u hidhej ndonjë fjalë. Behari nuk përfillej fare, sikur të mos ishte gjallë. Mbi kokën e plakut Brah ishte një kornizë e zverdhur dhe e vjetruar. Në të skema e diagrame tepër të rregullta në letër kalk. «Gjenealogjia e fisit Kukaj ndër brezni.» Në fillim ishte vetëm një emër. Pesë shigjeta nën të dhe pesë emra të tjerë. Pastaj secili emër lëshonte tufa shigjetash e secila prej këtyre tufëza të tjera, ashtu siç ndodh në një reaksion molekular. Po ky ishte një shpërthim mbi kokën e plakut Brah. Shpërthimi niste atje mbi kokën e tij drejt njerëzve që mbushnin odën. Dukej sikur kërcënonte gjithë ata që ndodheshin aty, pastaj odat e tjera, kuzhinat, bodrumet, oborrthin, lagjen, rrafshinën e shkretuar...

— Epo, izëm se na zuni dreka, — tha plakaruqi i Sojllinjve.

— Drekën që tu, — tha prerazi plaku Brah.

— Njihërë qetër. Robt na presin. Do rrugë e kena...

— Si koftë thanë, u baftë! — u tërhoq Braha. — Meqi perënia e madhe bani ymër me përzi zjerrmin, gjakin, bukën, në shpinë tuej jeni, hej burrë.

— Kjo kullë shtruve e ka pasë sofrën denbabaden...

E gjithë kjo bisedë për drekën e krushqve, pa hequr e pa shtuar asnjë presje, mund të jetë bërë tamam këshu, që kur Lekë Dukagjini i rreptë krihte mustaqet në pasqyrën e madhe, përpara se të hynte në një gosti fejesë. Ishte përsëritur brez pas brezi dhe miqtë nuk kishin qëndruar për drekë, kur rruga ishte e shkurtër, se nuk parashkruhej me të zezë në kanun.

Sojlliu ua krehu bishtin edhe ca Kukajve, duke treguar meritat e fisit, përdori atë gjuhën e rreshterëve të vjetër ndaj kapitenëve të tyre. Pastaj ai heshti ca, priti që plaku Brah ose i biri, Kallushani, t'ua kthente borxhin, duke treguar meritat e fisit të Sojllinjve. Po finoku Brah këtë radhë bëri sikur nuk dëgjoji dhe ia la lugën thatë krushkut të ri. Të gjithë ia ngulën sytë, kur Braha hapi gojën:

— Të vijë! — tha. Kjo fjalë çudibërëse i lëvizi të gjithë sa ishin aty, lëvizi djemurinë te dera, te kthina, në oborr. Kallushani doli. Të vijë! Urdhri i Babës Brah: Të vijë! Urdhër qiellor: të vijë! Urdhër djallëzor: të vijë! Zeusi, Buda, Junona, Krishti, Muhameti, baba Brah thoshin njëzëri: Të vijë! Të vijë Vjeda! Të vijë Vjeda!

Në oborr u bë pështjellim, zhurmë, pëshpëshe nervoze, të qeshura.

— Duhet të vijë Vjeda për shpërndarjen e llokumeve. Kjo është shenja e pranimit të dashurisë, — tha dikush.

Një zhurmë e mbytur tej mureve të odës. Braha zgjati dorën eshtake me një paketë cigare. Hatibi i shpejtë e rrëmbeu dhe nisi rritin: Nga baba Brah! Nga baba Brah! Nga baba Brah!

Zëri plot protestë i Dianës. Pastaj heshtje. Ca mër-mërime: Merre! Merre! Te dera u duk tabakaja e madhe, dy duar, Vjeda e zbehtë, e bardhë si letër. Nën sytë e kaltër vajzërorë dy rrathë të zinj. Të gjithë i lëshuan rrugë duke u ngjeshur pranë mureve, sikur aty të kalonte Eva, Havaja, Athinaja apo shën Mëria. Po kjo ishte Vjeda, një Dianë pak më e vogël, më e njomë, e mbytur në trishtim. Përkuli pak trupin e brishtë përpara Sojllit. Plakushi mori llokumin. Pastaj Vjeda ua ndehu dy «kreshnikëve» që po zgurdullonin sytë. Po edhe «kreshnikët» na i hakan llokumet. Kot thuhej se «kreshnikët» ushqeheshin me erën. Eh, nuk janë aq budallenj «kreshnikët» sa të mos hanë llokumet nga dora e një vajze të re e të bukur si drita. Ku janë zanat e shtojzovallet përpara Vjedës?! Për hair! Besimin e mori gazi

duke shikuar dy Sojllinjtë. Vjeda vazhdonte, ndërsa urimet e ndiqnin pas.

I erdhi radha Beharit. Gjithë sytë e odës u mbërthyen aty. Besimit i mbeti llokumi në dorë. Behari u turbullua. Fytyra e flashkët u ngrit tërë gaz. Ishte një gaz që s'kuptohej.

Po ja, rregulli u prish. Vjeda ngriti kokën, ia nguli sytë me egërsi Beharit, sa tjetri u fik e u rrudh menjëherë.

— Merre, — tha ajo me zë të lartë. — Për këtë ke ardhur... Merre! Po në botë kambana bie për ata që kanë veshë. — Beharit nuk i shkoi zëri. Ai nuk e tori fillin. Në gjithë jetën e tij çdo gjë kishte vetëm fillim, por jo pikëmbërritje.

— Epo llokumin e hanë të gjithë, — tha Behari. — Edhe unë si të gjithë... — Se si i dolën këto fjalë, si i tha, përse i tha, ç'kuptim kishin, ai nuk e dinte. Ngriti dorën, shkundi miellin e llokumit dhe e futi në gojë. Te kthina shpërtheu një gaz i papërmbajtur.

— Bir, ban zahmet dhe hape arkën, — i tha Beharit plaku i Sojllinjve për valixhen. Behari e vendosi në qendër të odës mbi sixhaden e bukur, endur nga Vjeda. Tani të gjithë shikonin lëvizjen e duarve të Beharit. Dhuratat! Dhurata e parë — Brahës! E dyta — gjyshes Rashë! E treta Kallushanit. Nënës Sanije. Pastaj me radhë. Radha ishte e gjatë dhe valixhja e madhe. Kuptohej, në të nuk kishte veç një unazë, një varëse e një orë. Jo! Kurrsesi kjo nuk ndodh. Llogaritë ishin bërë mirë mes Hatibit dhe Beharit. Ishin bërë një më një. Kot nuk kishin caktuar «ekonomistin» Hatib.

Beharit po i dridhej dora. Nuk e gjente dot vrimën e çelësit. E kishte vendosur së prapthi, ose në tufë nuk ishte çelësi përkatës. Njëri nga «kreshnikët» turfulloi si cjav i egër. Sikur të mos e donte puna që valixhen ta hapte vetë Behari, oh, si do të ngrihej ai faqe burrash dhe ta bënte fërtele atë valixhe të verdhë në ngjyrë portokalli. Po ç'tu bënte rregullave të reja që e sollën Beharin këtu! Ja, Behari e gjeti më në fund vrimën e çelësit. Kapaku u ngrit. Sytë e të gjithëve mbetën mbi be-

zen e bardhë, të trashë, nga ato që përdoren për qefin. Behari, i tunduar nga vështrimet dhe heshtja, as që kujtohet se në valixhen e vet nuk ka pasur beze të tillë. Ai e heq shpejt atë... dhe ja! Përpara del «mrekullia»! Fusha e valixhes është mbushur plot e përplot me kafka njerëzish. Ca janë të mëdha, ca të vogla, ca me dhëmbë, ca pa dhëmbë, ca të bardha, ca të verdha, por të gjitha të vjetra sa historia e tumave. Mbi bardhësinë e tyre janë ngjitur ca rripëza letre me numra të ndryshëm.

— Tobe! Tobe! Tobe! Ptu! Ptu! Ptu! — mallkoi dhe pështyu plaku Brah.

— Ja allah! — shfryu plaku i Sojllinjve.

— Xhit a qe shtu, bre? — tha njëri nga «kreshnikët». Tjetri u zverdh dhe u nxi. Kërciti dhëmbët. Njerëzit të hutuar, ngrinë. Tani mes tyre kishte hyrë vdekja e gjithëpushteshme. Mes gjithë kësaj disa këmbyen vështrime.

— Kjo është valixhja e arkeologut, — tha dikush.

Behari u ngrit në këmbë, u hodhi një sy të gjithëve dhe thirri:

— Hutaq i poshtër! Batakçi i mallkuar! Varrmihës i pabesë! — U kthye me vrull, mori këpucët dhe doli si furtunë, ndërsa valixhja me kafka qëndronte aty.

— Borxh s'jua patëm, or Sojllinj, — tha plaku Brah. — Për shej miqasie na sollët kafkat e Sojllinjve të parë... Tobe!

— Veç një zot e merr vesh, — tha plakushi i zënë ngushtë.

— Tonat s'janë, — tha më i riu nga të dy Sojllinjtë.

— As tonat! — tha prerë Hatibi.

— Aherna merrni e hidhni në lumë. Neve s'ka ç'na duhen, — tha plaku Brah.

— Kocinjtë s'janë tonat, — përsëriti kreshniku. Besimi pa se nga fytyra e tij ishte tretur e nemitur ai foddullëku i parë.

— Merrni, merrni me vete. Ju i sollët... — tha plaku Brah. Kjo do të thotë se çdo gjë mori fund. Shenji u prish. E si mund të kishte shpallje fejesë pa shenjin?

— Këto janë punë shkencore të një arkeologu, — sqaroi Emiri. — Duhet ruajtur me kujdes...

— Epo, ndjesë! — tha plakushi i Sojllinjve. — Në e paçim djalin shëndoshë, shenjin e sjellim dhe fejesën e shpallim edhe një herë tjetër.

— Miqasia mbetet, — tha Braha. Kallushani që deri atë çast ishte mpirë, tani u vrenjt e u nxi, po nuk foli. Edhe Emiri e shikoi gjyshin, sikur donte t'i thoshte diçka, por nuk foli. Ai seç i tha Dianës. Sojllinjtë po çoheshin. Plaku Brah tundi kokën, por askush nuk ia pa sytë e fshehur, se lëshoi një tymnajë të bardhë nga llulla.

Në oborr një vajzë po u tregonte të tjerave se shenji i Sojlliut kishte përfunduar diku në një muze.

KAPITULLI I GJASHTË

Besimi u ngrit vonë nga gjumi. Nënë Vasha dhe Drita kishin ikur në punë që në orën gjashtë. Ai dëgjoji kollën e t'et dhe u ngrit. U kujtua se në orën shtatë duhej të gjendej në komitetin e partisë te sekretari që merrej me kuadrin. Do të merrte detyrën për periudhën e praktikës.

Kishte bërë një gjumë të shqetësuar e plot ëndrra. U vesh shpejt e shpejt dhe u rrua, megjithëse duhej t'i përgjigjej plakut që interesohej për punën e re. Besimi ende s'po e merrte vesh të atin në kishte dëshirë që ai të fillonte një punë të re apo të mbetej në uzinë.

Nga nxitimi u pre në dy vende. Tani e ndjeu edhe ai shqetësimin e emërimit. «Vërtet, ku do të më caktojnë? Ë?» — tha me vete dhe shikoi në pasqyrë fytyrën pakëz të zverdhur. «Kam fjetur keq,» — tha me vete. U la dhe u afrua te tavolina. Nëna e kishte mbuluar mëngjesin me peceta.

— Ha diçka, — tha plaku. — E ke të ngrohtë.

— S'kam kohë. Në shtatë duhet të jem atje.

Hekurani nuk foli, por Besimi e ndjeu shikimin e tij derisa doli. «Pret lajmin tërë merak,» — mendoi dhe zbriti shkallët me nxitim.

Në sheshin para komitetit e priste Andrea Rajta. Ishin thirrur të dy. Andrea, sa e pa, i bëri me dorë të shpejtonte.

— Qenke mahmur, ç'ke kështu?

— Jo. Pse?

— Bes, takova atë artistin, Sojlliun, — Andrea qeshi.

— Kishte marrë autorizimin e banesës. Punën e kishte

rregulluar me ata të bashkimeve profesionale në një klub diku në ndërmarrjet ekonomike të qytetit. Ishte i gëzuar. Ç'u shkon grurë ca njerëzve...

— Je në vete? Dje ai humbi nusen, motrën e Diana Kukajt... — Andrea e shikoi mëdyshas.

— Humbi nusen, the? Ca njerëz si ai thonë: Kryet shëndoshë, pa qeleshe gjejmë përsëri. S'është çudi që nusja për të ka qenë trampolina për të kërcyer nga fshati në qytet. Po ti ç'ke? Nuk të shikoj mirë. U takove dje me Dianën?

— Sikur s'kam fjetur mirë natën, — u përgjigj Besimi.

Te Vasil Kushta ishte një instruktor dhe ata pritën ca. Besimi ndjeu t'i rrihte zemra dhe ta pushtonin emocionet. Shokët e tjerë që kishin mbaruar shkollën e lartë të partisë, i kishin dërguar nëpër kooperativa bujqësore, në ndërmarrje ekonomike dhe në pushtet. «Po mua?» — mendoi.

— Dje gjithë ditën kam shëtitur me djalin, — tha Andrea. — Gruan e kisha në aksion, nëna po me punët e shtëpisë. E mora çamarrokun dhe dolëm andej nga lulishtja. E, ç'kam bërë me të...

Andrea e kishte mendjen te djali katërvjeçar. Si çdo baba ai mburrej me të.

Instruktori doli dhe ata hynë në zyrën e Vasilit. Besimi ndjeu se përsëri i rrahu zemra. Ç'është kështu? — u zemërua me veten. Unë s'kam ëndërruar që me anën e shkollës të zë diku një karrige. Po përse më ndodh kështu?

Vasili ishte njeri i qetë, me një buzagaz në fytyrë. Ai e pyeti për plakun Hekuran, për motrën, për nënën. Ai i njihte të gjithë. Edhe Bashkimin, po, kur ra fjala për të, Vasili qeshi.

— Andrea, — tha Vasili, fare i qetë, sikur të vazhdonte bisedën e ngrohtë që kishte filluar, — tani për tani Besimi do të punojë te ju. Aty ta nisë praktikën. Ngarkojeni me detyra për problemet që dalin. Më vonë do ta tërheqim... Kështu?

E gjitha u tha kaq thjesht, sa që Besimi u çlirua me-

njëherë nga ajo që ndiente. Tani do të shkonte fill e te babai. S'ishte çudi, mund ta linin përgjithnjë në uzinë.

— Përfundimisht, pas nja dy javësh, do t'ju thërras përsëri, — tha Vasili. Ata dolën. Besimi shihte qëndrimin e heshtur e të menduar të Andreas dhe nuk e kuptonte se ç'lëvizte në sytë e tij. Një diell i ëmbël mëngjesor shkëlqente e përqafonte ngrohtësisht qytetin dhe blerimin përreth. Tymi i uzinës dilte gulshe-gulshe si bashka të mëdha leshi të larë, ngrihej lart, deri te mesi i malit. Aty shtrihej e formonte një tis të hollë, të gjatë deri tutje ku mali kërrusej dhe formonte honin e thellë.

Kishin kaluar disa ditë që kur Besimi kishte filluar punën në turnin e tretë tok me t'atin, Hekuranin. Në fillim kishte ndier lodhjen rraskapitëse të konvertit. Xhaketa bluxhins ndërronte ngjyrën që në orën e parë nga djersa. Kur kthehej në shtëpi, donte vetëm gjumë. Po nuk kishte harruar gjë nga mjeshtëria e tij si biraç, vetëm se muskujt kishin pushuar një kohë të gjatë dhe tani iu desh pak sforcim t'i tendoste si dikur mbi shufrën e gjatë prej çeliku. Godiste me tërë fuqinë, zhbllonte ajrin nga metalina, ndërsa djersët rridhnin çurg. Si kaluan ditët e para, ai u mësua. Djersitej më pak. Muskujt e shpinës, të duarve e të belit nuk i dhembnin më. Tani e ndiente veten më të lehtë.

Atij i dukej se i ati bluante diçka. Vetëm i kishte ardhur keq që e shikonte duke punuar si biraç tani pas mbarimit të shkollës. Ndoshta e lëndonin vështrimet e mjeshtrit Frrok apo të diemve që bënë shaka e qeshnin me Besimin. Apo kishte ndonjë hall tjetër?

Po Besim Përdriin e ndiente veten zot, si në shtëpinë e vet aty mes shokësh. Përsëri u mësua me shufrat e celikta të konvertit, përsëri dilte tërë gaz pas dyorëshit për të rregulluar majat e shufrave me varenë e madhe ndër duar, ndërsa i ati me mjeshttrin Frrok e shikonin dhe diç flisnin për të. Përsëri syri i tij i kapte ngjyrat

e flakës dhe i dallonte në kohë: edhe të verdhën, edhe të hirtën, edhe të blertën dhe u tregonte fazën e përpjekjes së metalinës. Kur mjeshtrit tok me të atin pohonin me kokë, ai ndiente gëzimin e nxënësit përpara mësuesit në provime. Ai ndiente krenarinë e parë që nuk kishte harruar gjë nga profesioni: Vetëm në disa ditë ai arriti të përcaktonte edhe pikën e pjekjes, atë pikë kritike që vetëm syri i mjeshtrit të mësuar gjithë jetën di ta dallojë. Edhe me fërshëllimat e konvertit, kur e godiste me shufër në syrin e zjarritë, u mësua. «Tani, — tha me vete, — unë vërtet jam zot këtu.»

Një natë, dy orë pasi kishte filluar turni i tretë, Besimi pa të atin që ngjitej për te furrat, ngadalë e i kërrusur duke u mbajtur fort pas anës së shkallares metalike. Ai shikoi furrën nr. 2, diç bisedoi me një metalurg dhe u ul po aq ngadalë. Atje lart diçka po ndodhte. I ati u ngjit edhe një herë tjetër. Besimi ia nguli sytë, kur ai po zbriste, po plaku kishte humbur në të vetat. Nga fytyra e vrarë e t'et ai mendoi se nuk donte të fliste. Edhe një herë tjetër plaku u ngjit po aty.

Kishte kaluar mesnata dhe nga furra nr. 2 nuk rridhte metalinë. Ndoshta plaku kishte pikasur diçka, por nuk ishte i sigurt dhe nuk fliste. Koha e zakonshme e metalinës kishte kaluar. Konverti gjëmonte e shfrynte nga goditjet e shufrës. Plaku e bëri edhe njëherë atë rrugë. Besimi e pa se si iu mblodhën ata të furrës dhe plaku u ul duke ecur si i dehur, duke shtrënguar anëzën e shkallës metalike mos rrëzohej. Sytë plot alarm i vërtiste sa te Besimi sa te mjeshtrit në kabinën e komandimit. Besimi e pa se si ai erdhi pranë platformës ku rregulloheshin kokat e shufrave.

— Bir, — tha. — atje te dyshi ka viskozitet të madh.

Viskozitetin Besimi e kishte ndier edhe në konvert, po ua kishte vënë fajin krahëve. Mendonte se ishte lodhur, prandaj e fuste dhe e nxirrte me shumë forcë shufrën, ndërsa shpimi jepte atë zhurmë të lemerishme. E pyeti të atin në mund të ndodhte gjë.

— Gjithçka mund të ndodhë. E dyta po bllokohet plotësisht, — tha Hekurani me zë të marrë. — Visko-

ziteti është aq i madh, sa djalli e di ç'mund të ndodhë. Po ti hiqi ato teshat e qullura se do të ftohesh. A e shikon si je bërë? Mbaj bluzën e lehtë dhe xhakëtën.

— Ka ndodhur ndonjëherë kjo gjë, baba?

Plaku e shikoi i hutuar. Përse i fliste ai e përse po e pyeste i biri.

— Neve jo. As Rubikut. Po kam dëgjuar se të tjerëve u ka ndodhur. Kam dëgjuar njëherë nga një inxhinier se, kur ndodh kjo, furra qulloset, kështu si sonte, dhe nuk shkrin. Metalina ftohet ngadalë dhe shkon drejt ngrirjes së plotë. Atëherë... atëherë punën e merr djalli...

Ajo do përpunim të plotë, ndërsa konvertet do të ngrohen në diell. E, po të ndodhë edhe në konverte ngrirja, duhet të porositim te kapitalistët të rinj... E di ç'të bësh ti, bir? Lëri shokët aty dhe shko e njofto kryeinxhinierin, drejtorin, Andren. Të vijnë urgjent. Shko vrap e në central.

Besimi ua la shufrat shokëve dhe u nis. Drejtori i tha të njoftonte edhe teknologun që drejtonte laboratorin. Andrea kishte qenë zgjuar. Besimi i tha se e priste Dema me makinën e drejtorisë. Kur u kthye, pa mbi platformën e furrave inxhinierin e turnit, një inxhinier elektrik dhe disa punëtorë të transportit.

Nisën diskutimet pa bukë, secili thërriste me zë të lartë, nervoz, të shqetësuar, pa dhënë dot një rrugë-zgjidhje. Edhe ata të transportit thoshin ç'të mundnin. Një xhips kërcente pupthi si xhuxh mbi gurët e rrugës. Ai u ngjiti me vrull në sheshin përpara konverteve. Prej tij zbritën Vasil Kushta dhe kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit. Makina e drejtorisë i kishte mbledhur të gjithë: drejtorin, Andrean, kryeinxhinierin. Ata u ngjiten njëri pas tjetrit në platformën e furrave.

Kryeinxhinieri Qamil Hamza tha se ky rast njihej nga shkenca, por ndodhte rrallë, prandaj as ai as shokët nuk dinin ku ndodhej defekti. Kur Vasil Kushta pyeti në e kishin literaturën që e parashikonte këtë rast të rrallë, kryeinxhinieri tha se nuk e kishin. Hekurani

ndërhyri dhe i tha sekretarit se kjo ndodhte vërtet rrallë. E përse? Ku e ka shkakun? Asnjëri asnjë fjalë.

— Po sikur të ngremë temperaturën? — tha Besimi.
— Kjo po shkon drejt ngrirjes së plotë... Ta ngremë temperaturën, qoftë edhe në një vend të vetëm...

Të gjithë shikuan djalin sikur të kërkonin aty të vetmin shpëtim për të sëmurin.

— Temperatura ka qenë 1083. — tha Hekurani.

— Kaq duhej, — tha Qamil Hamza.

— Kur kjo s'jep rrjedhë, duhet ngritur, — tha Besimi.

— Kjo është logjika e faktit. — tha kryeinxhinieri Qamil Hamza. — Kjo është një rrugëdalje.

— Sa duhet ngritur? — pyeti teknologu.

— Kjo varet nga lloji i mineralit të huaj, i prani-shëm në bakër, — tha Qamili. Fytyra e tij e hajthme tani shkëlqeu plot shpresë.

— Po me se do ta rritim temperaturën, me dru zjarri? — Fjala e mjeshtrit Hekuran Përdrini qëlloi mu në plagë. Të gjithë u shtangën. U shua edhe ajo shkëndijë që u ndez një çast më parë. Besimi shikoi fytyrën e hajthme të Qamil Hamzës. Ai ia kishte ngulur sytë.

— Po sikur të hapim me shina një vatër të izoluar aty?... Të ndezim zjarr të izoluar dhe ta nxitim me ajër. Zjarr e ajër për temperaturën në një pikë të vetme! Ndoshta nis shkrija... — tha Besimi. Ai po i fliste Qamil Hamzës, kryeinxhinierit. I foli me zë të ulët, sikur bisedonte vetëm me të, sikur donte vetëm një mendim prej tij. Qamilit i shkëlqyen sytë. Pranë tyre Hekurani ishte mpakur, tkurrur e plakur menjëherë. Ai shikonte tërë dhimbje furrën nr. 2 siç shikojmë krijesën e dashur, shtrirë në krevat, djegur nga ethet e që tashmë po ftohej në agoni.

— Mirë thotë djali, — tha Vasil Kushta. — Kjo është metoda jonë... me goditje të përqendruar. — E ç'humbe do të kemi? Si thua, mjeshtër? — iu drejtua ai Hekuran Përdrinit.

Plaku u shkund, u trand. Pa Vasilin, pa i luajtur asnjë nerv në fytyrën e mpirë.

— Ndoshta... — tha.

— Ta fillojmë menjëherë! — tha Qamil Hamza. Ai caktoi pesë nga punëtorët e transportit që të merrnin shina në sheshin përpara aglomeratit dhe ata u nisën me vrap. Disa të tjerë i nisi për afrimin e druve dhe të qymyrit. Pastaj iu kthye teknologut që rrinte si i ngrirë, i ftohtë e me një ndjenjë mosbesimi në gjithë atë që po bëhej. — Analizat të bëhen menjëherë.

— Luaj vendit, djalë! — i tha drejtori Demë Alia. — Analizat duhen shpejt. — Hekurani u afrua tek i biri pranë furrës nr. 2, i preku supin lehtë dhe i tha:

— Bir, more përsipër një punë të vështirë. — Fytyra e tij ishte e tendosur. — Ajrin do ta komandoj vetë, veç kujdes shinat... Atë vatrën hapeni me shumë kujdes. Të jetë e thellë, po jo e gjerë... Aty të bëhet, bir, gjysma e hapësirës të mbushet me qymyr. Dru mos vini më shumë se dy-tri copë, ngopi me naftë, por kujdes, se flaka do të godasë nga gryka, drejt teje... Kur ta kesh gati këtë, më bëj shenjë për ajrin. Çdo gjë do bërë me mend në kokë... Dije se, po u bë me kujdes, do të rrjedhë metalina, s'ka nga vete.

Mbi kokën e plakut binte shkëlqimi i kuqërremtë i uzinës. Hekurani u largua. Besimi e ndoqi me sy, gjersa ai u takua me një metalurg që po sillte një nga punëtorët e kompresorëve. Ata qëndruan të veçuar në platformë dhe, ndërsa Hekurani shpjegohej duke ndehur krahun drejt furrës, vajza ia kishte ngulur sytë Besimit. Ishte Delina.

I sollën shinat. Pranë furrës ishin Qamili, Dema, inxhinieri elektrik dhe grupi i mjeshtërive të konverteve. Goditjen me shinën e parë e mori përsipër vetë Besimi me mirditorin e fortë të konvertit nr. 3. Ndue Ndoi. Hekuran Përdriini shkoi te kabina, bisedoi me shokun e vet për gjendjen e flakës në konvertin e tyre dhe iku e u ngjiti përsëri te furra nr. 2. Tani kishte nisur ajo punë që kërkonte muskujt dhe mendjen, sak-

tësinë dhe forcën e veprimit. Besim Përdriini ishte tendosur aq fort pas shinës, sa dukej se qëllonte birën e konvertit dhe goditja bëhej po me atë saktësi. Hekurani ishte afruar aty ku hapej gryka e vatrës. Një djalë, metalurg i ri, qëndronte pranë grykës, vetëm disa hapa larg Besimit, shikonte viskozitetin dhe nuk lëvizte.

— Hë, po ti? — e pyeti Hekurani.

— Hiç, — tha djali.

— Si të duket?

— Keq, — tha djali dhe sytë iu mbushën me lot. Ai kishte ca tipare të bukura, dy sy të kaltër. Quhej Ylli Bregasi dhe kishte ardhur nga shtëpia e fëmijës. Hekurani e njihte se Besimi e mbante pranë, ishte interesuar për fjetjen dhe disa herë e kishte pasur për darrkë në shtëpi. Hekurani e donte djalin dhe i vinte mirë që Besimi interesohet për të.

— Ama ç'metalurg na qenke ti! Pa ndihmo me qymyr, ushqe zjarrin, atë bëj. Mos bëj si cucë, se je burrë malësie... — Plaku i buzëqeshi, i shkoi dorën mbi flokët e verdhë dhe u largua.

Mbi platformë pas Demës, Qamilit, Andreas dhe Vasil Kushtës ishin gjithë të tjerët në pritje. Nga goditjet e forta u hap foleza. Te dritarja pranë një llambe qëndronte Hekuran Përdriini me syrin e përçqendruar tek i biri. Besimi e dinte se te dritarja e hapur e kompresorëve ishte një sy tjetër po aq i vëmendshëm sa i t'et, ai i Delinës.

Si u hap foleza dhe mori formën e saj të gjatë e të thellë, u hodhën me kujdes lopatat e para me qymyr. Shtresa me qymyr arriti gati gjysmën e nivelit të folezës në gjithë gjatësinë e saj. Besimi kërkoi dru dhe naftë. Erdhën Qamili dhe Dema. Ata ishin të alarmuar. Porositën që punëtorët të largoheshin. I lagën drutë me naftë derisa u ngopën, pastaj i shtrinë mbi masën e qymyrit. U ndez zjarri dhe Besimi ngriti dorën. Hekurani doli me tërë trupin në dritaren e hapur, ngriti krahun lart dhe nisi ta ulte ngadalë, fort ngadalë. Rryma e ajrit erdhi e goditi lehtë në folezë dhe zjarri

e flaka përfshiu gjithë masën e qymyrit e të druve.
— Qymyr! Qymyr tjetër! — thirri Besimi.

Foleza u furnizua në atë masë, sa e mbushën gati gjithë vëllimin e saj, duke lënë hapësirat ku vinte ajri. Nga kompresorët ajri vinte e forcohej ose zbutej sikur ta kishin çelësin e komandimit aty në duart e tij pranë tubit. Zjarri u forcua dhe viskoziteti mori ngjyrë të verdhë. Mbi platformë grumbulli ishte i madh.

Mes viskozitetit Besimi pa një shkëndijë që shpërtheu nga metalina. «Sa e deshe temperaturën ti?» — tha me vete. Kjo ishte temperatura jote. Tani ti duhet të kesh shoqe. Pa prit...» Ai u bëri me dorë atyre që furnizonin me qymyr dhe priti që zjarri e flaka të vazhdonin në djegie. Shpërtheu një tufë shkëndijash. Ngriti krahun dhe shikoi t'atin. Një sekondë më vonë erdhi një rrymë e fortë ajri dhe shpërthimi i shkëndijave që më i madh, se ata të platformës thirrën tërë gaz. Nuk vonoi dhe vatra u shndërrua në një yll të zjarrit të madh që flakërinte. Ata thërritnin atje lart, ndërsa Besimit i rrahu zemra. Shikoi të atin me gaz dhe tha me vete: «Baba, s'do të blejmë konvert të ri te kapitalistët.» Plaku qëndronte mbështetur në parvazin e dritares së madhe, me krahët ulur, pa e hequr vështtrimin nga Besimi dhe nga gryka e folezës ku shpërthente tufa e shkëndijave të metalinës.

Besimi u thirri shokëve të sillnin përsëri qymyr dhe, si e pa që foleza e thithi të gjithin, drejtoi trupin, ngriti dorën lart dhe e mbajti ashtu. Nga kompresorët vinte rryma e ajrit dhe rritej ashtu siç duhej. Nga gryka e vatrës së izoluar shpërthyen shkëndija të kuqe, të verdha. E gjithë vatra shkëndijonte dhe në trupin e madh të uzinës ajo dukej si një sy fëmije, i bukur e plot jetë.

Besim Përdrini fshiu djersët që rridhnin çurg mbi lugun e shpinës. Hoqi syzet mbrojtëse dhe kapën. Flokët ishin qullur sikur po dilte nga banja.

— Ky zjarr duhet të përfshijë gjithë furrën, — tha,
— po kjo tani është vetëm puna juaj.

Erdhi teknologu. Ai kishte vrapuar dhe mezi merрте

frymë. Fytyra e gjatë, e verdhë ishte zbehur edhe më shumë.

— Manjetit! — tha. — Manjetit i poshtër! Na ka dalë manjetit.

— Si është e mundur? — pyeti Vasil Kushta.

— Ndodh, — tha Qamili. — Ndodh që pranë bakrit të nxjerrë kokën manjetiti.

— Po tani na duhet temperaturë e lartë, — tha Dema. Drejtori ishte inxhinier. Në atë uzinë e kishte nisur punën pas mbarimit të shkollës. Tani drejtonte uzinën. Ai e dinte mirë ç'punë kishte për të shkruirë bakrin e përzier me manjetit.

Ishte ora tre pas mesnate. Kishte nisur puna dhe ishin hapur edhe tri vatra të tjera të izoluara. Në vatrën e parë kishte nisur rrjedha e metalinës. Nga platforma përballë saj asnjëri nuk ishte larguar. Kur nisi të rridhte rregullisht metalinë, Besimi u largua nga furra dhe shkoi te shokët në platformë. Sytë i digjnin, veshët i ushtonin. Andrea ishte mes grumbullit të madh. Pranë tij Besimi pa sekretarin e parë të rrethit dhe kryetarin e komitetit. «Po këta paskan ngritur gjithë udhëheqjen,» — tha me vete. Pak si mënjane turmës ai pa Jeton Druvarin, Sali Kallinin dhe korrespondentin e ATSH-së. Ata dukeshin me sy të përgjumur dhe shikonin grykën e furrës ku ishte hapur vatra e zjarrit të izoluar. Rrjedhja e metalinës kishte nisur të zbriste ngadalë si një shirit flakërues i artë.

Besimi pa te dritarja, po i ati nuk ishte më aty. Ajri nga kompresorët vinte normal dhe dukej se çdo gjë kishte kaluar. Nga platforma e sipërme e furrave u larguan sekretari i parë, kryetari me Demën dhe Andrean. Puna po vazhdonte me të tjerë, ndërsa furra po zhblllokohej tërësisht.

Ylli Bregasi erdhi përsëri te platforma e konvertit dhe sillej sa andej — këtej. Siç kuptohej donte të thoshte diçka. Besimi e pa dhe i tha ta ndihmonte në ga-

titjen e shufrave. Ylli mori njërën, e pa me vëmendje, pastaj ia nguli sytë Besimit.

— Bes, — tha ai, — shoku Vaso të quajti «kirurg i metalurgjisë». Në të vërtetë këtë e tha njëri nga ata sehirxhinjtë që rrinin atje rreth e rrotull, por shoku Vaso tha: Po, vërtet, ai është kirurg i metalurgjisë.

Besimi e shikoi djalin. Ai e dinte ç'kishte bërë. Po s'ishte vetëm mundi dhe djersa e tij, po e të gjithëve.

Në orën gjashtë u ndërruan turnet si çdo ditë. Kishte rënë mëngjesi. Tutje uzinës shpaloseshin shpatet dhe kreshtat e malit të përhira e të blerta. Hekuran Përdrini, i lodhur nga kjo natë e jashtëzakonshme, pasi u kishte dorëzuar punën mjeshtrit Frrok dhe të tjerëve, u ul mbi një shinë dhe ndezi një cigare. Ylli Bregasi doli nga kabina e komandimit me xhakëtën krahëve, e pa, iu afrua dhe i foli:

— Baba Hekur, a s'po vjen nga klubi?

— Rrugën e ke të lirë, — i tha plaku pa qejf. Thi-thi cigare dhe e zuri kolla. Besimi, Ndue Ndoi trupmadh dhe grupi i biraçëve i shkuan pranë. E morën me vete dhe u nisën grup drejt klubit. Përballë tyre po vinte Andrea. E takuan mu përpara zyrave. Andrea i bëri shenjë dhe e tërhoqi Besimin mënjanë.

— Si m'i ke supet? — tha.

— Fol, ç'ke, — ia priti Besimi, — se dua ta pi kafën me ata...

— Sonte u fol shumë për ty. Më duket ta kanë vënë syrin, sidomos shoku Vasil...

— Përse ma thua këtë, Andrea?

— Ti nuk më kupton, Bes. Nuk mund ta mbaja në xhep, se këtë e dëshiroj edhe unë... Tani eja se kafën dua t'jua jap vetë.

— More Andrea, pa më shpjego një gjë... — Besimi u gjallërua dhe vuri buzën në gaz, — pashë Jeton Druvarin dhe ata dy gazetarët në platformë mes njerëzish. Po ata ç'donin, si erdhën aty?

— Kjo është punë e Yllit dhe e Qamil Hamzës.

Gazetarët, siç duket, i gjurmojnë këto ndodhitë tona, të shkruajnë. Le të shkruajnë.

Ata dolën në sheshin e madh të uzinës, ndërsa dielli shkëlqente. Te stacioni i urbanit ishte një grumbull vajzash që pritnin autobusin. Mes tyre Besimit i zuri syri Delinën. Ajo kishte vënë buzën në gaz dhe shikonte me bisht të syrit përkëtej.

KAPITULLI I SHTATË

Zilja e orës tringëlliu e papërmbajtur. Drita zgjati dorën që të shkelte butonin, pa i hapur sytë, por e gjeti me zor dhe zhurma mbushi odën. Po i duhej të çohet. Hapi sytë dhe pa e pakënaqur orën sikur ajo t'i kishte ndonjë faj. Në shtatë pa dhjetë duhej të ishte në punë. Do t'u jepte frontet e punës tri brigadave me punëtorë, pastaj kishte një barrë punë me transportin, me normat, me shembjet e reja. Duhej të ngrihej.

Mbi komodinë pa foton e madhe në një kornizë prej xunkthi. Në të dukej këndi sportiv i lojërave me dorë, mbushur me sportdashës, pranë urës në qytezën e vjetër. Në foto të gjithë rrinin ndenjtur në rrëpirën me pisha, vetëm një grup në fund të shkallëve qëndronte në këmbë. Mes tyre Jeton Druvari. Ai kishte kthyer kokën si mënjanë dhe buzëqeshte, po jo andej nga luanin femrat volejball. Vetëm Drita e dinte ku shihte Jetoni. Ja, pranë tij ishte edhe ai shkrimtari i ri, Saliu. Ai ishte i hutuar dhe diç bisedonte me një oficer, kurse Jetoni shihte Dritën dhe buzëqeshte. Se atë ditë aty ishte edhe Drita. Atëherë sa ishin njohur. Jetoni ishte dhënë shumë pas saj dhe ajo e dinte.

Sa herë e shihte këtë foto, gjithnjë i ndillte gaz e lumturi. Askush në shtëpi nuk e kishte ditur përse vajza e mbante këtë foto mbi komodinë, te koka e krevatit. Vetëm Besimi e kishte nuhatur kohët e fundit.

Mori foton ndër duar dhe e pa më nga afër. «Do të vish sot atje poshtë? Shiko sa të duash kështu, po eja poshtë, pa ta ndreq qejfin...» — tha me vete.

U shtriq. Pa orën dhe thirri: «Qyqja!» U ngrit me rrëmbim. Hodhi tutje këmishën e natës, veshi teshat e punës dhe u la me shpejtësi. Nuk kishte kohë të hante mëngjesin. Nëna kishte ikur me kohë në punë. Hekurani dhe Besimi ende nuk kishin ardhur nga turni i tretë. Në aneks mori bukë e djathë, ca domate të freskëta. Hapi frigoriferin dhe pa një pjatë plot me qofte. Mori ca e i futi në qeskën prej plastmase.

Ora po shkonte gjashtë kur ajo doli nga shtëpia.

Në stacionin e urbanit kishte pak njerëz, po asnjë autobus. Ajo llogariti me vete se autobusët sapo duhej të ishin nisur dhe deri në gjashtë e çerek kishte kohë sa të sillej një herë andej nga studioja e Jetonit. «Në fund të fundit, — mendoi, — nisem edhe me gjashtëtridhjetën.» Atëherë ajo do të nisej se s'bën, dhe në qoftë se urbani do të mbushej plot e përplot dhe te dera njerëzit do të shtyheshin. Ajo shkonte nga dera e shoferi e hapte atë, e përshëndeste sikur të ishte e shtëpisë dhe hipte lart.

U fut në rrugën mes pallateve dhe i ra studios nga fasada, ku ishte e vetmja dritare. Syri i kapi menjëherë dritaren pak të hapur dhe neonet e ndezura. U afrua. «Po këtë ç'e ka gjetur që punon me dritë që në mëngjes?» — mendoi. U zgjat te dritarja. Jetoni po flinte me kokën mbështetur në anësoren e kolltukut. Përpara kishte tavolinën e punës me baltë. Në të një njeri — figurinë sa një kukull e vockël. Atë e mori gazi. I hodhi një sy rrugës mos e shikonte kush dhe hapi derën lehtë. Studioja vinte erë baltë, terpeninë dhe tym duhani.

U afrua te tavolina e mesit. Futi dorën në qeskën e ushqimeve. Nxori qofte, dy byrekë që i kishte blerë në byrektore, dy feta bukë dhe i la aty. I shkroi dhe një copë letër, e la dhe doli jashtë.

Tani ishte e sigurt që ai do të vinte poshtë. Ajo do t'i mbaronte në kohë punët e saj me brigadat, me frontet e punës, me mjetet e transportit, me normat. Si t'i vinte punët në vijë, do ta priste. Ai sigurisht

do të vinte pas orës një e gjysmë, kur të mbaronte edhe orën e fundit të mësimit në shkollë.

Sapo shpërndau brigadat nëpër frontet e punës, Drita u largua nga qendra e materialeve të ndërtimit dhe i ra rrafshinës mes për mes. Pastaj ajo shkoi të kontrollonte punimet në njërën nga brigadat e shembjes. Puna e rrëmbeu të gjithën. Kontrollonte, udhëzonte të kihej kujdes në shembjen e mureve, në zbulimin e çative, në transportin e tjegullave e të tullave. Kontrollonte ndërtesat e boshatisura, inventarizonte dyer, kasa dritaresh, tjegulla, tulla dhe gurë. Kjo i hëngri gjithë ditën.

Jetoni erdhi me vonesë. Ajo e pa, kur ai kaloi te sheshi kryesor drejt klubit. E dinte se pas pak, si të largohej dhe punëtori i fundit dhe rrafshina të mbetej e shkretë, ai do të vinte. Dhe ai erdhi më në fund në barakëzën ku Drita kishte veç një tavolinë dhe një raft evidencash. Ajo kishte ulur kokën dhe plotësonte një pasqyrë.

— Kam leje? — tha ai tërë gaz dhe u ul në karrige. Ajo as që ia hodhi sytë. Vazhdoi pasqyrën. Kishte punë apo s'kishte punë? Të priste...

— Ato qoftet ish in të mira, veç na e shtuan oreksin, — tha ai.

— Jo, more! — Ajo e shtyu tutje pasqyrën. U ngrit dhe qeshi me zë të lartë sa ushtoi barakëza. — E di unë ç'do ti... gjumash!

Ajo vazhdonte të qeshte, ndërsa ai u shqetësua se mos vinte kush. Drita ndihej e lodhur. Ai e përkëdheli i lumtur që e kishte pranë.

Jetoni hyri në studio dhe ndjeu se ajri i nxehtë i ditës kishte mbushur sallën. Preku i shqetësuar figurat prej balte, mos ish in tharë. Prekja e tij ishte e lehtë. Siç mund të prekë njeriu kokën e një fëmije. Shpejtoi të merrte kovën dhe leckat. Dy nga figurat iu dukën të thara. Ai lagu leckat dhe i shtrydhi mbi to. Tri

të tjerat i lagu, por i la të zhveshura dhe i pa i menduar. Njëra prej tyre, ajo që Saliu ia quante «vajza kapriçioze», e kishte dorën të ngritur lart. Sytë ishin ende të papërfunduar, po ai e dinte si do të ishin ata. Gjithë figurën e përfytyronte si të gjallë.

«Dora, — tha me vete. — Kjo dorë e ngritur kështu duhet të thotë shumë. Këtë dorë të ngritur lart e kam parë me dhjetëra herë po kështu gjatë shembjes, po vetëm në dy vende kam parë atë që duhej: në shembjen e xhamisë së qafëpazarit dhe në shembjen e shtëpisë private të ish-spekulantit të dyqanit «Kinkaleri Ideale»... Jetonin e merrte gazi kur kujtonte mbishkrimin në dyqankën e ish-spekulantit. Atëherë ishte fëmijë në shtatëvjeçare. I zoti kishte gjetur belanë me fëmijët që grumbulloheshin aty dhe lexonin tabelën e çuditshme. I trembte, i kërcënonte, por fëmijët vinin si trumbë harabelash dhe qëndronin aty e qeshnin.

Drita e kishte shëmbur dyqankën duke ia hapur zgavrat brinjë më brinjë. Tamam siç ia kishte punuar edhe xhamisë.

Jetoni e la figurën e vajzës dhe shkoi e hapi albumin e skicave. Hapi një sërë skicash ku kishte Besimin, Dritën, Vasilin, Nikolla Bushin dhe «Perlën» siç e quante ai të kushërirën, Diana Kukajn.

Krahasoi skicën e Dianës me të Dritës. Drita iu duk serioze. Nga fytyra e dashur ai shikonte se mungonte buzëqeshja, gazi, butësia. «Kjo është Drita e vërtetë, — mendoi, — Drita e punës. Kjo më duhet...»

KAPITULLI I TETË

— Defekti me mineralin është në një pikë diku. Kjo duhet të jetë arsyeja që gjatë një muaji në kemi një o dy ditë mineral të varfër. Diku atje është një front që na e bën këtë lojë. Ata deri tani nuk e kanë gjetur dot. Sapo na furnizon ai front, neve na bie prodhimi. Edhe me anën e kontrollit të peshorja, ne nuk po e gjejmë dot. Mos e gjeni atje në vend... — Besimit i ishin ngulitur në kokë këto fjalë që i kishte thënë Qamili në mbledhjen ku atë e kishin caktuar në grupin e kontrollit punëtor që do të shkonte në minierë.

Që atë mbrëmje ai me dy metalurgë arriti në minierë. Në zyrat e ndërmarrjes gjetën zëvendëssekretarin e partisë, një inxhinier dhe dy teknikë turni. Zëvendëssekretari, një minator trupmadh e i mbushur, ardhur nga fshati, i priti ftohtë.

— Bukur, — tha ai, sapo e mori vesh përse kishin ardhur nga uzina, — minierën ja ku e keni. Shikojeni nga të doni, ditën dhe natën. S'kemi asnjë kundërshtim. Po pikën e shiut do ta gjeni mbi pullazin e shtëpisë suaj.

Besimi nuk e zgjati fjalën me të. U pajisën me kasa dhe llamba dhe hynë në një galeri, ku kishte punuar dikur njëri nga metalurgët e grupit. Po u pa shpejt se ish-minatori më tepër u çmall me galerinë e tij, sesa i ndihmoi për punë. Ai qëndronte vend e pa vend, prekte me dorë gurët, shikonte si i shastisur dhe nuk

pushonte së kujtuari ditët dhe netët në minierë, aq sa Besimi, kur pa se gjithçka ishte pa fryt, i tha:

— Më duket sikur këtu kemi ardhur për vizitë, jo për punë.

— Po ja, — tha ish-minatori, — ne punë po bëjmë. Po shohim dhe...

— Dhe asgjë! Dalim?

U kthyen në uzinë të nesërmen pa sjellë asnjë mendim. Kur po trokitnin në zyrat e ndërmarrjes, Besimi e hapi derën dhe pa se në drejtori ishte sekretari i parë i rrethit dhe Vasil Kushta. Ata sapo ishin kthyer nga një kooperativë bujqësore dhe po diskutonin deficitin e krijuar në uzinë. Andrea pa Besimin pas dy metalurgëve dhe i tha sekretarit të parë:

— Ja, këta janë shokët e kontrollit punëtor. Mbrëmë kanë qenë atje. Besimi u tregoi hollësisht ç'kishin bërë gjatë një turni.

— Po nga shokët e minierës ishte kush me ju? — e pyeti Vasili.

— Mos, — tha ish-minatori. — Po të ishte puna për ta, e kishin gjetur.

— Si? — Vasili ia ngjiti sytë ish-minatorit. — Po ju do të shkoni përsëri atje?

— Puna jonë s'mbaroi me një galeri, — tha Besimi. Do të shkojmë përsëri.

— U thoni shokëve atje, — porositi sekretari i parë, — që kjo punë të bëhet çështje partie. Shikojeni edhe ju me përgjegjësi partie këtë problem dhe na raportoni menjëherë. Atje le të merren komunistët, Vasil, të lëvizin kuadrot, gjithë pararoja e minierës e të mos na i lënë vetëm tre metalurgët.

Sekretarit të parë i kishte marrë fytyra flakë. Flishte pa e fshehur zemërimin. Besimit i dukej sikur ai donte të thoshte që bakri i kësaj uzine ishte i barabartë me bukën e përditshme të të gjithë popullatës së rrethit, se ajo vlerë matej me kaq e aq traktorë, kombajna, turbina që i importonim. Ai nuk tha asnjë llogari, asnjë krahasim. Po, kuptohej, nën vetullat e ulura, në fjalët plot zemëratë ndoshta këto ishin. Se-

kretarët u larguan pas pak dhe Andrea me Demë Alinë dolën t'i përcillnin. Ata të tre që mbetën, nuk folën asnjë fjalë.

Në orën njëzet e dy e tridhjetë minuta Besimi me një inxhinier miniere dhe një teknik të nëntokës po zbrisnin në deshenterinë e galerisë X. Ish-minatori dhe shoku i tij ishin me dy grupe të tjera në fronte të ndryshëm. Besimi me të dy shokët ecën rreth njëzet minuta derisa arritën në frontin kryesor të galerisë. Aty po hapeshin foletë për shpërthime. Kur u ndodhën pranë minatorëve, Besimi pa të vëllanë me Flamur Oshllanin që u dolën përpara. Ai ishte kushëri i parë i Dianës nga nëna, po trupi i drejtë prej djaloshi, lëkura ngjyrë gruri dhe kaçurrelat e zinj, i dukeshin atij sikur e largonin shumë nga Diana. Ai e takoi djaloshin ngrohtë, iu kujtua Diana, u turbullua dhe ndjeu mall. Inxhinieri dhe tekniku, që shoqëronin Besimin, kaluan në një degëzim anësor. Kishte shumë zhurmë nga pistoletat dhe ata u detyruan të flisnin me zë të lartë. Flamuri u largua dhe vazhdoi punën. Ai hoqi kasën një çast dhe kaçurrelat e zinj, qullur nga djersa, shkëlqyen. Ndërkohë Bashkimi po i fliste për të, po i thoshte se kishte një vit e pak që kishte kryer shërbimin ushtarak, se e kishte marrë punën me qejf. Ai i ktheu sytë andej dhe pa se si i fshinte djersët Flamuri.

— Kasën! — thirri Bashkimi me gjithë zërin. — Kasën! — U afrua me vrull dhe e detyroi të vinte kasën në kokë. Kuptohej që nuk e lejonte sigurimi teknik në atë thellësi, se edhe një guriçkë e vogël shkaktonte plagë të rëndë. Flamuri i buzëqeshte, ndërsa tjetri thërriste: — Përse, anarkist?! A e di ç'të gjen? Ti... Ti... Ti nuk bëhesh...

Po Flamuri as që e prishi terezinë. Rregulloi kasën, fshiu djersët dhe i shkeli syrin Besimit.

— Përse sillesh kështu? — i tha Besimi të vëllait, kur u afrua. — Ç'është kjo arrogancë me shokët? Ç'je ti këtu? Ti bërtet sikur miniera të ishte prona e babës Hekur...

— Lëri këto, Bes, këto i di vetë. Kështu i do mu shka drutë, — Bashkimi fliste i qetë sikur të mos kishte ndodhur gjë. — Pa më thuaj përse ke ardhur?

Besimi i tregoi pa qejf të vëllait qëllimin e kontrollit punëtor.

— Aha! — ia bëri Bashkimi. — Kot sillesh nëpër galeri. Ta them unë, s'keni për të gjetur gjë.

Besimi i dha dorën dhe u largua për në degëzimin anësor. Gjeti inxhinierin dhe teknikun e tok me ta shikuan edhe fronte të tjera, por më kot. Asnjë mendim, asnjë fakt. Ç'ti thoshte Partisë? Askush nuk pa as më të voglën gjë që të dëshmonte për varfërinë e mineralit. Doli nga galeritë në orën gjashtë e gjysmë tok me turnin e tretë.

Në klubin e minierës Bashkimi me Flamur Oshllanin e kishin shtruar me kafe e konjak. Ata po bisedonin kokë më kokë. Kur panë Besimin, Bashkimi ngriti kokën dhe e shikoi si fajtor me një buzëgaz dinak, kurse Flamuri u ngrit dhe e ftoi të rrinte me ta. «Po këta për pozë e bënë atë shamatë? Apo të gjitha kthehen në gota konjaku, sapo dalin? Po për mineralin ç'thonë?» — mendoi. Besimi u ul. Porositi paçe dhe verë.

— Pi, vëlla, — tha Flamuri. — Sot e ka radhën përgjegjësi i turnit. — Ai tregoi me kokë Bashkimin. Besimi hëngri në heshtje e pa qejf. Ata të dy i morën prapë konjakët.

— Unë e di ku e keni hallin ju të uzinës, — tha Flamuri. — Po ju nuk mund të gjeni gjë, edhe sikur të mbushni muajin brenda galerisë. Pikën e gjen i zoti i shtëpisë më mirë se çdo usta...

Besimit iu kujtua fjala e zëvendëssekretarit. Edhe ai i foli për pikën e shiut.

— Ti, Flamur, je anëtar partie?

— Dëgjo vëllanë, — tha Flamur Oshllani serioz e i përmbajtur, — unë nuk jam anëtar partie, po pa dëgjo këtu, këtu... — Ai zbërtheu gjoksin, mori dorën e Besimit dhe e vuri mbi zemër. — E dëgjon? Kjo rreh njësoj me tënden. Nuk ka zot mbi dhe që të më pengojë ta dua atdheun, socializmin dhe këtë minierë. E kupton? Nuk e kupton. Minierën e dua jo më pak se të tjerët... Ja, kështu është puna.

— Unë të besoj, Flamur, — tha Besimi. — Po unë dua të di, si e shpjegoni ju që ne atje poshtë shkrijmë gurë, ndërsa ju tejkaloni planin dhe mbushni xhepat. Zëri i Besimit që i rëndë, por i ngrohtë, vëllazëror. Flamuri shikoi fytyrën e nxirë të Bashkimit.

— Këto ditë, dua të them këta dy muajt e fundit, ka pasur periudha një-e dyditore që na vjen mineral i varfër dhe ne dalim me humbje. — Besimi ia nguli sytë Flamurit.

— Ka pasur, e morëm vesh që ka pasur. — Sytë dinakë të Bashkimit lëvizën ironikë: Flamuri e shikoi si për të kuptuar si e kishte mendjen.

— Po brigadën e shoferëve e keni pyetur nga cila pikë ju ka furnizuar? — e pyeti Flamuri. — Jo? Po ju s'e kuptoni se vetëm s'bëni dot gjë? Ejani sonte përsëri. Po vij unë me ju. E, si thua, Baç, të shkoj?

— Shko, — tha Bashkimi ftohtë. — Djalli e marrtë, merret vesh që defekti është diku. Po ku? Në gjithë këtë minierë... Sidoqoftë, Bes, mos na e njollosni minierën, edhe në gjetshi diku. Miniera s'ka faj, nëse ndokush na e bën borxh...

U ngritën. Bashkimi shpejtoi në banak dhe pagoi.

— Ti shko e paguaj kasën, — i tha Flamurit. — Të preva gjobën për shkelje.

Besimi nuk e kuptoi në e kishte me gjithë mend. «Çorbë e bën. Atje bërtet me arrogancë, këtu kërcet konjaku, tani shkon e paguan vetë. Do të duket bajraktari i turnit,» — tha me vete.

E ndiente se puna s'po i ecte. Të ishte vërtet një pikë diku që brigada e shoferëve do ta zbulonte? «Ndo-

shta,» — tha me vete zemërthyer. Po më shumë nuk kishte besim se mund ta gjenin.

Në orën tetë paradite ai me dy metalurgët e kontrollit punëtor hynë në zyrën e byrosë së organizatës. Të gjithë ata që ishin aty me Andrian, ua ngjiten sytë.

— Asgjë! — tha Besimi. — Do të vazhdojmë me shokët e minierës. — Fjeti disa orë dhe në orën dy-mbëdhjetë u ngjit në minierë. U takua me sekretarin e byrosë dhe i kërkoi minatorin Flamur Oshllani. Tok me inxhinierin e nëntokës, teknikun dhe Flamurin do të kontrollonte sektorët e karrierës, do të takonte shoferët në dinin gjë për rezultatet e ngarkesave të tyre dhe për frontin që jepte mineral të varfër, do të futeshin përsëri nëpër galeri. Hartoi një plan, në bazë të të cilit do të bënin lëvizjet nëpër minierë.

Kështu nisi një punë shumë të lodhshme, sepse gjatë tetë orëve iu desh të ecte e të ecte pa pushuar tok me Flamurin, inxhinierin dhe teknikun. Nga lodhja kishte nisur të pengohej shpesh, nuk kishte oreks, nuk duronte dot zhurmat e nëntokës dhe i dukej se nuk ngopej me ajër.

Kishte çaste kur Flamur Oshllani njëzetekatërvjeçar që fliste vazhdimisht me shaka, i kujtonte Dianën. Atëherë ai e ndiente praninë e djalit ashtu siç ndiejmë një rreze drite që na futet papritur në një dhomë të errët. Zëri i Flamurit dhe përfytyrimi i Dianës e shkëputnin nga ai tension që po ia thithte forcat. Njëherë, duke ecur në një galeri gjysmë të errët, Flamuri e zuri për krahu dhe i tha:

— Tani po shkojmë te «trupi monolit».

— Ç'është ky? — e pyeti Besimi.

— Janë Rametlinjtë, miqtë e mi, — qeshi djali.

— Ç'janë këta?

— Janë një degë e Kukajve. Po janë ata që rrinë në fshat. Në të vërtetë njërit ia quajnë plakun Ramë Meta, kurse këtu i thërrasim Rametlinj. Po Kukaj janë. Unë i kam kushërinj, m'i ruajttë zoti! Janë mbledhur me qiri në një pikë këtu afër. Tri turnet janë o

Rametlinj o lëng-stërlëng i tyre. Janë si diva dhe punojnë si dreqi. Gjithnjë tejkalim kanë, se në përgjithësi janë minatorë të vjetër dhe ia dinë zanatit... — Kuptohej nga toni se djali nuk i donte shumë miqtë e vet Rametlinj. Po nuk merrej vesh përse nuk hapej.

— Përse i thërritni «trup monolit»?

Flamuri qeshi.

— Erdhi njëherë një gazetar i gazetës lokale dhe u hoqi një dru për shfaqje tarafilëku. Kur u bë mbledhja e kolektivit, njëri prej tyre tha se ata ishin trup monolit, në unitet. Që atëherë të gjithë qeshin me ta. Si punëtorë mbaj inatin e jepu hakun. Megjithëse... për paranë të thajnë piten...

Besimit iu duk se tjetri u mendua ca në fund dhe nuk e kishte më gazin e zakonshëm. Ai shikonte shpinën e inxhinierit që po u printe. Tekniku i rrinte në krah inxhinierit dhe këshillohej vazhdimisht me të. Flamuri, ndoshta nga shoqëria që kishte me Bshkimin, e ndiqte Besimin në çdo hap. Tani ata po dilnin në frontin ballor të galerisë. Ishin bërë ujë në djersë. Inxhinieri qëndroi dhe po shikonte me vëmendje punimet. Për disa minuta ai nuk mori pjesë në bisedë. Mes shakave e të qeshurave ai i kërkoi teknikut të bëheshin matjet për seksionin e trupit mineral dhe të kontrolloheshin parashkimet sipas planit. Flamuri tha se këtu punimet devijonin nga trupi mineral. Erdhi teknik u i galerisë dhe u bënë matjet. Besimi ndiqte me vëmendje çdo vështrim të minatorëve, dëgjonte çdo romuz që hidhnin. Si kontrolloi përmasat e krahasoi matjet, inxhinieri tha:

— Këtu ka devijim. S'e luan as topi.

— Po ju ku i keni sytë? — iu përvesh Flamuri një minatori që punonte aty afër. — A nuk e shikoni se po i bini sterilin në anë të trupit?

— Ti shiko punën tënde, mos u përziej këtu, — i tha minatori. Ky ishte një kuqalash dërdëng e plot shëndet.

— Kjo nuk është shtëpia jote, — ia ktheu Flamuri. — Është e të gjithëve.

— A ç'më çan kokën! — Kuqalashi vazhdoi punën.

— More shoku inxhinier, e shikon ti ç'bëhet këtu?!
— Zëri plot protestë i Flamurit tërhoqi vëmendjen e të gjithëve.

— Qenka dreqi vetë, Oshllan, — tha kuqalashi, si për ta zbutur fjalën, po tani ishin hapur ruletat e po llogaritej sasia e dheut dhe e gurëve, që ishin nxjerrë ditët e fundit jashtë seksionit të trupit mineral. Përgjegjësi i turnit po i justifikojë inxhinierit, ndërsa minatorët po vazhdonin punën dhe shikonin me bisht të syrit.

— Shiko se si qeshin! Po ky është mashtrim me brirë! — shfryu Flamuri me nervozizëm.

— Oshllan, atë rrobë vishe vetë! — i tha përgjegjësi i turnit me egërsi. Ai kishte një fytyrë të ligësht, të zbehtë si prej të sëmuri. — Këtu, edhe në është bërë ndonjë gabim, padashur është bërë. Nuk ka mashtrim....

— Po ti, — iu drejtua teknikut të turnit që qëndronte kokulur pranë inxhinierit, — si e quan këtë, që një minator i vjetër t'i bjerë sterilit?

— Mashtrim s'ka! Mos ia mbyt buçes. E shumta... interesi i realizimit të planit, — tha përgjegjësi. Fytyra e zbehtë dhe e ligur dukej e zgjuar dhe si zor të mos e kuptonte atë që ishte bërë.

— S'ju kuptoj, — i tha Besimi. — Për ç'plan flisni ju, kur zgjeroni punimet jashtë planit dhe mbushni vagonat me gurë?...

— Minerali dhe sterili s'kanë gjë të prerë me thikë, shoku Musto, — iu drejtua përgjegjësi i turnit inxhinierit. — Dëshira për tejkalim, interesi, vrulli në punë kanë humbur kujdesin. Kjo po, por jo mashtrim.

— More, jeni në vete ju? — iu kthye inxhinier Mustoja. — Këtu duhen matje në dy-tri vende. Është lojë e përsëritur kjo juaja. Binak, — iu drejtua teknikut të grupit të kontrollit punëtor, — shko në zyrën time dhe merr projektet që kam atje! Shpejt! Të pres këtu!

Binaku dukej në moshë me Besimin, por ishte trup-

vogël dhe i shkathët si një fëmijë. Ia dha vrapit nëpër galeri.

— Ju aty! — thirri inxhinier Mustoja. — Ju, shoku minator, nuk më dëgjoni? Nuk merrni vesh ju se ç'bëhet? Pa lëreni punën.

— Drejt po i biem, bre burrë, — tha kuqalashi dhe qeshi me ligësi. Tërhoqi pistoletën dhe e la ngadalë përdhe. Edhe dy të tjerët, që punonin aty pranë tij, e lanë.

— Përse e bëni këtë? — i pyeti Mustoja. — Nuk e dalloni mineralin nga sterili?

— Aty na jepet, aty hapim, — ia nguli teknikut një minator i gjatë sa një katana, mustaqosh i zeshkët e që kishte dy sy të butë që bënë kontrast me kokën e madhe e shprehnin mirësi. Mustaqja e ngritur për-pjetë ndër maja tregonte njëfarë fodullëku e kokë-ngjeshjeje që binin në kundërshtim edhe më shumë me sytë e me zërin.

Të gjithë shkuan pas inxhinier Mustos nëpër traversa. Aty-këtu dallohej qartë fryrja e barkut të galerisë, tamam si një zgjerim piketash në transhenë luf-tarake. Tani ishte e qartë. I kishin rënë sterilit mbarë e prapë herë pas here.

— Ju nuk keni faj, — tha Mustoja. — Fajin e kam unë! Unë... Unë jam syleshi... Juve ju lumtë!

Arriti Binaku me projektin e punimeve në galeri. U bënë përsëri matje, përllogaritje. U kërkuan listat e sakta të përgjegjësve të turneve, të teknikëve, të inxhinierëve të prodhimit që kishin qenë aty, qoftë edhe rastësisht.

Përpara se të dilnin nga galeria, një fjalë e Binakut ishte përhapur në të gjithë minierën se grupi i kontrollit punëtor kishte hetuar sterilin të «trupi monolit». Thonë mirë, e keqja dhe era e kanë shpejtësinë njësoj. Erdhi drejtori i minierës, kryeinxhinieri, sekretari i byrosë së organizatës së partisë për minierën. Ata panë gjendjen e galerisë. Edhe mendimi i tyre ishte po ai. Ulja e prodhimit një ose dy ditore në muaj në uzinë vinte nga furnizimi me mineral prej kësaj pike.

Si dolën që andej, njoftuan komunistët për mbledhje. Organizata e partisë kërkoi që komunistët të raportonin për gjendjen në të gjitha frontet ku punonin. Pas katër orësh mbledhjeje, ata dolën me vendimin që problemi të shtrohej ndër kolektivat e minatorëve, ndër sektorë, turne e brigada.

Po Besim Përdrini nuk u mjaftua me ato që pa e ato që u bënë për t'i dhënë fund sterilit. Ai mendoi se duhej të shikonte në kuadër dokumentet e tre përgjegjësve të turneve, tre teknikëve, brigadierëve, madje edhe listat e minatorëve. Gazetari i gazetës lokale kishte dhënë sinjalin e parë për marifetet e «trupit monolit». Mos këtu burimi i vërtetë i sterilit ishte fisi, tarafi? Sa anëtarë të partisë punonin në këtë pikë? Si ishte shpërndarja e anëtarëve dhe e kandidatëve të partisë nëpër brigada e turne?

Tani për tani ai do të njoftonte Andrea Rajtën dhe Demë Alinë se u gjet defekti dhe u frenua në vend. Hollësirat do t'ua jepte vetëm pasi t'i sqaronte edhe këto pikëpyetje që i zienin në kokë.

Flamur Oshllani s'iu nda gjatë gjithë ditës. Në mbrëmje, kur po i jepnin dorën njëri-tjetrit në sheshin e uzinës, Flamuri i tha:

— Beso, s'pimë dot as një kafe tok...

Ishte hera e parë që djali e thirri «Beso» ashtu si e thërriste Bashkimi. Ai me mënyrën e tij i shfaqti dashurinë prej shoku. E Besimi pa në tiparet e ëmbla djaloshare përsëri diçka nga Diana.

— Flamur, me ty dua ta pi kafën te baca Mërgim, në shtëpi.

— Kur të duash, — tha Flamuri gjithë gaz. Ai nuk e dinte dhe s'kishte se si ta dinte që Besimi dëshironte ta pinte kafën tok me Dianën te baca Mërgim. Po ajo ishte larg, në NB-në e Pllajës, dhe zbriste rrallë. Do të merrej me «trupin monolit» të Rametlinjve dhe do ta çonte detyrën deri në fund. Pastaj do të kishte kohë të zbriste në qytezën e vjetër e, po të ishte Diana, do të shkonte te baca Mërgim me qejf.

Të nesërmen ai shkoi në zyrën e kuadrit dhe mori të dhëna për Rametlinjtë. Në krye ishin tre përgjegjësit e turneve: dy me mbiemrin Meta prej Kukajve të fshatit dhe i treti një dhëndër i tyre. Dy nga teknikët kushërinj. Pastaj vinin dajat, djemtë e tezeve. Me një fjalë ishin nga ata që dasmë e mort i bënin bashkë. Shefi i kuadrit i njihte një për një.

— Qenke usta i përsosur në punën tënde, — i tha Besimi me ironi, po shefi nuk e nuhati ironinë. Ai, kuptohej, ushqente një besim të verbër në vetvete dhe e quante me të vërtetë veten usta. Kishte një buzagaz të përhershëm që i rrëshqiste vazhdimisht mbi fytyrën e gjatë, të hequr e të rrudhur,

— I kam të mitë, — tha. — Të gjithë këta dreqër që janë pararojë e minierës, janë të mitë. I kam bashkëfshatarë. Janë punëtorë të mëdhenj dhe grijnë para me grushte...

Shefi, burrë rreth të pesëdhjetave, ish-oficer, i liruuar ngaqë ishte plagosur rëndë në një ditë me furtunë, çmohej në minierë si njeri që bënte mirë. Ai ishte nga ata që dinë vërtet të punojnë. Përpilonte me shkathtësi, me saktësi çdo karakteristikë ose informacion. Nëpër mbledhje përgjonte rastin të thoshte diçka që binte në sy, përndryshe as që e merrte fjalën. Fjala e tij ishte gjithnjë me ca fraza stereotipe, të mprehta e me interes të përgjithshëm. Këto fraza nguleshin si gozhdë edhe në mendjen më të fjetur. Kështu që të rinjtë i përsëritnin ato mbledhje më mbledhje.

Fytyra e tij thatime, e gjatë, e hequr, e tretur, verdhacuqe kishte ca zhubra gjithmonë të pastruara me kujdes të madh. Lëvizja e këtyre zhubrave përbënte lojën kryesore të fytyrës së tij. Tani balli i vizojë me rrudha të thella dhe vetullat i ngriheshin lart, tani uleshin poshtë e në faqe sajoheshin zhubra të thella, të theksuara. Sytë e vegjël, të futur thellë në

zgavrat si gropë, të vështronin gjithnjë drejt, me mprehtësi.

Shefi as që kishte dalë nga zyra të takonte ndonjë njeri në këto ditë. Kur sekretari i byrosë së organizatës i tha «mbaro punë me këtë shokun e partisë që na ka ardhur dhe eja nga unë», shefi e mori Besimin për «person» që ka punë të veçanta me të. Ai nuk e pyeti dhe vetë nuk dinte asgjë ç'kishte ndodhur me «trupin monolit», por e quante detyrën e tij të tregonte me hollësi, me fraza të sakta gjithë aftësitë e tij si nëpunës kuadri.

— Si e ke lejuar ti që të grumbullohen të gjithë nga tre, pesë e tetë veta në një turn, në një pikë? Nuk kishte mundësi t'i shpërndaje ndër galeri të ndryshme që të mos hynin si fis në marrëdhënie prodhimi e shpërndarjeje me njëri-tjetrin? — pyeti Besimi reptë.

Shefi filloi të fliste me fraza të përgjithshme dhe Besimi nuk po e ndiqte dot. Shikonte dy gisht mustaqe nën hundë që lëviznin mekanikisht sa herë që në tymnajën e duhanit dilnin fjalët.

— Ju e dini se tek ajo galeri ka plasur sterili? — e pyeti Besimi duke mbledhur fletët e shënimeve. — Ata kanë vepruar si spekulantë...

Shefit i ngriu buzëqeshja në fytyrën e zbehtë verdhacuqe. Deshi të thoshte diçka, por Besimi nuk e la. I mblodhi shumë shpejt ato fletët me shënime dhe doli duke e lënë shefin gjysmë të kërrusur mbi tavolinë.

Besimi hyri në zyrën e planit, kërkoi realizimin e fondit të pagave dhe tejkalimet në periudhat kur furnizimi ishte bërë nga galeria që kishte sjellë ulje të prodhimit. Doli andej i dalldisur, pa qenë në gjendje të përcaktonte se cilat ditë pikërisht ata kishin furnizuar me steril. Tejkalim ata kishin gati përherë.

Pasdite ai takoi sekretarin e byrosë për minierën. Ia tregoi një nga një ato që kishte parë e dëgjuar. Sekretari i tha se kishin nisur analizat në organizatat-bazë, në kolektivat e brigadat. Për tarafilëkun, farëfisninë as që u kishte shkuar mendja. Ai tha se do

të krijonin vetë disa grupe të kontrollit punëtor që të vepronin, me ditë të caktuara, ndër galeritë dhe sektorët. Tani Besimit i dukej se vërtet miniera po nxirrte nga trupi i saj diçka të tepërt. Ajo, si një organizëm plot gjallëri, po lëvizte, në çdo ind të saj.

Në muzg, aty nga ora shtatë, ai u nis në këmbë nga miniera për në uzinë. Urbani do të vonohej, kurse atë mund ta arrinte ndonjë nga makinat e transportit të mineralit. Ecte ngadalë, i lodhur e i këputur, por me zemër të lehtësuar. Thithte ajrin e freskët e të bollshëm që vinte tok me aromat e korijes pranë. Dëgjoi uturimën e një skode, pastaj borinë e saj. I lëshoi rrugë, por makina qëndroi. Shoferi i bëri me dorë të hipte. Ishte Nuza, një shofer që Besimi e njihte, burrë rreth të dyzetave, i kuq e plot shëndet.

... Andrea me Qamil Hamzën po dilnin nga zyra e kryeinxhinierit, kur Besimi u duk në korridor, Andrea ishte i gëzuar, ndërsa Qamili i ngrysur. Sa panë Besimin, Andrea thirri:

— Ku vete, mor i pahajër! Ku je, mor xhan? Pa qëndro këtu të të shoh një herë. Qamo, më duket sonte klubi ka birrë, ë?

— Si shkojnë furrat, a po del tani? — i pyeti Besimi.

— Shiko, na pyet për furrat! — Andrea ishte vërtet i gëzuar.

— Çka, — tha Qamili.

— Jo «çka», por mirë, dritë e florinjte rrjedh nga konvertet. Dielli duket që në mëngjes. Po ti, Beso, më duket qenke lodhur ca. Të shoh me bateri të shkarkuara...

Besimi vuri buzën në gaz. Vërtet ndihej i këputur dhe donte gjumë. Në klub birra ishte sosur, por kishte verë «Merlot». Vera sikur ia shkruftoi trupin.

— Andrea, nesër unë do të merrem me materialin.

Duhet të dorëzoj një material me shkrim për problemet që dalin atje, pavarësisht se me to po merret misionera vetë.

— Vazhdo. Vazhdoje punën dhe përgatite mirë materialin. Ai duhet dorëzuar te shoku Vasil. Pra, përgatite mirë e me kujdes.

Kur dolën nga klubi, ishte vonë. Ishte një mbrëmje e bukur vere, frynte erë e lehtë, e ngrohtë. Zhurmat e fushës së hapur ugar vinin të dashura e nanuritëse. Diku mes fijeve të gjelbra të barit, që po përtërihej, një bulkth i vogël ia kishte marrë këngës si zot në mbretërinë e vet aty pranë rrugës. Bulkth ishte, po zërin e kishte të ëmbël dhe ta kishte ënda ta dëgjoje.

KAPITULLI I NËNTË

Besimi arriti vonë në shtëpi, me urbanin e orës njëzet e dy. Plaku Hekuran nuk ndihej në dhomën e tij dhe Dritën e kishte zënë gjumi. Vetëm e ëma i hapi derën. Ai e kuptoi nga sytë e ujshëm e të dhembshur që ajo kishte qenë në merak. Ai u ul të hante supën. Pastaj e pyeti në kishte ujë të ngrohtë të bënte banjë.

— Gati e ka nëna, — tha Vasha me gëzim dhe shkoi t'i gatiste ndërresat e lara. Besimi e la supën. Mori një mollë, e ndau në katërsh, pastroi një rriskë dhe u largua në dhomën e tij. Mbi komodinë i zuri syri një pusullë. Letra ishte shkruar dy ditë më parë nga Drita.

*Bes, ku na humbe kështu? As me telefon nuk gjen-
desh. Të kërkoi Diana. Kishte një punë me ty. Rastë-
sisht kishim ardhur të shikonim një stof aty në dyqa-
nin e minierës, po s'gjetëm gjë. Ti ishe në galeri. Ajo më
tha se donte të këshillohej me ty. Nuk e mora vesh
se ç'hall kishte, por nuk i kishte punët mirë atje në
fermë. E mora edhe në shtëpi për një kafe. Pamë edhe
albumin. Unë ia ktheva vizitën, por jo në Kukaj. Isha
tek Oshllanët. Po erdhe sot, zbrit poshtë, se aty ka
qyfyre dhe do të çlodhesh ca.*

Drita

Kur hyri Vasha, e gjeti shtrirë mbi krevat, veshur me rrobat e punës e me letrën në dorë. Ajo shtrëngoi teshat e lara dhe u largua lehtë e me frikë se mos kërciste parketi. Te dera i hodhi edhe një vështrim dhe mendimi se ai ishte lodhur shumë, ia theri shpir-

tin. «Banjë mund të bëjë, edhe kur të ngrihet,» — mendoi.

Po ai nuk bëri dot banjë as të nesërmen. Kur i doli gjumi, shtëpia ishte bosh. Si hëngri mëngjesin dhe u rrua, u ul menjëherë në tavolinë dhe përgatiti materialin. Hekurani u kthye në shtëpi në orën dhjetë. Hyri në dhomë dhe u ul në tavolinë përballë tij.

— Ç'bën? — e pyeti.

— Ja, po nxjerr konkluzionet.

— Shiko, mor bir. Konkluzionet nxirri, po me mend në kokë. E ke marrë me vrull këtë punë më duket. Ruh, se do të thyesh qafën...

— Përse?

— I bëre lëmsh njerëzit atje... Kështu nuk të dua unë. Ruh, se do ta pësosh prej atyre Rametlinjve...

— Unë atyre nuk u kam asnjë faj, baba. Sterilin ata na e kanë dhënë dhe kanë mbushur xhepat, po nuk është halli i ca vagonave me steril, aty ka halle të tjera.

— Nuk i di unë halle e stërhalle. Di vetëm se puna do marrë ngadalë e me mend në kokë, jo yrysh e bjeri t'i biem.

Ndërkohë ra zilja dhe te dera u dha një metalurg. Andrea kishte dërguar porosi që të shkonte te Vasil Kushta brenda orës dymbëdhjetë me materialin, sido që ta kishte. Besimi u kthye, u vesh shpejt e shpejt dhe i mblodhi fletët e shkruara.

— Baba, më kërkon shoku Vasil. Porosinë tënde e kam parasysh, — i tha me seriozitet dhe me buzën në gaz. Sytë e plakut shikuan mprehtë.

Shkoi në Komitetin e Partisë dhe Vasil e priti menjëherë. Ai i bëri shumë pyetje. «Kush ishte me ty nga miniera? Kush është Flamur Oshllani? Sekretari i byrosë ç'mendim kishte? Minatorët si e pritën këtë?»

Besim Përdri doli nga sekretari me një ndjenjë që e shtypte dhe e ndrydhte. I dukej se detyrën e kishte lënë përgjysmë. «Po ç'kam lënë përgjysmë? — tha me vete, ndërsa ecte fare vetëm në rrugën e postës. Kujtoi inxhinier Muston që rrinte plot keqardhje me

projektet në dorë, Flamurin që ndizej si flaka, Binakun e shkathët si një fëmijë që vraponte në galeri. — Ata, — tha me vete, — ata e nxorën shkakun e vërtetë të uljes së prodhimit.» Kujtoi edhe Rametliun e gjatë që buqëqeshte me ironi, ndërsa i binte me pistoletë sterilite.

Në vend që të kthehej në shtëpi, vazhdoi rrugën dhe doli te brezi i gjelbër i qytetit. Eci kot mes mësh teknave, pa ndonjë qëllim, sikur ta kishte tërhequr dikush për dore. Qëndroi pranë një mësh tekne dhe pa barin e shkelur e të ngjeshur pranë trungut. Dikush kishte qëndruar aty. Pa mirë trungun e bardhë e delikat. Ajo ishte mësh tekna e tyre... Ajo mbrëmje e ngrohtë dhe mësh tekna i përfatuan në shpirt mall.

... Ai shtriu xhakëtën, ajo la trikon. Ky i tha «mos!», po ajo vuri buzën në gaz dhe tha «s'ka gjë». Ishte mbrëmje e vakët, e ngrohtë. Qetësi. Vetëm gjethet e mësh teknes zhurmonin lehtë. Bari ishte ca i lagësht si me vesë, prandaj ata u ulën të dy mbi xhakëtën, mbështetur pas trungut. Ai shikonte gushën e bardhë dhe sytë e kaltër si të pëllumbeshës. «Askush nuk e ka ndier këngën e këtij gjethi si ai që ka pranë një vajzë të bukur si Diana,» — mendoi.

«Si ndodhi kështu? Dianë, unë atje nën tokë kam qenë më Flamur Oshllanin tënd, kam qenë me Rametlinjtë e tu, me kushërinjtë e dytë, të tretë. U përplasa keqas me ta. Unë s'mund t'u lëshoja rrugë atyre, vetëm e vetëm sepse ishin të tutë. Jo, po ta bëj këtë, unë nuk do të mundja t'i shikoja në sy shokët e mi, as babanë, as ty, Dianë.»

Në atë tendosje shpirtërore atij i përfytyrohej Diana si një vegim i afërt e i prekshëm. Pastaj i largohej papritur po ashtu si i vinte. Vegimi humbiste, sapo kujtonte Rametlinjtë.

U ngrit me rrëmbim, sikur të shihte ndonjë gjar-për aty afër, mori xhakëtën dhe iku, pa ia hedhur sytë as mësh teknes, as barit të njomë. Nga parcela e mollëve, një aromë e këndshme, e njomësht ngrihej e përhapej sikur avullonte nga gjiri jetëdhënës i tokës.

Tej lumit fushëza, në pritje të përmbytjes, shtrihej

si një brez i verdhë, i përvëlur nga dielli. Në anë të saj nisnin e lartoheshin kodrat, veshur me dushk deri lart te shtëpitë që feksnin si ca njolla të bardha. Pastaj kreshtat çanin horizontin si ca thika plugjesh formëprishura. Tej horizontit vinte zbritja për në Pllajë. Mes Pllajës ferma. Në fermë Diana.

Ai u përpoq të shikonte vegimin e vajzës ashtu të qeshur e të bukur, por në shpirt ndjeu ftohtësirën e akullt që i sillnin Kukajt, Rametlinjtë dhe tarafet e tyre.

Kur e mendonte punën mirë dhe me gjakftohtësi, thoshte me vete: «Të gjithë s'janë njësoj. Ja, i ati, Kallushani, vërtet noton në ujërat e interesave të fisit, po ai është i pari që u ngrit kundër fejesës të së bijës me Sojlliun, paçka se pastaj edhe ai u nënshtrua. Kurse xhaxhai i Dianës, Ibishi, duket njeri i urtë, gazmor. Është punonjës i dalluar në bonifikim. Atë ditë ai rrinte i mërzhitur dhe i pakënaqur. Diana tha se ai ishte zënë me Kallushanin për punën e Vjedës. Xhaxhai tjetër, Kurtishi është nga ata njerëz që u pëlqen të duken...

Po Diana. Ku e ka vendin Diana në odën e plakut Brah? Ajo është larguar nga shtëpia katërmëdhjetë vjeç. Katër vjet në shkollën zooveterinare të Shkodrës, katër vjet në Institutin e Lartë Bujqësor, pesë vjet në Pllajë. Gjysma e jetës së saj, shkollë e punë, larg tyre...»

Ai kishte dalë tej spitalit. Vazhdoi rrugën e asfaltuar dhe u ndodh pranë varrezave të dëshmorëve. Shikoi monumentin dhe iu kujtua Bektash Sella, ashtu i bardhë, i menduar, që ia kishte ngulur sytë «Zukut» me arkivolin e kuq dhe kurorën. Besimi fshiu djersët dhe shkoi mënjanë pllakave të mermerta nën hijen e blirëve. Përpara i doli rrafshina e qytezës së vjetër që po shkretohej me shpejtësi, grumbuj njerëzish që punonin, lumi që nën rrezet e mesditës shkëlqente, fushëza...

«Sa mirë ishim kur unë nuk i dija këto!» — tha me vete.

U ngrit nga hija e blirëve. Bardhësia e mermertë e pllakave shkëlqente sa i merrte sytë. Ai eci deri te qendra e furnizimit të automjeteve. Aty pa një autobot. Bisedoi me shoferin dhe hipi në makinë. Do të shkonte në uzinë të takonte njëherë Andrean. Pa të bisedonte një herë me të, si i gjykonte ai këto punë...

Andrean e gjeti tek punonte një raport për byronë e organizatës. Ai ngriti sytë e qeshur dhe e pyeti:

— Ç'të tha shoku Vasil?

— Asgjë. Mori informacionin dhe asgjë, — i tha Besimi.

— Beso, dëgjo se mos më dalë nga mendja... Ajo shoqja të ka kërkuar në telefon. Merre, po mos i trego që ua fshikullove prapanicën kushërinjve të saj këtej sipër...

Besimi e shikonte i hutuar.

— Dëgjomë mua ti, — vazhdoi Andrea. — Nuk u pëlqen vajzave kjo punë. Ta thotë plaku ty. Merre tani në telefon, por sakën se ia hap... Asnjë fjalë për kushërinjtë. Ke kohë, kur ta takosh.

Besimi u ul dhe mori telefonin. U desh të priste ca, gjersa u lidhën.

— Jam Diana Kukaj, — tha ajo më në fund. — Kush më kërkon?

— Më tha Andrea se më keni kërkuar, — i tha Besimi. Zëri i doli i rëndë si i huaj.

— Ua, — tha ajo, — si më dole kështu? S'të prisja. Andrea më tha se sot s'do të dukesh në uzinë. Nga më flet? Si të gjeti Andrea?

— Këtu nga zyra e tij, këtu... — tha Besimi.

— Ti seç ke, Bes... — tha ajo dhe uli zërin. — Mos je gjë i sëmurë? Bes, mos je sëmurë?

— Mirë jam, mirë, po hë, ç'kemi, përse më kërkove?

— Besi, — tha ajo po me atë zë të ulët, — te dajë Mërgimi sonte kanë një darkë. Ata më kanë çuar fjalë dhe unë do të zbres. Po ti në ç'turn punon?

— S'kam turn. Jam marrë me punë të tjera...

Ai deshi t'i thoshte copë: «Jam marrë me Ramet-

linjtë e tu» dhe u prish në fytyrë nga zori, po Andrea, që e ndiqte me kujdes, ia mori receptorin nga dora dhe i foli asaj tërë gaz:

— Shoqja Dianë, pa zbrit një herë andej dhe lërini turnet. Ky shoku e ka punën jashtë konverteve. Aa, dëgjo, dëgjo këtu, moj Dianë! Gjer kur do t'ju shërbej unë si centralist?

Ajo qeshi dhe e pyeti në ishte Besimi sëmurë.

— Si molla është. Më mirë, prishet. Po eja, se telefoni sikur nuk punon mirë. — Andrea po qeshte. I zgjati receptorin Besimit.

— Bes, thuaj Dritës se plaçkën që s'gjetëm dot në minierë, po e sjell sot. Të më presë në orën shtatë të mbrëmjes. Hë, si thua?

— Mirë. Mirupafshim! — tha ai dhe e mbylli telefonin. E kishin mbuluar djersët. Andrea qëndronte në këmbë.

— Nuk ta shoh mirë syrin e pushkës, — tha. Besimi u ul dhe ndezi cigare.

— Mos je prishur me të dhe unë s'di gjë?

— Kush tha? Pse, mos bëra ndonjë gjë që nuk shkonte?

— Jo, por sesi m'u duk. Si i thonë, ishe shkëmb steril, pa zjarr e pa mineral.

— E ç'të të them, Andrea? Unë e kam dashur atë. Ti e di që kemi kohë që duhemi. S'kam ç'të të fsheh.

— Tjetri po e dëgjonte kokulur mbi letrat e raportit, i pakënaqur.

— Pse «e ke dashur»? S'e do më? Ç'ka ndodhur mes jush? Ç'do të më thuash me këtë «e kam dashur»?

Vetulla e Besimit u ngrit lart dhe ai buzëqeshi me njëfarë dhembjeje.

— E di si e kam hallin? Unë ata Kukajt e saj dhe këta Metët e Ramë Metët e minierës, që janë po të saj të, nuk i honeps dot. Kjo gjë po ma bren shpirtin dhe asaj s'ia fsheh dot. Them me vete: A do të bëhem unë dot njeri i tyre, a mund të ulem unë në një sofër me ta?

— Aaa, kjo qenka e ç'qenka! — tha Andrea dhe i shtyu tutje fletët e shkruara. — Po përse të mos rrih me ta? Ata nuk janë armiq. I kanë ato kusuret e tyre, po armiq nuk janë. Se ç'do të bësh ti, kjo është puna jote dhe nuk të ndërhyj dot, por... një gjë duhet ta kesh të qartë: vajza është e mirë dhe nuk të ka asnjë faj. Ndoshta jam gabim, po kështu ma thotë mendja. Shko e takohu me vajzën. Sqaroji punët me të dhe mos e shqetëso më... Blija mendjen si i gjykon ajo gjërat. Kjo ka rëndësi, ka shumë rëndësi! Mos e përziej jetën e vajzës dhe tënden me tarafet e saj. S'ke punë me të. Ke me vajzën. Hej drej o punë! Se si i ngatërron ca punë ti, vëllaço... Këtej shkon e m'i fshikullon Ramë Metët, andej u dashuron mbeskën, po kjo vërtet është për të qeshur. Megjithëse... ari, edhe me baltë të përziehet, ar mbetet, — tha ai duke e ulur zërin sikur po fliste me vete. — Kështu, Beso? Dhe tani dëgjo, se gati më doli nga mendja. Ajo puna jote në minierë, informacioni që i dhe sot shokut Vasil, atij i kishte pëlqyer. Do të të nisin përsëri me një detyrë tjetër. Nesër të jesh te shoku Vasil në orën shtatë të mëngjesit, jo më vonë.

— Ç'është kjo detyrë?

— Nuk e di. Nesër në orën shtatë të jesh te shoku Vasil. Ta thotë ai. Mos harro Dianën! — Andrea u ngrit dhe i vuri dorën mbi sup.

Besimi e quajti punë me mend që e bisedoi çështjen me Andream.

Dianën ai e priti si herët e tjera matanë urës së qytezës së vjetër. Ajo ishte skuqur nga dielli dhe ishte djersitur. Flokët e derdhur, kapur me karficë, i binin pa rregull mbi ballë.

— Mos m'u afro, — tha duke i dhënë dorën e duke qeshur. — Jam gjithë djersë. Ti si je? Mirë? Mirë qenke.

Sa mirë! Do të vete një çikë në shtëpi. Dajë Mërgimi sonte me gjithë mend ka darkë, po unë erdha si gjithnjë... Më prit atje...

Ku? — e pyeti Besimi. Ishte i hutuar.

— Tek Arrat, pra...

— Mirë, tek Arrat.

Ajo i shtrëngoi dorën dhe iku. Besimi e kaloi urën qetë-qetë. I doli rrafshinës në të majtë, nga bregu i lumit, andej nga kishte qenë thertorja. Punëtorët e she mbjes së qytezës e kishin lënë punën me kohë. Shtëpizat e pakta, ende të pashembura, i mbulonte një hije vetmie. Dielli ishte tretur në perëndim. Në rrafshinë aty - këtu dukej ndonjë mace që s'dihej se si e kishte fatin e saj. Shembja po i nxirrte rrënjët qytezës. Ai pa ca nga themelet e gërryera ku kishin tërhequr gurët për punime të reja. Dheu e suvaja dukeshin togje-togje. Gati te secila nga ish-banesat dukeshin ca gropa të zeza që u ngjanin varrezave. Ishin bodrumet. Vijoi rrugën bregut të lumit. Sasia e ujit po binte nga dita në ditë prej vapës përvëluese. Toka e etur thithte plot afsh ajrin kundërmues me atë pak lagështirë dhe mbante gjallë gjelbërimin e shelgjishtës, të konopicave e të manaferrave. Në ajrin e lagësht të bregut që binte erë llum, si ca re fluturuese, vallëzonin mushicat. Tufa zogjsh largoheshin me zhurmë për në bregun tjetër dhe i gëzoheshin lumit. Muzgu i kaltër po binte qetësisht mbi lumë. Një hënë e zbardhëlluar, si e sëmurë, po ngrihej plot përtesë në grykën mes dy maleve, bash mbi horizontin e honit të thellë. Duke i parë e i ndier të gjitha këto, njeriut ia pushtonte shpirtin gëzimi i jetës dhe harronte çdo andrallë. Kështu e ndjeu Besimi veten, ndërsa po priste Diana Kukajn atje pranë Arrave të Mëdha.

Ajo u duk mes gërmadhave, veshur me fustanin ve rror që zbardhëllonte mes ngjyrave të errëta të muzgut. Në dorë mbante trikon. Ata u takuan, përpara se ajo të merrte rrugëzën mes kaçubave që zbriste të shelgjet pranë Arrave të Mëdha. Nuk foli asnjë fjalë.

Iu hodh në qafë dhe e puthi, ndërsa gjoksi i ngrihej e ulej si tallaz. Kundërmonte sapun.

— Bes, sa të kam kërkuar, — tha.

— E di. Drita më kishte lënë një letër para disa ditësh.

— Bes, atë ditë... atë ditën e Vjedës... m'u duk sikur edhe unë të humba përjetë ty. Se mikun e vërtetë e kërkon me vite, por e humbet për një ditë... Po s'qenka e vërtetë, Bes! — Pastaj ajo tha me zë të dridhur:

— Po hë, më thuaj, ç'patë në minierë gjithë ato ditë e net? Hë pra! — Ajo u përpoq të qeshte dhe të paraqitej e gëzuar. — Ç'më shikon, fustanin? Ti e di që mua më pëlqen fustani i ri dhe mikun i vjetër... Fol Bes, pse rri kështu?

— Atje unë pata punë me të tutë, me ata Ramë Metët apo Rametlinjtë si i quajnë minatorët, — tha ai pa fije gazi.

— Si me të mitë?! Përse të çuan ty atje? — tha ajo seriozisht.

— Përse të mos më çonin mua?

— S'e kam fjalën aty, — e ndërroi ajo tonin e bisedës, — por ti, Besi, ke punë me mua... vetëm me mua... — e ktheu ajo me shaka.

— Dianë, unë me të vërtetë kisha ca punë me ta, dua të them me një grup të vogël minatorësh. Te ne edhe tre veta, pesë veta formojnë një grup apo një brigadë. Kisha me vete edhe Flamurin, djalin e dajës tënd. Flamuri është djalë për kokë të djalit. Ne të dy u përplasëm keq me ata të Ramë Metës, se bënë ca dallavere në punë...

— Aa, kështu na qenka puna! — tha ajo e çliruar. — Po a për këtë më rri kështu? Po ti nuk i njeh ata. Ata i kanë zanat këto gjëra. Sa herë jam përplasur unë me të mitë në shtëpi për ato marifetet e Ramës, të Idrizit, të Zojzos atje në fshat, të cilët ti nuk i njeh fare? Aq të mira u bëfshin! Po pa më trego ç'kishin katranosur?

— Vidhnin shtetin, ty, mua, të gjithë... Në vend

të mineralit, tejkalonin planin me gurë dhe na i nisnin neve në uzinë që t'i shkrinim. Kurse ata mbushnin xhepat me para. Këtë bënin...

— Të paktën, a ua treguat mirë vendin? — pyeti ajo dhe u mbështet në murin e gërmadhës.

— Jo tamam, — tha Besimi. — E nisëm punën, por nuk e mbaruam dot me ta. Janë disa punë që është vështirë t'i mbarosh shpejt. Megjithëse ata u frenuan. Tani s'do të na e hedhin dot më me steril. Kjo punë e pat, po nuk mbaroi. Unë i shikoj gjërat me zor, Dianë... — tha ai me hidhërim. — Unë, më duket, nuk bëj për punë të tilla të vështira... partie. I ngatërroj gjërat.

Ajo iu afrua. I futi dorën ndër flokë dhe e tërhoqi pranë vetes. E puthi me zjarr, por ai qëndronte i ftohtë dhe i brengosur.

— Dianë, vërtet do të shkosh te baba Mërgim?

— Po. Por, po të duash, e kalojmë bashkë sonte këtë darkë. Si thua? Atje shkoj edhe nesër, kurse ty s'kam ku të të gjej. — Asaj i kishte ikur fare humori.

— Dianë, më kupto drejt. Unë s'kisha se si të mos t'i thosha këto...

— Mirë, mirë, Besim. Unë të kuptova që nga zëri në telefon, që nga vështrimet e asaj së dielës se ti diçka kishe. Ikim, Bes, ikim, — u lut ajo duke e shqiptuar butësisht emrin e tij. — Unë sikur s'po e ndiej veten mirë. Nesër s'po iki. Do të rrimë përsëri bashkë nesër. E, si thua?

Hëna shndriste lart e derdhte zbehtësinë mbi rrafshinë e mbi gërmadhat gjysmë të shembura. Kur drita e saj binte mbi flokët e Dianës, i jepte shkëlqime të argjendta, të ftohta dhe flokët e saj dukeshin si të thinjur.

Ai e përcolli mes gërmadhëve drejt periferisë.

— Si thua, nesër paradite? — e pyeti ai.

Ajo e shikoi në dritën e syrit.

— Mirë, — tha dhe u ndanë. Ai qëndroi në vend si i ngurosur, ndërsa atë e gllabëroi porta e madhe, e

vjetër e Kukajve, ku ulërinë menteshat. Ai ndjeu një pështjellim në shpirt mes dhembjes, keqardhjes dhe pendimit. «Ndoshta unë u solla si guhak, — tha me vete. — Unë nuk di të sillem. I ngatërroj gjërat dhe i bëj lëmsh, kurse ato duhen shikuar me gjakftohtësi. Një djall e merr vesh. Në fund të fundit e ç'më hyjnë në punë Ramë Metët apo Kukajt e saj? Apo unë pashë diçka tjetër tek ata dhe...» Kohët e fundit i ishte bërë zakon të vinte në balancë çdo veprim të vetin dhe shpesh niste e qortonte veten. Kërkonte përsosmëri, megjithëse e dinte se përsosmëri nuk ka.

Te qendra e qytezës, ku ende qëndronte hijerëndë hoteli katërkatësh, ai pa Behar Sojlliun dhe një tjetër. Ai tjetri, një shkurto i shëndetshëm e i rrumbullt dukej si brumbull. Diç flisnin duke shikuar Besimin. Brumbullin e veshur shik e kishte parë edhe një herë tjetër me Sojlliun, Jetonin dhe Sali Kallinin. Ai pati përshtypjen sikur flisnin për të.

Shpejtoi hapin për në stacion të urbanit. «Në mos pastë autobus, do t'ia mbath më këmbë», — mendoi. Nga klubi sportiv po dilte Memish Kukaj me dy të rinj që e mbanin për krahësh. Pas tyre vinte një djalë i vogël nja dhjetë vjeç. Ata ecën gëc-gëc drejt sheshit. Besimi dëgjoi zërin e Memishit që thoshte: «Send apo gja, s'jam i pimë, or ti torollak. Ju më mbani se jam njëqindeshtatëmbëdhjetësh...»

Autobusi s'po dukej. Tej fushës së bregut, te kthesat e kodrës një gaz çante errësirën dhe i merrte kthesat me shpejtësi. Pas pak minutash gazi kaloi përpara tij me fërshëllimë dhe humbi për në periferi, andej nga binin përdhëset e Kukajve.

KAPITULLI I DHJETË

Duke dalë nga shtabi i kantierëve të ndërtimit të qytetit të ri, Kallushan Kukaj dëgjoi Vasil Kushtën që i tha Hekuran Përdrinit të njoftonte të birin se të nesërmen do ta nisnin me shërbim. Hekurani e pyeti: — «I larg?» Sekretari i tha me gaz se nuk do ta çonin larg, ja aty diku në kooperativat e Pllajës.

Kallushani as që do t'i kishte vënë rëndësi këtij fakti, sikur Fatih Groshi, përgjegjës i seksionit të bujqësisë, të mos i thoshte duke i zënë krahun miqësisht: «Bacë, nesër duhet të nisesh me shërbim në kooperativat e Kurorës për studimin e oborrevë personale. S'kemi si t'ia bëjmë, se i kemi nisur të gjithë, pa nuk të çoja.» Kallushani u mat ta kundërshtonte, po aty afër ishte sekretari. E dëgjoi i pëkënaqur dhe nuk foli. Bashkë me Përdrinin! Atij i kishte rënë në erë lidhja e tij me Dianën. Po qysh t'ia thoshte shokut Fatih që e kishte shef seksioni? Jo. Më mirë që e dëgjoi në heshtje dhe i pëkënaqur. Le ta merrte ngurrimin Fatihu për punë moshë. Më mirë kështu. Të paktën herë tjetër nuk do ta niste pa e pyetur. Kallushani i kërkoi gazin e seksionit për të zbritur në shtëpi. Fatihu ia dha.

Kur gazi kaloi përpara stacionit të urbanit, i doli papritur ai i fantaksuri Besim Përdrini, fare vetëm. Zemra e plakut ia bëri tak dhe diçka i dogji. «Po ky Përdreqi këtu kaq vonë?» — tha ai me vete.

— The gjë, bacë? — e pyeti shoferi.

— Jo, jo.

Shoferi e futi gazin rrugë e pa rrugë mes rrafshi-

nës dhe frenoi mu përpara portës së Kukajve. Ai e dinte se bacës Kallush i pëlqente ta shikonin që gazi i seksionit e sillte edhe në shtëpi, ndonëse kjo ndodhte rrallë, se ishte urbane. Kallushani vuri buzën në gaz, i dha dorën dhe u fut brenda portës.

«Po këta? — tha me vete. — Dëgjojnë gazin që u ndalet te porta, dëgjojnë zilkën e kecave dhe kurrkush nuk e luan këmbën. Ah!»

Në odën e madhe të plakut Brah kërciste muhabeti. Ishin mbledhur të gjithë. Ai u fut në odën e vet. Plaka Sanije e priste. Ajo nuk ishte plakë, ishte te të pesëdhjetat, po Kallushani ashtu i fliste. Ajo ishte motër me Mërgim Oshllanin. Ishte nga ato gra që nuk e thyejnë zemrën kurrë dhe nuk përzihen në ngatërresat e të tjerëve. Edhe kur i shoqi sillej keq me të, ajo vuarte dhe nuk i ankohej kujt. Sa e pa Kallushanin në fytyrë, e kuptoi se ai diçka kishte.

— Ke ndonjë pikë raki? — e pyeti Kallushani.

— Ka.

— Meze?

— Ka. Pse nuk erdhe për drekë?

— Ashtu e pata punën. Moj, kush është matanë?

— Tanët. Edhe Goni, Miri e Dana.

— Ashtu? — ai u prish në fytyrë. Hapi sytë plot dyshim. Sanija ishte grua e urtë dhe nënë e dhembshur. Jeta me Kallushanin e kishte mësuar që të përgjigjej shkurt, me zë të ulët. Ua kishte frikën atyre vetullave të trasha, të varura, të rënda. Ajo bënte ç'kishte në dorë që i shoqi të mos niste bubullimat në shtëpi. Kallushani nuk kishte vënë dorë kurrë mbi të siç bënin të tjerë me gratë e tyre. Po ja që nuk durohej kur ai bërtiste e u thërriste fëmijëve. Sanija, rritur në familjen e Mërgim Oshllanit, larg nga trojet stërgjyshore, ku kishin mbetur vëllezërit dhe të afërmit e tjerë, i kishte mësuar mirë «rregullat» në fis. Fjalët e saj të përditshme ishin: Mirë, e ban Sana. Ta ban Sana tash. Tash, posi. Ja, gati. Si ta duesh. Posi, ja, sa ora.» Ajo ishte nga ato kosovaret e mençura me

zemër pëllumbeshe që i dinë mirë huqet e burrit. E kuptonte që në të parë të shoqin në ai ishte i gëzuar, në qejf apo bluante ndonjë mërzi, në e kishte me gjithë mend fjalën, apo për hajgare, në i pëlqente turlia, apo turshia me mish të zier.

Kallushani e ktheu shpejt gotën e rakisë dhe po bëhej gati të dilte në odën e madhe të plakut Brah, kur hyri një djalë i Memishit, nja dhjetë vjeç. Djali mbante ndër duar një zarf të madh. U afrua me frikë dhe foli shpejt e shpejt.

— Babi harroi në klub cigarishten. Më çoi mua t'ia gjeja. Kur po vija, te rruga më ndali një burrë e ma dha këtë. T'ia japësh në dorë shokut Kallush, më tha. Kaq, bacë.

Kallushani grisi zarfin dhe nxori andej një pusullë të vogël.

«Jot bijë, Diana, hargaliset skutave me Besim Përdrinin. Një mik që ta do të mirën.»

Kallushani, i bërë baltë në fytyrë, shikoi rrotull mos shihte djalin e vogël të Memishit, por fëmija kishte dalë.

— Ku shkoi? — e pyeti Sanijen.

— Doli.

— Medet! — tha. — Edhe kjo na mungonte...

— Çka ka ba vaki? — Sanija u mpak.

— Ku është Dana? Kur ka ardhur?

— Me gjashtë.

— Këtu ka qenë që në orën gjashtë?

— E, pra.

— A ka mundësi?... — Kallushani e shikoi të shoqen si njeriu që ka mbetur në fund të pusit dhe, pa pritur, dikush i thotë: E gjeta litarin! Prite e ngjitu. — Pash zotin, Sanë, ka qenë Dana këtu që... — Ai ishte afruar dhe, pa kontrolluar veten, po i zgurdullonte sytë, sa gruaja u tremb.

— Këtu, pra. Me Mirin e Gonin a kanë.

— Kush do të jetë ky i poshtër? — tha nëpër gojë. E mblodhi letrën dhe e futi në xhep. Kërkoi djalin e

Memishit, e tërhoqi me kujdes dhe doli në rrugë mos e gjente njeriun që i kishte dhënë atë letër.

— Ta shoh, e njoh, — përsëriste djali i gëzuar nga-
që baca po i fërkonte kokën. — Një burrë i shkurtër.
Është i shëndoshë si top.

U sollën ca nëpër klube, në rrugë, por pa fryt.

Kallushani hyri në odën e plakut Brah. Në qoshen tjetër rrinte Ramë Meta. Pranë tij, i çelur në fytyrë si gjithnjë, ishte Ibishi. Kurtishi rrinte këmbëkryq si më-
njanë dhe lozte me tufën e çelësave, të prefeses së thonjëve dhe të briskut të vogël. Në fund, shtrirë si gjithnjë e mbështetur në një jastëk, ishte Memishi. Agroni se çfarë i thoshte Dianës dhe të dy qeshnin. Ata e lanë fjalën dhe u ngritën, sapo panë të atin. Diana ishte e qetë dhe qeshtë me të vëllanë, ndonëse ishte skuqur ca dhe nën sy kishte rrathë të errët. «Mosha, — mendoj Kallushani. — Mos është ndonjë intrigant që do të më shtijë flakën në shtëpi? Rrufeja nuk bie dy herë mbi një pemë, s'ka pse të bjerë mbi mua. Gjynah t'i bie më qafë pa shkak. Ma dogji dorën kjo pusullë e mallkuar...»

— Kur ke ardhur, Danë? — e pyeti në kalim.

— Me gjashtën, baba. Sa për sonte, — tha Diana dhe shikoi Ibishin, që po i thoshte diçka tjetër. Kallushani pa sytë e kaltër të bukur të së bijës, po ndër ta nuk lexoi dot gjë. «Gjynah, — përsëriti me vete, — unë marr zjarr si çakmak. U plaka...»

Ai u hodhi një sy të gjithëve. Rrethi i odës së madhe ishte mbushur plot me djem e nipa, të martuar e të pamar-
tuar. Djemtë përgjithësisht ishin të gëzuar. «Edhe mes këtyrë fryn era e shpërbërjes së fisit,» — mendoj Ka-
llushani. Kishte vite që ai e ndiente veten të parë në mes të vëllezërve. Nëse plaku Brah kishte qenë mendja e fisit, ky ishte dora e fortë e tij. Ishte njëfarë sekseri, njëfarë rregulluesi për vendin e punës të secilit, për profesionin, strehimin, të drejtat e studimit për fëmijët, me një fjalë ato ndërhyrjet andej-këtej të tij ai i quante

vendimtare në jetën e fisit, pavarësisht se vendimet i merrte pushteti edhe po të mos ishte gjallë Kallushani.

Këmbyen përshëndetjet e zakonshme. Mirë? Mirë. Mirë boll. Ti mirë? «Ja Rama që më ka zënë qoshen. — mendoj. — Ç'hall nuk ia rregullova në kooperativë? Mos gjithë ato të mira i ranë nga qielli? Jo po Idrizin kryetar, jo po Zojzon përgjegjës sektori, jo po puna e dynymëve, jo po bagëtitë personale, jo po leje largimi nga kooperativa e vendosje me punë në ndërmarrje shtetërore si minierë e bakrit, në sharra, në ndërtim e... Pak, hë! Po nuk është pak rroga ndaj ditëpunës, jo, e di Kallushi juaj atë punë. Kjo kockë ju ka rregulluar, more Ramë, paçka se tani kapardisesh në qoshe para babës.»

Ramë Meta vazhdonte bisedën me plakun për punimet në një ujëmbajtës.

Që atë ditë që ishin zënë për fejesën e Vjedës, veç shkëmbenin dy fjalë nga e keqja, se s'kishin si bënin përpara plakut Brah. Ibishi nuk mbante mëri. Me atë natyrën e butë, buzagaze, atë ironi që i dilte vetiu, Ibishi e detyronte këdo t'i fliste, por Kallushani nuk ia harronte atë ditë... Nuk kishte mjaftuar ajo, po para një jave, kur vinin të dy më këmbë bregut të lumit, Ibishi i kishte thënë të hiqte dorë nga këto punët me tarafilëqe, se do të bëheshin gazi i botës tani në pleqëri. Kjo e kishte tërbuar aq shumë Kallushanin, sa më mirë do të kishte pranuar një shuplakë nga vëllai më i vogël, sesa këtë.

Tani Ibishi shikonte plot gaz në sy Dianën që po tregonte për punën e saj kërkimore në blegtori, për artikuljt e botuar në «Bujqësia socialiste», për përhapjen në tërë vendin të dhisë mishtake të krahinës. Diana u thoshte se ajo i bazonte studimet në mikroklimën dhe mikrofaunën e zonës ku gjendej dhia e se ajo kishte studiuar edhe zona të tjera të përafërta ku mund të përhapej me anën e tufave racore që ajo kishte krijuar vetë në fermë. Ndërkohë Kurtishi po i fliste me inat Ibishit. Ky i tha se burrë është ai që fiton mbi veten.

Vetëm kaq mundi të dëgjonte Kallushani, se ata po flisnin me zë të ulët.

Kurtishi lëvizte me nervozizëm tufën e çelësave, briskun dhe prefsen e thonjve. Kallushani nuk po e duronte dot.

Ramë Meta, i qetë si burrë zakoni, po i tregonte babës Brah për të ardhurat e kooperativës nga puna sezonale në shqipëri. Po lavdëronte kusho Idrizin si kryetar, Zojzon si përgjegjës sektori që dinë ta dredhin sikur kanë lindur për ato punë. Kallushanit i ishte çuar shpirti peshë sikur t'i kishin bërë ndonjë padrejtësi, t'i kishin ngrënë hakun. Sytë i digjnin.

Pa këmbët e trasha si trungje të Memishit pranë kokës së një fëmije që flinte. Iu duk se edhe Memishi po flinte. «Po ky përnjimend ia këput gjumit këtu në odën e madhe të babës? — tha me vete. — Djall, o djall Mema! Në saje time u bërë njëqind e ca kile dhe s'ma di as ti. Je fryrë si derr.» I kaloi nëpër mend shakaja që bënin me të në klubin sportiv.

Shkrimtar Saliu e kishte pyetur Memën se si i kishte rritur nëntë fëmijët, se Memën nga mëngjesi në darkë e gjeje klubeve meqë punën e kishte natën si rojë. Mema i kishte thënë: «Send apo gja, unë... lopa i rriti, jo una, due me thanë, send apo gja... Kurrëgjja una, veç lopa...» Memishi kishte pasur tri gra. Me to katërmbëdhjetë fëmijë. Tani i rronin vetëm nëntë. Peshë të tjerët i ishin shuar veç nga pakujdesia. Edhe atë lopën që mbante e shoqja, gruaja e tretë, me mund të madh e mbante atje në qoshk të oborrit. I dinte Kallushani, i dinte të gjitha. Për fëmijët i therrte në zemër, se mendonte: «Sa bëhet dielli hënë, aq bëhet edhe njerka nënë...» Gruaja e tretë as që e çante kokën për fëmijët e dy të parave. «Mirë, mor Memë, — tha me vete, — ty do të të rregullojë bash kjo kockë. Shyqyr që fëmijët u rritën e s'ta kanë më nevojën as ty as njerkes. Do të ta gjej një apartament bash në katin e pestë që ta hipësh lopën në tarracë...»

Memishi u gjallërua papritur, sikur e kuptoi mendi-

min e Kallushanit. Njëri nga djemtë e ngacmoi dhe ai iu përgjigj. «Send, apo gja, rakia sefte të ban lepër, pastaj, du me thanë, skile, e mandej të ban derr.» Po ti ç'je?» — e pyeti djali. «Berr i zotit jam, kurrqja», — tha Memishi dhe ktheu kokën matanë. Përsëri fluturimi i zogut hodhi dritë mbi fytyrën e Kallushanit. Diana e kapi, e pa me dashuri të atin, por vetullat e rënda të babait u ulën dhe ajo u skuq.

«Po e hipa këtë në të pestin, gjithë qyteti do të mendojë se unë s'kam dorë në strehimin e fisit, — tha me vete Kallushani. — Po, or Memë, po, në të pestin. Hip e zbrit pesë palë shkallë, të të ulen pak ato tulaqet e do të të kujtohet lala Kallush.»

I gjithë ky hakërrim i Kallushan Kukajt e kishte nismën në mbledhjen e pasdrekës në shtabin e kantierëve të ndërtimit të qytetit të ri, ku ishin ngritur punëtorët dhe e kishin bërë për ujë të ftohtë si përfaqësues i komisionit të strehimit. «Mirë të tjerët, po ai Met Druvari, kushëriri?! Po ajo pipericka, Drita Përdriini... Përdreqi! Medet, e ç'm'u desh që vajta. Ishte edhe shoku Vasil, pale. Po gjene mirë, derisa nuk ia nxorën kokën projektit. Më ulën në vend pa e mbaruar fjalën. Lëre-lëre, po sikur të dilte projekti i pallatit nr. 83!»

Hakërrimi kishte rrjedhur si një rrëkezë nga mali që nis si një prroskë e vogël e bëhet lumë që del nga shtrati, rrëmben ç'të gjejë përpara.

Tani e kuptonte edhe vetë se të gjithë, megjithëse bisedonin për hallet e dynjasë, sytë dhe veshët i kishin drejtuar nga ai dhe pritnin një fjalë, ç'po bëhej me projektin, po nuk guxonin. Ja, tani po flisnin kot për një shef të komitetit ekzekutiv që do ta çonin kryetar kooperative, kot flisnin për punimet në hidrocentral, kot flisnin për drekën që shtroi dikush diku për komisionin e ujësjellësit, kot flisnin për kursimin e ujit të pijshëm, kot flisnin për energjinë elektrike se llamba e portës rrinte edhe ditën ndezur, kot flisnin për fejesat e reja në qytet, duke përcmuar vajzën ose djalin në çdo

çift. Dikush tha se Drita Përdrini bënte dashuri me Jetonin. Diana, skuqur e bërë flakë, i tha diçka atij që foli, por Kallushani nuk e dëgjoi. Agroni po i fliste me zë të ulët Emirit. «Cili nga ju merret me këto punë që i ditkeni kaq mirë?» — pyeti Emiri duke shikuar Kurtishin dhe djemtë aty rrotull. Djemtë u tërhoqën me shkathtësi. S'ishte punë të flitej përpara pleqve për këso gjërash. «Kështu thonë. Pishën s'ua ka mbajtur kush,» — tha njëri. «Thashetheme!» — tha e pakënaqur Diana. «Turp! Mos u merrni me thashetheme!» «Kush?» «Kush?» «Kush?» «Mor po kush merret me thashetheme?» «Unë jo!» «As unë!» Unë s'jam marrë kurrë me to... Kallushanit i erdhi mirë që Diana dhe Emiri i bënë të gjithë të tërhiqeshin.

Mendoi atë çast se të bijtë, edhe Skifteri, oficer në Bajram Curr, edhe Emiri, edhe Diana, edhe Vjeda nuk do të jetonin në pallatin 83. «Të gjithë janë shpërndarë, — mendoj. — Kurse unë rrekem për të tjerët. Sikur e bëj për vete... Po sikur unë të vdes nesër? Këta, vendosur në atë pallat, do të zgjatin duart e babëzitura drejt apartamentit tim, se edhe Goni s'dihet në vjen a s'vjen, hidrocentrale do të bëhen plot... Hajde-hajde, ç'më ka marrë koka erë! Pesëmbëdhjetë apartamente për Kukajt në një pallat! Bir o bir... Duhma e fisit m'i ka errur sytë. Nuk po shikoj as fëmijët e mi. Jam verbuar. Unë jam qorr me sy në ballë. Jam robtuar gjithë këta vjet për ta mbajtur me zor fisin dhe nuk shikoj se mbi fis ka rënë muzgu. Jo, ka rënë nata. Fisin e ka mbytur nata, kjo natë, ky pus i thellë i zi...»

Ai ishte djersitur dhe prishur në fytyrë. Kjo nuk u shpëtoi syve të Dianës.

— Baba, mos je gjë sëmure? — pyeti ajo.

— Mos ka kund një aspirinë, Dianë.

Vajza doli dhe pas pak solli aspirinën dhe një gotë ujë.

— Rrofsh, moj bijë! — tha. Zëri i saj, ajo aspirinë, lëvizjet e gjalla dhe sytë e shqetësuar atij i erdhën si një fillad i lehtë në shpirt.

— Ç'të gjeti? — e pyeti Kurtishi.
— Asgjë. Një turbullim, por kaloi.
— Ça u ba? — pyeti Braha që rrinte mbështetur, gjysmë i fjetur, por nuk u mor vesh përse pyeti. Djemtë kujtuan se kishte qenë në gjumë dhe mërmërima e tyre u kthye në gaz.

— Asgjë, baba, — tha Kallushani.
— Medet, — tha Braha, — po q'aj pallat a si barka e Noes... Pa të, si i dalim mbanë ksaj përmbytje?

— A-ha, — buzëqeshi Kallushani. — Për të jemi në projektin e ardhëm.

Plaku Brah nuk i mernte vesh fjalët «projekt, bllok, apartament, shkallë e parë, e dytë, e pestë». Ai, si e kishte rrahur në mendjen e vet si çullin në dërstilë pallatin 83, ku do të futeshin Kukajt me kuç e me maç, e krahasonte me barkën e Noes.

— Ç'projekt? — pyeti Diana. Ibishi buzagaz e sqaroi me zë të ulët. Vajza u vrenjt, pastaj u zbardh, mollëzat e faqeve iu ndezën flakë. Uli sytë, se nuk mund të shikonte t'anë. «Ibish, ma shtive flakën», — mendoi Kallushani përballë dhe lëvizi i shqetësuar. Po i duhej të përgjigjej. Në fund të fundit le ta dinin edhe të bijtë. E përse të mos e dinin?

— Te 83-shi ka tri dhoma e një kuzhinë, dy dhe një e një dhe një. Një shkallë e pesëkatëshit ka pesëmbëdhjetë apartamente... — Kallushani e dinte se si do të kacafyteshin për katet e për të marrë secili sa më shumë...

— Send apo gja, mos luejti gja? Du me thanë, kam thanë veta... Mirë boll... — Memishi ndërroi krahun me mundim. Truri i tij si një bodrum i errët nuk i mbante dot mendimet, ato vinin, përplaseshin, sakato-heshin dhe dilnin andej gjysmake.

— Pesëmbëdhjetë kurorat tona në një shkallë? — pyeti Agroni buzagaz, po në zë kuptohej lehtë ironia.

— Fisi a gjallë, hala s'u bdarr... — tha plaku Brah.

— Një mundësi është ende, se si bëhet, nuk dihet,

— i shtyu urat Kallushani. — Shumë herë ka shkuar shtamba për ujë, por një herë thyhet...

— Gjer më tash ke rregullue dhandurë e langstër-langu, — hyri në valle Ramë Meta. — Ani, pse të mos rregullosh tanët? — Fjala e tij qe e rëndë, plot qortim.

Ramë Meta ishte plak i mençur, finok. Përpara se të qëllonte me fjalë, i kishte bërë llogaritë qindarkë më qindarkë. Ai vetë as që kishte pranuar ta ndërronte fshatin me qytetin siç bënin shumë. Ishte punë për të, në shkonte kundër rrymës, kundër vërshimit në qytet. Ai e dinte se si i zgjidhte problemet e veta. Që të vegjël i kishte edukuar djemtë me dashurinë për punën dhe fshatin. Shkollës i kishin vënë ferrën që në klasën e shtatë, e shumta në të tetën. Kishin nisur punë diku: o në minierë, o në gjeologji, o në sharra. Familjet shtoheshin dhe ai përsëriste shpesh: «Zanat e rehat në fshat!» Sa bëhej djali për ushtar, i zinte nusen. Kur ktheheshin nga ushtria, secili e gjente fëmijën e parë dhe nusen aty. Kthehej baba, burrë që duhej të punonte mirë e të mbante nusen e fëmijën. Familjet shtoheshin dhe të ardhurat shtoheshin, se nuset punonin në kooperativë me cucat dhe gratë e tjera të Rametlinjve, nën kujdesin e kryetar Idrizit e të Zojzos. Në shtëpi thuhej për burrat që punonin në minierë e gjetkë: I kemi burrat të shkathët e të fortë që e nxjerrin lekun nga gurët, (Ramë Meta ende nuk e dinte breshrin mbi ata të minierës!) Djemtë sillnin të ardhurat dhe shtëpitë ishin plot fëmijë. E ç'donte Rama më shumë?

— Si për të gjithë, — tha Kallushani. Ç'do kurorë e ka të drejtën e vet. Ti, lala Ramë, s'i di fort hallet e këtushme.

Rama e shikoi me syrin e atij fshatarit finok, rrahur me vaj e me uthull, që të gostit për darkë dhe në përcjellje të nxjerr një kërkesë për kredi se do të ndërtojë shtëpinë e re, meqë kulla i ka dritaret të vogla dhe mikut i zihet fryma. Ah, more Ramë, edhe ti... — tha me vete Kallushani, duke kujtuar ndërhyrjet e tij për të e për ata të fshatit.

— A na mjaftojnë pesëmbëdhjetë? — pyeti Kurtishi, duke mbledhur në grusht tufën e çelësave.

— Teprojnë! — tha një nga djemtë që i rrinte pranë Ibishit e Dianës, po Kallushani nuk e mori vesh se kush qe. «Hë, ata po qeshin! Edhe Goni, edhe Dana! Po cili foli aty?» Kallushani nuk i binte më të. Ai nuk donte t'i zinte qetë me të bijtë. Ai e ndiente se po i hynte si një rreze drite fryma e mbledhjes së pasdrekes, po i futej thellë në ndërgjegjen e tij. Ajo rreze po i ndrinte mendimin dhe e kuptonte se kishte diçka që nuk shkonte. Në kushtet e përmbytjes shteti u kishte paguar përdheshet dhe do t'u jepte nga një apartament për kurorë, jo më nga dy dhoma e një bodrum siç kishte këtu secili. Kjo nuk ishte fantazi, por realitet. Realiteti ishte ai i mbledhjes së pasdites në shtab. Kështu ishte bërë për të gjithë qytetarët, kështu do të bëhej edhe për ta. E veçantë në gjithë këto ethe ishte se Kukajt donin të ngjiteshin të fundit që t'i merrte historia. Jo vetëm kaq, po atje sipër të ishin bashkë në një shkallë që të dalloheshin nga gjithë të tjerët.

Kurtishi vuri një cigare në gojë dhe, pa e lëshuar tufën e çelësave, i ra shkrepëses me aq forcë, sa një shkëndijë fluturoi si një sharapnel i verdhë drejt djemve.

— Lala Kurt, po na djeg, — tha dikush dhe ata qeshën. Vetëm Diana shikonte e ngrysur. Ibishi tani nuk kishte fije gazi në fytyrë, po ishte i qetë.

— Ani për katet keni menduar? — tha Kurtishi. Ai e dinte se tri e një kuzhinë të katit të dytë do t'i merrte Kallushani, meqë ende kishte në ngarkim Vjedën. Agronin dhe Dianën. Po në katin e tretë? Po në të katërtin? Po në të pestin, kush do të hipte në të pestin? Po në të parin? «Ku mendon ky për mua?» — tha me vete Kurtishi, i nxehur.

— Për katet do të qesim short, — qeshi Kallushani. — Secili nga ne do të ketë nga një me tri, një me dy e një me një, sepse na takojnë Kurse katet me short!

— Në të parin problemi është i zgjidhur, — tha njëri nga djemtë. — E merr lala Memë.

— Aa, doli send apo gja, asishne, shpia...

— Djemtë qeshën, por seç tha Ibishi dhe ata pushuan.

— Katet shpërndahen me mend, sipas moshës, të sëmurëve, jo me short, — tha Ibishi me zë të lartë. Aq i bënte Ibishit se ku do t'i qëllonte kati. Më mirë në të pestin. Atje nuk do ta dëgjonte kush zërin e zemëruar të së shoqes, Martinës, që nxehej e thërriste për hiç, ndërsa ai i lutej: «Bëj si të duash, veç aman mos na telendis kështu.»

— Në fund të fundit, unë veç një projekt kam bërë. Kur të merret vendimi... — tha Kallushani duke ua vënë në pikëpyetje shpresat.

— Atë projektin duam të dimë, atë, — tha Kurtishi i zemëruar e me kërcënim. Kallushani u vrenjt, por ndërhyri Agroni i papërmbajtur.

— Ai pallat nuk është prona e babës Brah që bëhet pazar kështu...

— Hë! — ia priti Kurtishi, i gatshëm për ta fyer, dhe e shikoi djalin egërsisht. Mbi të gjithë u nde heshtja e rëndë. Një tym i bardhë duhani qëndronte pezull nën tavanin e ulët të odës së madhe dhe e bënte edhe më të rëndë heshtjen.

— Baba, — iu drejtua Diana, ndërsa të kuqtë po i mbulonte fytyrën, — ju nuk veproni mirë kështu. Përse u dashka të përqendrohen gjithë tanët në një shkallë me pesëmbëdhjetë apartamente? Apo... që të bëjmë beli si fis, si Kukaj mes gjithë qytetit... Kështu? Kjo nuk më duket gjë e mirë.

— Oj cucë, — iu kthye Kurtishi, — ti i ke ditët të numëruara në fis, dertet janë tonat.

Diana që e mbrojti babanë duke e qortuar para të gjithëve, u bë flakë në fytyrë.

— Njësoj, — tha e emocionuar, — njësoj është, lala Kurt. Ju të mitë se të mitë mbeteni...

— Me gjithë këtë, si për shtetin, si për ne, pesëmbëdhjetë apartamente se pesëmbëdhjetë, qoftë tok,

qoftë të shpërndara nëpër lagje, — tha Emiri duke dashur ta zbuste sherrin që mund të ndizej.

— Më duket se gënjejme veten, — vazhdoi Diana dhe vuri re se të gjithë hapën sytë të çuditur. Askush s'po e ndërpriste. — Mos ndonjë nga ne ende mendon se jemi ne që bëjmë ligjin në qytet për strehimin?... Më duket se edhe për fisin gjykohet keq. Ju, baba, mendoni se pa ju... këta do të heqin keq?... — Diana po qëllonte me mençuri. Ajo ia dinte fodullëkun secilit dhe, duke qortuar babanë përpara tyre, në të vërtetë e mbronte atë. — Gabim e keni, baba. Juve vërtet jua dëgjojnë fjalën, ju respektojnë, por... ligjin e bën tjetërkush sot. Jo fisi ynë! Dhe secili nga tanët e zgjidh vetë hallin e tij.

— Unë jam me Danën, — tha Ibishi.

— Edhe unë, — tha Agroni.

— Edhe unë, — foli njëri nga djemtë aty afër tyre.

— Dana ka të drejtë, plotësisht të drejtë; — tha Emiri.

— Ka, megjithëse na vjen ca thartë... — tha Ibishi buzagaz.

Diana, skuqur ndër mollëza, ishte menduar gjatë për këtë. Që nga ajo dita e fejesës së Vjedës gjërat po rrokulliseshin me shpejtësinë e shembjes. Të pohoje të vërtetën që po ndodhte, ishte ndershëmëri, burrëri, mendonte ajo. Tani kishte ardhur koha që duhej mbajtur një qëndrim i prerë në fis dhe të mos heshtej, të mos flitej me zë të ulët për hir të autoritetit të babës Brah apo të babës Kallush.

— Edhe ti, Bishkë, si cuca mendon? — foli me kunj Kurtishi, duke zgjatur qafën e gjatë-e duke shikuar anash, pa lëvizur kokën. Ibishit i theri thumbi, po nuk e dha veten.

— Kjo nuk është «cuca», Kurt, por bija më e mirë që kemi në fis, është lulja e fisit, është burrëresha me të cilën ne krenohemi, — tha Ibishi. U kthye nga vajza dhe i hodhi krahun mbi supë. — Ti, bijë, mos u prek, se Kurti kështu i lëshon fjalët, pa doganë. Dana e tha fjalën e saj bash si duhet...

— Tok, or lala Kallush, tok! — thirri Kurtishi.
— A ka unitet këtu a çfarë ka? — i ra me forcë fijos së shkrepëses dhe shkëndija fluturoi drejt Dianës.

— Jepi, lala Kurt! — tha njëri nga djemtë dhe ata gjetën rastin të qeshnin.

— Për këso gjërash posi... — tha Ibishi.

— Send apo gja...

— Xhit, xhit thae? — u përmend plaku Brah nga dremitja. Ai i kishte dëgjuar mirë të gjitha, po nuk i merrte vesh. Fjalën «unitet» dhe «apartament» i vinte aty-aty.

— Asgjë, baba, asgjë, — tha Ramë Meta dhe u ngrit. — Mua do të më falni, se nesër ngrihem herët.
— Ai doli.

Djemtë bisedonin gjallërisht dhe qeshnin të gëzuar. Kurtishi dhe një pjesë e vogël ishin shqetësuar. Mos vallë vërtet Kallushani hiqte dorë nga projekti? Po të ndodhte kjo, jo vetëm që nuk do të merrnin në një shkallë, po si zor të merrnin nga shteti atë numër apartamentesh që kishin llogaritur.

— E keni dorëzuar projektin? — e theu heshtjen Emiri. — Të gjithë ia ngulën sytë.

— Është hedhur një fjalë, por... — Kallushani nuk vazhdoi. Të interesuar e të paimntesuar mbajtën frymën dhe sytë i drejtuan te balli i madh e vetullat e rënda.

— Tërhiqe, baba, — tha Diana. — Duhet tërhequr patjetër. Ky qytet nuk është si njëzet vjetë më parë, kur ne rrihnim gjoksin dhe thoshim: «Fisi! Fisi!» dhe hakmerreshim ndaj kujtdo që na cenonte interesat tanë, kur ne, duke shfrytëzuar ndonjë detyrë, vendosnim për të tjerët këtu në këtë odë, kur ne mendonim se bënim ligjin në jetën e të tjerëve. Jo! Fisi ynë po bëhet qesharak me këto që ndodhin. Ti, baba, ke bërë ç'ke bërë për fisin, tani asgjë mos bëj pa u këshilluar me shokët e Partisë...

— Shife, shife dreqin! — lëvizi Kurtishi dhe u kthye me vrull të shikonte vajzën. — Veza po mëson pulën.

E shifni? — Ai priti që të qeshnin, ta mbështetnin, por të gjithë e shikuan ftohtë.

Plaku Brah pyeti edhe një herë: «Ça u ba?»

— Asgjë, gjysh, — tha Emiri dhe u ngrit. E ftoi Agronin të shkonte me të dhe tjetri tërhoqi Dianën për krahu, i tha se do të flinin lart, ngaqë nuk kishte vend aty. Diana u tha natën e mirë dhe doli me të vëllezërit. Fill pas tyre u ngritën dy nga djemtë e Ibishit që punonin në ndërtim. Ibishi u buzëqeshi. Kuptohej, ai krenohej me të bijtë. Ata ishin të urtë dhe punëtorë, nga ata djem që më shumë dëgjojnë sesa flasin dhe nuk përpiqen të bien në sy.

Kallushani nuk i mbajti për të fjetur aty Agronin dhe Dianën. Tani që kanë filluar shembjet, ai është ngushtë. Në njërën odë fle ai me Sanijen, në tjetrën, një kthinë e ngushtë, ka vetëm një krevat tek sa për Vjedën. Në bodrum s'mund t'i futë. Ai shkoi e ra pa këmbyer asnjë fjalë me Sanijen. Në zemër kishte një trazim të madh. I therte shpirti nga këto përplasje që kishte me fëmijët. E kuptonte se ata kishin të drejtë. Megjithëse në fillim edhe ai ishte i bindur se do të ishte më mirë të ishin të gjithë bashkë, tani kishte ndërruar mendje. «Po ç'të bëj, hë? T'u liroj rrugë tani që po dal në pension? Jo! Kjo nuk do të bëhet. Bëra e hyra në valle, tani do ta dredh shaminë edhe ca...» — mendoi.

Iu kujtua përsëri mbledhja në shtabin e kantiereve të ndërtimit të qytetit. Met Druvari foli kundër tij. Hekuran Përdrini foli kundër tij. Përdrina e vogël foli kundër tij. Vasil Kushta... Fatihu. «Djalli e mori, — mendoi, — po kush shkon nesër me shërbim tok me djalin e Hekuranit! Mor, po si nuk i thashë Danës të shkojmë tok nesër dhe, me marifet, t'ia hidhja një fjalë ashtu larg e larg. Apo jo, jo. Më mirë ta lë një herë këtë punë. Pa ta shikoj edhe më nga afër atë

Përdreqin që më vjen andej me shërbim. Mor, po Fatihu tha se po shkojmë për oborret... Pse nuk ia hapa Ramës këtë?»

Kallushanin nuk e zinte gjumi. U kthye nga e shoqja. Donte të bisedonte me të e t'i thoshte që Dana të mos nisej, se do të shkonin tok, por Sanija po flinte. Mbi fytyrën e bardhë, me rrudhëza të thella, te sytë, kishte djersë. Ai psherëtiu. Mbylli sytë që ta zinte gjumi...

KAPITULLI I NJËMBËDHJETË

Herët në mëngjes Kallushani shkoi të shihte në kishite ikur Diana. Ishte ende tek Emiri. Do të bënte një vizitë tek Oshllanët dhe pastaj do të tërhiqte disa barna në farmaci. Kallushani iku. Duke shkuar përpara komitetit takoi instruktorin e kuadrit, Sallah Silën, një burrë që nuk mund ta quaje as plak e as të ri, por që e mbante kokën pak si mënjanë e që të shikonte nga poshtë-lart me një buzëqeshje si të dalë me zor. Kallushanit nuk i pëlqente as lëvizja e kokës, as vështrimi e as buzëqeshja, por nuk harronte ta përshëndeste gjithnjë i pari.

— Mirëmëngjesi, shoku Sallah!

— Mirëmëngjesi, bacë! — ia ktheu tjetri. — Pse kaq herët?

— Epo u plaka tani, gjumi e rinia ikën. — Tjetri e shikoi buzagaz dhe e ftoi për kafe.

— Sot prej meje, — tha Kallushani dhe i futi kra-hun. — Timen e di vetë, — i tha bufetierit.

Kallushani e pinte kafën në shtëpi edhe të mesme, edhe me sheqer, por në bufenë e komitetit e shijonte më shumë të fortë e me pak, sidomos kur bufetieri e veçonte nga të tjerët dhe thoshte: «E forta, për bacën!» dhe kështu ia jepte të parit. Edhe helm të ishte pas këtyre fjalëve, ai do ta pinte me qejf. E bufetieri, burrë malësie nga ata mjeshtrit e tregtisë që e dinë mirë se në cilin xhep mbahen qindarkat, ia dinte huqet plakut Kallushan.

Tek pinin kafet fjala rrodhi si me gaz e me kapërcime të shpejta që do t'ua kishte zili edhe Pindari, prej

moshës te pensioni e prej këtej te detyra e ekipit të madh në kooperativat e Kurorës së Pllajës ku do të shkonte ai dhe Besim Përdrini mes të tjerësh. E këtu sapashtu papritur doli emërtimi i Besim Përdrinit.

— Shoqet që kryen shkollën e partisë i caktuam, — tha Sallahu. Sallahu i tregoi për disa që kishin nisur punën nëpër ndërmarrrjet ekonomike. Po ai çuni i Hekuran Përdrinit ku u vendos? Flitet sikur atë e morët në aparat, hë?

Kallushani foli me zë të qetë, të ulët, si i çintere-suar. Por Sallahu që ia njihte gjurmët bishtit të dhel-prës plakë, mendoi ta dridhte më shumë të vetin.

— Llafet! — tha Sallahu. — Llafet e klubit dhe bi-rat e gardhit s'i mbyll dot njeri. Por... me sa duket, jo vetëm do ta marrim. Ai djalë ka shumë perspek-tivë... — Ai ngriti dorën për t'i thënë se do të ngjitej lart dhe ia nguli sytë hetues plakut. Po edhe Kallushani nuk e bëri veten Syri i tij u fsheh qetësisht nën ve-tullën e rëndë.

— Mos ma merr për kapital. Kot llafi. Sesi më du- ket ai spurdhjak që më shumë merret me të tjera pu- në sesa...

— Pas këtij shërbimi ai merr emërimin, — i hodhi më shumë benzinë zjarrit Sallahu. Plaku u ngrys.

U ndanë në sallon. Kallushani u ngjit te Fatihu të merrte hollësira për shërbimin. Një në dorë, — tha me vete. — Po të jetë gjë puna e tij me Dianën, gurin e kam unë në dorë. Unë në udhë, ai në udhë. Një e kam në dorë. Tafti-bafti!»

Sallahu kishte ndaluar te hyrja dhe shikonte i për-qendruar se si i ngjiste tjetri shkallët. Nga njëra anë ishte i kënaqur që ia hodhi plakut. Plaku kishte diçka që interesohej për Besim Përdrinin.

Vasil Kushta ishte me ekipin e shpërnguljes së fsha-trave. Kishte fshatarë që rezistonin për të shkuar në shtëpitë e reja, sepse, sipas tyre, përmytja o bëhej

vitin e ardhshëm o nuk bëhej fare, se nuk kishte bërë vaki të ngjitej përpjetë uji. Jo vetëm kaq, po kishin mbjellë ara e kopshte perimesh dhe pritnin vjeshtën, kurse në hidrocentral ishin zënë tunelet dhe ujërat e liqenit po afroreshin çdo ditë metër pas metri.

Vasil Kushta ishte njeri i qetë, nga ata që marrin zjarr ngadalë, por furtunën e kanë të fortë. Besimi që ishte thirrur prej tij e gjeti në tavolinën e punës duke u marrë me një punë të çuditshme. Ndonëse kishte përpara një dosje, ai, pa u shqetësuar, vazhdonte të shikonte me lente një copë mineral bakri. Ishte zhytur aq shumë në punën e tij, sa nuk e ndjeu Besimin kur hyri. Përkulte kokën mënjanë dhe rrudhte sytë për të parë mirë. Besimin e mori gazi dhe u bë gati të dilte, kur Vasili ngriti sytë, buzëqeshi me përzemërsi, la lenten dhe mineralin e u mbështet i lodhur pas kolltukut.

— Ulu, Besim, ulu! — tha dhe një dritë e gëzueshme i përshkoi fytyrën. — E shikon mineralin? E mora mbrëmë në minierë. Isha atje në mbledhjen e organizatës. Po zien miniera...

— Prapë me sterilin?

— Asgjë për t'u shqetësuar. Ata Rametlinjtë i shpërndamë nga ai front, pasi u dhamë nga një dackë të mirë. Po e keqja nuk është vetëm tek ata. Ajo është edhe në zyrë, edhe këtu te ne. Që të vijë minerali pa llumra, duhet një punë më e mirë te ne, në drejtorinë e ndërmarrjes dhe atje në galeri, — Vasili zgjati dorën, mori gurin mineral dhe psherëtiu. — Interesi, egoizmi, tarafet janë si rrënjët e një nejësi që na ka dalë në dorë. Thonë se nejësit dalin ngase njeriu numëron yjet. Kështu më thoshte nëna, kur isha foshnje. Ka njerëz që nejësit i djegin me eshkë, të tjerë i shkulin pa mëshirë. Atje në minierë, Besim, dikush ka numëruar yjet dhe na mbinë nejësit... Besim, materialin tënd e pamë me sekretarin e parë. E ke bërë mirë. Dua të them që i ke parë mirë gjërat atje. Ne jemi dakord me atë që thuhet në relacionin tënd se kryesorja atje është tarafi, fisi, shefi i kuadrit, të tjerët, pastaj vjen mine-

rali. Po unë nuk të thirra për këtë. Besim, ne kemi vendosur të të dërgojmë me njërin nga ekipet në kooperativë bujqësore: ose për oborret vetjake në Like, ose në Bregaj për të verifikuar një letër që na shkruajnë një grup kooperativistësh. Hë, si thua, në Like apo në Bregaj? Aty në Bregaj do të kesh punë me Ramë Metën dhe Idriz Metën. Apo s'ke qenë ndonjëherë ndër fshatrat e Kurorës së Pllajës? Hë! Si thua?

— Do të shkoj në Bregaj për letrën, — tha Besimi dhe me vete mendoj se rasti po e çonte përsëri afër Dianës dhe njerëzve të saj.

— Neve na intereson shumë të gjejmë rrugë të reja për ngritjen e rendimenteve dhe të vlerës së ditë-punës.

— Bregaj është shumë larg nga ferma?

— Jo, as një orë. Pse? — e pyeti Vasili.

— Kot pyeta, kot.

— Dëgjo, Besim, letra përmban një ngatërresë me kryesinë e kooperativës. Sipas letrës kanë të drejtë punëtorët, sipas një informacioni ka të drejtë kryesia. Neve na duket se aty problemi nuk është shkoqitur mirë as në byro të organizatës, prandaj po të çojmë ty të na e shikosh edhe një herë. Duhet të zgjidhet ky problem...

Vasili u ngrit dhe hapi sirtarin te kasaforta, nxori andej tri fije letra të shkruara me dorë me një shënim në krye, bërë në formë të pjerrët për ndjekje të çështjes.

— Kjo duhet bërë përpara se ata të shqopës, ata janë punëtorë sezonalë që mbledhin shqopë ndër rrethe të tjera, përpara se ata ta denoncojnë kryesinë në gjykatë për shkelje të normave ligjore. Më duket se ata i sqarojnë mirë gjërat këtu. Pa studioje, ndoshta kjo punë zgjidhet në rrugë partie. — Ai i zgjati letrën. — Merre edhe relacionin e kryesisë. — Vasili nxori ca fletë të daktilografuara. I bashkoi me letrën dhe i futi në një dosje. — Pa studioji një herë dhe mendo ç'do të bësh, nga t'ia nisësh.

— Kur të nistem?

— Sot studioji këto. Mirë është të nisësh nesër, por,

po s'qe gati... Besim, shikoje mirë se kjo çështje nuk është e thjeshtë. Ne kemi bindje se do të na e zgjidhësh si duhet... Problemi i punëtorëve të shqopës është ca i ngatërruar, po pa dëgjoji një herë vetë ata shkruesit e letrës, pastaj mendo se ç'mund të bëhet për ta.

Vasili ia kishte ngulur sytë dhe përsëri buzagazi ia ndriçoi fytyrën. Ai kujtoi takimet me punëtorët e uzinës natën e manjetitit. «Besi! Besua! Besua ynë! Kirurgu i metalurgjisë!» — tha njëri nga djemtë e uzinës. «Kush» — e pyeti Vasili. Djali u skuq dhe tha: «Ja, e kam fjalën për shokun Besim.» Edhe në minierë flisnin kështu.

«Mirë, mor shoku Besim, — mendoj Vasili, — a do t'i biesh në të se ç'bëhet atje në kooperativë? Ti je metalurg dhe nuk ke qenë asnjëherë në fshat. Pa të shohim sa do t'i vësh në jetë ato mësimet e ekonomisë politike. Shqopa është provim i vështirë për ty.»

Ra telefoni. Vasili e ngriti dhe i bëri shenjë me dorë Besimit që të mos lëvizte.

— Kush, Nikolla Bushi? Të vijë, po pati punë të shpejtë. Sa, një minutë?! Le të vijë! Besim, qëndro, se dua të pi një kafe me ty.

Pas pak hyri një burrë bojalli, i bëshëm, fytyrëvrrarëlie, me një kasketë ushtarake, nga ato që mbajnë oficerët në lirim.

— Qenkeni i zënë, — tha. — Po s'ju pengoj. Vetëm një minutë.

— Pa uluni, — i tha Vasili. — Uluni një herë. Si i keni punët, a u rregulluat në shtëpinë e re? Më thanë se keni mbjellë dardhë aty rreth shtëpisë. Dikush më tha se keni hapur edhe një si punë tuneli për mbrojtje nën nivel...

Po Nikolla kishte të tjera punë. Mbi ballë i rëndonin mendimet ndër rrudha të trasha, të thella.

— Vaso, më fal që të erdha në zyrë, mund të të takoja edhe jashtë e të mos të haja kohën e punës, — tha Nikolla. — Erdha të të them se pensioni po më mërzit jetën... — Fytyra vrrarëlie iu nxi. Gjurmët e

lisë së dikurshme iu bënë blu dhe zëri iu ul vajtueshëm. — Më caktoni në një punë. Nuk dua asnjë qindarkë më shumë se pensionin. Boll e kam pensionin, po dua punë. Dua një kolektiv, një organizatë-bazë ku të jap llogari e ta ndiej veten të gjallë. Nuk e duroj dot... — Ai e preu fjalën. Si duket, donte të thoshte edhe diçka, po e kishte zor...

— Shoku Nikollë, — iu kthye Vasili serioz, — sikur të na vinin gjithë pensionistët kështu, ç'do të bënim me ta?

Nikolla nisi t'i shpjegohej, po Vasili e kishte mendjen te një pensionist, një ish-nëpunës financash. Ky njeri në vitet e para pas Çlirimit kishte pasur një detyrë me përgjegjësi, por e kishin shkarkuar shpejt, se e kishte kthyer ndërmarrjen në kopsht personal zarzavatesh për njerëzit e tij. S'kishte ndenjur shumë, por që nga ajo kohë jetonte me ndjenjën e njeriut të zotin që ia kanë ngrënë të drejtën. Sapo kishte dalë në pension, nuk kishte bërë punë tjetër, vetëm shkruante letra. Letër sekretarit të parë, letër kryetarit, letra shefave të seksioneve, letra e ankesa lart. Ai merrej edhe me historinë stërgjyshore të fisit të tij, edhe me vjedhësit e mollëve, edhe me një kanal që ata të komunales po hapnin për kabllon elektrike, edhe me trapin që lidhte qytezën e vjetër me shkollën e fshatit ku kritikonte kryetarin e kooperativës që nuk u priste biletë mësuesve të fshatit. Shkruante e shkruante. Vetëm një herë Vasili e kishte parë atë njeri të hollë e të gjatë që erdhi të ankohej kundër drejtorit të muzeut. Ata ishin zënë për punën e tij në vitin 1942. Me sa i kujtohej Vasilit, drejtori i kishte thënë se në vitin 1942 kishte punuar diku në një zyrë... dhe kjo e kishte shqetësuar njeriun e gjatë. Ai kishte ndenjur pa gjumë disa net, nuk shkroi më letër, por erdhi vetë te Vasili. Foli gjatë sa të lodhte. Vasili i tha të rrinte i qetë. Ato gjëra diheshin dhe do të porositej drejtori që të mos bënte pyetje pa takt, por ama edhe ky të rrinte urtë, se si shumë i kishte shqetësuar shokët me

letra pa vend. Tjetri kishte dalë nga zyra dhe s'ishte dukur më. Po edhe letrat i kishte rralluar. «Kur s'ke punë, merresh me gjepura,» — mendoi Vasili.

— Nuk mundem më, — tha Nikolla Bushi me zërin lutës e të mbytur. — Nuk merrem dot me shitësit, kamerierët dhe plakat e lagjes... U zura me plakat e lagjes për plehrat e rrugës. U fola. Pa m'u vërsulën si grerëzat. Më shanë, ç'nuk më thanë. Jo po ti do të na vësh në rresht si ushtarët, jo po ke mbetur si qyq, jo po... s'ia del dot plakës sate... Më kërdisën. Edhe unë i shava sa i tërbova.

— Plakat e lagjes kështu? Plakat! O ç'ta paskan bërë mirë! — po dorën s'ia lëshonte, ndërsa Nikolla kishte ulur sytë dhe nënqeshte i shqetësuar. Rrudhat në ballë ishin thelluar më shumë e shkëlqenin nga djersa.

— Po sikur të të dërgojmë në shtabin e kantiereve të ndërtimit të qytetit? — pyeti Vasili serioz. — Atje kemi punë sa të duash. Je i deleguari ynë. Natyrisht do të ndihmohesh atje për ndonjë problem që nuk na shkon mirë. Ke edhe shokë të mirë aty, metalurgë, punëtorë. Do të jesh i deleguari ynë, veç komandën e kanë të zotët e shtëpisë. Ti do të jesh në rolin e komisarit... Për ndonjë gjë që nuk shkon, eja edhe te ne...

— Po jetën e Partisë?! — Nikolla u çel në fytyrë.

— Me organizatat shoqërore të aparatit. Kurse atje do të ndihmohesh për cilësinë në ndërtimet e reja për aksionet masive me popullin, veç kujdes me plakat e lagjes... — qeshi Vasili.

— Ju falem nderit shumë! — Nikolla lëvizi tërë gjallëri. Vasili thirri një instruktor dhe e porosi të paraqiste Nikollën në shtabin e kantiereve, ku, tok me këshilltarët e frontit, do të merrej me aksionet masive për shembjen e qytezës së vjetër dhe punën vullnetare për ngritjen e blloqeve me apartamente të reja.

— Sallah, — i tha Vasili instruktorit, ndërsa shikonte vetullat e rënda të Nikollës dhe diç mendonte. — Nikollën ta angazhojnë shokët edhe në atë komisionin e strehimit. Më duket është një komision që dis-

kuton problemet e strehimit. përpara se të merret vendimi nga këshillat popullore. Edhe atje le të marrë pjesë Nikolla, se do të na shkojë puna më mirë.

Dolën andej me Vasil Kushtën. Besimi vërejti se Vasilit xhaketa i rrinte lirshëm. Trupi i gjatë, i dobët nuk e mbushte. Kurse Nikolla kishte përshtatur kostumin ushtarak dhe ai i rrinte si i ngrirë në trupin e bëshëm e të lidhur.

Besimi shkoi në shtëpi, u mbyll në dhomën e tij dhe lexoi e rilexoi disa herë letrën dhe relacionin. Vriste mendjen ç'të bënte, po nuk dinte. Dy materialet përjashtonin njëri-tjetrin. Po të pranoje ankesën e punëterëve, dilte se dikush spekulonte mbi kurrizin e tyre. Po të shihje relacionin, dilte se ata ankoheshin me të padrejtë. Ai nuk po i binte më të.

«Të dalë ku të dalë, — tha me vete. — Unë po shkoj në Bregaj dhe ndoshta e takoj edhe Dianën. Rasti ma solli shërbimin kështu.»

Zbriti në qytezën e vjetër duke vrarë mendjen se ç'do t'i thoshte e si do t'ia thoshte që atë e kishin caktuar të shkonte në Bregaj te Ramë Meta. Dielli digjte. Afshi përvëlues ngrihej nga toka si frymë e një të sëmuri. Lumi tekanoz tani ishte ujëpakë dhe tufa fëmijësh laheshin nëpër bërrylat e qetë ku kalohej pa vështirësi edhe në vë. Bregut të lumit ende gjelbëronin kopshtijet e perimeve e të familjeve të pashpërngulura. Hoteli, e vetmja ndërtesë katërkatëshe, përhapte vetmi me lartësinë dhe bardhësinë e tij.

Besimi u fut turmës së vullnetarëve, kaloi në periferi nga Kukajt, shkoi edhe përpara oborrit të Oshllanëve, mos i zinte syri kund Dianën. Po ajo nuk dukej dhe ai nuk mund t'i dërgonte njeri për ta thirrur. U kujtua se nuk kishin lënë orë takimi. «E para herë, — tha me vete. — As unë as ajo. A shihemi nesër paradite? Mirë. Po ku, kur? As unë as ajo.» I vinte pla-

sje se e quante veten fajtor. Ja, tani kishte ardhur këtu dhe po sillej kot.

Te stacioni ishin grumbulluar dhjetëra njerëz në pritje të urbanit. Ata sapo kishin mbaruar orët e punës vullnetare dhe pritnin të ngjiteshin lart.

«Nesër unë do të jem atje, — tha me vete. — Rasti po më çon drejt saj dhe njerëzve të saj.»

KAPITULLI I DYMBËDHJETË

Të nesërmen u vonuan ca se pritën një inspektor arsimit. Në xhips do të vinte një instruktor i rinisë për ta parë gatishmërinë e vullnetarëve që do të niseshin së shpejti në hekurudhë. Ky ishte nga ata të rinj që e marrin punën me merak dhe duan ta kryejnë atë një minutë e më parë. Do të vinte edhe shkrimtari i ri, Sali Kallini. Ky ishte një njeri i heshtur e i vëmendshëm.

Shoferi ishte bërë nervoz se po humbisnin kohën duke pritur inspektorin. Besimi shikonte lëvizjet e tij tek hapte kapakun për të parë motorin.

— Ç'ke kështu? — e pyeti Besimi.

— Patjetër duhet ta presim atë shefin? — pyeti shoferi.

— Ai është inspektor, jo shef.

Shoferi ishte një djalosh që sapo kishte kryer shërbimin ushtarak dhe flokët e verdhë i kishte ende të parritur. Ishte veshur me një këmishë verore në ngjyrë të kaltër.

— E, mo, do ta presim shefin? — përsëriti shoferi i paduruar.

— Inspektorin, — qeshi Besimi.

— Mirë. Ulu përpara, se makina është jona. Vjen për ty e Rexhën, — tha shoferi duke treguar inspektorin.

— Unë do të rri këtu prapa me Saliun, — qeshi Besimi. — Përpara le të rrijë Rexha ose inspektori. — Po Rexha buzëqeshi dhe erdhi e u ul pas. Inspektori doli në sheshin mes ndërtesave, veshur me një kostum blu

të mbyllur që i rrinte mirë. Në dorë kishte një çantë të madhe, të zezë. Ai erdhi tërë gaz dhe, si përshëndeti me kokë, u ul në ndenjësën e parë. Besimi pa se si shoferi i hodhi Rexhës një vështrim komplotues.

— Bëje flutur, se kemi punë, — tha Rexha. — More vesh, Meriman? — Merimani rrudhi ballin nën flokët e verdhë dhe makina e kaloi sheshin me ulërimë. Një copë herë u desh të shtrëngoheshin në ndenjësë se gazi po e rriste shpejtësinë. Kur kaluan rrafshinën e qytezës së vjetër, Saliu i tha Merimanit ta pakësonte shpejtësinë, po shoferi ia ktheu se ekipet kishin shkuar një ditë më parë, kështu që shefin dhe Rexhën nuk i priste puna.

— I kemi të ndara punët, — tha inspektori që Merimani e quajti shef, po kuptohej se ai donte ta për-typte kumbullën që i dhanë, ndonëse ishte e thartë. — Ju, shoku Sali, me leje krijuese jeni?

— Jo. Vetëm për pak ditë mora leje nga drejtori. Po shkoj në gjeologji të bëj një shkrim për gazetën lokale.

— Juve jua lumsha! — tha inspektori. — Orar të reduktuar po, leje krijuese po, leje vjetore po... Ç'të bëjmë ne të varfrit që na robtoi puna.

— Dukesh, — tha Saliu. — Kohët e fundit sikur je dobësuar ca!

Fytyra e inspektorit shkëlqente nga shëndeti e nga gazi. Mbi fytyrën e zbehtë si të tejdukshme të Saliut u ndeh nënqeshja. Makina po i merrte kthesat e malit me gulçimë pa e zvogëluar shpejtësinë. Merimani ishte tendosur në timon dhe nuk merrte pjesë në bisedë. Pas pak ata kaluan qafën dhe përpara u doli Pllaja e gjerë, me relievin e përthyer nga kodrina të ulëta. Fusha vende-vënde ishte pluguar, diku kishte blloqe të mëdha pemësh frutore, diku kishte ende blloqe të gjelbra e të mëdha që i jepnin gjallëri fushës. Rreth e rreth Pllaja kishte malet si një kurorë të vërtetë tërë kreshta të ngri-tura, veshur me pyje. Mes Pllajës zbardhëllonin e shkël-qenin një varg ndërtesash, buzë një përroi që e ndante

fushën mes për mes. Besimi pyeti Saliun në dinte gjë për Bregajt, tjetri i tregoi një grykë mali nga vareshin gjunjët e dy kodrave që sillnin përrua. Ai tha se përroi vazhdonte deri te ndërtesat e sektorit të blegtorisë që zbardhëllonin mes fushës, ndërsa qendra e lokalitetit nuk dukej.

— Edhe sektori i gjeologjisë aty afër Bregajt është. Ju kur do të ktheheni?

— S'e di. Po mbaruam punë, që nesër. — Besimi e pyeti për Jetonin dhe pa se Saliut i ndritën sytë. Buzëqeshi dhe i tha se ai kishte një vepër të bukur ndër duar, një grup skulpturor, por e kishte të vështirë realizimin. Besimi e pyeti se çfarë ishin këto vështirësi që e pengonin Jetonin.

— «Artistike»... — tha Saliu dhe tundi kokën duke treguar inspektorin. Kuptohej se vështirësitë nuk ishin vetëm artistike.» Ndoshta janë nga ato të përditshmet,» — mendoi. Ai e dinte se Jetoni jepte mësim në shkollat e qytetit.

Tani rruga kalonte rrëzës së malit, veshur me lis, frashër e shkozë. Era e pyllit ndihej e freskët dhe e lehtë. Në disa vende, ku kalonin përrenjtë, makina futej mes ujit që rridhte në formën e prroskave të vogla dhe aty-këtu formonin pellgje, të cilat ajo i kalonte me shpejtësi. Besimi zgjati kokën që ta ndiente më mirë erën e pyllit, po vuri re se inspektori e mbylli xhamin e dritares së vet.

Pas pak rruga mori një ulje, ra në livadhe e ara të punuara dhe befas përpara u doli lokaliteti, qendra e gjithë fshatrave. E kaluan atë pa qëndruar, Besimi pa në të dalë të qendrës zyrat e ndërmarrjes bujqësore. I bëri sytë katër mos shihte Dianën, por kot. Ndiante dëshirë të zjarrtë ta takonte këtu, kështu papritur.

Si kaluan pranë dy ujëmbajtësve që shkëlqenin në diell si dy sy të mëdhenj rrëzë Kurorës, rruga mori tatëpjetë një përroi të thellë. Ajo kalonte mes një pellgu të madh plot llucë. Merimani e futi gazin duke ia ngadalësuar shpejtësinë dhe pak, para se të kalonin

mes ujit e llucës. Xhipsi bënte xhiro në vend. Njëra nga rrotat e pasme sillej e ulërinte duke i hedhur stërkalat e ujit e të llumit përpjetë.

— Po tani? — pyeti inspektori i mërzitur.

— Tani pa zbritni pak, — tha Merimani, mbështetur mbi timon. — Do të përpiqem ta nxjerr vetë.

Zbritën të gjithë. Shoferi nuk bëri gjë tjetër, veç i jepte gaz dhe rrota sillej e hidhte stërkalat e ujit sa fëlliqte gjithë suprinën e makinës. Inspektori u ul në breg të përroit mbi zall dhe ndezi një cigare. Shoferi e la makinën dhe erdhi pranë Besimit.

— Mos duhet ta shtyjme? — e pyeti Besimi. Vetulla e Merimanit u ngrit lart me djallëzi.

— Mirë do të bënit, veç duhet të vini të tre, se Saliu... — Inspektori nuk foli. Rrudhi fytyrën dhe hoqi xhakëtën, kur pa se Besimi hoqi këpucët, çorapet, u përvesh mirë e u drejtua te makina. Edhe Rexha i përveshi pantallonat dhe shkoi e u fut në pellg. Instruktori i hoqi ngadalë çorapet, po pantallonat i përveshi fare pak. Merimani e porositi Rexhën të hiqte pantallonat, se mund të stërpikoj. Iu afrua Besimit dhe i tha të zinte anën e djathtë të makinës nga dritarja.

— Kurse ti, — i tha ai Rexhës, — kusur e ke. Atë pas në anën e djathtë. Shpejt! — Ai foli me zë të ulët, ndërsa shikonte vazhdimisht instruktorin dhe i hidhte një sy vjedhurazi inspektorit të arsimit. Kur erdhi ai, këta kishin zënë vendet. Inspektorit i tha ta shtynte makinën në anën e majtë nga fundi.

Sa nisën ta shtynin pak, Merimani i dha me tërë gazin, rrota e pasme e krahut të majtë bëri ca rrotullime aq të furishme, sa e ngriti ujin dhe llumin me një shpejtësi të çuditshme. Inspektori, lagur e përbaltur i gjithi, doli nga pellgu. Sidomos dangat e mëdha bënin kontrast mbi këmishën e bardhë dhe mbi kravatën me ngjyra të ndezura.

Makina as që kishte luajtur fare, ndërsa Merimani i jepte gaz kot dhe shikonte nëpërmjet pasqyrës inspektorin.

— Ç'bëre? — e pyeti Besimi.

— Ç'ke ti, vëlla, mos të ndodhi gjë? — Djali ishte fare i qetë. Shoi motorin. Inspektori ishte afruar dhe po e shante e kërcënonte.

— Pa qetësohu ti, shok, — i tha shoferi, — se nuk u bë hataja. Merrr një shami dhe shko e pastrohu atje më lart.

— Maskara shofer!...

— Pa lëri dënglat, se nuk më hyjnë në punë shef-llëqet, — u nxeh Merimani. — Mos shaj si carrok, se... Dreqi, edhe shef, edhe di të shajë si carrok, dreq shef!

— E di ç'të bëj?! — thirri inspektori i xhindosur ndërsa kullonte ujë nga gjithë trupi. Besimi dhe Rexha e morën shoferin mënjanë. Saliu qeshte nga maja e një kodrine dhe i bënte shenja me dorë dikujt të vinte për ndihmë. Besimi pa se në atë faqe të përroit ngrihej një sondë e gjeologjisë. Tre burra po uleshin poshtë gëmu-shave. Pas ca erdhën aty, këmbyen cigare dhe i thanë Merimanit të hipte. E ngritën xhipsin nga pas dhe e shtynë me forcë përpara. Njëri thirri që të lironte frenat. Xhipsi ecte vetëm me dy rrotat e para. Doli nga pellgu dhe nisi të ecte mbi zall.

— Qenke mistrec i madh, bre! — tha njëri nga sondistët. — Salë, ku e keni gjetur këtë bandill?

— Është dora jonë, po lëre, — tha Saliu.

Po kthehej inspektori. I kishte larë të gjitha dangat, veç i ishte prishur hekuri dhe pantallonat ishin bërë si tuba. Ai rrinte si mënjanë nga grupi. Sondistët nisën t'i ngacmonin, duke i marrë të gjithë si të arsimit.

— Po pse, mor të uruar, i hyni vetëm kësaj pune? Pse s'na thirrret?

— S'është makina ime, — tha inspektori, që rrinte pranë proskës dhe thahej në diell.

Aty u ndanë me sondistët, po edhe me Saliun. Ai ecte mes sondistëve që qeshnin. U ngjitën lart drejt sondës. Xhipsi u ngjit në faqen e djathtë të përroit, eci pesë minuta e qëndroi.

— Këtu rruga shkon për në Bregaj, — tha Meri-

mani. Inspektori seç tha nëpër gojë, mori çantën e zezë, u dha dorën Besimit e Rexhës dhe doli. E përplasi derën aq fort, sa makina u drodh.

Në dalje të luginës së Bregajt, aty ku kodra binte mbi fushë, ishte një ujëmbledhës i vogël. Pak më këtej, si në një kënd të mbrojtur nga erërat ishin shtrungat e dhenve dhe një barakë e vogël barinjsh. Përpara rrugës tufa të mëdha dhensh po ktheheshin nga kullotat. Një bari plak, buzë rrugës, po shikonte valën e bardhë që rrëshqiste lehtë si një re mes gjelbërimit të luginës.

Besimi e kishte mendjen te Diana.

— Të kujt do të jenë këto tufa, të kooperativës, apo të fermës? — e pyeti ai Merimanin.

— Të fermës, — tha djali. — Këtu afër këta kanë edhe baxhon. — Djali e kishte mendjen tjetërrkund. Besimi i tha të qëndronin. Makina frenoi mu pranë bariut plak. Ai u ngrit i turbulluar. Buzëqeshi dhe Besimit i bëri përshtypje se plaku i kishte të gjithë dhëmbët të rregullt. Dukej i fortë, ndonëse i hequr në fytyrë. Ishte i thantë në trup. Plaku shtrëngonte rripin e patickës italiane pranë trupit. Merimani e thirri «baca Selman», Besimi e pyeti në kishte kund ujë aty afër.

— Burimi a bukur larg, — tha baca Selman. — Po ju eni, hej burra, ja ku e kena plemen tonë. Kena dhallë...

Besimi pa se pas tufave qëndronin dy barinj të rinj, të fortë.

— Janë djemtë e bacës, — tha Merimani. Barinjtë po u merrnin anën tufave dhe i shtynin drejt vathave në një si livadh të hapur mu në mes të korijes me lisa.

Bariu plak ecte përpara tyre mes shkurreve. Te lesa e shtrungës së parë dy qen të mëdhenj, të ushqyer mirë, i pritën në mënyrë të çuditshme. Ishin ngritur

dhe shikonin qetësisht këtej. Njëri prej tyre u shtriq.

— I paske të urtë qentë, bacë, — i tha Besimi.

— Posi, posi... Janë sharofë, nuk lehin kot.

— Jemi me bacën, — tha Rexha, — qeni i stanit e njeh mikun dhe armikun.

Plaku u foli qenve dhe ata ikën të qetë e madhështorë si dy gjeneralë kapadainj. Në koliben e barinjve, Selmani u nxori kos e dhallë. Besimi mori bukë me qumësht të ngrohtë. Syri i zgjuar i plakut e ndiqte me vëmendje. Buzagazi në fytyrën e hajthme ishte edhe më i çiltër e më dashamirës.

— Bukën e hake pa teklif si në shtëpi, — tha ai.

— Ha e t'u bëftë tul e dhjamë, mor bir.

Ata u ngritën. Plaku e pyeti se ku punonte dhe Besimi i tregoi se ishte punëtor në uzinën e bakrit. Rexha i tha se e kishin dërguar për punë partie.

— Në Bregaj për punë partie? — pyeti plaku Selman me interes.

— Në Bregaj, bacë, në Bregaj. Po ti pse qesh?

— Jo, kot. Bosh llafi. Po shkoke ke Idrizi, ke kryetar Idrizi. Ani... Edhe ai ka kanë dikur me dhentë e shtetit, po tufa i pakësohej si me i pa hi dreqi në kope, kurse qetash që aj a zot atje, i paket tufa e koprativës, nësa ato personalet i rriten e shumohen si bari i pranverës.

Dy djemtë e bacës i takuan afër shtrungës së parë.

— Ua paske dhënë zanatin djemve, — i tha Besimi.

— Bash qashtu a! — tha Selmani i gëzuar. — Këta i kam me vedi, po e kam edhe nja doktor për bagti atje me doktoreshë Dianën.

— E ka zooteknik, — tha Merimani. — Është në sektorin e blegtorisë atje... — ai tregoi me dorë qendrën blegtorale në mes të Pllajës.

Te sytë e kaltër e të mençur të plakut Selman, Besimi përfytyroi tiparet e djaloshit flokëverdhtë që e kishte parë disa herë me Dianën kur vinin në qytet për ndonjë mbledhje. Djali e shikonte me një ndjenjë xhelozie se, si dukej, e kishte hetuar miqësinë e tyre.

— Djalin ta njoh, bacë. E kam takuar tok me doktoreshën.

— Ah, me doktoreshën! — Plakut i ngazëllyen sytë plot gëzim e shqetësim. — Doktoreshën s'na e ka kush. Po e preku ajo kafshën me dorë, e ka prekë vetë zoti. E ka dorën vakëf. Se njeriu a gjaja ma e çmueshme e tokës dhe e qiellit.

— Po pushkën, pse e mban edhe në mes të ditës? — e pyeti Merimani.

— Ç'lanë ujqit natën, përlajnë çakajtë ditën, paj pushka po më duhet. Mandej, edhe sikur më kruhet pak supi. S'baj dot pa te... — Dora eshtake lëvizi e shtrëngoi edhe më mirë rripin e pushkës. — Në jetë të jetës im gjysh e im atë janë marrë me bagëti. Tani ene unë e bijtë me to po merremi. I duem njisoj si tonat, ene kto qi shifni, ene ato që i ruejnë cullt në oborrin personal tu shpija. Qe kshu a puna eme ene e pushkës, or bir.

— A të vjen djali këtej, bace? — e pyeti Besimi.

— Dje më erdh Diana, doktoresha. Ishte me Kallushin e ata të ekipit qi shkuen dje në Bregaj, po u kthye e pa tufën e rimontit. M'i pa dhentë një më një, po ne i kemi bet, na, shifi vetë...

Besimi u përpoq të dallonte nëse baca Selman ia kishte vënë syrin për të birin Dianës. Ndoshta diku në ndërgjegjen e këtij njeriu të mirë jetonte e fshehtë dhe e tulatur, xixëllonte plot dëshirë diku thellë e largët dhe e ngrohtë si dashuria e prindit ëndrra për ta pasur Dianën nuse në shtëpi. Po nuk dalloi dot gjë. Plaku buzëqeshte vazhdimisht dhe herë-herë shtrëngonte rripin e patickës italiane, trofe të luftës. I ishte bërë qejfi që Besimi ia «kishte ngrënë bukën në stan» edhe i pëlqente të fliste e ta lavdëronte doktoreshën. Besimi i shtrëngoi dorën, e falënderoi për pritjen dhe u ndanë me të aty ku niste rruga e makinës.

Po binte mesdita dhe vapa po derdhej mbi korije. Mbi lisa zhuzhinte gjinkalla që plaste prej të nxehtit. Një avull i lehtë ngrihej mbi korijen e gjelbër.

KAPITULLI I TREMBËDHJETË

401

«Gazi 69» qëndroi në sheshin përpara zyrave të kooperativës. Rexha shkoi të takonte shokët e rinisë. Besimit i thanë se sekretari i byrosë për kooperativën ishte aty. Ai ngjiti shkallët e ulëta të ndërtesës së gjatë. Sekretari ishte një burrë i shkurtër, i shëndoshë. Nën ballin e lartë vështronin dy sy të mprehtë. Besimi e kishte parë vetëm një herë në mbledhjen e plenumit të partisë në rreth, ku ai kishte diskutuar për blegtorinë. Atëherë ata e kishin pasur mirë blegtorinë. Sekretari i parë e kishte pyetur për mungesat në sektorët e tjerë. Ai ishte skuqur dhe i kishte thënë se disa zëra të planit po i mbyllnin me blegtorinë. Sekretari nuk i kishte thënë gjë aty për aty, po në fjalën e mbylljes e kishte kritikuar. «Nëse ke plan grurë, populli do grurë dhe jo lesh në vend të grurit,» — kishte thënë. Ajo përskuqje nuk i ishte hequr nga faqja e këtij burri dhe Besimit i kishte lindur përshtypja se ky ishte nga ato natyra të ndershme që ndeshen me një mijë halle në jetë, luftojnë, arrijnë deri në një pikë, janë të ndërgjegjshëm për mosarritjet, shpërdorimet dhe nuk ua bën zemra t'i fshehin. E, nëse vetëm një çast ngre krye ajo ndjenja e vetëmburrjes për suksesin e arritur, skuqen. Të tillë e njihte Besimi. Quhej Tafë Danaj.

Tafa i hodhi një sy mandatit, rrudhi ballin i pakënaqur dhe nuk tha asnjë fjalë as për letrën e as për relacionin. Ai e pyeti për punën e biraçëve ndër konverte, për realizimin e gjashtëmujorit të parë, për perspektivën. Pastaj, si papritur, tha se metalurgët i ki-

shte qejf, se diskutimet i bënin shkurt dhe të prera. «Puna përcakton edhe llafet, — tha. — Kurse në bujqësi diskutimet s'kanë fund.» Biseduan për thekrën, për gjendjen e misrit, për grurin që kishin futur brenda. Tafa tha se kishin marrë mirë. Kjo «mirë» ishte tetëmbëdhjetë kuintalë për hektar, kurse ndër parcela eksperimentale kishin marrë njëzet e tetë. Besimi vrau mendjen të kujtonte ndonjë shifër nga arritjet në grurë në kooperativat malore, por nuk i kujtoheshin. I zënë ngushtë, ndjeu se i digjnin faqet. Ngriti sytë dhe pa se Tafa kishte vënë buzën në gaz.

— Po ferma sa mori? — e pyeti Besimi.

— Ka marrë njëzet e tetë për hektar, ka marrë edhe dyzet... Po atje ndryshon puna, ndryshon toka, edhe kushtet janë të tjera. Megjithëkëtë ne atje i kemi sytë. «Të gjithë flasin ndryshe për fermën, — mendoi Besimi. — Edhe baca Selman, edhe ky.»

U ngritën dhe shkuan nga klubi. Tafa porositi kafe dhe u ulën në një kënd. Salla ishte plot njerëz. Pas ca erdhi Rexha, skuqur e djersitur. U ul pranë tyre dhe tha me zë të ulët, ndërsa sytë i nxirrnin xixa:

— Shoku Tafë, unë nuk ulem poshtë pa vullnetarët...

— Kush të tha të shkosh pa vullnetarët? — qeshi Tafa. — Rri këtu dhe të shtunën shko tok me vullnetarët tanë. Tani pi një kafe, se je lodhur, pastaj takohu me Xhemaliun, sekretarin e byrosë së rinisë. Ai të priste që mbrëmë.

Rexha nuk foli më. U zbut. Piu kafën dhe ata u ngritën e shkuan përsëri në zyrë. Mbi tavolinë qëndronte letra e punëtorëve të shqopës. Sytë e mprehtë ngjyrë plumbi të Tafë Danajt u ngjitën te letra, pastaj lëvizën të shqetësuar sikur kërkonin hapësirë.

— Ah, sa punë e ngatërruar kjo e shqopës! — tha Tafa. — Shokët këtu mbështeten në statut e nuk u japin të drejtë punëtorëve... Disa i mbështesin dhe ngulin këmbë që t'u jepen paratë në dorë. Unë nuk i bie më të. Si na mbeti edhe kryetari me ata të ekipit... Ta thërras?

— Jo, — i tha Besimi, — dua mendimin tënd. Përse kooperativa të marrë përqindjet nga paga që u paguan shteti si punëtorë? Përse punëtorët ngulin këmbë që t'i marrin paratë në dorë tani dhe jo me ditë pune në fund? Ky është kyçi.

— Po. Ky është kyçi, — tha Tafa i nemitur. — Ky drejç interesi po e ngre kokën sa herë... — Ai e lexoi letrën përsëri, po edhe relacionin që kishte nënshkruar vetë. Besimi po e vërente me ngulm dhe pa në fytyrën e ngjallur dhe të ngrysur një bezdi, prej së cilës donte të çlirohej sa më parë.

— Ç'thua? — e pyeti, si pa që ai e shtyu relacionin mënjanë.

— Ç'të them? Disa gjëra janë të njohura, po ka edhe të tjera që s'i marr vesh as unë. Një pjesë të punëtorëve kooperativa i lejoi të shkonin pa kontratë, se ishin nevojtarë. Një pjesë tjetër i lejoi, por me kontratë, si forca pune të rregullta të kooperativës. Te ne është ditë-puna që përcakton pagën, nuk ka paga fikse si te ju në uzinë...

— Po shqopën e mbledh ndërmarrja shtetërore, jo kooperativa?

— E di. Po forcat janë tonat.

— Sa vetë kanë qenë këtë vit? — e pyeti Besimi, pa i hyrë mirë kuptimit të fjalëve të Tafës mbi punëtorët me kontratë e pa kontratë.

— Nja tridhjetë a dyzet shpirt.

— Tridhjetë apo dyzet?

— Saktësisht i di shefi i llogarisë. Ta thërras?

— Jo, më vonë. Më duket se këtu duhet të dimë saktësisht njerëzit që kanë punuar, përqindjet e ndaluar, derdhjet e tyre në fondin e kooperativës e ndonjë gjë tjetër, sepse nuk shkruhet letra kot për sekretarin.

— Të them të drejtën, me këtë punë u mor vetë kryetari, Idriz Meta, dhe unë e quajta të mbaruar. Edhe relacionin në bazë të shokëve e bëra.

— Cilët shokë?

— Po ja, kryetari që e kemi edhe anëtar të byrosë së organizatës, shefi i llogarisë...

— Dhe ju i quani të ligjshme veprimet?

— Sigurisht. Ndryshe s'e nisja relacionin. — Ai buzëqeshi me zor dhe vazhdoi i qetë e me tonin dashamirës: — Po ule pak tonin. Më mbyte me pyetje sikur të isha në hetuesi. Fundi i fundit, jemi shokë. Jemi anëtarë të partisë. Unë mund të jem edhe gabim, por tonin s'e ke mirë...

— Unë dua të di të vërtetën. Atë do ta gjejmë bashkë se, më duket, këtu, — ai mori letrën, — ka diçka që nuk shkon. Nuk mund ta shkruajnë kot...

— Ah, ajo bushtra plakë, prona private, ajo gene e ka fajin. Leh diku brenda gardhit dhe këputet zinxhiri i telasheve... — tha ai i menduar dhe sytë ngjyrë plumbi u thelluan e u rënduan përsëri. «Prona private, — mendoj Besimi. — Po ku është këtu prona private? Disa janë me kontratë, disa pa kontratë. Interesi i tyre, interesi i grupit kooperativist, interesi i shoqërisë. Ku është e keqja këtu?».

— Letrën e kanë drejtuar në emër të të gjithëve, apo jo? — e pyeti Besimi. Tafa pohoï me kokë. Ata u hëngrën edhe ca për udhëzimet që lejonin anëtarin e kooperativës të punonte në industri, të punonte si punëtor i përkohshëm në shqopë, të punonte si anëtar kooperative në sipërmarrje të vogla si hapje kanalesh, për ujësjellës e ujëmbledhës. Besimi mundi të fiksonte në kokë punën e njeriut në marrëdhëniet me grupin kooperativist dhe punën e njeriut në marrëdhënie me gjithë shoqërinë në shtet, pagën e punëtorit dhe ditën e punës.... Ai e pa se Tafa disa gjëra i shpjegonte nga praktika. Udhëzimet e qeverisë nuk i kishte shumë të qarta. Po si ishin udhëzimet e qeverisë? Përpara po i shpaloseshin të gjitha ato që ai kishte mësuar në shkollë.

— Nëse në këtë mes nuk përfillet dita e punës, por paga, këtu lind diferencimi, — tha Tafa. — Diferencim ndër pagesa, në shpërndarje. Po ku është e keqja, as unë nuk e kam të qartë. Për këtë djall relacioni unë u mbështeta në ato që më thanë shokët.

— Shefi i llogarisë është anëtar i partisë?

— Jo.

— Po te punëtorët e shqopës keni anëtarë?

— Vetëm tre. Të tjerë nuk lejuam. Ata të tre punuan në luginat e Fanit, në Kërrabë dhe Sulovë. Kurse të tjerët ia nisin në Fushë-Arrëz dhe mbarojnë pas gjashtë muajsh në krahinat e Vlorës. Është punë e vështirë. Për pesë a gjashtë muaj as që e merr vesh se ku janë...

— Përse nuk e bëjnë këtë punë punëtorët e rretheve të tjera?

— Nuk e njohin zanatin, kurse tanët e kanë trashëgim. Çdo vit, kur zbritnin e dimëronin me bagëti zonave të buta, merreshin edhe me punë andej-këtej. Ose çanin dru qyteteve, ose nxirrnin shqopë luginave. Për shqopë janë mjeshtër, por heqin pisërinë... Shpërndahen kokrra-kokrra shpateve e luginave. Gjejnë zonën me shqopë. Nxjerrin trungjet, shkulin rrënjët. Atje ngrenë një kasolle, hanë, flenë. Furnizimin e përballojnë vetë, transportin e shqopës vetë. Një mijë telashe ka kjo lloj pune, pesëfish më e vështirë se në kooperativë. Prandaj rrallëkush shkon në shqopë.

Siç shihej, Tafa me zemër ishte për pagesat, por kishte diçka që e pengonte. Ai kishte nënshkruar që t'u jepej shpërblimi të gjithëve vetëm mbi bazën e ditë-punës sipas vlerës vjetore që do t'i dilte kooperativës. Kurse tani u qante hallin punëtorëve.

— Byronë e mblodhe përpara këtij relacioni? — e pyeti Besimi.

— S'ish nevoja. U këshillova me shokët dhe...

— Po me punëtorët?

— Me ata? Ata dihet, duan lekët. S'është çudi që ata tre shokët që kemi të organizuar mes tyre, të jenë nxitësit e letrës.

Besimi mendoi se duhej të takonte patjetër tre punëtorët komunistë. Po edhe kryetarin dhe shefin e llogarisë. Shefi kishte udhëzimet e qeverisë, ai inter-

pretonte statutin, udhëzimet, ligjshmërinë, ditë-punën. Ndoshta e drejta qëndronte me të, ku ta dish. «Më mirë po bisedoj me tre punëtorët.» — mendoj ai.

— Dua të takoj tre punëtorët komunistë, — tha.
— A ke se si të m'i thërrasësh?

— Këtu janë, — tha Tafa, — veç ata s'janë punëtorë, po kooperativistë. Ti je mësuar në uzinë dhe të gjithë të duken punëtorë, — buzëqeshi ai.

— Ta shikojmë tok, — tha Besimi. — Ndoshta këtu ka një ngatërresë të vogël që do sqaruar. Mundet që në rastin e dhënë të jenë pikërisht punëtorë dhe pikërisht këtu të jetë ngatërresa: paga si punëtor dhe ditë-puna si kooperativist. Nga tërheq interesi i tyre? Kujt i shërben ky interes? Si janë udhëzimet? Pse kaq këmbëngulje nga të dy palët?

Kryetari Idriz Meta ishte me ekipin e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit për studimin e oborreve personale. «Është me shokun Kallush,» — tha shefi i llogarisë. Ai është një djalë i ri. Besimit i bëri përshtypje vështrimi tinëzar, gjithnjë si i hutuar, teposhtë, kurrë drejt në sy. Një maskë përvujtnie e dashamirësie të shtirur i ndehej mbi fytyrën e bardhë. Flokët e lyrosur me vaj flokësh i qëndronin si të lëpirë e të ngrirë në kokë. Edhe veshjen e kishte të kujdesshme dhe njeriu nuk mund të thoshte se ky djalë i ri nuk kishte shije. «Ku e kam parë këtë njeri? — tha me vete Besimi. — Jo kam parë një tjetër, jo këtë. Ai ishte normist, kartelist, llogaritar ose diçka tjetër, por jo shef. Bëhej një gjyq për atësi fëmije. Një grua e re truphedhur me foshnjën në duar kërkonte atësinë, kurse ai «shenjtori» shikonte pllakat e dyshemesë, fliste me zë të ulët si një fatkeq që i binin më qafë dhe nuk pranonte fëmijën. Besimin e kishte tërbuar ajo pamje prej njeriu të pafajshëm, të përvuajtur e të urtë, që dinte të vishej mirë.

Këtë mendonte me vete Besimi duke shikuar shefin e llogarisë, ndërsa tjetri po i fliste shpejt e rrjedhshëm.

Ai bëri një hyrje të gjatë, hapi statutin, lexoi disa nene, nxori një udhëzim të qeverisë. Edhe një tjetër. Shefi kishte kryer Fakultetin Ekonomik. I dinte përmendsh nen për nen. Mbronte me zjarr ditë-punën, interesin e grupit.

— Çdo kooperativist i di ligjet tona ekonomike më mirë se ne të dy, — tha Besimi pa e fshehur neverinë. — Ligjet janë jeta e tij, buka e përditshme. Ka njerëz të thjeshtë që e bëjnë ekonominë politike në parcelë. Gjithë puna është si zbatohen këto, si interpretohen nga ne, Mos vallë ne e shkelim diku pa dashur?...

Po shefi përsëri nxori dispozitat, udhëzimet. «Këto i përdor si mburojë», — mendoi Besimi. Shikoi Tafën. Ai i ulur në karrige, nuk e kishte hapur gojën gjatë gjithë kohës. Tafa shikonte i mërziur e si në merak tej dritares, andej nga binte përroi i thellë nën këmbët e korijes me lisa. Ishte e qartë: shefi nuk po hapte asnjë shteg.

Kur u ndodhën vetëm për vetëm me Tafën në sheshin përpara zyrave, Tafa i tha:

— Ndoshta e kam gabim edhe unë. Këtu vjen erë puna... Ka mjaft gjëra të paqarta. Edhe ky drejt, — Tafa tregoi zyrën e llogarisë, — si shumë po përpushet. Mos e ka qullosur edhe ky me Idrizin?

— Me cilin?

— Me kryetarin tonë, Idriz Metën. Më duket se përqindjet këta i kanë derdhur në bankë në fondin e të ardhurave. Ky mund të jetë ndonjë marifet për rritjen fiktive të ditë-punës, po ajo s'duhet të rritet në kurriz të disa vetave... Unë nuk i kam parë as dokumentet. Atëherë dëgjova Idrizin që ma shpjegoi këtë punë si me të qeshur, kalimthi, shoqërisht. Dhe nuk i pashë dokumentet. Që ta marrësh vesh ti, vëlla, mes punëtorëve janë tri grupe: njëri, ata shkruesit e letrës që kërkojnë përqindjet, një grup tjetër që, me

sa më ka zënë veshi, është dakord t'u mbahen dhe t'u paguhen në fund të vitit ose tani nuk e kam shumë të qartë. Është edhe një grup që nuk thonë gjë, sikur i druhen Idrizit.

— Nëse është kështu, ka mundësi të kenë të drejtë punëtorët.

— Është shpejt ta them këtë. Këtu, ose nuk ka gjë, ose ka diçka më shumë se ato përqindjet që kërkojnë punëtorët. Të gjitha prroskat çojnë ujë po në një vend. Pa të shohim... — Tafë Danaj u largua që të thërriste kooperativistët që kishin shkruar letrën.

Në majat e ulëta të malit binte dielli i pasditës dhe korijet me lisa dukeshin të verdha e të praruara. Një erë e freskët zbriste gjatë grykës e derdhej poshtë për në fushë. Tufat e fermës ishin përhapur livadheve rrëzë korijes. Ai kujtoi Dianën dhe u përpoq të shquante njerëzit që lëviznin përpara stallave të gjata në sektorin e blegtorisë.

Dita po zbehej dhe zunë të vareshin hijet. «Sikur ta dinte ajo që unë jam këtu, — tha me vete. — Do të gjej rastin e ta marr në telefon nga zyra e Tafës.»

Ai hoqi xhaketën dhe u ul nën hijen e një molle. Përpara tij zbriste lehtë bregu i përroit. Zëri çjerrës i një laraske ushtoi në përrua. Ai e ndoqi me sy fluturimin e saj në kërkim të mashkullit të vet. Një harabel-çoban me krifikën e hirtë këndonte me zë të ëmbël fiu-fiuu-fiu! Seç kishte gjetur për të ngrënë. Ai kulloste mbi barin e egër të livadhit.

KAPITULLI I KATËRMBËDHJETË

Po binte muzgu malor. Koriya po dremiste. Diku mes lisash fëmijët po afronin tufat e dhive, të lopëve dhe ca tufa të vogla dhensh. Ata kishin ndezur zjarr diku pas shpïnës së murrme të kodrës dhe tymi i kaltër ngrihej lart e tretej në ajrin e korijes.

Besimi dëgjoi se dikush u kollit pas tij. Ktheu kokën dhe pa një burrë të shkurtër dërdëng me tiroide të zhvilluar që i varej si gushë patoku. Krahas i shkonte një djalë me favorite të gjata e flokë të paqethur.

— S'ka, më heq fati, — qeshi mbytur burri. — Nuk shkel kush në vakëf, pa marrë dorë ke shehu. Mbramë Kallushi, sonte ky shoqi. Ku na hupi ai drej zootekniku? — Burri fliste si me vete dhe djali qeshte. Burri ishte kryetari i kooperativës, Idriz Meta, ndërsa djali me favorite ishte agronom i sektorit të dytë. Besimit iu duk i vogël djali dhe e pyeti për shkollën. Djali tha se kishte kryer shkollën e mesme bujqësore. Idrizi nuk e dha vëten. Nuk u interesua për problemin e as e pyeti për gjë tjetër. Me gazin e një babiloku ai hapi fjalën për valën e të korrave, për thekrën e faqeve (i tregoi me dorë brezat e sipërm që verdhonnin ende nga drita e zbehtë e perëndimit), për elbin. Edhe pataten e kishin të mbarë. Edhe për blegtorinë do të merrnin masa e do të siguronin me kohë bazën ushqimore, po Bregaj ishte vend i lartë, «grykë furtunash», e bagëtinë e kishin ca zaif.

— Kur më thanë tash se ka ardhë edhe një shok tjetër për ekip, pyeta shokin Kallush, po s'dinte gja.

Thashë mos na ka ardhë ndonji gazetar, se ata janë ca xhevahirë... A i njef ata të gazetës lokale?

«E paskan njoftuar, — mendoj Besimi, — por, sa e nxori kokën, i fshehu menjëherë këmbët nën vete.» Sytë e shkathët hetues, plot gjallëri, nuk tregonin gaz sesa një kërshtëri këmbëngulëse.

— A keni berber këtu? — e ndërroi fjalën Besimi.

— Aty a, — tha Idrizi. — Kur të dush, shko e qithu. Po eja njëherë, eja e shkojme ke klubi, se Tafa s'po duket e...

Besimi s'po lëvizte. Idrizi e pikasi që fjala ishte për djalin.

— Or ti tutkun, — i tha djalit, — shko e qithu, se m'je ba si dash merinos. Shko e tako pak ene zooteknikun e thuji të duket kah klubi...

Djali u largua. Përpara klubit Tafë Danaj me një grup burrash po pritnin.

— Shife, shife Tafën, — qeshi Idrizi pa shkak. — Qetash po shkojmë kah shpia eme. A vonë. Po e thërras edhe Tafën.

— Jo, — i tha Besimi. — Unë kam punë dhe dua të shikoj revistën televizive. — Ai tregoi antenën e televizorit mbi pullazin e klubit.

— Ani, si t'duesh. Për shfaqje shko, po për darkë klubi s'ka gja të hajrit, veç grosh e kos...

U nisën të dy drejt klubit. Besimi e pyeti për gjendjen e deles rude. Idrizi qeshi sikur t'i thoshte: «Do të më shëtisësh kodër më kodër, ani...»

— A flliqë, — tha. — Rudja a ligë e ba për faqe të zezë. Që kur i përzime me cigaja e merinosa, peja e kape dashin se ku shkon me kërkue nuse. Pa po ngrihet q'ai rudaki ynë e ua hyp cigajave, pa po vjen q'ai merinosi e të lan lesh ndër rudat. Kejt tufa a ba lesh dreqi. Me m'pyet mue, i përdaj sa në një majë e në një majë, që t'i shofin delet e njeni-tjetrit, veç në andërr. Dëgjo, — tha dhe i vuri në sup dorën eshtake si kucër, rrudhi sytë e i foli

plot seriozitet, — pushtnia e njerëzve jashta shtetit a shtri ene në deshët e tyne. Q'ai merinosi a bash pusht...

Besimi qeshi me zë të lartë. Pa fytyrat e vrenjtura të një pjesë të burrave pranë Tafë Danajt që e shikonin ftohtë e me mosbesim. Ata nuk pritën, por hynë në klub.

Në sallën e klubit mbi njëzet veta po shikonin programin televiziv, ulur ndër stola të gjatë. Disa të tjerë luanin shah, pinin duhan dhe flitnin me zë të lartë. Kryetari e tërhoqi Besimin në një sallë të vogël si të veçuar, ku duhej të ishin futur të tjerët me Tafën.

— Qenki ba një dorë e mirë, — tha Idrizi. — A i ka kush letrat? — Po ata nuk iu përgjigjën. Besimi u përshëndet dhe u ul. Në sallë ishte një raft librash, një tavolinë shkrimi dhe ca karrige e stola. Siç kuptohej, kjo duhej të ishte zyra e përgjegjësit. Idrizi u tregoi për agronomin dhe ata qeshën. Vetëm njëri, një malësor i gjatë, pak i thyer në moshë, i parruar, me dorë të trashë sa një kopaçe, kishte ulur sytë, thithte duhan dhe nuk ia vuri veshin Idrizit. «Kjo dorë-kopaça duhet të jetë njëri nga ata të letrës, — mendoi Besimi. — Më panë si qeshnim me Idrizin dhe tani ndoshta thonë: E paska bërë Idrizi për vete. Hokat e Idrizit u thonë: Me mua s'kapeni dot. Shkruani letra ju, të dërguarit vijnë tek unë.»

Kuptohej, malësori ishte i vendosur për t'i qëndruar ballë për ballë deri në fund Idriz Metës.

«Mos ky Idrizi bën ligjin këtu?» — tha me vete Besimi. Ai shikoi dorëkopaçen dhe, kur vështrimet e tyre u ndeshën, burri vuri buzën në gaz. Futi dorën në xhepin e xhamadanit prej shajaku të zi dhe nxori kutinë e duhanit.

— E dredh vetë apo ta dredhin të tjerët? — e pyeti ai për cigaren. Besimi mori kutinë. Fjala që si thikë me dy tehe. Nuk ishte fjala për cigaren, po për detyrën. Besimi e kuptoi se deri tani kishte parë

vetëm dorën e trashë si kopaçe të malësorit, por jo mendjen e tij të mprehtë.

— Si të qëllojë, — ia priti Besimi pak i mërzitur, se mendonte që nuk duhej ta hapte fjalën kështu pa e studiuar mirë me Tafën. — Ose e bëj si duhet bërë, ose e prish krejt. Po deshe, ndihmomë...

Ia tha. U morën vesh edhe kështu. Sytë e mençur u gjallëruan në fytyrën e parruar. Ia tha me gjuhën e tij:

— Ose do ta zgjidh problemin e shqopës, ose mirë mbetshi. Po më mirë ndihmomë. — Malësori i tha ta provonte një herë vetë cigaren. Pastaj e pyeti ku punonte.

— Në uzinën e bakrit, në konvert. — tha Besimi.

— Bakër! Ajo është punë... E sa për cigaren, mos ki keq, të ndihmoj që ç'ke me të. Dora m'u thaftë në s'të ndihmofsha!

— Punë a çdo punë, — u fry tiroidja e Idrizit nga të keqtë.

— Kështu ka thanë edhe im atë, — tha malësori dhe i zgjati cigaren Besimit.

— Cigaren dridhe, po jo llafin ti, Aziz, — tha Idrizi i përmbajtur. — Këtë shoqin e kena prej qytetit e s'na e kap dot llafin.

— Prandaj ia drodha, — qeshi malësori që e quanin Aziz.

— Atje në uzinë paguajnë mirë, — ngacmoi Idrizi.

— Ama llaf! — ndërhyri malësori.

— Me normë, — tha Besimi.

— Po ju, shoku Besim, sa ju paguajnë, kur punoni mirë, kur e tejkalonë normën? — pyeti malësori. Problemi po dilte si rastësisht. Besimi vendosi ta nxiste bisedën.

— Si të qëllojë, — tha. — Shtatëqind, tetëqind, po, kur kemi tejkallim, edhe më shumë.

— Hë, më ta lumsha! — ndërhyri Idrizi. — Kam thanë unë, punëtori e ka qeleshen mbi sy. — Tafë Danaj thithte duhan i shqetësuar, po nuk ndërhynte.

— Bash ashtu nuk është, shoku Idriz, — i tha Besimi. — Metalurgu nuk ka oborr personal, as dynmëshin, as lopën, as të imëtat. Sikur të hiqnit këto oborret dhe të forcohej kooperativa, këtu ditë-puna do të rritej edhe më, por në rrugë të tjera...

— Or ti, or ti... — Idrizi përplasi qerpikët e shqetësuar.

— Kam dëgjuar, — vazhdoi Besimi i qetë, — se në një kooperativë, ndoshta te ju kjo nuk ndodh, po diku tjetër kishin më shumë dhen ndër tufat e oborreve sesa në kooperativë. Bile po ajo kooperativë nxirrte nga parcelat personale më shumë misër sesa nga ato të përbashkëtat. Ju e keni dëgjuar këtë?

— Or ti drej, më fal, — e mori me gaz Idrizi, — mos ma thellë. Paj ti je fshatar a metalurg?

— Dridhe, kryefar, dridhe, — e kapi Azizi.

— Mos përziej, or Aziz... Mos e përziej komshinë në avllinë tënde. Shoki a lodhë e ka ardhë për punë të tjera, kurse ti...

Tafë Danajt iu çel fytyra. «Domethënë s'ia ke hapur fjalën?» — pyesnin sytë e tij ngjyrë plumbi si me lutje. Besimi i buzëqeshi, po malësori e kishte zënë me Idrizin dhe po vazhdonin haptas.

— Shoku Besim, — tha ai, — ti je i dërguar nga Partia, mund të kesh punë të tjera e ne kot po të ngasim me pyetje. Dua të di, a ka ligj që të merren përqindjet nga paga e njeriut, kur vetë shteti ta jep për punën e bërë?

Të gjithë ngulën sytë te Besimi. Ai ndjeu pëshën e gjithë asaj që donte të zgjidhte, po u përplas pa kohë dhe vendi nuk ishte i përshtatshëm. Si duket Tafa e kuptoi gjendjen dhe ndërhyri:

— Boll na sollët anës e anës. Ana s'ka veç kallinj pa bukë. Ky, shoku Besim, — Tafa tregoi Azizin, — është njëri nga punëtorët e shqopës. Atje e ka hallin. Mund ta sqarojë vetë kryetari.

— Kur qielli s'ka ré, s'ka ça me kthjellue, — tha Idrizi.

— Ka, ka, — nguli këmbë Tafa.

— Qe to punë nuk bahen krye e më krye që tu në klub, lum Tafa, — fytyra tërë kërcënim e Idriz Metës u ndez, — por në zyrën e llogarisë. Atje janë hëm ligjet, hëm paret.

— Ne po bisedojmë, — ia priti ftohtë Tafa. — I urti fjalën s'e lëshon azat.

— Sekretar të kena zgjedhë jo për me na i dredhë llafet klubeve... — Tani ai po i bënte presion sekretarit në emër të parimeve, se në zgjedhjet e reja në Parti Idrizi mund të thoshte fjalën e vet dhe mund ta hiqnin. «Ky po sillet si zot këtu, — mendoi Besimi. — Kjo është e qartë edhe këtu ka shumë që ia kanë frikën. «Të kena zgjedhë,» tha Idrizi. Çdo vit bëhen zgjedhjet në Parti. Po ti, Idriz Meta, a jep llogari ndonjëherë? A pyeten këta që u bie bretku pas shqopës? Përse nuk diskutohesh edhe ti vit për vit?» Besimi po shikonte me vëmendje një burrë që rrinte pas Tafë Danajt. Ishte një malësor i dobët, i hequr, i zbehtë. Rrinte si mënjanë dhe nuk fliste. Si hetoi vështrimin e Besimit, ai u kthye nga ata dhe sytë i morën një shkëlqim të ethshëm.

— E përse nuk e sqaron shokun e ardhur, o kryetar? — tha ai. — Ja, po ia them unë. Qe ta merrni vesh punën e shqopës, unë, për besë, edhe pesëdhjetë djem të kisha, një nuk e çoj të mbledhë shqopë, sikur ta di se jetoj në labot e broktha. Niset njeriu në teotor me një sëpatë e kazmë në qyr, ngre diku një kasolle, shfrytëzon zonën. Ai ec e kasollja ec si kërmilli herë në një breg e herë në një kodër. As ky Idrizi dhe askush tjetër nuk pyet në jemi gjallë. Me vete kemi erën, shiun dhe të ftohtët e dimrit. Kthehemi aty nga marsi tok me dallëndyshet. Kthehemi te shoku Idriz. Këtu na dalin këto marifetet e përqindjeve. Ja, kështu është puna, shoku i deleguar... E rëndë, e vështirë, pa njeri pranë. Këtë vit i kemi bërë disa fjalë me kryesinë se... ky thotë kështu e do rregulli. Neve, du të them, një pjesë prej nesh, sikur të na vrasësh, nuk na mbushet mendja se ka të drejtë.

Të gjithë po shikonin burrin shëndetlig.

— Jo, po m'thuej, je a s'je anëtar i kooperativës?

— Idrizi u mbufat në fytyrë.

— Jam, — tha malësori. — E përsëri kam të drejtë.

— Derisa je, bindju statutit. Vetë ke hi në kooperative, s't'i ka vu kush thonjtë në grykë.

— E me gjithë këtë, ju, shoku Idriz, jeni dallash, — tha malësori me kryeneçësi, i bindur në fjalën e vet. — Gjatë dimrit gjashtë muaj këtu kërcet tavlla e dominoja, kurse në pranverë kërkoni të rritet ditë-puna me djersën tonë. Jo, për besë, kjo punë është dallash! As ti, shoku Idriz, as ai «filozofi» yt në llogari nuk po ecni në rrugë të drejtë me këtë punën tonë... Lëre më ata të tjerët...

— Ju tërheq luga veç për vedi, prandaj ulërin, — thirri Idrizi. — Kurse unë jam baba që mendoj për të gjithë. Hajt i merrni vesh në kooperativë këto që thoni... — Ai ishte skuqur e nxirë.

— Ju po i kërcënoni? — e pyeti Besimi ftohtë dhe ia nguli sytë. E përmbajti veten aq sa t'i fliste me zë të butë, po gjaku i kishte hipur në kokë. Idrizi hapi sytë i hutuar.

— Këtu vërtet na ke në dorë, shoku Idriz, se kemi fëmijët. E këtu vallja hiqet si ta dojë kryetari, — tha malësori, duke shikuar si me frikë e zemërtlyer Besimin.

— Jo që shtu, Mujë Elezi, jo që shtu, bre burrë! Vallahi bilahi, qi sonte e mbledh asamblenë e të vë në shpinë gjithë gjindjen qi ta bën tuzak sa të kërkosh birën e minit... — Idrizi s'po përmbahej.

Malësori Mujë Elezi u ngrit në këmbë e Besimit iu duk sikur qafa e hollë u zgjat, ndërsa sytë shkëndijonin.

— S'më tremb dot me asamblenë! — thirri ai. — Unë e di që shumica ta mban krabun o për interes, o për frikë, edhe kur s'ke kurrfarë të drejte. Po unë s'ta kam frikën. Këtë punë, po nuk e zgjidhi

Partia, atëherë... — Mujo Elezit i lëshuan shkrepëtima sytë.

— Kur vjen kush, qe shtu e zgjidh gjuhën ti, e dimë, por ai qi vjen ik e ne mbetna prapë qe tu...

— Të deleguarit i tiganis vetë ti në shtëpinë tënde me ato therjet e sforcuara, prandaj flet kështu. Mbrëmë e gdhitë me atë kushëririn tënd Kallushanin. E bëtë mirë studimin e oborreve personale... — Ai u ngërdhesh ironik. — Sonte ia ke hedhë grepat këtij. Merre, po s'ka për të të dalë mbarë. — Mujo Elezi po shpërthente i papërmbajtur. Të tjerët dëgjonin dhe nuk e ndërpritnin fare. Kuptohej, të gjithë ishin me të.

— Për ideal, qe shtu veç kulaku m'ka folë, — tha Idriz Meta.

— Kulak s'më bën dot as ti, as yt bir!

— Të baj qi të luej fenë. Ti po na prish unitetin. S'e ke hallin ke paret ti, se je krymbë në to, po don të na prishish unitetin qi kena gjanë ma të shtrenjtë...

— Unitet që ti të fryhesh me djersën tonë, të mbushësh xhepat me ndalesat e të tjerëve? Nuk e dua këtë farë uniteti. Kjo është poshtërsi, jo unitet. Unitet kam me Partinë, me këta burra! Me këta nuk më ndan dot as ti, as yt bir, askush! — Mujo Elezi ishte zbehur fare dhe po dridhej.

— Mujë vëlla, pa ulu aty, ulu e mos thirr, — i tha Tafë Danaj i ngrysur. — Nëse tre njerëz i bashkon ideali, tokën e kthejnë në flori. Por, po ta mihin veç e veç, floririn e kthejnë në pleh. Ti, shoku Idriz, — iu përvesh Tafa kryetarit, — i ndeze urët keq. Ato që the për Mujon, futi në xhep e çoji ku i ke gjetur. Nuk i takojnë Mujos ato. E për sa i përket kësaj pune, kemi ku e bisedojmë dhe do ta zgjidhim se s'bën...

— Shife shife si kinka puna! Paska hi hilja mrena e una s'po di gja, po i bie kumones jashta... Po ti fol, bre sekretar! Po a e ke ndrrue pllakën a? Po a nuk e ciklove vetë relacionin a?

— Mashtrimin edhe arusha s'e pëlqen, — tha Tafë Danaj. — E ciklova ashtu si ma diktove ti me shefin e llogarisë. — Tafa ishte ndezur në fytyrë.

— Nuk pyeta Mujon e shokët unë, po duhej t'i kisha pyetur. E, po t'i kisha pyetur këta, nuk do ta kisha cikluar ndoshta. Do të ishte shkoqitur...

— Unë nuk kam ç'ka shkoq. Nesër mbledh asamblenë. Të gjykohna na të dy atje. Ti dhe unë atje! Atje!

— Unë gjykohem në parti, — tha Tafa. — Ta shohim në byro një herë këtë problem, se nuk e kemi parë. Pastaj, po qe nevoja, në organizatë. Unë të gjykohem i pari, s'ka asnjë sekret në këtë mes, por, pas meje, do të gjykohesh ti, shoku Idriz, e ndoshta edhe ndonjë tjetër.

Malësorët u gjallëruan. Fjala e Tafë Danajt u derdh si valë e ngrohtë ajri brenda tyre dhe ata lëvizën plot besim. Shikonin me gaz Tafën dhe, kuptohej Idrizit ia kthyen shpinën të gjithë. Nisën të flisnin me njëri-tjetrin, po romuzet binin mbi Idrizin që e ndiente se kishte mbetur vetëm.

— Mirë boll, — tha Idrizi duke zier nga zemërimi. — Mirë boll! Do ta shohim në byro e në organizatë. «Qesh mirë kush qesh i fundit,» ka thënë i moçmi.

— Vetëm një fjalë e tha mirë, — qeshte njëri pranë Azizit, — s'duhej biseduar kjo punë këtu në zyrën e përgjegjësit të kulturës.

— Jo po, fol ta kam rixhanë, ka apo s'ka parime. Hë pra, më thuaj! — mori zemër Idrizi që kishte mbetur vetëm, sikur t'i lutej fshatarit. Po malësori i ktheu shpinën dhe nisi t'i fliste me zë të ulët Azizit.

— Puna është kush i mbron e kush i shkel ato, jo kush i lexon, — tha Azizi dhe i ktheu shpinën edhe ky Idrizit.

Tafa u tha të ngriheshin dhe ata dolën nga shtëpia e kulturës.

Jashtë kishte rënë nata, një natë e kthjellët me qiellin blu plot yje. Frynte pak erë dhe oshëtima e lehtë e korijes pranë derdhej poshtë grykës. Fusha e ndërmarrjes bujqësore flinte nën jorganin e errët. Vetëm dritat e sektorit të largët të blegtorisë dukeshin si sy të bukur mes hapësirës së fushës. Ata rrinin zgjuar, shkëndijonin të qeshur e të gëzuar. Më tutje, në fshatrat e rrëzës së Kurorës, dritat shpërndaheshin aty-këtu. Mbi majat e kodrave horizonti i bardhë i lindjes.

Fshatarët e ftuan Besimin të shkonte me ta, por Tafë Danaaj tha se do ta merrte në shtëpinë e vet. Fshatarët bënë mënjanë klubit. Vetëm Mujë Elezi idhnak dhe Azizi i patundur qëndruan me ta.

— Dëgjo, or mik, — tha Muji, kurrë mos u rregulloftë puna e shqopës, eja tek unë sonte. Edhe ti, Tafë. Fjalë s'kam çuar në shtëpi, zootekniku nuk ma dëgjon zërin, se është tjetërkund... — qeshi ai. — Do të heqim keq tok...

— Shkojmë? — e pyeti Besimi Tafën,

— Shkojmë, — tha Tafa, — veç për të fjetur, do të flejë tek unë.

Në sheshin përpara zyrave dy veta po pritnin Idrizin që po u afrohej fare vetëm. «U ba m...», u tha Idrizi me zë të lartë. Të tjerët nuk folën. Si panë grupin që po afrohej, ata u larguan. Nga e majta e zyrave, grupi i fshatarëve u preu rrugën Besimit dhe të tjerëve.

— Për ku kështu? — pyeti njëri nga ata.

— Te Muji, — tha Tafa i mërzhitur.

— Mos, burrë! — tha një tjetër.

— Hajt, bre shokë, ua ktheu Muji, — bukë e gjizë ka për të gjithë. — Deri para shtëpive të para të lagjes ata shkuan grumbull, po aty një pjesë u nda. Pas pak u ndanë edhe të tjerët. Me ta qëndruan vetëm tre veta. Shtëpia e Mujit ishte përdhese me dy oda, kthinë, verandë të mbuluar dhe oborr të rrethuar me gardh. Në oborr ishte plevica e gjatë, mbuluar me kashtë thekre, dy këvaleta të lartë dhe nja dy pemë. Oborri zbriste nën gardh për në rrëpirën e përroit. Në shtëpi i priti e shoqja, një malësore e thyer në moshë, po e mbajtur dhe kockëfortë, grua nga ato që çdo punë e kanë qejf ta bëjnë dhe shëndeti u shkon mbarë; i biri, nja njëzet e ca vjeç; e reja u përshëndet me druajtje e pa fije gazi dhe iku për në kthinë. Gjashtë fëmijë të tjerë prush të vegjël erdhën njëri pas tjetrit dhe e mbushën odën plot gaz. Po kjo nuk zgjati, se fëmijët u larguan njëri pas tjetrit dhe nisën biseda të tjera. Djali i madh i Mujit, burri i dytë i shtëpisë, përpiqej të tregohej i sjellshëm dhe fliste duke peshuar çdo fjalë. Kur e pyeti Besimi për dynymët, djali tha shkurt:

— I kemi mbjellë pak nga të gjitha.

Pastaj s'foli më. Erdhi nusja dhe ata qëndronin në këmbë gati për çdo shërbim. Besimi mori vesh se gruaja, nëna e shtëpisë, e reja, njëra nga vajzat dhe një çun pesëmbëdhjetë vjeç punonin në kooperativë. Si pjesëmarrje ishin mirë, po vlera e ditë-punës ishte ende e vogël dhe ndihej nevoja e punës së Mujit në shoqëri. Kooperativa kishte kredi të pashlyera përsëri edhe pas faljes së kredive nga shteti kooperativave mallore. Vlerën e ditë-punës ata e krahasonin me kooperativat e tjera si veten, po edhe me kooperativa të zonave fushore. Tafë Danaq që i sqaronte këto, kuptohej, dinte mirë të ardhurat në çdo shtëpi.

— Kemi vendosur që djalin ta çojmë në gjeologji

te sondat, — tha Tafa, — po ende nuk përfundoi ky muhabet. Duhej të kishte filluar...

— S'ka gjë, — tha djali dhe sytë i ndritën nga gazi, — veç të bëhet.

— Do të bëhet! Kemi vendosur dhe do të bëhet. Ju jeni e vetmja familje që s'keni njeri me rrogë në ndër-marrjet shtetërore. Shko atje puno, se edhe Mujit do t'i vijë ca shëndeti... — Tafa vuri buzën në gaz dhe sytë ngjyrë plumbi u zbutën e ndritën. Mujë Elezi përpiquej që bisedën t'ua bënte sa më të ngrohtë, duke iu larguar fillit të halleve, po ajo, për çudi, sillej nga sillej aty vente.

U shtrua darka me raki, turshi, gjizë. Gjysmë ore më vonë hyri gruaja me nusen dhe sollën pilaf me pulë. Si kishin pirë nga një gotë raki, ata flisnin lirisht pa e pasur kujdesin e parë.

— Te ne, shoku Besim, — tha Aziz Ramizi, — të ardhurat e vërteta nuk janë vetëm ato që ndahen nga kryesia. Nuk është puna se ne marrim më pak se kooperativat e tjera. Jo, ka edhe të tjera të ardhura... Është edhe dynymëshi që s'ia mbush syrin kujt, po rrogat e pjesëtarëve që punojnë në shtet. Mandej shpërdorimet në pronën e përbashkët prej njërit e tjetrit... Kështu që punën e Bimit... — ai shikoi djalin e Mujit, — e kanë gjykuar bash me vend. Nuk është kjo si puna e shqopës. Puna e shqopës është punë dreqi, por hajt. More shoku Tafë, kush i kontrollon këto përqindjet e ndaluara nëse derdhen apo nuk derdhen në kooperativë?

— Llogaria, — tha Tafa.

— Më duket ka allishverishe. Disa prej nesh marrin të ardhura prej bonifikimit e SMT-së, bile janë disa që s'vijjnë me ne të shqopës...

— Cilët?

— Nga kooperativat fqinje.

— Je në vete! — Tafa zgurdulloi sytë.

Malësorët ia ngjitën sytë dorës së trashë sa një kopaçe që e prishi kofshën e pulës. E copëtoi dhe e la

mbi pilaf. Fshiu duart në shaminë e tij dhe vazhdoi buzagaz:

— Përçindja e ndaluar te ne bëhet mbi bazën e ditë-punës sonë prej gjashtë lekësh, kurse te fqinjët mbi bazën e nëntëlekëshit. T'i mbash tridhjetë për qind gjashtëlekëshit, do të thotë të marrësh 1 lekë e tetëdhjetë qindarka më pak si punëtor, kurse të mbash vlera prej nëntë lekësh që kanë fqinjët do të thotë t'i mbash dy lekë e shtatëdhjetë qindarka, pra ai miku që i bën derdhjet në emër të kooperativës sonë, i merr të ardhurat me një shtesë sa është diferenca jonë me atë të fqinjëve. Mirëpo këto nëntëdhjetë qindarka çojnë shumë peshë në të ardhurat e përgjithshme. I derdhin te ne dhe i tërheqin tek Idrizi o te Samiu.

— Kjo është poshtërsi, — tha Tafa. Sytë iu ndezën dhe përskuqja i flakëroi fytyrën. — Pse keni heshtur? Në këtë qull, dashur pa dashur më keni futur edhe mua.

— E do copë?

— Copë!

— Në besë të kësaj buke? — Azizi shtriu dorën e trashë si kopaçe mbi bukë.

— Besa e saj besë e Partisë!

— Sepse kemi kujtuar se ju i bëni vetë këto dërcka tok me Idrizin dhe atë putanën e llogarisë, Samiun...

Tafën e mbuluan djersët.

— Vërtet ti nuk di gjë për këto? — Azizi ia qepi sytë.

Tafa zgjati dorën mbi bukën që kishte përpara.

— Jo, për fjalë të nderit! — tha i nemitur. Fshiu djersët mbi ballë dhe të zbehtët i mbuloi fytyrën. — Po dolën me fakte këto, këtu ka dorë të fëlliqur. Po ju mos i bisedoni jashtë, se na e ngatëroni keq. Në pastë një o dy njerëz që na i bëjnë këto, mjerë ata!

— Po pse na trajtoni njësoj si ne pa kontratë dhe ata që ka nisur kryesia me kontratë në ndërmarrjet shtetërore? Edhe për këtë nuk di gjë? — Azizi e vuri

përpara Tafën, por, me sa shihej, ai e donte Tafën dhe tani donte që këto t'i merrnin vesh të gjithë të pranishmit.

— Këtë e di, ju trajtojnë si kooperativistë.

Azizi tundi dorën dhe qeshi. I luajti syrin një vogëlushi që rrinte pranë tij, e mori në prehër, e gudu-lisi, e puthi dhe u zu ca me të se nuk pranonte të merrte një copë nga kofsha e pulës që ai ia dha nga pjata. Fëmija shikoi sytë e egërsuar të Bimit dhe nuk e pranoi.

— Bim, të lutem! — tha Azizi. Bimi i foli djalit. Ky e mori mishin dhe u ngrit e iku matanë.

— Dispozitat janë të tjera për ne dhe të tjera për ata me kontratë. Ky është ndryshimi. Atyre me kontratë u mbahet përqindja dhe vlera tjetër u jepet mbi bazën e ditë-punës në fund të vitit, kurse neve jo. Po aty në llogari po kërcen qeni i kallajxhiut...

— Në qofshin punët kështu, — tha Tafa i nemitur, ndërsa dora po i dridhej nga emocioni, — puna jonë është pus.

— Dhe i thellë bile, — tha Muji. — Bash kështu janë.

— Veç një gjë ta dimë patjetër: ç'bëhet me ndalesat, derdhen rregullisht ato apo teren rrugës? A ka lista ai Sami Bullona për derdhjet individuale? Kush i kontrollon ato? Humbur se humbur, ta dimë ku shkojnë, të paktën ato të shkojnë në kooperativë.

Tafa i shikoi njërin pas tjetrit të gjithë. Gruaja dhe nusja ishin larguar me kohë.

— Dëgjoni, vëllezër, — tha i mpakur në fytyrë.

— Kjo punë e shqopës nuk është veç punë e shqopës... Nuk është veç juaja. Ashtu si gabimet nuk janë veç të atyre që i bëjnë. Ju lutem, asnjë fjalë, pa e parë ne si byro. Shoku Besim për këtë punë ka ardhur.

— Kur? — pyeti Azizi i paduruar.

— Që nesër! — tha Besimi. — Me këtë punë do merrim si Parti.

— Është puna jonë në radhë të parë, nuk është

punë e shefit të llogarisë dhe kryetarit. Puna juaj, jeta juaj, është punë e Partisë.

Aziz Ramizi u gjallërua dhe lëvizi nga vendi.

— Të paktën e keni të qartë që ato udhëzimet nuk na përfshijnë njësoj të gjithë... Se ne nuk e humbasim besimin, por kjo është djall pune.

«Çdo kooperativist i di ligjet ekonomike më mirë se ne të dy. Se ligjet janë jeta e tyre, buka e përditshme e fëmijëve. Ka njerëz të thjeshtë që e bëjnë ekonominë politike në parcelë,» — i kishte thënë Besimi shefit të llogarisë. «Ja, — tha me vete, — ky Aziz dorëkopaçja na i dha mirë porositë. Ja se ç'duhet të shikojmë.» Një ndjenjë lehtësie ia pushtoi shpirtin.

— Burra, këtu po hamë bukë e s'po bëjmë mbledhje, — tha Muji pa qejf. — Lëreni tash këtë punën e shqopës... — Ai disa herë kishte nisur bisedë tjetër, po miqtë ia kishin prerë fillin dhe atij i dukej se do t'i thoshte kush «nuk na ftove për bukë, por për hallet».

— Kjo punë do të shihet nga byroja, nga organizata. Nuk do të lihet lehtë... — tha Besimi. — Ju thatë se donit ta hidhnit në gjyq kryesinë, po përse nuk e hodhët? Përse nuk e bëtë këtë, po i shkruat letër sekretarit? E bëtë kështu se kishit besim te Partia, ja, tek organizata, te ky Tafa, sepse organizata nuk është Idrizi...

— Ashtu është, por kryetari ka «levat», — qeshi njëri nga malësorët që rrinte pranë Azizit.

— Lëre! — i tha Azizi dhe malësori heshti.

— Çfarë «levash»? — e pyeti Besimi. Po malësori nuk kishte ndër mend ta zgjaste fjalën. Azizi ishte njeriu që i kishte dalë zot kësaj pune.

— Në Bregaj, sa shkel kush për ndonjë problem, e mbërthen Idrizi. Atje në konakun e vet shkon e ha, fle, bisedon. Kuptohet, zootekniku ka bërë ndonjë «therrje të sforcuar», se helbete... Aty në davet shoku Idriz «i del së keqes përpara» dhe të nesërmen «ujërat rrjedhin në përruan e Bregajt», siç thotë kryetari! Kështu

ndodhi edhe me ata që kanë ardhur për oborret mbrëmë. Ti, Tafë, ishe atje?

— Jo, mbrëmë isha i deleguar në mbledhjen e organizatës së partisë të Shkëmbës.

— Aa, kështu qenka puna! Bash sot që ata i kanë studiuar oborret... — qeshi Azizi. — Levat e Idrizit, shoku Besim, janë zootekniku dhe shefi i llogarisë. Pa ta Idrizi s'ia bën bam! Më afër ka ata se Tafën. Ju shikojeni si Parti. Ne këtë duam. Gjejini ju kush ka të drejtë.

Tafë Danaj ishte nxirë në fytyrë.

— Po pse, mor Aziz, i keni grumbulluar këto që t'i zbrazni thasët sonte? Çfarë më keni kujtuar mua?

— Ta thashë në fillim. Kujtonim se edhe ti i bëje tok me ta, kurse sonte u pa puna. Ne e morëm vesh. Ja, ky shoku punëtor është si ne. Ndryshon puna. Tok erdhëm te Muji e gjizë hëngrëm si në shtëpinë tonë, po e ndiem veten zot dhe hapëm zemrat. Ti je mes nesh dhe kjo më gëzon shumë. Vaj halli të na e merrje këtë shokun në shtëpinë e Idrizit sonte dhe... — Azizi qeshi. — Luajti puna, vëlla Tafë.

— Gjizë, gjizë, po sheka jonë s'ka vetëm gjizë... — tha Tafë Danaj i mërzhitur.

U shpërndanë në mesnatë. Frynte erë e fortë. Gjëmonte korija me lisa. Zhurmat e natës, oshëtima e korijes, ajri i lehtë atij i hynin në shpirt. Mendonte për jetën e njeriut që prodhon grurin, mishin, lëshin, lëkurën, bile edhe drurin e shqopës, njeriun që, ashtu si ai, në konvertet e uzinës i ndien mbi supe stuhitë e dëborës dhe diellin përvëlues.

Tafa i kishte futur krahun dhe po ecnin në një rrugë mes shtëpizave. Lehu një qen. Pas tij lehën të tjerë nga oborre të ndryshme, po nuk u preu rrugën asnjë.

— E vërejte fytyrën e Mujit? — e pyeti Tafa që ende jetonte me përshtypjen e darkës.

— M'u duk shumë shëndetlig.

— Në shqopë u sëmur. Sikur të mos e kishin gjetur barinjtë e Labërisë, Muji s'kthehej më. Ata e çuan në spital, por nuk është mirë. Edhe atij i janë mbajtur pagesat me frimën time. Eh, si e qullosem kështu!

— Do ta gjejme zgjidhjen, s'do ta lëmë kështu, — i tha Besimi.

— Do ta gjejme që ç'ke me të, — tha Tafa, ndër-sa po hapte derën ngadalë që të mos zgjonte njerëzit. Si hynë në derë, erdhi e shoqja. Ajo ishte një grua shtatlartë, e veshur me fustan. Që në pamjen e parë, Besimi e kuptoi që gruaja nuk ishte vendase. Tafa e pyeti për djalin dhe ajo i tha se po flinte. Pas pak ajo doli dhe Besimi u zhvesh e ra. Tafa qëndronte në karrige.

— Po ti, s'ke gjumë? — e pyeti Besimi.

— Dua të pi një kafe. Do ti?

— Jo, jo, të faleminderit. Tani është vonë, kurse nesër kemi gjithë ato punë.

— Epo, natën e mirë!

KAPITULLI I GJASHTËMBËDHJETË

Po Tafë Danaj nuk fjeti.

Ndodh nganjëherë që një rrethanë e jetës të ngulet në kokë si gozhdë dhe të mbetet aty si një mësim që vlen për gjithë vitet që vijnë. Kështu i kishte ndodhur edhe atij. Dikur djalë në lulen e moshës, nëntoger me shkollën ushtarake të porsakryer, më 1949 ai ishte nisur me regjimentin e këmbësorisë nga Shkodra për në frontin e Bozhigradit, ku zhvilloheshin luftime të ashpra të provokuara nga monarko-fashistët. Në ditët e para sektori i tij bombardohej me artileri dhe në llogoret e hapura kishte pasur shtatë ushtarë të vrarë. Nëntogeri i ri kishte nën komandë vetëm një togë. Po bombardimet vazhdonin dhe pritej sulmi.

Sa herë që vritej një ushtar, radha mbushej me katër-pesë fshatarë që vinin dhe zinin pozicionet pa zhurmë. Kjo ndodhi në dy raste. Kështu që në llogoret e togës luftonin edhe njëmbëdhjetë fshatarë në vend të dy ushtarëve të vrarë. Kur u vra ushtari i tretë, në llogore erdhën tri gra dhe një vajzë. Vajza ishte shtatlarhtë dhe kishte një pushkë të shkurtër italiane që dukej qesharake në duart e saj të forta. Në brez kishte një gjerdan dhe në sup një trastë ku kishte fishekë dhe bukë. Ajo erdhi e zuri pozicionin pranë Tafës. U mbështet brinjazi, mori vijën e shënjitimit dhe shikoi Tafën sikur t'i kërkonte leje. «Mos qëlloni pa urdhër!» — i tha Tafa. Falanga armike po vinte si një valë e zezë atje tej mes kaçubave, shkurreve e shkëmbinjve. Pozicionet ishin zënë në një vend të ngritur si në brinjë të kodrës dhe ata qindra

veta që po vinin me radhë të shtrënguara, me sa shi-
hej, e kishin pikën e tyre të sulmit. Po ai çast pri-
tjeje që njeriut i duket një vit, mori fund me sinja-
lin e sulmit që dhanë borizanët. Tafa dëgjoi thirrjen
e një komandanti të kompanisë së parë: «Para, parti-
zanë!» Kishte pesë vjet që kishte mbaruar lufta dhe
tani kishin ushtri të rregullt. Kjo thirrje kishte qëndruar
diku në kujtesë si e fjetur dhe e solli papritur ai çast
kur ushtarët po vinin drejt tyre aty në kufi. Ai e
kishte dëgjuar shumë herë gjatë luftës këtë thirrje, e
dinte ç'do të thoshte, kur përdorej, por në fshatin e
tij asnjëherë nuk qëlloi që ndonjë njësi partizane të
hidhej në sulm dhe ai ta dëgjonte në veprim kështu si
e dëgjoi. Në fillim thirrja e ngjethi, ia ngriti peshë
shpirtin dhe pa i turbulluar se si vraponin oficerët për-
para njësisë të tyre. Nuk priti më. U ngrit nga pozi-
cioni. Në krahun e djathtë të tij një grup oficerësh
vraponin përpara radhëve të ushtarëve. Ata përdornin
automatikët dhe mbroheshin nga mitralozët. Arritën
të hidhnin edhe bombat e dorës. Tafë Danaj që e ki-
shte ngritur togën e tij dhe vraponte drejt monarkove,
ishte vetëm njëzet-tridhjetë metra pas tyre. E pa me
sytë e tij se si ra ai farë djali. Komandat i merrnin
zëvendësit dhe, kur vriteshin këta, e merrnin komandën
ushtarët. Pastaj çdo gjë u mbyl në mjegull. Brinja e
blertë në fillim u mbulua nga tymi, pastaj u përzje me
horizontin e bardhë dhe ai mbeti vetëm pak hapa
larg një grupi fashistësh që qëllonin nga kaçubat. Ndjeu
se dikush e zuri për krahun dhe e tërhoqi zvarrë, një
krismë arme italiane dhe klithmën e një vajze. Asgjë
më!... Ushitari fashist e kishte qëlluar nga afër dhe
plumbi e kishte marrë në bark në ijen e djathtë.
Vajza truplartë, që nuk i ishte ndarë Tafës në atë vrap
të rrëmbyer sulmi, kishte qëlluar mbi ushtarin armik.
Ajo ia kishte shkëputur nga duart e tij Tafë Danajn
dhe, si kishte parë që plumbi e kishte marrë në ije, e
kishte tërhequr në një vend të mbrojtur. Nga paji-
met personale të tij ajo kishte marrë tamponat e gar-

zave dhe i kishte frenuar gjakun. Nën gjëmimin e artilerisë së rëndë, të mitralozëve, të thirrjeve dhe të britmave të lemerishme, ajo, pikërisht ajo vajzë fshatare e Bozhigradit, e quajtur Luljeta, mori në krahë nëntogerin e ri dhe iu ngjiti kodrës. Armiku matanë përroit, groposur me kohë ndër pozicione, mbronte trupat në tërheqje gjatë gjithë gjatësisë së përroit. Kodra rrihej nga të gjitha anët nga larg. Pa arritur mirë në krye të kodrës, një plumb i dogji klavikulën vajzës. Po ajo nuk e lëshoi nëntogerin e ri që rënkonte lehtë. Pastaj ajo pa dy gra fshatare dhe tre ushtarë. Ishte rrëzë një shkëmbi. Mendoj se aty ishte e mbrojtur dhe u rrëzua tok me të. Aty i mjekuan infermierët dhe i nisën për në spital. Ai e mori veten në spitalin e Korçës mes të plagosurve, pasi e operuan. Kishte edhe civilë që kishin marrë pjesë në luftime. Mes tyre ai pa vajzën truplartë që i kishte shpëtuar jetën. Pak kohë qëndruan bashkë, se ajo doli shpejt nga spitali. Pastaj erdhi nja dy herë tok me të emën. Luftimet kishin mbaruar, kur ai doli nga spitali. I dhënë një muaj leje, po ai nuk u nis për në shtëpi. Shkoi në Bozhigrad dhe u kërkoi prindërve Luljetën për grua. Kështu nisi jeta e tij e gjatë prej oficeri të kufirit. Postë më postë i lindën gjashtë fëmijë. Doli në lirim pesëdhjetë vjeç, por i fortë, plot energji për të punuar përsëri, ndonëse thinjat po i mbulonin kokën. E pyetën në donte të vendosej diku në ndonjë qytet. «Jo, — tha ai, — veç në fshatin tim. Aty kam shtëpinë, të afërmit, miqtë.»

Nga jeta ushtarake në kufi mësoi që t'i mbante sytë hapur, të mos e zinte gjumi sikur një sinjal, një dyshim t'i vinte ashtu rastësisht se diku diçka nuk vente. Kufiri dhe puna e Partisë për atë ishin një. Po ai kishte mendimin se punët në kooperativë nuk shkonin keq, se vlera e ditës së punës po ngrihej nga viti në vit dhe do t'i arrinin kooperativat e tjera e do t'i kalonin.

Po ja, shpirti i tij që kishte ndenjur si i fjetur pa-

pritur u zgjua. Ai ndjeu se përpara syve të tij, bile me dorën e tij, me emrin e tij po spekulohet. Hante veten nga inati dhe nuk e zinte gjumi. Si përcolli Azizin, në ndarje e porositi të shkonte dhe të ruante zyrat. «Në ardh të kush natën aty, më thirr me telefon nga ROGL-ja,» — i tha. Sa u nda në odë me Besimin, shkoi dhe mori e pastroi pistoletën. Kontrollloi karikatoren, fshiu fishekët dhe i tha së shoqes: «Lule, më bëj edhe një kafe!» «Ku do të vesh?» — e pyeti ajo tërë merak. «Në kufi jemi, halle ka... Ty ç'të duhet?» «Ua, qyqja! Si ç'më duhet? Ku do të vesh, se nuk të shikoj mirë. Kemi edhe mikun këtu...» «Për mikun ke djemtë, në rast se dal. Hajt pra, do ma bësh edhe një kafe?» Ajo ia bëri kafën dhe ai e piu i qetë në ankthin e pritjes. Hoqi xhakëtën, veshi gjimnastjorkën e vjetruar. Futi revolverin në brez dhe nuk ia ndau sytë telefonit. Po syrit të vëmendshëm të Luljetës nuk i shpëtonte asgjë. «Dëgjo, — i tha ajo si me gaz, — në qoftë se dëgjoj krismën e parë, do të marr automatikun dhe atje më ke.» «Ku «atje?» «Ku të jesh, ku t'ia bëjë bamp!» «Nuk është gjë me rëndësi. Po mos më ngacmo, ti, plakë, mos u bëj shumë kureshtare. Dyshohet për njëfarë vjedhjeje. Sido që të jetë, kjo... — ai preku revolverin, — më duhet. Ti mos më ngacmo, se ende nuk dihet gjë e sigurt, vetëm dyshohet. Ndoshta nuk është gjë...»

Ajo nuk e kishte pirë ende kafënë, kur tringëlliu telefoni. Ai e rrëmbeu dëgjuesen. «Hë! Foll!» — i tha. «Eja shpejt!» — i tha Azizi. Tafa e uli telefonin.

Në vrap e sipër ai arriti te shtëpia e kryetarit të këshillit popullor. Kryetari nxori kokën te dritarja dhe Tafa i tha të vinte shpjet te zyrat, se ashtu ishte puna. U largua me vrap, pa i lënë kohë që ai ta pyeste përsëri. Azizin e gjeti te këndi i zyrave në errësirë.

— Kush? — e pyeti me gulçim.

— Samiu! Nuk e di ç'kërkon.

— Mirë, prit, — i tha Tafa. — Në daltë, do ta

detyrojmë të kthehet? Mbërtheje mirë. Duhet ta bllokojmë në vend. Rri aty dhe mos bëzaj, unë po pres kryetarin e këshillit.

Pas pak ai dëgjoi hapin e nxituar të kryetarit të këshillit që i ngjitej rrëpirës dhe i doli përpara. I shpjegoi shpejt e shkurt dyshimet dhe ardhjen e shefit të llogarisë në zyrë.

— Po për këto, mor i uruar, më çon nga gjumi? — e pyeti kryetari. Ai e merrte këtë si një gjë fare të thjeshtë.

— Ka shpërdorime këtu, — tha Tafa. — Pastaj... «nga të voglat lindin të mëdhatë», ka thënë Lenini.

— Në qoftë kështu si thua ti, po ia tregojmë të s... — shau kryetari. — Vetëm është?

— Këtu vetëm është, po në këtë qull, më duket, i kanë ngjyer duart edhe të tjerë...

Ata arritën përpara zyrove. Azizi ishte ngjeshur pas shtyllës.

— Po ky tjetri këtu kush është? — e pyeti kryetari dhe u fsheh në cep të ndërtesës.

Tafa i tregoi se aty kishte lënë vetë Aziz Ramizin. Ata u afruan tek Azizi. Mes heshtjes dëgjohej kërcitja nervoze e akteve, dosjeve dhe e hapit të Sami Bullonës. Ai nuk po dilte, ndërsa Tafa ngulte këmbë që ta ndalonin, vetëm pasi të dilte. Do ta kontrollonin dhe pastaj do të futeshin në zyrën e këshillit popullor.

— Ah, ç'm'u ça hunda për një cigare, — tha kryetari. Azizi vazhdonte të qëndronte te dera pas shtyllës. Gati te këmbët e tij, aty ku një tufë bari kishte dalë rrëzë kolonës, një bulkth ia kishte marrë këngës. Mbi kokat e tyre u dëgjua fërfërima e një lakuriqësi që ndiqte ndonjë flutur, afruar aty nga drita që lëshonte zyra e llogarisë.

Pas pak ata dëgjuan hapat e Samiut, u fik drita dhe dera u hap. Në kohën që Samiu futi çelësin të mbyllte derën, Azizi e mbërtheu me të dyja duart. Tjetri ngriu në vend. Çanta e madhe i ra dhe u përplas me zhurmë.

— Mos lëviz dhe mos bëj zhurmë, se të bëra nuse, — i tha Azizi me zë të ulët. Tafa ndezi dritën e korridorit.

— Mos u tremb, Sami, — i tha kryetari i këshillit. — Kujtuam mos ishte ndonjë tjetër. Merre çantën dhe eja të hyjmë këtej nga zyra ime...

Samiu shikonte i tmerruar Azizin dhe ende s'po e merrte veten.

— Eja, pra! Ç'më shikon si buf?

Kryetari hapi zyrën e këshillit. Sami Bullona, bërë si meiti, u përkul, mori çantën pa folur asnjë fjalë. Në zyrë Tafa u ul pranë kryetarit. Azizi u ul nga fundi dhe nxori kutinë e duhanit dhe nisi ta dridhte me ngadalë e me qejf. Samiu qëndronte në këmbë, pa e marrë veten nga tronditja.

— Po ti ç'ke kështu? Ulu, pra. Hajde! — i tha Tafa.

— Kot. U shqetësova se nuk e prisja, — tha dhe, me dorë të dridhur, mori cigare nga paketa e kryetarit. Tafa e ndezi për vete dhe ia zgjati Azizit që ishte ngritur e po sillej rreth tavolinës.

— Kush të dërgoi? — e pyeti Tafa Samiun.

— Kurrkush. Erdha vetë.

— Dukesh, të mbyti puna, — tha Azizi. Samiu e shikoi me bisht të syrit dhe i bëri llogaritë shpejt. «Në fund të fundit, — mendoi, — në këtë punë ka dorë Idrizi. E përse të bredh me këta kodër më kodër? Më mirë drejt.»

— Më tha shoku Idriz se do të mblidhet byroja për problemin e pagesave të punëtorëve të shqopës. Kështu që u hodha edhe një sy dokumenteve që të jem gati...

Tafa tërhoqi ngadalë çantën, por Samiu shpejtoi ta merrte dhe e shtrëngoi pranë.

— Ju s'keni punë me çantën time, — tha.

— Po kush ka punë? — e pyeti Tafa.

— Llogaria është e kooperativës.

— Po unë i kujt jam?

— Ju jeni një anëtar i thjeshtë... Dua të them, me probleme ekonomike merret kryesia e kooperativës, jo të tjerët...

— Po ju, shoku shef i llogarisë, nuk e dini se këtu udhëheq Partia? — i tha kryetari i këshillit. — Dorëzoja çantën!

Në fund të fundit, çanta është objekt personal. Ju, kontroll po më bëni? Keni autorizim për këtë?

Kryetari i këshillit u ngrit në këmbë, u ndez në fytyrë nga inati, drejtoi trupin e gjatë dhe i shtrëngoi fort duart mbi tavolinë.

— E di që je në zyrën e pushtetit këtu?! — i thirri

— E di.

— E di që, në emër të popullit që na ka zgjedhur, kemi të drejtë të të kontrollojmë? Dorëzo çantën aty ti...

Sami Bullonës i ranë pendët. La çantën mbi tavolinë. Tafë Danaj e tërhoqi me nervozizëm dhe ia vuri përpara kryetarit.

— Ke dokumente në xhepa? — e pyeti Tafa.

Samiu mbylli sytë përgjysmë dhe tha me hidhërim të shtirë, ndërsa me vete bluante të tjera gjëra:

— Meqë e nisët, vazhdojeni kontrollin. Përse më pyesni?

Kryetari i tha të ngrihej, iu afrua dhe e kontrolloi. Nxori andej ca shkresurina të bankës dhe dy listëpagesa e një thikë të mprehtë me dy tehe. Në portofol kishte vetëm pak lekë dhe fotografi. Kryetari, si pa foton e një femre, ia hodhi përpara me neveri. Thikën, shkresat bankare dhe listëpagesat i vuri mbi tavolinën e tij.

— Po këtë, or Sami Bullona, për pagesa e kishe?! — e pyeti kryetari duke i treguar thikën e nxjerrë nga këllëfi, që shkëlqente.

— Kur dal natën, e marr, siç merrni edhe ju pistoletat. Kuptohet, për vetmbrojtje...

— Kush të dërgoi këtu? — e pyeti Tafa.

— Jua thashë një herë. Erdha vetëm se më tha

shoku Idriz që do të shihen listëpagesat nga byroja, përndryshe...

— Shoku Idriz?

— ...

Tafë Danaj hapi çantën e madhe. Brenda ishin dy dosie pagesash. Ajo e një viti më parë dhe tjetra e reja. Shfletoi në të, por nuk mori vesh asgjë.

— Një gjë nuk e kam të qartë, — tha Tafa, — njësoj paguhen si ata me kontratë dhe ata pa kontratë?

— Shikojini, ja ku i keni, — tha Samiu gjoja gjakftohtë tërë hundë e buzë. Nxori paketën dhe ndezi cigare. Po fytyra limon e verdhë tregonte se ai ua kishte frikën, ndonëse kishte një shpresë që ata nuk do t'ia dilnin t'i shtjellonin gjërat. Veç kësaj shpresa më e e madhe e tij ishte Idriz Meta, kryetar i kooperativës dhe anëtar i byrosë së organizatës. Ai ishte interesuar në bisedën me Idrizin dhe kishte marrë vesh se i deleguari ishte punëtor i uzinës metalurgjike e s'merrte vesh nga financa.

— Unë po dal, — tha Tafë Danaj. Kryetari ia nguli sytë i habitur sikur t'i thoshte: Po ne ç'të bëjmë pa ty? Tafa e kuptoi. «Një minutë», — i tha dhe doli. Hyri në zyrën e tij. U lidh me qytetin. Kërkoj drejtorin e bankës bujqësore në shtëpi. Iu desh ta priste mjaft kohë. Kur ai doli, Tafa i kërkoj ndjesë që e shqetësoi aq vonë. Ai nuk e njihte nga afër drejtorin. I vinte çudi se si ai njeri po qeshte, ndërsa ky i kërkonte ndjesë. I tha shkurt se si e kishte hallin dhe kërkoj që ai të vinte në Bergaj paradite. Drejtori i tha se nuk mund të vinte përpara orës dymbëdhjetë.

— Është problem i ngatërruar, — i tha Tafa. — Ne po e shikojmë si Parti, por ka lidhje edhe me ju si bankë. Kemi shumë nevojë t'ju kemi këtu.

— Për çfarë pagesash bëhet fjalë? — e pyeti drejtori i bankës.

— Për shqopën, për punëtorët e shqopës!

Drejtori qeshi dhe i tha se dinte diçka për to dhe do të vinte në mesditë. Tafa hyri në këshillin popullor

dhe e gjeti kryetarin tek kontrollonte fletët e dosjes së parë.

— Ku deshe t'i çoje këto? — e pyeti ai Samiun.

— Ku jam këtu, në hetuesi?! — turfulloi Samiu.

— S'do të përgjigjesh? Mirë. Do të marrësh veten më qafë...

— Përse e zgjat? — i tha Tafa kryetarit. — Ky e di mirë ku është dhe ku do të përfundojë. — Ai e shikoi me ad zemërim kokën në flokë të vajosur të rrasur, saqë Azizi kujtoi mos e qëllonte dhe e tërhoqi për krahu tutje. Vuri buzën në gaz dhe i shkeli syrin.

— Me bankën i ke në rregull punët? — e pyeti Tafa.

Koka e vajosur e Samiut u ngrit menjëherë, e shikoi me vëmendje si për studim dhe tha më protestë:

— Ju është ankuar kush?

— Si i ke bërë derdhjet në bankë, me gjithë përqindjet e punëtorëve?

— Sa më ka dhënë kooperativa, kam derdhur. As më shumë as më pak.

Kryetari po shikonte listëpagesat që i nxorën nga xhepat.

— Po këta njerëz nga janë?! — e pyeti.

— Ky është një xhirim i adresuar gabimisht te ne me listëpagesa.

Tafa u afrua dhe e lexoi listëpagesën në duart e kryetarit.

— Jo, more, jo, more! — thirri. Ç'do këtu te ne ky Hysë Kadria? Jo, more... qysh erdhi ky që nga Lkeni e këtu? Po ky Zekë Qafuku! Shiko shiko... Po këta të tjerë? Apo vijnë e marrin te ne të ardhurat nga SMT-ja e Lushnjës dhe bonifikimi i Durrësit, se helbete...

— Edhe atyre u është ndaluar përqindja, — tha Samiu pa ua shqitur sytë.

— Por jo mbi bazën e ditë-punës prej trembëdhje-

të lekësh që mori Lkeni, as me atë të Zekës prej pesëmbëdhjetë lekësh, — tha Azizi. — U ke mbajtur mbi bazën e ditë-punës sonë. Apo jo?

Mbi fytyrën e Samiut menjëherë ra të zbehtët. Ai ndjeu tmerr dhe u kthye të mbyllte derën e llogarisë.

— Bëni ç'të doni, — tha. — Unë s'ju përgjigjem për asgjë. Ju s'merrni vesh fare nga dispozitat e as nga llogaria.

Në orën shtatë zyra e llogarisë ishte mbyllur me tri kyçe. Samiu qëndronte në zyrën e këshillit popullor. Idriz Metës, që u interesua i pari, dikush i tha se e kishte parë Samiun të nisej në këmbë për në bankë, se e kishin kërkuar me urgjencë. Idrizi nuk e bëri veten. Ai u largua me Kallushan Kukajn në zyrën e kryesisë së kooperativës për të shikuar si shkonte studimi i oborreve personale.

Besimi e gjeti Tafën në zyrën e byrosë duke folur në telefon me dikë. Tafa i bëri shenjë të ulej dhe vazhdoi të fliste me zë të ulët. Sytë ngjyrë plumbi ishin të lodhur, por të qetë e të gëzuar.

— Na duhen derdhjet prej punimeve jashtë kooperativës... E pra, nga të tjerë që s'janë të kooperativës sonë. Merret vesh... Posil! Edhe borderotë që duhet t'i ketë ky këtu. Sikur të kishim mundësi... Po, po! Edhe nga rrethe të tjera. Mos ka fonde të ardhurash që kalojnë nga kooperativa jonë te të tjerat? Po, pra... Këtë duam, o shoku drejtor! Mirë, ju presim.

Tafa mbylli telefonin. Fërkoj duart i gëzuar.

— Fola me drejtorin e bankës bujqësore, — tha.

— Më duket, e zëmë miun në çark sonte natën... Sonte ai Sami Bullona u zu në zyrë tek mbushi çantën me dokumentet e shqopës. E kishte dërguar Idrizi, me sa duket. Kishte një thikë me vete...

— Si e zutë, ju e zutë? — e pyeti Besimi i hutuar!

— E pra, ne. Dua të them, unë, kryetari i këshi-

llit popullor, shoku Lam dhe Azizi, ai shoku që ishte mbrëmë te Muji. Tani çështjen e kemi në dorë. Ankesat e letrës janë të drejta. Drejtori i bankës bujqësore me ata të kontrollit të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit vijnë sonte nga mesdita. Ata nuk vijnë para orës dymbëdhjetë. Deri atëherë na i kanë lidhur duart. S'kemi ç'bëjmë. S'kam si dal në byronë e organizatës, pa i shkoqitur punët me ta. Hë, si thua?

— Mirë, — i tha Besimi. — Pa t'i shohim dokumentet.

— S'ke ç'sheh. Shih Samiun dhe i kupton të gjitha.

— Ku është Samiu?

— Aty te Lami e kemi, po Idrizi nuk e di. Dikush ia tha një fjalë se shkoi në qytet. Le të rrijë Samiu pa të, derisa të vijë drejtori i bankës.

Tafa po fliste pa pushuar. I ishte rikthyer qetësia shpirtërore. Ishte i gëzuar, se më në fund po zbulohet e vërteta.

— Ndërkohë ti përgatitu mirë për në byro, — i tha Besimi. — Çdo gjë duhet të jetë e saktë dhe e argumentuar.

— O të përgatitur! Tani çdo gjë e ka marrë rrugën mbarë. — Fytyra e zbehtë nga pagjumësia shkëlqente.

— Më thuaj të drejtën, — i tha Besimi duke ia ngulur sytë, — po ti për vete a ndien përgjegjësi në këtë mes, po të dalin punët ashtu siç duken?

Tafa qëndroi përpara tij dhe Besimit iu duk sikur trupi i tij i bëshëm, veshur me gjimnastjorkën verore të zbardhur, u mpak, u shkurtua dhe humbi në vetvete.

— Të mos të gënjejë mendja se do të laj duart nga përgjegjësia, — tha. — Jo, or djalë, jo. S'jam nga ata unë. Puna ime s'ka rëndësi. Rëndësi ka që ne, dua të them, ne të gjithë, Partia këtu në fshat heqim nga shpina e njerëzve një barrë dhe të mos lejojmë që të lëkundet besimi i tyre. I pe mbrëmë ç'më thanë ata? I dëgjove? Ata kishin humbur besimin tek unë. Kur mora vesh që unë vërtet nuk dija gjë, ata u gëzuan. U gëzuan se më llogaritën me veten. Kupton? Mua sekretarin e

byrosë së organizatës më kishin ndarë nga vetja. Pra, tani që puna po merr rrugë, do të jap llogari i pari dhe unë e di si duhet të jap llogari, por më parë duhet të lajmë hesapet me Sami Bullonën dhe Idriz Metën. Këtu ka spekulim në para, po kjo nuk është kryesorja. Kryesorja është thyerja e unitetit! Besimi i Azizit, i Mujit dhe i të tjerëve. Kjo më intereson. Ti më pe të gëzuar... Po, unë jam vërtet i gëzuar. Jam aq i gëzuar, sa sikur të fitoja një sektor në front. Ti je i ri, mor djalë, por, kur nisesh në sulm për të marrë një sektor, nuk mendon se a kthehesh apo nuk kthehesh, nuk mendon se ç'plagë do të të lidhin shokët. Jo! Atje ke vetëm një mendim: të marrësh sektorin me çdo kusht dhe me sa më pak humbje. Ja, kështu është kjo punë, mor shoku Besim. Unë s'qaj hallin tim... Për relacionin do t'i përgjigjem unë Partisë edhe këtu në organizatë, edhe në rreth, mjaft që këto marifete të marrin fund.

KAPITULLI I SHTATËMBËDHJETË

Drejtori i bankës bujqësore erdhi aty nga ora 10. Kishte marrë me vete edhe një ekonomist dhe një nga ata të kontrollit të komitetit ekzekutiv. Ata qëndruan në sheshin para zyrave. Përpara u dolën Idrizi, Kallushani dhe një tjetër nga ata të ekipit. Drejtori kërkoi Tafën, u ktheu shpinën atyre e u fut në zyrën e Partisë.

Ai pa një nga një të gjitha aktet. Ua dha atyre të kontrollit të bënin konkluzionet dhe mori pjesë në mbledhjen e kryesisë së kooperativës. Byroja, si nxori konkluzionet, përgatiti një raport ku dilte përgjegjësia e secilit, sidomos e Idriz Metës. Raporti përqendrohej në dy çështje kryesore: interesi personal dhe uniteti. Idrizit i dogji rruga që po merrte problemi. Ai kërkoi me këmbëngulje mbledhjen e asamblesë, sepse shpresonte një mbështetje nga masa. U vendos të mblidhej organizata-bazë e partisë ditën e nesërme. Aty të dilte përgjegjësia e secilit.

Të nesërmen mbledhja e komunistëve nisi paradite në orën tetë dhe vazhdoi gjithë paraditen. Pas raportit të paraqitur nga Tafë Danaj, nisën të shkëmbeheshin replikat pa radhë dhe protokollisti thirri:

— Me Idrizin s'mbahet protokoll!

Besimi kishte porositur që protokollin të mbahej i hollësishtëm, mundësisht fjalë për fjalë, Tafa i tha protokollistit të kishte kujdes.

— S'kam mundësi, — tha ai. — Idrizi grin si mitaloz i lehtë.

— Trus aty, se për ideal... — u përtyt Idrizi duke i hedhur një sy Sami Bullonës që ishte ftuar në mbledhjen e organizatës të dëgjonte dhe të jepte ndonjë sqarim.

— Nëse do të flitet pa leje, — tha Besimi, — organizata do të ndryshojë rendin e ditës dhe të shqyrtojë disiplinën...

Në fillim ata e mbështetën materialin e byrosë. Ajo pjesë që diskutoi kundër tij ishte fare e vogël. Pasaj ata u tërhoqën dhe shikuan të çuditur Idriz Metën. Sami Bullona ishte thyer. S'ishte çudi që Idrizi t'i zbrazej Samiut në çastin e fundit. Po ja, diskutimet kaluan prej pagesave të shqopës drejt Idrizit dhe shefin e llogarisë e lanë në hije, sikur e harruan. Idriz Meta inkurajon interesin personal, Idriz Meta inkurajon pronën private në oborret personale! Idriz Meta arrogant me njerëzit! Idriz Meta thotë se unë jam baba në kooperativë! Idriz Meta prepotent! Idriz Meta bajraktar! Zojzoja i ngjante t'et dhe sillet në sektor po si Idrizi. Zojzoja nuk përfill askënd. Zojzoja njeh veç të anë, bile edhe atij ia kthen mbarë e prapë në kryesi. Jo, kështu nuk shkon.

Komunistët po qëllonin në shenjë. Problemet po analizoheshin, ato po dilnin nga rrënjët. Idriz Meta ishte skuqur dhe mbufatur. Gusha i ishte fryrë. Lëvizte në karrige dhe mezi përmbahej.

— Jepini, jepini pa doganë! — tha me zë të ulët. — Po qe kush burrë, le t'i nxjerrë paret... — e ngriti zërin dhe shikoi mbledhjen. — Po jua them unë: veç do të rrujë vezë, pare s'ka!

Idriz Meta nuk ishte budalla. Idriz Meta e drodhi fjalën. Të diskutohej problemi i lekut, jo figura e tij si kryetar.

Disa qeshën, por shumica heshti dhe e shikuan me dhembje sikur t'i thoshin: Sa poshtë ke rënë, o Idriz! Po këtë nuk ia tha kush. Heshtën. Besimit iu duk se aty ende qëndronte pezull brenda kokës së secilit një turbullirë. «Këta ende e kanë frikë Idrizin, —

mendoj Besimi. — Atij duhet t'i tregohet mirë vendi që këtu.»

— Këtu në organizatë secili është burrë dhe fjalën ka kush e dëgjon, — i tha Besimi duke e shikuar me mospërfillje. — Këtu je një anëtar i thjeshtë i organizatës dhe asgjë tjetër.

— Jam anëtar i byrosë!

— Si anëtar i byrosë dhe si komunist po gjykohesh.

— Aaa, unë po gjykohna?! Unë jam anëtar i thjeshtë. Po si kryetar, a s'jam kryetar?

— Secili në punën e ngarkuar është një kryetar, këtu asgjë, veç një anëtar i thjeshtë. Ti, shoku Idriz Meta, që flet pa radhë, që thërrret e kërcënon kështu, më duket ke harruar që dikur këta komunistë dhe ata punëtorët e shqopës të kanë zgjedhur kryetar. Ke harruar, prandaj thërrret kështu, prandaj kërcënon secilin diskutant, prandaj janë bërë gabime, prandaj je mospërfillës ndaj të gjithëve... Po mos harro se zot shtëpie këtu në kooperativë nuk je ti, është kjo organizatë, kolektivi, njerëzit. Këta, — Besimi hapi krahët sikur t'i përfshinte të gjithë pranë gjoksit të vet, — pa ty mund të jetojnë mirë dhe pa telashe, kurse ti pa këta...

Mbledhja rrinte si e mpirë. Idrizi kishte hapur gojën dhe ndoshta donte të thërriste, po nuk kuptohej çfarë e pengonte. Tiroidja ishte fryrë shumë, sa të shkaktonte dhimbje, kur e shikoje.

— Kur njeriu ynë mendon se pa të nuk gatuhet as buka në magje, bëhet si mishi i huaj që duhet operuar sa s'është vonë...

— Or ti shoq, bre-bre, or ti... — Idriz Meta për herë të parë foli me zë të ulët, si me të qeshur, por nuk e vazhdoi fjalën. Ai pa fytyrën e ndezur flakë të Besim Përdrintit.

— Shoku sekretar i byrosë, — tha Besimi duke iu drejtuar Tafës, — më jepni protokollet e byrosë së organizatës dhe të kësaj mbledhjeje...

Tafë Danaj mori protokollin nga komunisti që shkruante.

— Nënshkruaje, — i tha. E tërhoqi dhe ia la në duar Besimit.

— Kush jua ka dhënë këtë të drejtë? — thirri Idrizi. U ngrit më këmbë.

— Ulu në vend, — tha Besimi i qetë, ndërsa ziente nga brenda. — Të drejtën ma ka dhënë sekretariati i Komitetit të Partisë të Rrethit, që më ka dërguar këtu. Protokollin i mban byroja e organizatës, sekretari i saj, ju s'keni përse të shqetësoheni...

— E batë lamsh dreqi, por vallahi bilahi ti, Tafë Danaj, do të përgjigjesh.

— Mos u bëj merak për Tafën, Idriz-o, — i foli njëri nga komunistët, — po përgatitu për mbledhjen e asamblesë...

Mbledhja u mbyll. Kishte qenë një mbledhje e gjatë, me seanca, paradreke e pasdreke. U bë një pushim i gjatë, kur komunistët u shpërndanë të hanin drekën. Ishte vonë. Në sheshin përpara zyrave, në pjesën e errët, ashtu si rastësisht ishte grumbulluar një tubë njerëzish, nja njëzet-tredhjetë veta. Dikush tha se ishin nga ata të shqopës me shokët e tyre. Tafë Danaj hyri në zyrën e byrosë dhe mori protokollin tjetër. Besimi e priti në korridor. U mbështet te shtylla dhe shikoi si u afrua grumbulli i njerëzve. Ndihej i lodhur.

— Tafë, ça u ba? — pyeti njëri nga grumbulli, sapo e pa Tafën.

— Po ju ç'bëni këtu? — u tha Tafa.

— Shkretë. Kuvendi i pasdarkës...

— Qenkan të gjithë, — i tha Tafa Besimit. — Të gjithë ata. Grumbulli u rrit, se me ta u bashkuan komunistët. Askush nuk po largohej.

— Or ti, nuk di unë sekrete e llafe pazari, dua përgjigjen nga i deleguari.

— Nuk bëhen punët tak-fak, ti prit, hej burrë, ke pritur nëntë muaj... S'ke lindur shtatanik.

- Përgjigjen do ta marrësh nesër.
- Më mirë sonte se nesër.
- Ti e ke fjalën për lekët?
- E, po për çfarë tjetër?
- Prit, ja i deleguari.
- Shokë, — u foli Besimi, — përgjigjen do ta merrni nga shoku Tafë.
- Ani, burrë, po djalë a apo çikë?
- Djalë a çikë, do ta merrni vesh në mbledhje, jo këtu.

Ata kishin qenë gati gjithë pasditen në pritje të mbarimit të mbledhjes së Partisë. Kur dilnin ndër pushime, ata shikonin me vëmendje humorin e komunistëve dhe përpiqeshin të shquanin si po shkonin punët. Dikush kishte thënë se Idriz Meta po jepte llogari në organizatë për gjithë punën në kooperativë. Fjala ishte përhapur menjëherë në gjithë Bregasin. Disa u shkëputën nga shokët dhe njëri prej tyre iu afrua Idrizit. I foli si me dashamirësi, po pa se Idrizi ishte nervoz dhe këputi ca të shara që nuk u morën vesh se për kë i kishte. Ata të tre erdhën te shokët dhe u thanë se Idrizi nuk hapej, por nuk dukej mirë.

Njerëzit pritnin me besim se do të ndodhte diçka, do të merrej një vendim, do të ndryshonte diçka dhe kjo nuk ishte vetëm puna e lekëve të një grupi kooperativistësh. Jo, diçka tjetër, më e mirë, diçka që u takonte të gjithëve, jo për një ditë, po për gjithë kohën.

KAPITULLI I TETËMBËDHJETË

Idriz Meta çau mes errësirës fill i vetëm, duke vrarë mendjen si t'ua gjente anën barrëve që po i binin nga samari. Te trangu i gorricës në kënd të sheshit, aty ku niste rrëpira për në fshat, dikush u shkëput nga shokët dhe i thirri. Ai ishte aq i hutuar, sa me zor dalloi Kallushin.

— Kushëri, o kushëri, — tha Kallushani, — pa ndalu një minutë... — Kur iu afrua, e pyeti me zë të ulët se çfarë u bë atje në mbledhje.

— U ba m... — Idrizi ia këputi një të trashë në adresë të Tafës. — Ai personi, që ka ardhë, e ka futë në thes Tafën. Tana punët po marrin rrokopujën. Lesh dreqi u banë pëtërr.

— Po ç'doli nga ajo analizë? Unë s'po marr vesh. Në u dashtë, ju paguajuani. Lekët të kooperativës janë, ty s'të hyn gjë në xhep.

— Se mos ishte veç puna e atyne pareve. Kallush, më duket se po fryn erë e keqe në grykën e Bregajt. E ndiej unë. Ma kanë vu synin. U jam mërzitë e tashti po duen me vu ndonji tjetër, prandaj qesin e këpusin bishta. Jo po puna e pagesave, puna e drejtimit të kooperativës, puna e administrimit të pronës, puna e trajtimit të njerëzve, puna e arrogancës e pallavra. Bile edhe puna e oborreve. Dyshojnë ke ti, Kallush... Ai drejtori i Bankës e hodhi një fjalë që më dogj. Ndigjo, Kallush, ai personi i mori protokollet e dy mbledhjeve. Ia kam frikën ndonji procesi gjyqësor... Nji dreq e din ç'del mandejna...

— Jo, more! Shiko, shiko... Driz-o, a ma le mua të merren me atë Përdrëqin një herë?

— Me cilin?

— Me Përdrinin, pra, të deleguarin.

— Si do të merresh? Ai mblodhi protokollet dhe po nisët qetash.

— E di unë si e kap pisk atë, mos ma ki merakun. — Ai i shtrëngoi duart Idrizit dhe u ndanë në errësirë.

Kallush Kukajn e pushtoi ndjenja e vetëbesimit. «Unë jam nga ata ushtarë, — mendoj, — që, kur i përmbledh gjithë energjitë, qëlloj në shenjë.» Gjithë jetën kishte vepruar me shkathtësi, shpejtësi. Kishte shfrytëzuar minutën, rastin e duhur, njeriun dhe ia kishte dalë mbanë.

Kur ishte fare i ri, një rast fatzi bëri që Kallushanin ta mbante në gojë Bregaj, Lkeni e për shumë vjet më vonë mbeti histori puna e tij. Ai e kujtonte atë rast me një ndjenjë dashurie e krenarie ndaj vetes. Plaku Brah ishte me ethe dhe kishte kërkuar borë. Po ishte gusht dhe borë kishte vetëm në sternën e Gropës së Madhe. Kallushani u nis paradite me një thes në krah. Bëri ca rrugë në këmbë. Përpara i doli plaku Matosh Tali, hipur mbi një kalë kërr. Kallushani i tregoi gjendjen e Brahës, kuptohet, u përpoq t'ia nxinte sa më shumë. Matosh Tali u trondit. Zbriti nga kërrit dhe ia dha Kallushanit pothuaj me zor. Djali i prapë i Brah Kukajt e ngau kërrin si në mall të begut, u rrëzua në rrëpirën e përroit të vogël, ku kërrit theu këmbën e parë, ndërsa Kallushi, i shkathët si një mace, vetëm u gërvisht mes një dëllinje. Matoshi, si pa që Braha ishte më mirë, i dredhoi vdekjes, nuk e pranoi kalin me tri këmbë. Kërkoj paratë. Kallushani kundërshtoi. Braha nuk u përzje në punët e djalit. Po puna shkoi në pleqësi. Pleqësia u mblodh në shtëpinë e Matoshit. Ka-

llushani, si u këshillua me Brahën, u paraqit me vonesë në shtëpinë e Matoshit. Pleqtë e kishin pirë kafën dhe pritnin. Matoshi i nxori kafën Kallushanit dhe pritej të niste pleqërimi i çështjes. Kallushani e vuri filxhanin te goja, pastaj «i ra» dhe filxhani u thye. Brofi i shqetësuar, «Baca Mat, ta paguej kafën e filxhanin,» — tha dhe nxori një tufë të trashë kartëmonedhash. «Jo! — tha Matoshi, i prekur në sedër. — Në jetë të jetës Matosh Tali s'e ka shitë kafën në shtëpinë e vet.» Ai ishte njeri i mirë, fisnik dhe njihej për bujari. Kallushani nuk priti të vinte kafe tjetër. U përshëndet dhe doli. Matoshi shikoi pleqtë. Ishte fare i hutuar. I pyeti pleqtë se përse nuk po e ndalnin. «Përse?» — e kishte pyetur njëri nga ata. «Për lekët e kalit, pra...» «Ti ia fale vetë, — tha më plaku. — Me mikun ha e pi e treg mos ban.» Ata ikën. Matosh Tali humbi kalin, ndërsa dredha e Kallushan Kukajt u përhap si era. Ndonëse ai e dinte se ishte finokëria e babës Brah, nami i mbeti atij. «Kot nuk thonë, — mendonte, — dhentë e dhitë e Zeres e nami i Hasan Qeres.»

Duke kujtuar shpesh këtë ngjarje, Kallushan Kukaj ushqente një vetëbesim në mprehtësinë, zotësinë, shkathtësinë e vet. I kishte hyrë aq shumë në ndër-gjegje kjo, sa i ishte bërë mani. Kjo ishte arsyeja që për interesin e tij o të dikujt në fis, ai e merrte vendimin shpejt, rebelohej dhe i hynte realizimit të pikësynimit me të gjithë forcën, pa marrë parasysh asnjë pasojë.

Si bisedoi me Idriz Metën, ai vendosi t'i dilte ballë për ballë Besim Përdrinit. «Gjithë puna është që ta takoj, — mendoi, — pastaj e di unë si gatuhet pilafi.» Nëse e takonte pikërisht atë natë, gjithçka mund të rregullohej në njëfarë mënyre. Idrizi nuk duhej të digjej, në mos po... me shqopën ishte vetëm fillimi, qilizma do të hapej me oborret personale.

Kallushani u soll ca rreth klubit. Mori vesh se në

sallë po jepeshin përgjigjet për letrën. Dikush i tha se i deleguari ishte atje, po do të nisej menjëherë për në qytet. «Po shkoj me të deri te kthesat e sektorit të blegtorisë, — mendoj. — Mandej shkoj nga Diana. Nësër jam përsëri këtu. Në xhep i kam dy armë: pusullën e lidhjes së tij me Dianën dhe anën politike të çështjes. O njërën o tjetrën ai do ta hajë. Sonte ai nuk duhet të shkojë në qytet. Karamelet e këtij Kallushit do t'i hash edhe ti, Përdrin, s'të lë të shkosh...»

Kallushani i mbajti me bisedë dy fshatarët derisa dolën nga salla e klubit Tafa me shokë. I foli Tafës, këmbyen cigare. Besimi erdhi aty. Kallushani e dinte që Besim Përdriin nuk i ndahej Tafë Danajt. Kallushani ishte plot humor, plot gjallëri. Besimi nxori paketën, po ajo ishte bosh. Ai e zhubrosi dhe e hodhi. Kallushani u tregua më i shpejtë se të tjerët, nxori paketën e vet.

— Ndize, shoku Besim, ndize një nga plaku, — qeshi. — Plak jam njimend, po cigaret i kam të reja.

Tafë Danaj i hodhi një sy Besimit dhe i tha:

— Në shtëpinë time na presin. A do të vish edhe ti, Kallush?

— Unë po nisem, — tha Besimi. — Nata është e freskët. Deri në qendër s'ka veç një copë rrugë. Pastaj, kushedi, na del ndonjë makinë e gjeologjisë.

— Ama llaf, — tha Tafa. — Ç'është kjo, të na ikësh natën?

— Natën, natën, — qeshi Besimi. — Gjurmë s'kam. Përse të rri kot?

— Edhe unë po vij me ty deri në qendër, shoku Besim, — tha Kallushani. Ngadalë-ngadalë, plaku ecën më mirë, kur ka një shok me vete.

Besimi e shikoi me vëmendje. Plaku Kallushan ishte fytyrëçelët dhe plot humor. «Aq më mirë,» — mendoj.

— Mirë, bacë. Ke gjë për të marrë, apo je gati?

— Jam gisht, — qeshi Kallushani. — Po zbres deri në qendër, o deri në sektor të blegtorisë, tek

ime bijë. Nesër do të ngjitem prapë këndeje...

Besimi i dha dorën Tafës, po ai s'e la. Nguli këmbë që të merrte ndonjë ushqim me vete, meqë nuk do të rrinte.

— Kështu s'bën, se s'jemi në front, de, — tha Tafa. — Megjithëse edhe në front, është dikush që të vjen pas me bukë e me fishekë... — Tafa shikoi se te këndi i klubit dikush rrinte vetëm mbështetur te muri. — Drin, Drin, mor bir! — thirri. U afrua një djalë i gjatë, i bukur, plot shëndet, me jakën e këmishës hedhur mbi atë të xhaketës. — Shko një vrap në shtëpi e gatit bukë për dy veta, se kanë rrugë. Shpejt ama, se nuk do të rrinë. Tani vijmë edhe ne. — Drini iku. Ata u ndanë me fshatarët dhe ecën ngadalë në rrugicën mes gjerdhesh. Besimi dëgjoi këngën e bulkthit, të ëmbël, nanuritëse që e thërriste të qëndronte diku në ledh aty, aty... Zogjtë e natës thërritnin njëri-tjetrin. Një kukuvajkë fluturoi mbi kokat e tyre drejt çatisë së një kulle. Horizonti i lartë i malit po zbardhej nga hëna që po dilte me përtesë. Pllaja nën këmbët e grykës rrinte si e fjetur nën shkëlqimin e zbehtë hënësor dhe dukej edhe më e lartë. Në mes të saj xixëllonin dritat e sektorit të blegtorisë.

Gjysmë ore më vonë Besimi ecte krah për krah Kallushanit në xhadenë brinjë nomeve të fermës, mu te gjunjët e kodrave të grykës, pranë ujëmbajtësit. Kallushani ishte në humor, tregonte gjëra për të qeshur, kur, papritur, ia nguli sytë Besimit dhe e pyeti:

— Po ti, si e kalove sot?

Besimi i tregoi për sa kishin ndodhur. Kallushani ia miratonte fjalën duke thënë shpesh «posi», «posi!». Pastaj, si kalimthi i tha:

— Do pasur kujdes në këto punë, se është zonë kufitare... Jo më kot shteti u fali kreditë gjithë zonavave malore. I shikon me sy tjetër, prandaj ca punë duhen bërë urtë e butë.

Besimi nuk e kapi ku e kishte fjalën plaku. Zo-

nat malore nuk ishin zona kufitare dhe falja e kredive nuk bëhej se ishte vend kufitar, por për arsye të terrenit, që ato të përparonin e të ishin afër atyre të fushës.

— Pikërisht, — tha Besimi, — pikërisht për këtë në Bregaj s'duhet lejuar asnjë shkëlje. Si thoni ju, bacë?

— I bëjnë nga budallallëku.

— Hë, — qeshi Besimi. — Idrizi e Sami Bullona s'janë budallenj. Ata e komandojnë ekonominë si kopshtin personal. Me sa kuptoj unë, interesat e tyre personale puqen diku me ata të disa individëve që përpiqen të zhvatën diçka më shumë dhe të diferencohen nga kolektivi. S'ka si shpjegohet. Ja, njëfarë Zekë Qafoku ka marrë nga bonifikimi i një rrethi dy mijë e shtatëqind lekë për hapje kanali, punë e llogaritur në njëzet e katër ditë... Buldozer është ky Zeka që hap një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë metra kub kanal në njëzet e katër ditë? Mesatarisht aty i qëllon të ketë bërë shtatëdhjetë metra kub në ditë. Asnjë buldozer nuk e arrin dot këtë normë. Zekë Qafoku ka punuar si sipërmarrës fshehurazi dhe ka shfrytëzuar punën e tjetërkujt, ndoshta edhe të mjeteve të mekanizuara. Spekulli nis diku në një rreth tjetër me këtë Zekën dhe na vjen këtu tek Idrizi që derdh paratë nëpërmjet llogarisë së kooperativës...

«Qenka djalli vetë,» — mendoi Kallushani dhe e shikoi me bisht të syrit.

— Po ç'ke ndër mend të bësh? Si përfunduat? Unë pashë edhe ata të kontrollit, drejtorin e bankës që u dukën aty...

— Ç'do të bëj unë? Hë! Asgjë. E ç'do të bëj?

— Jo, ta kam llafin, si do të marrë rrugë kjo punë. Do ta mbyllni në rrugë Partie, apo...

— Nuk ju kuptoj, bacë, — tha Besimi. — Për ç'rrugë e keni fjalën?

— Mos ia vënë hekurat kujt?

— Në e pastë hak, dikush e meriton, megjithëse nuk i dihet.

— Cili?

— Nuk di të them. Secili ka fajin e vet, dikush më pak dikush më shumë. Vetëm për disa jam i sigurt që nuk kanë asnjë faj, veç të drejtë: punëtorët. Ata duhet t'i marrin pagesat një më një. Punë tjetër është ajo që nuk duhen lejuar në të ardhmen. Edhe për grupin e dytë, ata me kontratë, rregullat duhet të zbatohen e të paguhen në kohën dhe sasinë që u takon. Kurse tek ata të kooperativave të tjera si puna e Zekës që adresojnë urdhërshirimet këtu dhe u ndalohen përqindjet mbi bazën e ditë-punës së Bregajt, ka spekulim, ka allishverishe. Ata duhet të përgjigjen diku...

— Jo, more! Pa shih, pa shih... — tha Kallushani dhe Besimi ndjeu se ajo «jo, more!» kishte nota ironie. — I paske hyrë në damarë kësaj pune. Pirolla të qoftë! A qëndrojmë pak, se u lodha?

Qëndruan anës rrugës. Besimi nxori bukën që u kishte mbështjellë në gazetë djali i Tafës dhe hëngrën, pa këmbyer asnjë fjalë. Kallushani, si mori pak bukë e djathë, piu pak dhallë dhe e la. Ndezi cigare.

— Punë e ngatërruar, — tha. — A s'mund t'i vësh kapakun kësaj pune, Besim? — Ai i foli ngadalë, si me lutje, ngrohtë, gati familjarisht. — Atë drejt Idrizin e kam timin. Besoj e di që në Bregaj unë kam të mitë... — Mes asaj lutjeje, ngrohtësie e familjariteti ziente nga brenda një ndërsim i fshehtë. — U bë si u bë, edhe për hir të zonës malore, ja në kufi jemi edhe për... Sa lëshime u janë bërë këtyre, vetëm kreditë të mendojë njeriu. Jo po ndihmat e... Pse mbyllet kjo punë, — ta kam llafin me kaq e pikë, burrërisht! — të mos bëhet objekt i rrethit, i hetimeve e çetimeve, jo po pse, jo po qysh...

Besimi po e ndiqte me shumë vëmendje. E la bukën. E mbështolli në gazetë dhe e futi në çantë. U kapërdi

me zor dhe e shikoi drejt në sy, po tjetri përplasi qerpikët dhe uli sytë.

— Si ta mbyll, të hesht?

— Po ti e bëre punën tënde, mirë boll. Problemi u zgjidh. Punëtorët do të të paguhen sipas rregullave. Tani mos e zgjat. Mos e bëj fjalë më tej. Mos i merr më qafë njerëzit. Po dogje Idrizin, na dogje edhe ne. Na bëre me njollë edhe... mua, Dianën e...

— Ç'hyn Diana këtu?

— Hyn, hyn... Diana është jo veç ime bijë, po edhe mbesë e Idrizit. Por, po u bë Idrizi me njollë...

— Ç'flitni kështu, shoku Kallushan? Përse e përzieni Dianën me këto?

— I di unë, i di punët e mia, mor bir. Kam lindur më herët se ti... — Toni i Kallushanit zbuloi hakërrimin e fshehtë që ai e ndrydhte me zor.

— E pastaj? Ju më vini si kusht Dianën që unë të... — Besimi u ngrit me rrëmbim. Gjaku i kishte hipur në kokë sa i rrihnin tëmthat. Po me atë lehtësi u ngrit edhe Kallushani. Tani ishin ballë për ballë. — Ju, Kallushan Kukaj, më vini si kusht Dianën që unë të bëhem bashkëpunëtor i atyre...? — Besimi u përmbajt që të mos thoshte «spekulantëve».

— Leri këto pallavra! — tha Kallushani me për-buzje. — Mos merr njerëzit më qafë, këtë bëj. Që tani eja të kthehemi dhe dorëzo protokollin. Lëri ata në hallet e tyre. Mos kujto se Bregaj është uzina e bakrit.

«Domethënë ky e ditka se unë kam marrë protokollin, — mendoj Besimi. — Për këtë ka ardhur me mua!» Kallushani po fliste me mllef, me hakërrim fare hapur.

Besimi për një çast u hutua, por ndjeu dorën e madhe eshtake që i shtrëngonte fort krahun dhe u përmond. E tërhoqi krahun me rrëmbim dhe çanta ra përtokë. Kallushani e humbi durimin dhe e zuri me të dyja duart në jakën e xhaketës. Besimi ndjeu shtrëngimin dhe kërcitjen e dhëmbëve të Kallushanit.

— Kthehu! — thirri Kallushani. E kishte humbur

mendjen nga tërbimi. Besimi ia shtrëngoi duart në kyçe dhe u përpoq ta largonte. Por Kallushani humbi drejtpeshimin dhe e tërhoqi me vete e ranë të dy. Plakut sesi i ra pistoleta aty afër. Ai zgurdulloi sytë dhe zgjati dorën ta merrte, po Besimi qe më i shpejtë. Mori armën dhe u ngrit, pa ia hedhur sytë.

— Të lumtë! — i tha. — Edhe burrë i vjetër... — U largua disa hapa. I tha të ngrihej, ndërsa vetë po dridhej nga tronditja dhe turpi, sa i vinin të përziera në stomak. — Ngrehu, — i tha. Ç'më shikon ashtu? Nuk vë dorë mbi ty. As që kam ndër mend t'ia them kujt këtë turp. Veç pistoletën... Nuk ta jap. Sa për ato të tjerat... më qafë na paç mua dhe Dianën. Në Bregaj unë nuk kthehem.

— Vritmë! Hajt, qëllomë! Ç'pret? — shkumëzoi Kallushani. Besimi i ktheu shpinën me neveri. U përkul të merrte çantën, po një gur si një zog nate fërfëroi ajrin mbi kokën e tij dhe ra më tutje. Besimi u rras në tokë, mbi çantën ku kishte dokumentet.

— Mos lëvizni! — Një klithmë çau natën. Besimi pa në anën e poshtme të xhadesë bariun plak Selman Sula dhe të birin, Rizanë, që u kishin drejtuar pushkët.

— Kallush, paske luejtë mendsh sonte! Ça a puna? — pyeti Selmani, kur e njohu, ndërsa qëndronte si mënjanë me pushkën në duar.

— Asgjë, — tha Besimi. — E kam fajin unë. E ofendova dhe mirë u bë...

— Hë! — shfryu Kallushani.

— Shkojmë në vathë, atje i gjejmë llafet, — tha Selmani. Besimi pa se plaku nuk e lëshonte pushkën dhe nuk lëvizte. Mori çantën dhe u nis i pari poshtë rrugës drejt vathave. Iu morën mendtë dhe u rrëzua. Rizai i dha dorën. Në lug qentë po lehnin me tërsëllëm. Mbi ujëmbajtës hëna mbyste plot reflekse shndritëse valët.

Kur hynë në plemen e barinjve, Kallushani u ul mënjanë. Nën dritën e zbehtë të fenerit, Besimi u freskua me ujin e ftohtë që i hidhte Rizai. Kallusha-

ni ishte shfytyruar. Drita e verdhë, e dobët e fenerit e kishte mpakur e plakur më shumë.

— Turp, bre! Turp, pasha besën! — tha Selmani duke qëndruar më këmbë në hyrje të plemes, pa e lënë pushkën, sikur t'i ishte ngjitur ndër duar.

— Fajin e pata unë, — buzëqeshi Besimi. — I rashë më qafë bacës pa vend e pa kohë.

— Hë! — u grind Kallushani që ziente ende.

— Për atë zot, s'po marr vesh, — tha Selmani. — Ti, mor bir, — iu drejtua Besimit, — më duket kot po e merr barrën mbi shpinë. Kallushin e njoh unë...

— Baca Selman, unë kam uri, — qeshi Besimi. — Ke kos a dhallë? Këtë dua. — Plaku shikoï Rizanë buzagaz dhe balli iu qetua. La armën, gërmoi në kënd dhe solli bukë e kos. Besimi, ulur rrafsh mbi lëkurë dhensh, hëngri përshesh me kos, pa ia hedhur sytë Kallushanit. Piu ujë, falënderoi Selmanin dhe tha:

— Vetëm këtu te ti, baca Selman, dhe në shtëpinë time unë e ha përsheshin me kos me kaq oreks.

E dinte se plakut i pëlqente t'ia haje bukën pa ngurrim.

— As që e marr me mend si ju ndodhi kjo marrëzi, — tha Selmani i menduar pa ia hequr sytë Kallushanit. Besimi mendoi se mos ata e kishin dëgjuar zënkën me kohë dhe e dinin përse. Pastaj mendoi se ata duhej të mos e kishin dëgjuar mirë, se ishin larg nën rrugë.

— Për kryetarin e Bregajt u zumë, — tha Besimi buzagaz. — Ti baca Selman, besoj e di se si sillet me shokë Idrizi i rreptë. Sikur kooperativa të ishte xhaketa e tij.

— Besa, mor bir, turp për ty e marre për Kallushin! Po le të mbetet mes nesh, ani. Veç zoti e kjo pleme ta dinë. — Nxori kutinë e duhanit, iu afrua Kallushanit dhe ia drejtoi me dorë në zemër.

Jashtë kishte zbardhur agu i mëngjesit. Drita hynte në pleme si shirit i bardhë. Dhentë ishin larguar tok me Rizanë.

— Kallush, djali a i mirë dhe gjykon si plak,
— tha Selmani. — A gjynah i zotit t'i ngucni urët
në ditë me diell.

Kallushani mori kutinë e Selmanit, nxori paketën
e vet dhe ia drejtoi bariut plak. Një lot i vezulloi në
cep të syrit dhe ai ktheu kokën mënjanë. Në lëkurën
e rrudhur, të fishkur, ngjyrë gruri kishte diçka që ngja-
sonte me Hekuranin. Besimit i erdhi keq. Vriste men-
djen si ta bindte që të vazhdonin rrugën të dy.

Kur dolën nga plemja, Kallushani tha se donte
të kthehej në Bregaj.

— Do ta vazhdojmë rrugën tok, — i tha Besimi.
— Tani s'ka as lezet të kthehemi në Bregaj.

— Si të duash, — tha Kallushani. — Më zure ngu-
shtë, tani...

— As të zura, as më zure. Ishte natë dhe s'u pa
mirë si qe. Më duket s'i lamë kusur njëri-tjetrit.

Ecën të tre derisa u ngjitën në xhade. Selman Sula
i përcolli deri tek ujëmbajtësi, u përshëndet me ta dhe
u kthye. Pas pak, aty ku xhadeja merrte kthesën, Be-
simi pa se bariu plak qëndronte pranë lisit dhe shi-
konte andej.

Urbani i linjës kërcente mbi gropat e rrugës, ndër-
sa ai po gjykonte veten, pasi ishte ndarë me Kallu-
shanin.

«Përse e tërbova ashtu plakun? — thoshte me vete.
Ç'ishte gjithë ai shpërthim i tij? Apo unë nuk kisha
faj. Jo. Unë kam pjesën time në këtë qull. Bobo,
sa turp! Tani do të dergjesha kushedi ku nga ai gur
i pabesë! E përse? Sepse një Idriz nuk duhet të jetë
kryetar, se disa persona s'duhet të hanë me speku-
lime në kurriz të të tierëve... Po unë me sa mend ia
thashë një e nga një të gjitha hallet e Bregajt? Që
t'i tregoja se jam i zoti, se unë i di, se jam unë që i
vë gjërat në vend... Unë? Kështu? Hë!! Mirë ma bëre,

more Kallushan Kukaj. Ky është mësimi yt dhe unë s'do ta harroj kurrë. Kurrë!»

Ai shkoi menjëherë në Degë të dorëzonte armën. Operativi i tha se arma i kishte humbur Kallushan Kukajt dhe se ai ishte ende brenda. Kur hyri Besimi, Kallushani uli sytë.

— Rastësisht, — tha Besimi duke lëshuar armën mbi tavolinë. Ata shikuan markën, numrin dhe Kallushani tha «kjo është». Pastaj ai tha se nuk donte ta mbante më e se, po ta lejonin rregullat, armën le ta mbante djali. Bënë ca fjalë, po Kallushani nuk pranoi kurrsesi ta merrte përsëri armën. Besimi i bëri kërkesën me shkrim komisionit të armbëmbajtjes dhe, pa dalë andej, erdhi libreza për firmë. Dolën të dy: njëri i armatosur, tjetri i çarmatosur. «Po të mos kisha vepruar me kujdes, — mendoj Besimi, — tani mund të ishim të dy tek operativi duke dëgjuar këshilla.»

Shkoi Kallushanin që ishte bërë pikë. Ecte ngadalë, kërrusur e lodhur, tamam si një i sëmurë. «Po ky ç'mendon?» — tha me vete. Po nuk kishte si e kuptonte atë. E njihte pak, fare pak, nëpërmjet Dianës. Kallushani dukej i qetë, po në të vërtetë ziente nga brenda. Ishte shkrehur fizikisht dhe ndihej i lodhur, por llogaritë i bënte si për vete.

«Mjerë unë, — thoshte me vete plaku. — I varfri unë! Popo, ç'do të kisha bërë. Me atë gur unë qëllova veten. Djemtë e mi, Dianën, Vjedën, vëllezërit, fisin... Emrin tim tani që... Medet ç'bëra! E përse? Për atë pis Idrizi. Tani do të dergjesha brenda, ose... ose më mirë t'ia hiqja vetes. Kurse ky djalë, me gjithë ato që ngjanë, ka zemër njeriu...»

— Në kryqëzim Kallushani qëndroi. Qëndroi edhe Besimi.

— Dëgjo, mor bir, — tha Kallushani. Nxori nga xhepi i xhaketes një copë letër. — Një maskara ma ka shkruar këtë para disa ditësh. Është për ty e për Danën, time bijë. Unë Danën e kam si dritën e syrit.

Ca dardhiçka s'i përtyp dot, se jam burrë i vjetër. Me këtë... s'të them as eja, as mos eja, veç... të lutem mos u lër shkas njerëzve të tillë, se pastaj... — Ia la pusullën në duar dhe iku. Besimi lexoi shënimin e zi brenda. «Ky njeri vërtet na ka përgjuar, — tha me vete. — Po kush është ky?»

Kallushan Kukaj ecte ngadalë, i këputur dhe i menduar. «As eja, as mos eja...» — tha me vete.

KAPITULLI I NENTËMBËDHJETË

Si mendoj edhe një herë mirë e mirë punët, takimet me punëtorët e shqopës dhe me njerëzit e tjerë si dhe protokollet e mbledhjeve, Besimi vendosi të raportonte për të gjitha ç'pa atje.

I hodhi në letër të gjitha këto dhe, kur nisi të trajtonte çështjen e pagesave dhe ndryshimet mbi bazën e ditë-punës ndër kooperativa të ndryshme, i lindi problemi i fuqisë së lirë punëtore në stinën e dimrit. Nuk dinte të jepte asnjë mendim. E la punën dhe shkoi të takonte drejtorin e bankës bujqësore. Ai djalë i gjatë, ballëllartë, i zbehtë dinte si në pëllëmbë të dorës gjithë gjendjen e kooperativave. Ato që Besimit i dukeshin të ngatërruara, ai i quante të thjeshta, të njohura. Për fuqinë e lirë punëtore në kooperativë gjatë stinës së dimrit ai qeshi dhe tha se asnjë kooperativist nuk ishte i lirë gjatë dimrit.

Besimi u kthye në shtëpi kur mbi qytet po binte muzgu. Njerëzit po ktheheshin në grupe të mëdha nga aksionet me punë vullnetare për ndërtimin e blloqeve të reja të banesave të lagjes nr. 7 dhe të lagjes nr. 4. Ai qëndroi pak në kryqëzimin e rrugës duke parë vërshimin e njerëzve.

Në shtëpi ishte vetëm nëna. Shqetësimi i saj për ushqimin dhe gjumin, gëzimi i njerëzve në rrugë, zhurma e atij vërshimi pas aksioneve masive, sqarimet që mori nga drejtori i bankës ia kishin mbushur zemrën plot gëzim dhe ai mendonte se do ta përfundonte punën menjëherë.

Do ta bënte relacionin, se tani çdo gjë e kishte të qartë. Përveç të tjerash do të sugjeronte që Bregaj të bëhej një kooperativë e specializuar blegtorale për dhinë e madhe mishtake dhe delen rudë. Ky ishte mendimi i Dianës. Ai do ta paraqiste. I kishte folur disa herë për këtë punë ajo. Kishte edhe një studim, kishte botuar edhe artikuj në «Bujqësinë socialiste».

Pastaj do të pushonte dhe të nesërmen do ta daktilografonte në komitet.

Po ai nuk e daktilografoi dot. Vasil Kushta, sapo e pa te nëpunësi i shërbimit, i futi krahun dhe shkuan të dy në zyrë.

— Ndenje gjatë atje, — qeshi Vasili. — Më duket, të pëlqeu klima. — Besimi ishte si mbi gjemba se materialin e kishte vetëm në dorëshkrim dhe në disa vende me korrigjime.

— Po ti ulu, ulu, hej burrë. Më fal se të lashë në këmbë. Ulu, pa të bisedojmë. — Besimi i drejtoi materialin dhe u ul. Vasili shikoi fletët e shkruara. I kaloi shpejt dhe u ndal te konkluzionet. Lexoi diçka aty dhe tha: — Gjithë kjo për atë letër?

— Për atë letër dhe për të tjera, — Besimit iu duk se në fjalët e sekretarit kishte doza ironie. Po ai, si i zgjati paketën, hapi fletët përsëri nga e para dhe po shikonte nëntitujt, problemet që ngriheshin. Në ballin e madh iu formuan rrudha, mbi fytyrë sikur ra një zymtësi. Një tis i hollë djerse se si u shfaq e mbuloi ballin dhe buzën e sipërme të Vasil Kushtës. Besimit i shkuan sytë te copa e mineralit të bakrit që rrëzëllente plot shkëlqim në kënd të tavolinës, siç e kishte parë ca ditë më parë.

Vasili u ngrit pas pak me materialin ndër duar. Ndenji një çast pranë dritares. Dielli i ra mbi një pjesë të fytyrës, te flokët që zbardhëllonin. Shikoi jashtë, larg, diku. Besimi e ndjeu veten ngushtë. Po e

humbte durimin, si studenti që pret notën e provimit, ndërsa pedagogu është mënjanuar dhe nuk vendos. Gjithë lodhja, tensioni i ditëve dhe netëve të Bregajt u zbrazën njëherësh dhe Besimi e ndjeu veten si në mëngjeset kur dilnin nga turni i tretë. Le ta jepte një mendim, le të thoshte ç'të donte, le ta gjykonte me përvojën shumëvjeçare të tij sekretari, le ta hidhte poshtë, le të tregonte rrugët si të donte, punët ishin ashtu siç i kishte treguar në atë relacion. Ai i kishte parë vetë, i kishte dëgjuar vetë, i kishte peshuar në vend. Le të vendoste vetë sekretari, po nuk mund të thoshte se gjërat nuk ishin ashtu. Po ja, Vasili u kthye i qetë, la materialin mbi tavolinë. Ai po i thoshte se materialin do t'ia jepte sekretarit të parë. Pas dy javësh e shumta do të shkonin tok të dy përsëri atje dhe çdo gjë do të vihej në vend. Ndërkohë organizata, kryesia e kooperativës, vetë asambleja do të bënin punën e tyre.

— Drejt e ke qëlluar, — tha Vasili. — Atje nuk është vetëm problemi i pagesave me lekë në dorë, me ditë-pune apo si kohë këtë muaj a në fund. Atje gjërat janë të lidhura dhe ti i ke parë drejt.

— Mua më duket se i ngatërrova ca... — i tha Besimi.

— I ngatërrove? Po ato ashtu ishin. Tani ato shtjellohen, shoshiten, duhet të jenë bërë menjëherë problem i të gjithëve, se kështu janë. Byroja me Tafë Danajn, organizata... Nuk arrijnë njerëzit atje, vëlla. Sa mirë je kujtuar për protokollat. E shikon si e lëvizni gjithë makinën atje vetëm ai instrument? Vetëm ajo letër nga poshtë? E shikon ç'forcë?... — Vasili e futi materialin në njërin nga dosjet që kishte mbi tavolinë, mori çelësat dhe dolën. Ai pyeti për shoferin dhe dikush u nis ta kërkonte në garazh.

Ecën ca në sheshin e mitingjeve dhe qëndruan nën hijen e një pishë.

— More Besim, aty kishte një mendim për ta kthyer Bregajt në kooperativë të specializuar blegtorale për

dhinë e madhe mishtake të krahinës dhe delen rudë. E di se këtë mendim e kemi edhe nga një specialiste, nga një shoqe, nga ajo veterinerja e NB-së, e njeh? Diana Kukaj. Ajo ka një studim për këtë. Është një studim i mirë, me argumente, të bind. Me gjithë këtë, ne ua kemi dhënë nja dy shokëve... Si thua, sikur të punoje edhe ti me dy instruktorët për këtë problem? Ne kemi vështrimin larg, kuptohet, pak më shumë se të bëjmë atë. Duam që në të ardhmen të bëhen studime, kërkime me interes ekonomik e shkencor. Po ja që po na ecën ngadalë kjo punë. Sikur të punoje edhe ti për këtë problem me grupin e instruktorëve? E, si thua?

— Shoku Vasil, unë s'ia thek shumë kësaj pune. Ndryshe është me bakrin. Atje e kam mësuar herët abecënë. Kurse Bregaj më dha një mësim të mirë... Unë s'bëj për punë të tilla, i bëj me vështirësi.

— Ç'thua kështu, more?! — Vasili e shikoi me qortim. — Vërtet nuk do të punosh me grupin?

— Unë do të punoj, kudo që të më çoni, por... ca punë si kjo e Bregajt, janë shumë të vështira dhe unë mund t'i ngatërroj në mënyrë të pandreqshme... Puna me njerëzit nuk është si puna me bakrin. Mua më pushton ndjenja e euforisë së atij që është i zoti, që e ka fatin e njerëzve në dorë dhe bëj marrëzira...

— Të ndodhi gjë atje?

Besimit i digjnin faqet. Ato që ndodhën nuk tregoheshin.

— Nuk di ç'të them. Po ato që kam shkruar, i kam menduar mirë. Idriz Meta duhet të japë llogari përpara asamblesë dhe të shkarkohet. Ai sillet si padron. Shefi i llogarisë, pasi t'i bëhet një kontroll i mirë financiar, duhet të largohet nga Bregaj. Zootekniku, siç thoshin kooperativistët, i nxitur nga Idrizi, bënte shumë «therje të sforcuara». Organizata është e shëndoshë dhe, me sa pashë, ka në krye një njeri jo vetëm me përvojë, por shumë të mirë, të vendosur, pavarësisht nga ato që kanë ndodhur. Idrizi është marifetçi

i madh dhe ua ka mbyllur gojën njerëzve, Tafa ka vënë firmën, pa ditur se si janë punët, po ashtu siç ia jep Idrizi. Ajo kooperativë më tha se unë nuk kam pikën e përvojës në këto punë dhe mund të bëj çdo marrëzi... Ja, këtë mund ta them. — Besimit ende i digjnin faqet. Ai s'mund t'i thoshte sekretarit se si thërriste Idrizi, si shkoi Tafë Danaj me pistoletë në brez dhe zunë Sami Bullonën natën, se ai Idrizi s'është tjetër veç një degë e lisit Kukaj, degë që kishte lëshuar hije atje në fshat, se dega tjetër, Kallushan Kukaj, arriti ta qëllonte me gur si ndonjë carrok... Jo, jo! Si t'ia thoshte? Metalurgu i ri i gjykonte punët vetëm. Ai kishte filluar të kuptonte që Bregaj, pas minierës, ishte prova më e mirë e vënies në jetë të atyre gjërave që kishte mësuar nga i ati, Hekurani, nga konverti, nga Andrea, nga Diana, nga shkolla. E në këtë luftë të madhe, jo më të vogël se ajo që kishin bërë të tjerët përpara tij, jo më drejtpërdrejt me armiqte, por luftë për të ruajtur të pastër njerëzit tanë, atë, metalurgun Besim Përdrini, e kishte futur me ndërgegje, me besim dhe pikësynime të caktuara vetë Vasil Kushta, ky mjeshtër i vjetër i punës me njeriun, punë që e kishte nisur në vitin 1943 në malet e Labërisë, kur e kishin caktuar zëvendëskomisar kompanie...

— Dëgjo, Besim, — tha Vasili, — pas dhjetë ditësh, e shumta pas dy javësh, në Bregaj do të shkojmë bashkë. Do ta shohësh vetë se si do të shkojnë punët atje. Ndërsa për atë që thua se e ke «tepër të vështirë», ta shikojmë. Po të dëgjojmë ç'thonë shokët atje në Bregaj... — Vasili qeshi, sytë i shkëlqenin. I dha dorën dhe u ndanë.

KAPITULLI I NJËZETË

Besim Përdriini po rrinte vetëm nën hijen e një gorrice në kënd të sheshit. Një tufë fëmijësh të vegjël, moshash të ndryshme, rrinin pak më tutje, e shikonin e diç bisedonin. Flisnin me zë të ulët e si me frikë dhe nuk guxonin të afroheshin.

Ekipet nuk kishin lëvizur nga fshati për dy javë. Vetëm Kallushan Kukaj nuk ishte dukur më. Idriz Meta ishte thirrur në seksion dhe pastaj në kryesi të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit. Probleme të reja kishin dalë. Gati në të gjitha oborret personale mbaheshin bagëti mbi statut. Numri i tyre ishte më i madh sesa ai në tufat e kooperativës, kurse sipërfaqja e dymëve dhe kullotat për to ishin më të vogla se ato të kooperativës. Gjithë ajo sasi dhish e dhensh thithite jo vetëm punën si kohë, por edhe bazën ushqimore të kooperativës. Idrizit ia kishin ngritur këtë gjë si më kryesoren në uljen e vlerës së ditë-punës. Edhe ato marifetet e Idrizit për ngritjen me anën e burimeve të tjera si të shqopës apo punëve të tjera në ndërmarrjet shtetërore, i kishin kritikuar ashpër si shfaqje të interesave të ngushtë të grupit kooperativist. Materiali i kryesisë së komitetit do t'i shkonte sekretariatit. Do të studiohej gjendja në gjithë rrethin dhe pastaj do të përgatitej baza e tufëzimit të oborreve personale. Pritej një aktiv ekonomik. Të gjitha këto po ndodhnin me shpejtësi. Kjo ishte era që kishte hyrë në çdo familje të Bregajt dhe kishte gjallëruar të madh e të vogël.

Nga korija po vinte një trok kuajsh. Besimi ktheu

kokën dhe pa Dianën, zooteknikun flokëverdhtë, dhe në kalin e tretë shkrintar Saliun.

Diana kishte kaluar një ditë më parë për në bjeshkë tok me zooteknikun. E kishin urdhëruar ata të drejtorisë së fermës të shikonte tufat racore të dhive, se javën e fundit dyshohej për një sëmundje. Ata të kryesisë së kooperativës e kishin dëgjuar këtë dhe justifikonin therjet e «sforcuara» të tyre. Tek zbrisnin, vendi ishte pjerrinë dhe ajo lëkundej lehtë mbi kalin e bardhë.

— Po këta krushq nga vijnë? — i pyeti Besimi fëmijët.

— Ajo s'është nuse, — tha njëri prej tyre. — Është doktoreshë Diana. Ai tjetri është Neri, Neri i bacit Selë. Kurse ai i fundit... — Djaloshi ngriti supet.

Diana mbajti kalin nën hije dhe zbriti. Kishte veshur pantallona prej doku bluxhins e bluzë të bardhë të hollë poliestri. Neri, djaloshi flokëverdhtë që s'ishte tjetër veç Skënderi i Selman Sulës, ishte tërë gaz. Ai zbriti i pari dhe shkoi e ndihmoi Saliun.

— Tprrrrry! — i thirri Diana kalit, i fërkoj qafën e djersirë dhe i hoqi mëngojzën. E la të kulloste aty afër.

— Besim, përsëri këtej? — Ajo i dha dorën dhe u ul. — Çfarë vape, ë? Sapo del nga korija, të përvëlton... — Ajo ia ngjiti sytë e qeshur dhe hetues sikur kërkonte me padurim vështrimin a fjalën e tij pas një bisede të lënë përgjysmë.

— Paske kalë të mirë, të bardhë, — i tha Besimi.

— I mirë?! — Ajo vuri buzën më gaz dhe shkoi kalin. — Kalin nuk e përcakton lëkura. As ngjyra... — Nxori shaminë, fshiu ballin, gushën. Erdhi Skënderi u takua me të dhe u ul.

— Shoku Besim, kishe zënë miqësi me babanë, — tha ai tërë gaz duke i shtrënguar dorën me gja-llëri. — Të mban në gojë. Ka ca njerëz që e gjejnë në rrugën e shkurtër për të hyrë në zemër. Baca s'e ka zakon të flasë shumë, po për ty bëhet bilbil.

Besimit i theri fjala e Skënderit. Mos kishte hedhur ndonjë fjalë plaku për ato që kishte parë?

— «Ai djalë ma hëngri bukën», thotë Baca. E bacit tim, po ia hëngre bukën... — Skënderi qeshte.

— Po ti, Sali, ende këtej? — Besimi qëllimisht ndërroi fjalë.

— Këtej. Këta të dy dolën për ajër, unë me ta. Po ç'e do. Këta ende nuk po lëshojnë raporte për «therje të sforcuara». Dianë, — iu kthye ai vajzës, — unë po qëndroj në mbledhjen e asamblesë. Si të bëj me kalin?

— Në mbledhje! — qeshi Skënderi. — Jepja edhe këtë Idrizit.

Diana qeshi e papërmbajtur, pastaj iu kthye Besimit.

— Ma ke parë babanë?

— Nuk ka ardhur më. Po përpara dy javësh me të kam qenë. Me të bëmë një copë rrugë deri në lokalitet. Bile rastësisht u takova edhe në qytet...

— Vërtet?! — Asaj i shkëlqyen sytë plot gaz e shpresë. — Po përse nuk ka ardhur përsëri babai?

— «S'ditka gjë, — mendoi ai. — Epo mirë. Më mirë që s'di gjë.»

— Me sa duket, i mbaroi punët që kishte, — tha Besimi i ngrysur. Ai nuk mundi ta shikonte në sy. Kur ngriti sytë dhe pa, mbi fytyrën e saj ishte terur gazi i parë.

— Këtu është ekipi?

— Fatih Groshi, shefi. Po edhe të tjerët.

— Unë duhet ta takoj Fatihun, — tha ajo. — Duhet ta takoj, pa filluar mbledhja. Gjendja ndër tufat e kooperativës është shqetësuese. Kanë vënë dorë edhe mbi tufën racore të tyre. — Zëri i saj u bë i vrazhdë dhe ankues. Skënderi u ngrit të merrte kuajt.

— Dianë, takohu edhe me shokun Vasil, — i tha Besimi. — Ndoshta të pyet për ndonjë gjë për blegtorinë.

— Për çfarë?

— Për dhinë e racës o për laramanen. Për çfarë tjetër?

— Kështu? Ta 'dija, kisha ardhur në qytet më këmbë. Apo s'më ka marrë malli për të mitë? M'u bënë tetëmbëdhjetë ditë...

— I paske numëruar, — tha ai. Diana e shikoi dhe nuk i tha gjë, po e kuptoi se atij sikur nuk i pëlqente të bisedonte për kohën që ata nuk ishin parë. U ngritën dhe dolën nga hija.

— Bes, — iu drejtua ajo plot merak, — ç'biseduat me babanë?

Besimi uli kokën dhe ajo qëndroi.

— Të lutem, folmë.

— S'kam kohë, — i tha ai. — Për fat, mbas mbledhjes do të nisemi, nëse nuk na del ndonjë punë.

— Bes, — ajo sikur u pendua, hodhi sytë mbi fushën e Pllajës, po ai e kuptonte se ajo nuk shikonte asgjë. — Ti se çfarë ke... Me ty se çfarë ka ndodhur. Nejse. A po vjen nga sektori ynë? Kalo andej nga ne. Prej aty e në Qafë një copë rrugë është, bëhet edhe më këmbë. Do të vish? Të të pres? — Ajo e shikoi e përgjëruar.

— Nuk e di si vjen puna. Sidoqoftë, mos i lësho qentë, se, po erdha, do të vij vonë.

— Bëj si të ta thotë zemra, — tha ajo e zëri iu drodh. — Unë do të pres... Po ti se çfarë ke, Bes. Se çfarë ka ndodhur më ty... Mos kujton se... — po nuk e mbaroi fjalën. Po përmbahej me zor.

— Dëgjomë, Dianë, — i tha ai dhe i preku krahun. — Po nuk më doli ndonjë punë me sekretarin, unë do të vij në sektor nga ora dhjetë e gjysmë.

— Mirë, — tha ajo. — E lëmë se erdhën këta. — Ajo shikoi me bisht të syrit Skënder Sulën dhe Saliun që po sillnin kuajt. Atje nën zyrat, ku ngriheshin plepat, ishin gurbulluar qindra kooperativistë për mbledhjen e asamblesë.

— Unë po shkoj të takoj shokun Fatih, — tha ajo dhe i shtrëngoi dorën. Besimi u fut në zyrën e byrosë.

Tafë Danaj po fliste në emër të byrosë. Problemet dilnin një e nga një dhe aty-këtu nga turma shpërthenin zëra. «Turp! turp!» Idriz Meta që nxinte gjatë gjithë kohës, sa dëgjonte thirrjet, ngrinte kokën dhe sytë e tij me atë tërbim të njohur të Kukajve lëshoheshin mbi turmën si vështrim i një skifteri. Thoshte diçka nëpër gojë, po nuk arrinte të thërriste. Vasil Kushta shikonte njerëzit i qetë e me buzën në gaz. Lëvizte lehtë kokën në shenjë miratimi sikur t'u thoshte: Drejt, vëlla! Edhe unë jam me ty. Ashtu është, turp!

Si u ul Tafë Danaj, fjalën ia dhanë Idriz Metës.

— S'kam ç'a them. I tha Tafa boll mirë. Gjer më dje s'bëzante kush. Ani qetash morne krah prej ekipeve ene oburra, kush të flasë ma shumë. Ani!

— Cili është ai që flet mes atyre pleqve? — e pyeti Besimi Aziz Ramizin.

— Nëna e dreqit? — qeshi Azizi. — Idrizi s'është gjë para tij... Ai është Ramë Meta, kushëri i parë i Idrizit.

— Po ai i riu, ai dërdëngu me kasketë?

— Zoizoja, i biri i Idrizit, përgjegjës i sektorit të blegtorisë në kooperativë.

Tani po fliste një kooperativist. Një tjetër e një tjetër. Besimi ndiqte me vëmendje si e gjykonin ata problemin e oborreve personale, vlerën e ditë-punës, administrimin e pronës, shpërdorimet, punën jashtë kooperativës dhe për tufat racore të dhive, të dheneve, të lopëve. Kur njëri nga kooperativistët tha se kishte faj edhe veterineri i kooperativës që leionte «therje të sforcuara», u ngrit Zoizoja. Ai ishte i shëndoshë dhe i fortë si lis. Hodhi sytë andej-këtej dhe tha:

— Kur sëmuren bagëtia, s'ka ç'u bën jo veterineri, po as perëndia. — Po Diana nuk e la të vazhdontë, sepse thirri nga mesi i grave që rrinin tufë të veçuara:

— S'është e vërtetë! Asnjë lloj sëmundje s'ka atje deri më sot. Isha tok me zooteknikun e fermës atje. Edhe juaji aty ishte. Nuk ka asnjë lloj sëmundjeje. Therjet e kanë shkakun tjetërkund.

Filluan të flisnin shumë veta njëherësh. Hidhnin romuze, qeshnin me Zojzon.. Tafa u tha se problemet ishin rrahur dhe ia dha fjalën Vasil Kushtës. Sekretari foli për të ardhmen e kooperativës, mundësinë për ta kthyer në qendër të specializuar blegtorale, foli për rritjen e ditë-punës dhe punën kolektive për mbarëvajtjen e kooperativës. Ai kërkoi zgjedhjen e kryetarit të ri. Propozuan një mësues vendës, një djalë i gjallë nja tridhjetë vjeç që kishte folur për administrimin e pronës. Sami Bullonës iu komunikua largimi dhe i thanë të paraqitej në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit. Veterinerit iu hoq vërejtja para gjithë masës si bashkëpunëtor në shpërdorimet e bagëtive të imëta.

Gjithçka u rrokullis si një gur nga mali. Idriz Meta as që e kishte marrë me mend se mund të ndodhte kështu. Diana ishte larguar në pushimin e drekës. Pasdreke u zhvillua vetëm një mbledhje e shkurtër dhe njerëzit u larguan grupe-grupe.

Idrizi po shkonte drejt zyrave të bënte dorëzimet. Ai ecte pas Tafë Danajt e Vasil Kushtës që kishin vënë në mes kryetarin e ri.

Besimi shikoi në fushën e gjerë mos dukej kund Diana, por avujt e tokës formonin një mjegull të hirtë, të lehtë dhe ishte e vështirë të shquaie në rrugën drejt sektorit kalimtarët. Hijet e maleve kishin zbritur mbi fushë. Besimi hyri në zyrën e kryesisë. Pastaj doli dhe takoi Vasilin. Donte t'i kërkonte leje të largohet, po Vasili, pa e pasur mendjen tek ai, i tha Tafës se në mbledhjen e partisë që do të zhvillohej atë

mbrëmje, do të merrte pjesë edhe ai me Besimin. Tani s'i mbetej tjetër veç ta njoftonte Dianën me telefon. Doli që andej, u kthye në kryesi dhe kërkoi telefonin. Diana ishte atje. Ai i tha me keqardhje se nuk mund të shkonte dot tek ajo.

— Po nesër? — e pyeti Diana.

— Nuk e di. Po kurdo që të nisem, andej do të kaloj. — Në zyrë hyri Idrizi.

— Shpejt e paske lëshue zyrën azat, — tha ai.

— Dorëzimet do të m'i bëni tani, — i tha kryetari i ri.

— Ja ku i ke! — Idrizi hodhi çelësat mbi tavolinë. — Kasaforta, rafti, tavolina, stoli dhe karriget. Tjetër s'kam. Fushën dhe bjeshkën i ke jashtë.

Mësuesi bëri ca fjalë me të dhe kërkoi që dorëzimet të bëheshin me protokoll. Idrizi nuk pranonte dhe donte të dilte menjëherë.

— Lëre, — i tha Besimi mësuesit. — Lëre, se s'do të vazhdojë gjatë kështu. Ku do ta caktoni me punë?

— Në brigadën e arave. Kështu u vendos. Kali i shalës e di se ç'është ngarkesa vetëm pasi t'i vritet ca kurrizi, — tha ish-mësuesi.

Besimi qeshi. Mendjen e kishte te doriu i bardhë i Dianës. Një shkëndië zilie e digjte brenda, kur mendonte zooteknikun Skënder Sula, të ri, të pashëm, që e shoqëronte atë sa andei-këtej në cdo hap. Po prapë gjykonte drejt dhe e qortonte veten. «Në liqenin që ka ushqim, ka edhe peshq; te njeriu me karakter ka edhe miq.» — mendoi. Shikoi tej dritares horizontin e mbyllur të perëndimit. Diku larg, tej në horizont, flakëronin e shuheshin shkrepëtimat, po gjëmime ende s'kishte. Kryetari i ri i tha se së shpejti do të vinte ndonjë shtrëngatë shiu.

— Mundet pas tri-katër orësh. — tha ai. — Është në kalim. Mëngjesin do ta kemi të freskët. Kështu ndodh në ditë përvëluese si kjo e sotmje.

KAPITULLI I NJËZETENJËTË

Kapanoni gjëmonte e dridhej sikur do të shkulej i tëri e do të binte rrokopujë në përrua. Binte shi me erë të fortë, kërciste mbi eternitet e çatisë, mbi xhamat e dritares dhe të sillte trishtim e vetmi.

Besimi nuk po vinte. E vetmja shoqe e dhomës, mamia Liljana Murga, kishte shkuar në një fshat të Kurorës për një lindje. Si dukej, edhe ajo s'do të vinte. Ose kishte mbetur në fshat, ose kishte zbritur në spital tok me të sëmurën.

Nuk mjaftonin këto, por, sa erdhi në drekë, i tha në se dy viça ishin sëmurë. I pa menjëherë dhe hietoi dispepsi toksike. Njëri prej tyre ngordhi aty nga ora katër pasdreke, kurse tjetri po kurohej. Ajo po mbante nën vëzhgim të rreptë gjithë sallën e boksave. Kishte nisur kurën me penicilinë e streptomycinë. Kishte punuar me ethe mbi antibiogramën e tij dhe materiali patologjik jepte më shumë dispepsinë toksike. I kishte dhënë edhe dozën e dytë me barna, por rezultati ishte i vajtueshëm. Diana hahej me vete dhe i vinte plasje, kur mendonte se e kishin dërguar te dhitë e kooperativës, në një kohë që viçat ishin në rrezik ngordhjeje. Lëre lëre po priste edhe Besimin. Më mirë që s'po vinte. Ajo e përmblodhi veçen dhe bëri ç'ishte e mundur që viçi të mos ngordhte. Shfletoi literaturë dhe krahasoi simptomat, gjendjen e të dhënave nga antibiogramat, shkoi në stallë dhe pa një nga një gjithë të tierët. Së fundi vendosi që në orën dhjetë nëse viçi i sëmurë nuk do të kishte përmirësim,

të ndërronte kurën. Do t'i bënte një dozë neomicinë.

Nuk qëndronte në një vend. Sapo lexonte e rilexonte diçka në dhomë, nisej për në laborator dhe kontrollonte antibiogramat e reja. Duke shkuar në stallë, shtrëngata u derdh mbi të me tërë forcën dhe gabardina nuk po i shërbente më. Sa hyri, e hodhi gabardinën dhe mori një peliçe. Viçi ankohej si njeri. E shikonte me sytë e tij të mëdhenj, të ujshëm dhe lëvizte me mundim qafën e gjatë, të kuqërreme e të lëmuar. Në orën nëntë e gjysmë ajo u kthye në dhomë dhe ndezi sobën. Tani pothuaj i ishin lagur e bërë qull të gjitha teshat. Veshi golfin e leshtë, hodhi peliçen e qullur kraheve, rrëmbeu çantën dhe shkoi përsëri në stallë.

Shtrëngata shfrynte e ulërinte me tmerr. Sheshi nga dhoma te stallat ishte mbushur plot ujë e llucë. Po ajo s'donte t'ia dinte. Çizmet i kishte të mira dhe këmbët ia mbanin ngrohtë. Gjithë puna ishte që t'ia arrinte të mos kishte më ngordhje.

Kur u përkul të injektonte neomicinën për të arritur nivelin hematoterapik, stallieri plak ia kishte ngulur sytë dhe asaj iu duk se ai po e shikonte me dhimbje e mosbesim. Ai thoshte diçka nëpër gojë që ajo s'e kuptonte. Ishte i dëshpëruar për ngordhjen. Dyshonte se mos ngordhja kishte ardhur nga ushqimi. Po përse të ndodhte kjo kur mungonte doktoresha?! Stallieri plak ndihej keq. Ai duhej të kishte ikur, sepse e kishte mbaruar turnin e tij, por kishte qëndruar aty. Si pa vështrimin pyetës të Dianës, ai tha:

— Të këput shpirtin, moj bijë, kjo gjë e gjallë. Të shikon si njeri dhe s'ka gojë të thotë se «këtu më dhemb». Ah!

Diana mbaroi injektimin dhe e porositi të rrinte aty që të ndiqte gjendjen sa të ndërrohej ajo. I tregoi fustanin që avullonte, ngjitur për trup.

— Do të plevitosesh, moj bijë, — tha ai.

— Shi vere është, bacë, me gjithë këtë duhet të ndërrohëm.

— Shi dreqi, jo shi vere. Shiu i verës e vaji i nuseve ikin shpejt, kurse ky...

Viçi bëri një përpjekje që të ngrihej, por nuk mundi. Në stallë hynë dy gra të maternitetit të sektorit, roja e natës dhe brigadierja. Përshëndetën dhe qëndruan pranë gardhit të boksit. Njëra nga stallieret, një grua e bëshme, hyri brenda dhe u përpoq ta ngrinte viçin në këmbë, po ai nuk qëndroi dot.

— Qenka keq, — tha ajo. — Po ti, Danë, ç'bën këtu? Shko në dhomë e ndërrohu. Këtu e gdhij unë.

— A, po unë të ruaj plakën? — tha baca me nervozizëm.

— E ç'do të bëni të gjithë? — u tha Diana. Ajo shikoi brigadierin. Me të i kishte ndërruar pak fjalë pasdite dhe ai kishte thënë se ngordhjet do të vazhdonin si me veterinerin, si pa të. Tani ajo e shikoi dhe sytë i flakëruan sikur t'i thoshte: E, mos do ta therësh? Nuk të mjaftoi i pari?

Doli dhe shkoi në dhomë. U ndërrua, u mbështoll me batanije dhe i shpëtoi rrebeshit.

— Danë, bijë, ma mirë! Ma mirë u ba! — thirri stallieri plak. — Duket që nga sytë. Veç këta të tjerët shikoj pak, se...

Edhe të tjerët kishin vërejtur dobësi e mungesë oreksi te boksat. Stallierja e bëshme u fut në tharkë, ngacmoi viçin e sëmurë dhe ai u ngrit. U shkund. Sytë e tij të ujshëm shikuan qetësisht stallieren, pastaj ai zgjati qafën drejt ushqimit. «Shpëtoi! — tha me vete Diana. — E bëri të vetën neumicina.» Porositi stallierin plak dhe ai solli një kovë me ujë. Kafsha piu pak sikur të kuptonte shqetësimin e njerëzve. I sollën ushqim të gjelbër dhe ajo nisi të përtypej qetësisht. Ajo porositi stallierët të kontrollonin mos gjenin mes ushqimit të bagëtisë barishte që sillnin diarenë.

«Neumicinë, vetëm neumicinë më duhet, — tha me vete. — Po sa doza kam në farmaci? A më mjaftojnë ato të mjekoj gjithë këta? Ku e gjeti dhe ky Skënderi të shkante sonte në shtëpi?»

U kthye në dhomë. Soba ishte gati në të shuar. Govata ishte mbushur me tesha të lagura. Ajo i mori e i shtrydhi një rën pas tjetrës. Të parin shtrydhi fustanin ngjyrë kremi që i pëlqente shumë Besimit. Vendosi ta lante që ta kishte gati për të nesërmen. Pastaj veshi fustanin prej fanellate dhe u shtri. Atëherë e ndjeu me të vërtetë lodhjen. Nuk e zinte gjumi. Ndjeu të nxehtë sikur i avullonte gjithë trupi. U zbulua pak, shikoi llërët dhe mendoi Besimin. «A thua do të vijë? — mendoi. — Nesër do të vijë me siguri. — E pushtoi një ndjenjë e ngrohtë e ëmbël. Dëshira dhe shpresa u shkrinë mbi qerpikun e gjatë, rënduan aty dhe ia ulën qetësisht. Ajo fjeti me mendimin se ai do të vinte...

KAPITULLI I NJEZETEDYTË

Për Kallushan Kukajn e marta e kthimit nga Bre-gaj ishte një ditë fatzezë. Donte t'i shpëtonte hijes së asaj nate, të dilte në dritë, por nuk arrinte. I dukej sikur guri që hodhi drejt kokës së Besim Përdrinit, nuk i kaloi tangent, por e zuri, e trullosoi, e përgjaku. Koka e përgjakur e Besimit, pistoleta në duart e djalit, fjala e tij, të gjitha këto i peshonin rëndë në shpirt.

Një mendje i thoshte se Besimi nuk do t'i tregonte ato që ndodhën. Kishte ca arsye që plaku Kallushan i kishte situr me sitë majaje. Se djali dukej njeri i besës dhe nga ata njerëz që e mbajnë fjalën o nga fanatizmi, o nga frika, o nga egoizmi. Qysh mund të tregonte ai se ishte zënë me një plak si Kallushani dhe gati kishte ngrënë një gur në kokë? Besimi ishte djalë me sedër. Nuk do ta bënte këtë, mendonte Kallushani dhe ndihej i lehtësuar. Por pastaj niste të shkoqiste marrëdhënet e Besimit me Dianën. Këtu Kallushani ngatërrohej keqas. Në fillim djali e pranoi se e donte Dianën. Kurse, pasi doli Idrizi në shesh, puna u prish.

Në këtë gjendje ishte Kallushani deri atë ditë që e thirrën në mbledhjen e frontit për të dhënë llogari në emër të komisionit të strehimit. U turbullua aq shumë në këtë mbledhje, sa e harroi ngjarjen e së martës.

Doli tym nga mbledhja. Qëndroi një çast në she-shin e mitingjeve. Vrau mendjen nga të nisej për në shtëpi. Në atë çast s'donte të kishte njeri pranë. Do

të nisej vetëm në rrugën këmbësore nga bregu i lumit, më mirë vetëm.

Pas pak ai po zbriste në bokërrimat në anën përrëndimore të zabelit, për të zbritur në bregun e lumit. Ecte me kujdes se mund të rrëshqiste dhe të rrëzohej. I tronditur sa më s'behej. «Pema ka lëkurën, njeriu fytyrën.» — tha me vete për të dhjetën herë. Që pa hyrë në mbledhje ai kishte vendosur të vetëmbrohej dhe të mos kundërshtonte. Atje u përpoq të qëndronte i qetë, të dëgjonte ato që thuheshin. Fjalët e pjesëtarëve të mbledhjes së frontit ishin të hidhura. E goditnin pa mëshirë si gurë nga të gjitha anët. Dhe ai duroi si s'kishte duruar kurrë në jetën e tij. Ishte këputur diçka në jetën e tij. Ora s'po tingëllonte si më parë. Po mbushte gjashtëdhjetë vjeç.

Karta për strehimin e fisit në një pallat ishte djegur.

Ai doli në rrfashinë dhe po ecte rrugë pa rrugë mes gjurmëve të buldozerit drejt përdheseve të Kukajve.

«Hë, — tha me vete. — Ç'kam qenë unë në këtë rrafshinë? Një nëpunës i vogël që kam shtirë e përzier me sa më ka ngrënë krahu. Kam punuar veç për fisin tim. Kaq! Kështu? Si kalë jam rrekur. E tani, pak pa dalë në breg, pak pa dalë në pension, u lodha. S'po më ecën më.»

Ai arriti në shtëpi dhe hyri në dhomën e plakut Brah. Vuri re se kishin ardhur edhe disa nga ata që kishin qenë në mbledhje tok me të. Kishin ardhur përpara tij. «E paskan përfolë atë që ndodhi,» — tha me vete. Kallushani i përshëndeti ftohtë dhe zuri qoshen përballë plakut.

— Ça u ba? — e pyeti Braha, pa pritur më shumë. — Pleqtë dhe foshnjat nuk presin shumë. — Kallushani i vështroi me bisht të syrit Ibishin e Kurtishin dhe ca nga djemtë e nipat që ishin në mbledhje. Të gjithë ulën sytë njëri pas tjetrit.

— Asgjë, babë. Projekti im nuk piu ujë. — Shikoi përsëri të tjerët dhe vazhdoi i vvarë në fytyrë: —

Shtamba eci e eci dhe u thye. S'mbajti më. Tani o Mete për vete...

— E këshilli popullor për të gjithë, — qeshi Ibishi.

— Oh! Oh! Oh! — bëri plaku Brah dhe ktheu kokën mënjanë. Tok me Ibishin kishin qeshur edhe një pjesë e mirë e atyre atje rrotull tij. Ibishi, që e kuptoi rënkimin e plakut, u ngrit dhe i shtoi edhe një jastëk. Braha e vështroi me frikë dhe tha me zë të mekur:

— Jam keq...

Kurtishi i shkathët u zgjat, i zuri krahun kockë e lëkurë dhe i pa pulsën. Kallushani e dinte se askush s'i merrte vesh rrahjet e pulsit.

— Shpejt doktorin! — thirri Kurtishi. — Luani vendit, he... — iu hakërrye ai djemve.

Kallushani e njihte mirë të vëllanë. Ja, Kurti i shfrytëzonte mirë këto raste, sidomos vdekjet. Kur njerëzit shtangeshin nga ngjarja e plotpushtetshme, Kurtishi jepte tri të katërtat e urdhrave me hakërrim, sharje dhe kërcënime.

— Kallush, shpejt! Doktorin shpejt! — thirri përsëri Kurtishi.

Kallushani u ngrit qetësisht, u afrua te plaku, i vuri dorën te zemra. Ajo punonte sahat. I preku ballin, damarët e qafës.

«Ky do e bën,» — tha me vete. U tërhoq në qoshen e vet.

— Send apo gja, diç duhet... — tha Memishi.

— Çfarë të bëjmë? — tha Ibishi. Ai vërtet ishte i shqetësuar, i tronditur. Kallushani e shikoi me keqardhje. Natyra e padjallëzuar dhe e dhembshur e Ibishit zbulohesh shpejt si te një fëmijë. «Çfarë të bëjmë?» Kallushani e shikoi me keqardhje dhe me qesëndi të vëllanë.

— Njerëzit! Thirrni njerëzit! Baba po na mbaron, hej takaqyla! Luani b... hej... — Zëri i Kurtishit ushtonte në dhomë. Disa nga djemtë dhe nipat dolën me rrëmujë.

— Paç uratën, mor bir! Mor Kurti im... paç ur... — Zëri i mehur e Brahës u tha naivëve: «Erdhi fundi!, të tjerëve, atyre që s'e marrin lehtë sapunin për dja-

thtë: «Mblidheni fisin! Nxirreni llafin për mue, të shohim kush na do e kush nuk na do...»

Kallushani po e ndiqte i qetë çdo lëvizje, çdo fjalë. Tani e kishte të qartë sa e hollë ishte loja e plakut. Duhej të vinin për ta parë shokët e aparateve, pastaj... «Këtu e ke hallin ti, baba? — tha me vete Kallushani. — Edhe ti, Kurt, që po i bie lodrës? Do të shikosh se sa e kush do të vijë nga ata... Dhe pastaj mes atyre bisedave dashmirëse ju të bëni atë që s'e bëra dot unë, të merrni pallatin nr. 83. Kështu? Si zor ta bëjë dinakëria atë që s'e bëra dot unë.»

Në oborr ndihej një rrëmuje plakash, nusesh, çupëlinash. Hapat e tyre, pëshpërimat, thirrjet e habitës. «Vdiq? Vërtet? Qyqja unë, po si do të bëjmë pa të?! Ai ishte nuri i fisit. T'u thaftë goja, moj! Pse, s'ka vdekur? Po atëherë ç'më lihi këtu, përse ma prishët gjumin? Ah, çfarë ëndrre që po shihja, moj xhane! Ma trego, më qafsh! Ik tani, se u bëra nervoze. Hë, pra! S'tregohet. Është me kalë të bardhë... Do të dalë keq. Vdekja vonohet, kur varri përgatitet herët. Yyy, marrroqe, ç'llap kështu! Sikur gjyshi të jetë mbret...»

Kallushani i dëgjonte këto të gjitha që hynin në odë nga dritaret e ulëta, po nuk fliste. Kishte ulur sytë dhe po dridhte duhan. Gratë flisnin jashtë në errësirë, pa guxuar të hynin brenda.

Vetëm njëra, Martina e Ibishit, hynte në odë... Martina e kolme dhe e mbajtur mirë, bijë e një nëpunësi, ishte e përkëdhelur, e mbajtur në pëllëmbë të dorës në fis. Ishte grua me autoritet që e kishte bërë Ibishin t'i bindej për çdo gjë. Kallushani mendonte se Marta ia kishte nxirë jetën Ibishit të shkretë, derisa ai i kishte dhënë karar të bënte veç çfarë të donte e shoqja. Ky Ibishi ishte njeri i butë e i dashur. Që natën e parë Martina e përkëdhelur ia kishte peshuar zemrën Ibishit në pesë minuta dhe e kishte detyruar të fliste me zë të ulët, me lutje e t'i buzëqeshte. Ndoshta Ibishi do t'ia kishte numëruar ditët Martinës në përdheckën e tij, por ajo mbeti shtatzënë menjëherë. E pas-

taj ajo i lindi fëmijët njërin pas tjetrit. Ç'të bënte Ibishi? I mbeti të fliste me zë të ulët, lutës e të buzëqeshte nga e keqja.

Martina hynte në odën e miqve, takohej me të ardhurin, merrte edhe gotën e rakisë, uronte, pinte, pa u turbulluar fare, edhe rakinë e Skraparit. Në odën e babës Brah, veç asaj dhe nënës Rashë, nuk i lejohej kujt tjetër të hynte nga gratë.

Kallushani kishte hetuar ndjenjën e zilisë te gratë e tjera. Marta hahej edhe me Kurtishin. I hidhnin romuze njëri-tjetrit. Si me shaka Kurti nuk ia kursente ato shprehjet e tij të rënda, po Marta ia kthente borxhin dyfish në sy të të shoqit. Kjo garë që niste me kërcitje dhëmbësh dhe mbaronte me të qeshura, sikur e zbrunte zemrën e Kurtit të rreptë. Buzagazi dhe sytë flakërshë të Martinës thyenin edhe gurët e oborrit e jo më kokëfortësinë e një burri si Kurti.

— Vëlla Kurt, qysh është? — hyri në valle Martina për babën Brah.

— Si mos o zot, Marte, — i hodhi kripë Kurti.

Martina u afrua si një mace pranë plakut, e kuptoi se nuk kishte gjë me rëndësi dhe tha:

— T'ia përvëloj një kafe të fortë? Ia forcon zemrën. Ë, vëlla Kurt? — Sytë e Martinës mbetën mbi Kurtishin sikur në odë të ishin veç ai dhe ajo.

— Kurrë s'të ka punuar mendja për keq, Marte. Shyqyr që e kemi një grua me mend në fis, se ato dosat tona s'janë veç... — Kurtishi po ia mbante llërrën plakut mes duarve të tij. Ai deshi të bënte një gjest të ndyrë kundër grave të tjera, por ja, dora e babës Brah... po e pengonte. Ibishi shikoi si me gaz të shoqen. Martina ishte guximtare Martina ishte burrëreshë. Martina e pa të shoqin, vështrimin e tij, rru-dhi buzët e kënaqur sikur t'i thoshte: Mos u grind me gruan në darkë, se do të flesh vetëm.

Kallushani ishte djersitur. U mbështet te pragu i dritares së ulët dhe tërhoqi pak kapakun e saj. Martina u dha grave berihanë në oborr. Dy komshinj

erdhën për kafet e para. Rrëmuja në oborr vazhdoi edhe ca, derisa gratë panë se si e pinte kafënë ndenjor Brah Kukaj. Tani filozofonin për jetën e vdekjen. Jeta këputet menjëherë dhe vjen vdekja. I vdekuri me të vdekur.

— Sikur thae dikush se kanë ardhë viturat, — tha plaku Brah, po të gjithë heshtën. Dielli i mesditës nuk mbulohej me shoshë. «E, mor Kurt? As me «vitura», as me këmbë», — tha me vete Kallushani, pa e fshehur gëzimin që e kishte kuptuar me kohë lojën e plakut dhe të Kurtit. — Dështuat, Kurt. Nuk merret pallati nr. 83 kështu...»

Në zyrë hyri shefi i administratës dhe i tha të ngjitej në katin e dytë te përgjegjësi i seksionit të organizimit. Ai luftoi ca me veten. Të shkonte? Apo të mos e përfillte fare atë shefin? Dikur kishte pasur një ngatërrësë me të dhe ia kishin ruajtur njëri-tjetrit. Po tani, tani që ai po e thërriste? Mos e acaronte punën më shumë, po të mos shkonte. Një vit, kur ishte shtruar problemi i shkuarjes së kuadrove në fshat, shefi ishte ngritur dhe kishte thënë se kishte njerëz që e kishin nisur dhe po e mbaronin jetën në karrige. Njëri prej tyre, sipas tij, qe Kallushani. Ai i kishte thënë hazërxevap: «Shko ti, se je më i ri!» Atëherë Kallushani ishte pesëdhjetë e një vjeç. Ai personi u bë shef i seksionit të organizimit, kurse Kallushanin nuk e lëvizi kush nga kadastra. Në mes tyre, njëri në katin e parë dhe tjetri në të dytin, ishin vendosur marrëdhënie të ftohta.

Kallushani hyri pa trokitur. Përgjegjësi nuk ia hodi sytë. Ai vazhdoi t'i diktonte daktilografes, pa e ftuar Kallushanin të ulej. Pas pak ai u ul në karrigen e vet dhe tha duke shikuar te këmbët e Kallushanit:

— Shoku Kallushan, ju thirrëm t'ju themi se ka qenë gabimi ynë që ju kemi lënë të livadhisni ca me

punët e këshillit popullor... si me projektet e strehimit e me ndonjë tjetër...

«E gjete rastin të më qëllosh,» — mendoi Kallushani. Aty për aty vendosi të tallej ca me të.

— Po bëni autokritikë? Dobarem ta bënit në mbledhjen e frontit, kishte ca lezet.

Përgjegjësi u nxi nga inati.

— Po, shoku Kallushan, edhe autokritikë mund të bëjmë. Se ju e kuptoni vetë... Keni punuar për faqe të zezë!

— Mati fjalët, — u hodh Kallushani dhe u përkul ca përpara. Rebelimi i shpirtit Kukaj rrodhi ndër damarët e plakut dhe ai iu zbraz djalit: — Po i lëshon fjalët si lopa bajgën...

— Je burrë i vjetër. S'kam ç'të bëj, — tha përgjegjësi.

— Lëri pallavrat. Ti po lan hesapet e vjetra me mua.

— Çfarë?! — Përgjegjësi, i zbehtë, u ngrit më këmbë. — Po të them në emër të kryesisë dhe të këshillit popullor që ju, shoku Kallushan, në punën tuaj keni shikuar tarafet, farefisën dhe na keni çoroditur punën.

— Mos më fol me këtë ton. Kështu s'më ka folur as... as... — Po përgjegjësi e shikoi në fytyrë triumfues dhe i qëndroi në këmbë ballas. — Me strehimin nuk do të keni më punë. Tani mund të shkoni.

Përgjegjësi shikoi derën. Kallushanit i lëshonin sytë xixa, po s'po gjente dot një fjalë t'i shfrynte. U shtrembërua në fytyrë dhe u kthye me rrëmbim. Në të dalë përplasi derën. «Ah, more pis pisi! — tha me vete. — Gjete rastin dhe më godite me duart e të tjerëve. Ani, unë s'vdes shpejt...» Një mendim i shkrepri në kokë që ta padiste te kryetari për fyerje. Po sikur kryetari t'ia niste nga e para? Jo strehimi, jo tarafet, jo oborret personale në kooperativën e Bregajt. Jo, jo! Nuk do të shkonte te kryetari. Zbriti shkallët i rënduar dhe ndjeu nevojën e një kafeje. Bufetie-

rja e pyeti si e donte. Ajo s'kishte ca që kishte ardhur aty.

— Të zezë, — i tha Kallushani. Disa djem të urbanistikës që rrinin një tavolinë më tutje, e lanë bisedën. Njëri prej tyre seç foli me zë të ulët dhe Kallushanit i zuri veshi fjalët «stuhi në sirtar». Stuhi tek... Kallushani ia këputi një të sharë, rrufiti kafen dhe doli.

Në çdo hap që hidhte, tani i dukej se kjo ishte dita e gjyqit.

Në orën një e gjysmë ra telefoni. E kërkonte Zana në këshillin e qytetit. «Po kjo? — tha me vete. — Edhe kjo për punë të strehimit? Apo mos ka ndonjë vërejtje tjetër.»

Zana ishte vajza e një shoku të tij që kishte vdekur ca vjet më parë. Një muaj para Çlirimit të vendit Kallushani kishte marrë pjesë në luftimet me çetën e krahinës. Ato ditë kishte ardhur në çetë edhe grupaja e shokut me Zanën foshnjë. Armiku kishte nisur një sulm të përgjithshëm për të liruar rrugën e tërheqjes së tij drejt veriut. Fshati ishte djegur dhe nëna me foshnjën u detyruan të bashkoheshin me çetën. Çeta atë natë po tërhiqej nga bregu i lumit drejt bjeshkës. Foshnja ishte dhjetëmuajshe. Qante. I ati i Zanës i tha së shoqes ta pushonte. Nëse s'e pushonte dot, sa të merrnin më qafë njerëzit, më mirë... Kallushani pa se ai po shikonte lumin. E shoqja po zgurdullonte sytë dhe thoshte se nuk kishte gjë. Foshnjën e kishin marrë dorë më dorë partizanët. Një nga të parët që e kishte rrëmbyer foshnjën nga krahët e së ëmës, ishte Kallushani. Ai e kishte mbajtur në rrugën pyjore mes panjave tek po ngjiteshin së përpjetës për në ije të malit. Dikur vajza ishte lodhur së qari dhe Kallushani kishte pasur përshtypjen se i kishte vdekur në duar, po ajo ishte mekur. Çeta kishte qëndruar. Ç'të bënin?

Ç'ti jepnin. Vendosën t'i linin nënë e bijë te kulla e parë që do të ndeshnin rrugës. Ashtu bënë dhe vajza shpëtoi.

E donte Zanën Kallushani, por edhe ia kujtonte ndonjëherë atë natë të zezë, sikur t'i kërkonte shpërblimin. «Nuk të them që të më bësh këtë e atë, por mos harro se unë të mbajta në krahë, se qeshë unë, pa...» Po përse po e thërriste Zana tani? Mos edhe ajo do t'i komunikonte ndonjë gjë të keqe? Zana e priti njerëzishëm. E pyeti për shëndetin, për fëmijët. I kujtoi se ai ishte arsimdashës, se nga fëmijët vetëm Vjeda kishte mbetur me tetëvjeçare. Kallushanit iu bë qejfi, po priste me padurim ku do të dilte vajza pas këtyre fjalëve.

— Më fal, bacë, që po të pyes, po unë të kam si babanë tim. Kam dëgjuar sikur e ke fejuar Vjedën? A është e vërtetë, se ti s'më ke thënë gjë?

— Ç'është ajo? — kërceu Kallushani. — Jo, moj bijë. U fol një fjalë, po s'u bë gjë...

— Bacë, të më falësh, se në këto punë s'ka të drejtë të të përzihet kush, por... — ajo ngurroi një çast, pastaj ai nguli sytë seriozë e hetues, — kam dëgjuar se të ka ardhur për Vjedën dy herë nëna e një piktori të ri nga Tirana. Për djalë të mirë e serioz, e njoh edhe unë atë djalin. Nuk e di si e sa njihet Vjeda me Batushin. Batush Selita e quajnë. Po, përderisa ngrihet plaka e vjen dy herë nga Tirana këtu...

Kallushani ishte zbehur pak. «Ja, — tha me vete, — edhe shpulla e re. — Për këtë të paskan gjetur ty, moj Zanë...»

— Oj bijë, po më rëndon si shumë, bre... Vjedën e kam fëmijë, s'e kam gjetur në arën me misër. Ajo plaka vërtet ka ardhur, po unë s'e kam takuar. Së pari unë isha me shërbim, së dyti ajo ka takuar Kurtin, jo mua. E Kurti si Kurti...

Zana nuk ia tha të gjitha. Si t'i thoshte që Vjeda me Batushin kishin ardhur në zyrë dhe kishin kërkuar të bënin celebrimin? Zana ishte e mençur. E

përse të merrte rrugë të tillë puna, kur kishte mundësi të bëhej me mirëkuptim?

— Bacë, të vijë nëna, do ta presësh? Të rinjtë duhen...

— Po ti nga i njeh ata?

— Rastësisht... Janë njerëz të mirë, për këtë të siguroj.

— S'më interesojnë, — u bë tym Kallushani. — Fajin ma ka vajza. — Zana e pa se plaku ishte prekur në sedër dhe ishte i tronditur. U ngrit dhe i foli e qetë:

— Po unë s'të thirra për këtë. Për këtë mund të vija në shtëpi. Unë të thirra të të jap këtë... — Ajo i drejtoi autorizimin për strehim. Kallushani e lexoi i habitur. Pallati nr. 83, kati i dytë, tri dhoma e një kuzhinë. Tamam ajo që ai e kishte paracaktuar për vetë.

— Oj, drej! — tha. — Zanë, bre bijë! — Mbi fytyrë iu ndeh kënaqësia. — Po të tjerëve? — ai e kishte fjalën për të vëllezërit, për disa nga nipat, me një fjalë për fisin. Zana i tha se atyre u kishin dhënë strehim sipas kurorë-frymëve dhe i kishin shpërndarë ndër godina e shkallë të ndryshme.

— Po, bre bijë, unë e kuptoj, por një fjalë e urtë thotë: Mos zgjidh shtëpinë, por komshinë.

Zana ndoqi me vëmendje lëvizjen e dorës së majtë. Ajo e mbështolli mirë autorizimin, e palosi, e futi në xhepin e majtë të xhamadanit.

«Eh,» — psherëtiu i lehtësuar duke shikuar pallatin nr. 83 që shkëlqente i bardhë, në pritje të banorëve.

KAPITULLI I NJËZETETRETE

Drita i kishte thënë Jetonit që të zbriste poshtë pasdreke se do të shembte shtëpinë e Kukajve, po ai u vonua. Kur erdhi ai, përdheset ishin përtokë. Punëtorët po grumbullonin gurë e tulla. «Mirë që erdhi vonë, po ç'iu desh atij të vinte tok me Saliun?!» Ajo e shikoi me inat. «Janë bërë si binjakë,» — tha me vete. Po atyre nuk u tha asnjë fjalë. U takuan në rrafshinë pranë zyrës. Ajo sapo kishte mbyllur dokumentet dhe ora po binte nëntëmbëdhjetë.

— Sa vonë që erdhët! — u tha si me gaz. — Kukajt i shembëm pasdreke, kurse ju... Mirë se erdhe, Sali!

— Ajo i zgjati dorën atij. Saliut iu duk se ajo e tha këtë me zor. Iu duk vetja i tepërt aty.

— Unë ika, — tha ai. — Kam pak punë. Shihemi pastaj nga stacioni i urbanit.

Ata të dy nuk folën. E ndoqën me sy derisa ai u largua.

— Ç'bëre? — e pyeti Jetoni.

— Hiç. Mirë bëri që u largua. Na është qepur sikur ta kesh dado...

— Mojt po lëre Saliun ti, ç'bëre me të tutë, u the gjë?

— Ia thashë nënës mbrëmë. Ajo e bisedoi me babën Hekur. Edhe babai nuk ka kundërshtim, po i kishte thënë nënës të pyeste Besin.

— Po nëna ç'të tha?

— Nëna? «Mirë, mojt bijë, ta bisedoj një herë me Hekuranin.» Dhe Besi erdhi poshtë. Sigurisht që

nëna kishte folur me të, se më tha: «Tani ti u rrite dhe e di vetë ç'bën.» Po ti, Jeton, mos u shqetëso për Besin. Besin e kam këtu... — Ajo i tregoi xhepin e vogël të grykësës.

Ajo fliste shpejt dhe i përsëriste gjërat. Jetoni e dëgjonte i paduruar. Në fund i tha se do të shkonte ta kërkonte në shtëpi. Si u endën nëpër rrafshinë, u kujtua se te stacioni i urbanit duhej të priste Saliu. Saliu vërtet qëndronte atje dhe sodiste fushën me mi-srin e zverdhur.

— Më shkoi huq, — tha Saliu. — Rojën e Kryengritësit nuk e takova. Më parë ai rrinte klubeve, kurse tani...

Saliu do të shkruante për Kryengritësin. Pastaj ai e la Kryengritësin dhe rojën dhe e pyeti Jetonin diçka mbi njëren nga figurat në skulpturë. Jetonit i ishte bërë mendja grup skulpturor. Sa ta ngacmoje një çikë, ia niste me figurat dhe harrohej. Ajo e ndjeu veten të tepërt, të largët, të humbur, po nuk i ndërpreu. Dëgjonte në heshtje, kokulur, si e hutuar. Nuk i merrte vesh bisedat e tyre. Të ishte puna për ndërtime pallatesh, për urbanistikë qytetesh, e dinte ajo si flitej. Por për kompozicion në letërsi e pikturë, për figurë, tip, karakter, plan, linjë, ngarkesë emocionale, oh, jo! Këto e ngatërronin keqas dhe e ndiente veten të paditur pranë tyre.

Erdhi një çast dhe ajo e ndjeu veten krejt të mënjanuar. U dha dorën pa qejf dhe u largua. Jetoni e ndoqi pas dhe e pyeti i shqetësuar:

— Dritë, ç'pate?

— Lërmë! — tha ajo dhe me zor i përmbajti lotët. Shpejtoi hapat duke i lënë të hutuar ata të dy.

Drita i gjeti të gjithë në shtëpi. Sa e panë, ata e lanë bisedën. Baçi me Besin e shikuan me dhimbje e dashuri.

Në mëngjes ajo dëgjoi kokulur kur nëna Vashë e porositi që të vinin e ta kërkonin njerëzit e Jetonit. Ajo vrapoi të takonte Jetonin. Ai e priste në stacion.

Sytë i kishte të thelluar nga pagjumësia. Asaj i erdhi keq.

— Ç'pate mbrëmë? — e pyeti ai. — Më ke lënë pa gjumë tërë natën.

— Hiç, — i tha ajo duke e parë drejt në sy me ngazëllim. — Thuaji babës Met të vijë e të më kërkojë. Ja, këtë kam. Tani më fal, se po më ikën urban! — Ajo u largua me vrap duke lënë pas buzëqeshjen e saj të hirshme.

Ishte një mbrëmje shumë e bukur. Me një qiell të mbushur plot me yje që ndritnin ëmbël. Ajri i freskët mbrëmjesor të mbushte gjoksin. Ca zhurma të çuditshme, të gëzuara, tamam si një muzikë, mbushnin rrugët. Ca fëmijë të vegjël të gëzuar, të bukur si pëllumba, ecnin në trotuar. Ah, sa donte ta puthte Drita atë çunin e vogël topolak që mezi hidhte hapat pranë së ëmës!

Kështu i duken njeriut gjërat, kur zemrën ia pushton gëzimi. Ajo shpejtoi dhe pas pak trokiti te dritarja e studios. «Binjakët» ishin aty. Po silleshin rreth figurave prej balte që tani ishin bërë të mëdha. Ajo hyri brenda me vrull. Iu drejtua Jetonit me ton qortues:

— Bravo të qoftë, o njeri me kulturë! Dërgove plakun dhe një shkues që të më kërkosh për grua!! Kështu? — Jetoni u zverdh, por e përmbajti veten.

— Ai ishte daja, — tha.

— Lëri këto! Unë refuzova një shkuesi të tillë. Nuk jam berr që të dal në pazar.

Jetoni ende nuk po i binte në të shakasë. Tha me zë lutës:

— I nisa vetë, sa të hapnin fjalën, jo si shkues...

— Posi! I kishte blerë edhe këpucë atij tjetrit, pale!

— Ç'më polli! E shikon, mor Salë? Po ai ishte daja, — tha Jetoni. Hodhi me nervozizëm daltën e drunjtë

pranë figurave. Mori një leckë të lagur dhe fshiu duart. Vajza i bëri shenjë tinëzisht Saliut, ky e kuptoi se e gjitha ishte një shaka.

— Besoj se u morëm vesh. — tha Drita. — Thuaji bacës Met të mos lodhet pas një djali që kërkon nuse me kanun. Ja, kaq pata. Ti, Sali, eja me mua se dëshiroj të shëtis. Eja, pra! — Ajo e tërhoqi Saliun disa hapa drejt derës, por Jetoni, me hap të gjatë e nervoz, u zuri derën me trup.

— Pa qëndro një minutë, se i kam edhe unë dy fjalë, pastaj shko në djall...

— Ti, Jeton, ke bërë gabim, — i tha Saliu duke shikuar Dritën. — Të paktën të më kishe dërguar mua. Nuk të kërkoja as këpucë...

Jetoni i zbehtë shikonte sa njërin, tjetrin.

— Ju, më duket, po luani komedi me mua?!

— E përse të mos bëjmë komedi? Atje në shtëpi-në tonë seç ngatërruan me shishen e rakisë. Më duket u pëlqyen bërçollat e mia, se babai në fund më tha: «Qofsh e lumtur, bijë!»

Jetoni u largua prej tyre pa folur asnjë fjalë. Shkoi dhe u rras në divan. Mori cigare, e ndezi dhe e thithi sa lëshoi një tymnajë të kaltër.

— Salë, e shikon ç'më punon kjo? Do të gjej be-lanë me të...

— Do të jeni të lumtur, — qeshi Saliu.

— Tani s'kemi kohë për parashikime, — tha Drita. — Pa hiqe përparësen dhe lëri vetëm këta heronj-të prej balte. Vemi të hamë ndonjë xupë ndokund.

Ata dolën plot hare. Drejt tyre, në trotuar, po vi-nin ngadalë Batushi me Vjedën. Dritës i bëri përshty-pje mënyra se si Vjeda ia shtrëngonte krahun të sho-qit. Pastaj ajo lyerje buzësh, fustani i ri. Kurse ga-bardina i kujtoi se po vinte vjeshta.

— Po këta kur u martuan? — tha Saliu.

— Pak para shpërnguljes së Kukajve, — tha Je-toni. — Plaka e Batushit kishte shkuar edhe herë të

tjera në atë shtëpi, po ata nuk kishin pranuar. Këtë radhë u prit nga Kallushani, po u prit aq ftohtë, sa ajo doli nga Kukajt e acaruar. Aty te sheshi e priste i biri me Vjedën. Kur Batushi pa lotët në sytë e nënës, i tha Vjedës, o të shkonte me të, o të rrinte me shëndet. Dhe Vjeda shkoi me të që atë çast. Tani banojnë diku në lagjen nr. 7.

Po Drita nuk e dëgjonte Jetonin. Ajo shikonte me vëmendje atë shtrëngim të krahut. «Mbaje fort, moj e zezë, — tha me vete, — mbaje, se kushedi ç'të bëjnë Kukajt e tu.»

— Tani kjo i ngjan shumë Perlës, — tha Saliu. Jetoni pohoi me kokë. Ishte tërë gaz.

— Kush është Perla? — pyeti Drita.

— Një figurë prej balte nga ato të Jetonit.

Dritës iu kujtua figurina e vogël që i ngjante asaj.

— Po Vjeda i ngjan Danës... — tha Drita me druajtje.

— Kujt? — Jetoni e pa si i habitur.

— Dianës, pra! Ç'më shikon kështu, a s'i ngjan Danës? — Ata të dy qeshën.

— Domethënë ti po bën Dianën në ato marifetet e tua dhe e quan Perlë...

Jetoni e shikoi në ninëz të syrit. Ai donte t'i thoshte se figura ishte larg Dianës, por s'kishte si ia shpjegonte. Ishte shumë i gëzuar. I ndiente pranë dhe Besimin edhe Dianën. A mos na duhet më shumë se pranja e njerëzve të dashur që të kemi një çast lumturi?

Fejesa e Dritës u shpall të dielën e parë pas këtyre ngjarjeve. Pa bujë, pa zhurmë. Në orën dhjetë paradite te Përdrinët erdhën Met Druvari, e shoqja, Zonja, Jetoni, një punëtor i ndërtimit dhe Sali Kallini. Drita shpërndau korjakët, llokumet. Bardha e ndihmonte. Gjatë gjithë kohës të ftuarit folën për fabrikën

që po ngrihej, sikur nuk kishin ardhur për Dritën. U bënë shakara. Bashkimi se nga i gjente ca histori me varre perandorësh. Një presidenti a perandori modern ia kishin pregatitur një varr mu në mes të kryeqytetit.

— Epo, sikur ta shpejtojmë këtë punë... — Met Druvari i bëri shenjë Zonjës. Vjehrra e Dritës ishte një grua e bëshme, një kuzhiniere pak e sertë që e kishte ndjekur pas gjithë jetën Met Druvarin nëpër kantieret e ndërtimit e që tani punonte në bufenë e vogël pranë parafabrikateve. Zonja hapi çantën, nxori unazën, orën dhe një varëse me zinxhir të hollë, të verdhë. Nënë Vasha nxori nga kutia e vet unazën për Jetonin dhe e vuri mbi tavolinë. Thirrën Dritën. Jetoni e priti më këmbë përpara tavolinës. Tani qëndronin të dy si fajtorë. Të gjitha këto u bënë në he-shtje. Jetoni mori unazën e vet, i zuri dorën Dritës e ia vendosi në gisht. Drita i tha: «Faleminderit», por u skuq pak. Kjo shkaktoi gaz, sepse nusja nuk u dashka të flasë. Më serioze se kurrë ajo mori unazën e vet dhe ia vendosi Jetonit në gisht. Jetoni ia mori dorën dhe i vendosi orën. Zinxhirin ia la në dorë dhe i tha që ajo ta vendoste vetë. Zakonisht në ceremoni të tilla nusët rrinë kokulur, kurse Drita e kishte syrin pishë. Ajo e shikoi Jetonin drejt në sy me qortim e me gaz sikur t'i thoshte: Mos do që të ma varësh ti në qafë varësen?

Të gjithë qeshën dhe i përqaftuan. Besimi i shikonte të gjithë dhe zemrën e kishte plot. Ai rrinte si mënjana. Si i përçollën miqtë, hyri në odë dhe gjeti nënën të përplotur, ndenjtur në divan.

— Nënë, të kam thënë se kjo është më e mirë se unë, ë? E, e shikon?

— Rri, bir, lermë të qetë. Edhe gëzimi të lodhka... Drita e fejuar rrinte më këmbë, plotësisht e hutuar, duke luajtur me zinxhirin që i varej në qafë si një send i çuditshëm, pa kuptim.

Në darkë, si u mblodhën të gjithë përsëri, Hekurani pyeti Dritën për mësuesin që kishte marrë Jetoni me vete.

— Është shkrimtar, — tha Drita. — Do të shkruajë një libër për Kryengritësin e Nahijes.

— Shkrimtarët janë si heronjtë, — tha Hekurani. — Jetojnë gjatë. Edhe Jetoni si punë shkrimtari është, apo jo?

— Jetoni është skulptor, — sqaroi Besimi. — Po njësoj janë.

KAPITULLI I NJEZETEKATËRT

Ndodh shpesh që njeriu bën një hap të ri në jetën e gjerë dhe ajo i rrëmben me pushtetin e saj, e tund dhe e shkund në dallgën e saj, sa atij i duket vetja një gjethe, një gjethe e pafuqishme për t'u kthyer edhe një herë te brigjet ku kishte degën, trungun, rrënjën. E ky njeri nuk e kupton se është pikërisht ai zoti i plotfuqishëm edhe i detit edhe i tokës.

Besim Përdrini punoi javën e fundit pesë ditë me radhë në turnin e parë tok me të atin. Ditën e gjashtë, me kërkesë të Komitetit të Partisë të Rrethit, u mblodh organizata e partisë e konverteve dhe i bëri karakteristiken.

Gjatë gjithë kohës që shokët diskutonin, Besimi kishte ulur kokën dhe e ndiente se tani po ndodhte një ndryshim i rëndësishëm në jetën e tij. Po largohej nga konverti, nga shokët, nga uzina, nga ajo punë, ku kishte hyrë një çunak i druajtur e pastaj ishte bërë usta. I kishin marrë mendimin në njëfarë mënyre për të punuar me grupin e instruktorëve, po Besimi nuk i kishte vënë rëndësi. Sapo kthehej nga shërbimet, ai vazhdonte punën në konvert me shokët dhe shërbimet i harronte shpejt. Tani ndiente dhimbje që do të linte uzinën, do të ndahej nga shokët e tij të punës për të zënë shokë të rinj.

Kur po dilnin që andej, Andrea i shtrëngoi krahun dhe i bëri shenjë të dëgjonte mjeshtrin e vjetër Frrok Zefin që po i ankohej Hekuranit. Besimi nuk e kapi dot bisedën e tyre, veç pa fytyrën e ngrysur të babait

dhe dëgjoi Frrok Zefin që tha: «Na morën djalin.» Frroku tundi dorën si për diçka që ka marrë fund dhe ikën tutje që të dy. Andrea po i shikonte me vëmendje, duke shtrënguar protokollin e mbledhjes në duar.

— Djallo punë! — tha. — E dëgjon Frrok Zefin? «Na e morën djalin...»

Besimi gjendej ende i paçliruar nga ajo ndjenjë që i shtrëngonte gjoksin.

— Bes, nesër në orën njëmbëdhjetë të jesh në Komitetin e Partisë të Rrethit.

— Kaq shpejt?

Andrea i futi krahun dhe e tërhoqi për në zyrë. I tregoi se karakteristikën e kishin kërkuar me urgjencë.

Në orën njëmbëdhjetë pa pesë minuta ata hynë në zyrën e Sallah Silës. Sallahu, si u hodhi atë vështrim enigmatik nga poshtë-lart me buzagazin e ngrirë, i mori dhe i çoi menjëherë te sekretari i parë. Ora ishte plot njëmbëdhjetë. Vasil Kushta ishte aty. Komunikimi që i shkurtër, i thjeshtë. Do të punonte në grupin e instruktorëve. Kur dolën andej, Vasili e tërhoqi në zyrën e tij. Thirri njërin nga instruktorët dhe i tha se Besimin do ta ngarkonin me përgatitjen e materialeve për aktivin ekonomik që pritej të bëhej së shpejti.

Dy ditët e para Besimi shkoi në uzinë. Atje do të shikonte përvojën e përparuar, rendimentin, futjen e shkencës në proceset e prodhimit...

Në uzinë materialet ishin gati, studimet ishin bërë ose po bëheshin dhe perspektivat ishin të qarta.

— Ia keni dhënë seksionit të industrisë këto? — e pyeti Besimi inxhinier Qamilin. Ai e shikoi i habitur. Sytë e thelluar, të pastër e shikuan me vërejtje sikur Besimi t'i kishte thënë: «Keni njoftuar për gabimet tuaja?»

— Nuk na i ka kërkuar kush deri më sot, — tha

Qamili. — Seksioni ka marrë hollësira për ecjen e planit, realizimet, tejkalimet, metalurgët pararojë.

Besimi i tha të përgatiste diskutimin me shkrim për aktivin ekonomik që pritej së shpejti. Përmes këtyre dy studimeve të tregohesh se si mund të rritej rendimenti duke futur dijet, shkencën pikërisht kështu siç i kishin bërë.

Edhe në minierë Besimit nuk i shkoi puna keq. Studimi kryesor që do t'i paraqitej aktivitet ekonomik ishte ai i inxhinier Mustos për shpimin e lëngshëm. Ky studim ishte përhapur dhe tani në mjaft miniera të Republikës punohej me të, por Mustoja as që e kishte vrarë mendjen që të nxirrte një përgjithësim, një studim për rritjen e rendimentit.

— Hë — qeshi Mistoja sapo e pa, — përsëri për «trupin monolit?»

— Jo! Tani kam ardhur për ty.

Mustoja qeshi dhe e përqafoi. Shpimi i lëngshëm kishte zhdukur mjegullat e pluhurit në galeri, por kishte rritur edhe rendimentin deri në tridhjetë e pesë për qind. Mustoja i tregoi hollësisht për fuqinë eksperimentale, tubat dhe punën e Bashkimit e të një grupi minatorësh, si ishte zbatuar ajo në një front dhe pastaj në të gjithë minierën, si e kishte marrë ministria dhe e kishte zbatuar në minierat e tjera.

— Po në rreth përse nuk u fol e as nuk u shkrua për këtë? — pyeti Besimi. Ishte vërtet gjë e çuditshme. Përse heshte në rreth për një gjë kaq të madhe, kur bëhej zhurmë nganjëherë për hiçgjë?

Aty nga dreka u bë një mbledhje e këshillit teknik të minierës dhe u rrahën mendimet.

Babai flinte. Drita ishte në punë. Besimi shikoi me vëmendje nënën dhe iu duk sikur ajo i mënjanohesh vështrimit të tij. Si hëngri bukë, u ngrit dhe pastroi vetë tavolinën. Nëna doli nga aneksi dhe vuri buzën

në gaz, ia mori pjatat nga duart dhe i tha se do t'i lante vetë.

— Ç'kemi këtej? — e pyeti Besimi duke shikuar dhomën ku flinte babai.

Nëna psherëtiu, u vrenjt ca dhe vetullat iu rënduan.

— E ç'do të kemi, bir. Kjo puna jote e re sikur na e ngatërroi ca jetën. Ishim aq mirë... — Vasha i shqiptoi me njëfarë dhimbjeje fjalët e fundit.

— Pse, nënë, tani nuk jemi mirë? — Besimi e pa i çuditur.

— Po ja, yt atë thotë se «unë e kam fajin, vetë ia dhashë këtë rrugë». Ai e quan të vështirë, shumë të vështirë punën tënde të re, bir. Ka frikë mos vjen një ditë e bëhesh edhe ti si disa që i vënë në karrige sot dhe nesër harrojnë që veç prapaniken kanë të tyren, se karrigia është e kujt është. Sillen si në mall të babës. E marrin birin e botës, e bëjnë për ujë të ftohtë dhe i thonë: Pa shko një herë atje ku ke qenë, se atje ke qenë mirë. Ja, kështu është puna. Pse, pak veta ia kanë bërë borxh këtij pushteti? Plaku shqetësohet dhe vuan...

— S'ka besim tek unë?

— Jo, s'është puna aty. Po ti je i ri, mor bir, Punët e Partisë janë të rënda për ty.

— Edhe ti, nënë, ashtu mendon? — Besimi ia nguli sytë. Ajo u afrua, i zuri kokën me të dyja duart dhe ia afroi pranë vetes.

— Unë kam besim te ti, bir. — tha nëna me zemër të dridhur. — Ti nuk na turpëron as ne, as shokët e tu. E di nëna... Koha ndërron me orë, me stinë, njeriu me vitet.

Besimi doli. Do të shkonte të njëra nga kooperativat e luginës ku kishin marrë rendimentet më të larta në grurë dhe në misër: dyzet e tetë kuintalë grurë për hektar ndër parcela eksperimentale dhe dyzet e dy kuintalë për hektar në gjithë sipërfaqen e mbjellë, kurse në misër kishin arritur të merrnin mbi gjashtëdhjetë. Ishte bërë një studim për rentabilitetin e tokës dhe

kishte dalë se toka e asaj kooperative me të kooperativës fqinje ishte e njëjtë, kurse prodhimi, rendimenti ishin shumë larg. Duheshin nxjerrë konkluzione mbi këto diferenca, duhej argumentuar mirë nga agronomët se si ishin arritur rendimentet e larta në grurë dhe në misër, ku qëndronte burimi, ç'rol luanin aty organizimi, drejtimi, administrimi i pronës dhe futja e të rejave të shkencës. Këto ishin porositë. Po si ishin përgatitur shokët për aktivin ekonomik? A duhej t'i shikonte vetë dhe të kishte një ide për këtë diskutim që do të vinte nga kooperativa me rendimene të larta.

KAPITULLI I NJËZETEPESTË

Shefi i seksionit të bujqësisë, Fatih Groshi, një burrë i vjetër, që kishte gjithnjë një ndjenjë krenarie në fytyrë, krenari që nuk kuptohej nga i vinte, i tha Besim Përdrinit se nuk e kishin raportin gati edhe në ditën e fundit. «Silleni vetë pasdite,» — tha Besimi. Po Fatihu nuk e solli. Në orën shtatë e gjysmë, kur ai e solli raportin, nuk pati kohë ta lexonte as Vasil Kushta dhe as ndonjë tjetër.

Të nesërmen në orën tetë Besimi hyri në sallë me një ndjenjë faji. I dukej se përgjegjësinë për mosleximin e raportit e mbante ai që nuk këmbënguli te Fatihu. Ndiente edhe njëfarë druajtjeje nga prania e gjithë kuadrove të rrethit: sekretarë byrosh, drejtorë ndërmarrjesh, shefa plani, kryetarë kooperativash, shefa seksionesh të komitetit ekzekutiv, specialistë. Mes tyre pa edhe një grup të ftuarish rreth Nikolla Bushit. Me ta ishin dhe Jetoni me Saliun.

Në radhët e para, ku kishin zënë vend nëpunësit, kishte njëfarë shkujdesjeje. Flisnin e bënë shaka, siç ndodh zakonisht në sallat e koncerteve, përpara shfaqjeve. Ndërsa në radhët pas tyre, ku kishin zënë vend edhe Andrea me Qamilin, grupi i metalurgëve qëndronin si të topitur, sikur sapo kishin lënë turnet. Pas tyre ishte Diana me Skënder Sulën. Ajo ishte pak e zbehtë, dukej e vrarë në fytyrë. Në të djathtë të saj, pranë dritares, ishte një karrige bosh. Po edhe pranë Andreas kishte një karrige bosh. Siç dukej, të dy palët e pritnin, sepse, sapo Besimi ktheu sytë andej, Diana u tur-

bullua dhe uli kokën, ndërsa Andrea e thirri me zë të lartë: «Beso, eja te ne!» Besimi mbaroi punë në sekretarinë e aktivitetit dhe shkoi pranë Andreas. U kthye pas dhe u dha dorën Dianës e Skënderit. Çuditërisht dora e Dianës ishte e ftohtë.

— Do ta diskutosh? — e pyeti Besimi.

— Materialin ia kam dhënë sekretarit të byrosë. Po mund të diskutojë edhe Skënderi, — tha ajo dhe shkoi në të majtë. Skënder Sula ishte shend e verë. Se ç'kishte njëfarë mospërfilljeje në vështrimin e tij që Besimit nuk i pëlqeu dhe u kthye përpara. «Gjithnjë i shikoj bashkë,» — mendoi. Po ajo karrigia bosh në të djathtë?

Rrapëllimë karrigesh. Njerëzit u ngritën dhe kthyen kokën pas të shikonin kush po vinte në presidium. Besimit i zuri syri dy të panjohur mes atyre që po hynin: i pari i shëndoshë e i plotë, tjetri hollak e i thinjur. Diana i tha Andreas se i pari ishte profesor Bujar Darësi që punonte në Institutin e Kërkimeve Veterinare, kurse ai tjetri, hollaku i thinjur, vinte nga ministria dhe Diana nuk e njihte.

Nënkryetari i komitetit ekzekutiv e hapi mbledhjen dhe Fatih Groshi u ngrit të mbante raportin. Ai lëvizti ngadalë, rëndë-rëndë, vuri syzet dhe shkoi sallën, pasi tha «shokë!». Disa nga radhët e para duartrokitën. Fatihu vuri buzën në gaz dhe tha se ishte mbledhje pune, po u kuptua se atij i pëlqeu gjesti entuziast i shokëve në radhët e para. Besimi kërkoi me sy ata që duartrokitën, po nuk mundi t'i dallonte. Mes tyre ai pa fytyrën e ngrysur të Kallushanit. Pak më këtej ishte Ibishi i qetë e me humor të mirë. Ishte rruar dhe fytyra i shkëlqente plot gjallëri. Pak më tutje, mes atyre të komunales, dalloi qafën e gjatë të përgjegjësit të gjelbërimit për qytetin, Kurtishit.

«Sikur të diskutonin të gjithë këta me radhë, — mendoi Besimi, — ai profesori i Dianës do të mendonte: «Kjo është mbledhja e Kukajve.»

Fatih Groshi e ngriti zërin: «... se e kaluara e hi-

dhur iku një herë e përgjithmonë. Në ekonominë tonë bujqësore lulëzon jeta jonë e re. Ai fshatari që deri dje rraskapitej nën thundrën e xhandarit e të bajraktarit, rroku armën e u bë zot i fateve të tij, sepse fshati ynë s'ka të krahasuar me të kaluarën e zezë, sepse...»

Andrea po hahej me Qamilin. Ata diç pëshpërisnin dhe Besimi dëgjoi vetëm fjalën «historizma», pastaj Andrea ngriti zërin dhe i tha Qamilit se këto mund të thuheshin në ndonjë historik fshati apo të lagjes, po jo këtu. Në presidium profesor Bujari dëgjonte me vëmendje ç'i thoshte ai i ministrisë. Vasil Kushtës i ishte tretur ai buzagazi që kishte në fillim. Një ngjyrë e zbehtë ishte ndehur mbi ballin e madh.

«...këtu ku ngrihet ky qytet i mrekullueshëm, tri dhjetë e ca vjet më parë, shumë nga ne vraponin me armë në dorë për t'i zënë pritë armikut gjakatar në...»

— Dianë, për kë e ka fjalën shoku Fatih? — e pyeti Besimi. Ajo kishte ndenjtur gjatë gjithë kohës si mënjanë dhe Besimi e ndiente vështrimin e saj të mprehtë.

— Pyet Demkën, — tha ajo me gaz. I erdhi mirë që ai i foli më në fund.

— Cilin?

Ajo u përkul pranë dhe i tregoi për zanatçin e raporteve të «shokut Zylo», një inspektor që rrinte pranë tavolinës së sekretarisë. Besimi njohu inspektorin me të cilin kishte udhëtuar për në Bregaj dhe iu kujtua lodra që i bëri shofer Merimani.

Inspektori kishte po atë kostum blu, prerë me bel.

Jashtë dëgjohej zhurma e lehtë, e bezdisshme e shiut. Pastaj erdhi një dallgë e fortë ere dhe shiu u përplas në asfaltin e sheshit e jehona erdhi në sallë, saqë zëri i Fatihut u përzje me të.

«...që të mos themi tërësisht e rrënjësisht, zakonisht janë ndërtuar shtëpi të reja në njëqind e njëzet e pesë fshatrat e rrethit. Drita elektrike ka hyrë në kullën më të largët. Natyrisht...» — vazhdonte Fatihu.

Në sallë kishte filluar një mërmërimë e përgjithshme që përzihej me jehonën e shiut.

— Po kjo ka dhjetë vjet! — thirri një zë i trashë nga fundi i sallës. Njerëzit u kthyen menjëherë pas, sikur të pritnin pikërisht atë zë.

— Qetësi, shokë! Jemi mbledhur për punë, — tha nënkryetari.

— Jo për historira! — thirri përsëri po ai zë dhe njerëzit këtë radhë panë Nikolla Bushin e skuqur.

Besimi u mbështet te pragu i dritares. Në sheshin e asfaltuar, mes rrebeshit, çante një burrë i gjatë, me flokët të rënë në pjesën e sipërme të çaçkës së kokës që i shkëlqente, me syzet e lagura. Ai shpejtonte pas Sallah Silës. Sallahu qëndroi një çast dhe i bëri një gjest me dorë si për t'i thënë «Mjaft, m'u hiq!», por njeriu i gjatë i preu rrugën dhe i tregoi xhepin e xhaketës, të cilin e shtrëngonte me dorën e majtë. «Ky është njeriu i letrave.» — tha Besimi me vete. Letër sekretarit të parë për shitjen e spinaqit, letër kryetarit për furnizimin me makarona nga Durrësi dhe jo nga Shkodra, letër nënkryetarit për orarin e dyqaneve, letër kryeredaktorit të gazetës lokale kundër Sali Kallinit, letër... Edhe ditën e fundit, përpara se të vdesë, ky njeri do të shkruajë ndonjë letër-ankesë. Në mos për ndonjë njeri tjetër, për plakën e vet, ose për varrmihësin. Iu kujtua takimi i fundit me të. Njeriu i gjatë kishte shkruar kundër shkrimtar Saliut. Ato ditë ishte botuar artikulli «Ndienja e fisit dhe bajraktarizmi» në gazetën lokale. Njeriu i gjatë ankohej në letrën e tij se tek ai artikull prekej krahina, se atje duhej të sqarohej se bajraktarët nuk kanë qenë të gjithë xhahilë. Kur e thirrën t'i jepnin përgjigje, ai shpresonte se do të hynte në debate me sekretarin për parinë e krahinës, bajraktarët. Por sekretari, si e sqaroi se në artikull bëhej fjalë për bajraktarizmin dhe jo thjesht për bajraktarët, i tha në fund: «Rri urtë, se je mirë...» Kaq.

Fatihiu po fliste për vendburimet. «Bakri çan bllò-

kadën. Kromi çan bllokadën. Minatorët janë heronj. Gjeologët janë heronj. Metalurgët janë të mrekullueshëm... Hekurnikeli...» Besimit iu duk se ai zanatçiu këto fraza i kishte kopjuar nga këndi i emulacionit.

«së shpejti liqeni do të përmbysë qytezën e vjetër, vendlindjen tonë, të të parëve tanë që...» — Fatihu e kishte ulur ca zërin dhe po e mbaronte me dramë fjalimin. Besimin e mori gazi. Lëvizti rëndë sa kërciti karrigia.

— Përse qesh? — e pyeti Diana. Ai pa se edhe ajo qeshte. Ajo u afrua dhe i pëshpëriti te veshi: «S'e mbajte fjalën. Unë të prita...»

— Nuk kisha kohë.

— Ti nuk më thua të vërtetën, — tha ajo.

— Të vërtetën po të them. Ti e di që isha nën urdhrat e shokut Vaso.

— Unë të prita edhe të nesërmen, po ti nuk erdhe nga sektori.

— Nuk kisha sesi, pra. Po të them të vërtetën.

— Përse nxelesh? Dëgjo ç'thotë Fatihu, se do të të vijë humori.

Po Fatihu e mbylli raportin. Ai shikonte me vëmendje nga salla mos kapte ndonjë vështrim miratues, po në sallë kërciste muhabeti. Nënkryetari, i mërzhitur, e mbylli seancën.

Jashtë vazhdonte të binte shi. Besimi u detyrua të ngjiste shkallët për në katin e tretë, sepse Diana do të takonte pak kryezooteknikun e rrethit. Ai e priti në korridor, ndërsa ajo hyri te kryezootekniku. Nga zyra përballë Besimit vinte një debat me britma.

Pas pushimit mbledhja filloi përsëri.

Dy të tretat e pjesëmarrësve të aktivitetit sollën në sallë gjurmët e shiut mbi peliçe, fëshfëshe, xhaketa,

bluza, gabardina e pallto. Shiu kishte hyrë në sallë si shok i pandarë i të gjithëve.

— Erdhi vjeshta, — i tha Skënder Sula Dianës.

— Erdhi, — iu përgjigj ajo si me frikë. — Vërtet që erdhi.

Besimi e ndoqi bisedën e tyre për vjeshtën dhe iu duk sikur ata po flisnin për dasmat. Dikur ai fjalën «vjeshtë» e kishte përdorur për fjalën «dasmë». Po kur? Me Dianën? Atij nuk i kujtohej.

Po bëheshin pyetje. Ato binin si breshër mbi supet e Fatih Groshit. Ishin dorëzuar të shkruara, tani bëheshin gojarishte drejtpërdrejt nga salla. Kur personi pyeste. Fatihu ia ngulte sytë e ftohtë sikur t'i thoshte: Edhe ti? Çfarë do ti? Po njerëzit shikonin Vasil Kushtën dhe nuk ia kursenin Fatihut. Vetë Vasili kërkoi t'i shpjegonin cili ishte grupi i punës për raportin.

— Si është futur shkenca në prodhimin bujqësor dhe industrial? — pyeti Vasili. — Fytyra e tij dukej tepër e lodhur. Përgjigjet po i jepte nënkryetari i komitetit ekzekutiv. Kur ai tregoi grupin e punës, u dëgjuan disa të qeshura. Grupi, përgjithësues i përvojës së përparuar, ishte një agronom i seksionit, një nëpunës i kadastrës, inspektori i arsimit, një inxhinier ndërtimi. Nënkryetari heshti një çast, pastaj tha:

— Shokë, kjo nuk është vetëm punë e Fatihut. Në radhë të parë përgjegjësia rëndon mbi mua. Besimi i tepruar dhe mungesa e kontrollit sjellin një raport të tillë. Prandaj ju qeshni me të drejtë, se për të qeshur është. Qeshni...

Po pikërisht pas fjalëve të tilla njerëzit heshtën. Fatihu përfitoi dhe thirri që nga vendi:

— Raporti i preku të gjithë sektorët. Nuk e kuptoj përse...

— Do ta kuptosh nga diskutimet, — tha nënkryetari. Ai vazhdoi të jepte përgjigjet e tjera.

Papritur mbledhjen e kapërtheu një shqetësim i çuditshëm. Në fillim u fashit euforia që Besimi kishte vërejtur në radhët e para. Në pushim grupi i punës

për raportin ishte thirrur te nënkryetari. Aty u ishte bërë një dush i ftohtë që nuk i diheshin pasojat. Dikush kishte thënë duke hyrë në sallë: «Qarkullim bujqësor në seksion...» Tjetri që e kuptonte mirë atë lloj qarkullimi në seksion, ia kishte kthyer: «Dikush do ta lexojë mirë atë librin «Stuhi në sirtar». Kjo bisedë pati një efekt çudibërës. U përhap si erë krahëlehtë dhe la hije mbi kokat e ulura, mbi ballin, mbi sytë e atyre të radhëve të para.

«Kush ka mbushur dhjetë vjet në një vend qarkullim!»

«Si dhjetë? Besa, flitet për pesë. Je në vete, more? Qe besa! Ma jep dorën, s'ta fëlliq! Thonë se njeriu u bëka si ujët e ndenjur, prandaj... Uji i ndenjur? Po shoku Fatih që ka pesëmbëdhjetë, çfarë uji është? Mirë ai, po baca Kallush? Shshsh! Mos e prek gjarpurin me krande, se e gjen të zezën tande. Pse, more, edhe Kallushi si të tjerët. Është i Kukaj dhe Kukajt, shshsh!»

Euforia kishte mbetur jashtë nëpër shi gjatë pushimit. Tani nuk kthehej kush të fliste me atë që kishte pas, as të qeshte, as të bënte ndonjë shaka. Jo, jo. Kishin punë serioze tani.

«More, po kush qenë ata që e përhapën llafin? Pse qarkullim bujqësor dhe jo industrial? Ç'është ai libër i tmerrshëm i «Stuhisë»? Mos këto llafe i përhap Nikolla Bushi?»

Ngado e shikojnë Nikollën edhe me frikë edhe me inat. Ah, more Nikollë, që s'e ha rehat atë pension, po merresh me të tjera punë! Mirë, more vëlla, ti lufto për rendimentin, për bakrin, kromin, hekurnikelin, për qumështin, mishin, leshin, grurin, misrin. Kush të thotë mos puno. Puno! Fute shkencën kudo për rendimentin. Po ky qarkullimi, i vogël të duket? Po mosha a kihet parasysh. po raportet mjekësore?

Besimi i dëgjonte pëshpërimat aty afër me vëmendje. Tani po diskutonte Ibish Kukaj. Ai e sillte ndër duar fletën e shkruar dhe, siç dukej, i vinte

zor. Po përse? Besimi e pa se si e palosi⁷ letrën, iu afrova mikrofonit e tha:

— Shokë, kisha diçka të shkruar, por e shikoj se ajo s'vlen një para. Më mirë po jua them dy fjalë kështu. Ne kemi një sipërfaqe të madhe toke mbi ujë. A është menduar për këtë deri më sot që ta futim nën ujë? Jo! Po do të më thoni ju: Po ti ç'ke bërë? Si të tjerët edhe unë. Kurse tani kam këtë mendim; të bëjmë një studim për ujëmbajtës të rinj, për motopompa që ta ngremë ujin nga liqeni ndër tokat e zonës kodrinore. Si mund të shfrytëzojmë vrellat që kanë ujë gjithë vitin? Mendja ma thotë se djemtë dhe vajzat tona mund të bëjnë një studim të përpiktë për këtë gjë dhe brenda pesëvjeçarit të futim nën ujë një sipërfaqe të madhe toke. Studimi do shkollë. Djemtë dhe vajzat tona do ta bëjnë. Sekcioni duhet t'i mbështesë dhe t'i nxitë... — Ibishi shikoi Dianën. I buzëqeshi dhe numëroi disa vende ku mund të shfrytëzoheshin përrenjtë e formuar nga vrellat, ku mund të vendoseshin motopompat dhe ku mund të hapeshin ujëmbajtës të rinj.

Në podium u ngjiti një tjetër. Ai nisi të lexonte. «Jam dakord me raportin.» Në sallë shpërtheu gazi. «Jam dakord me pjesën e mirë të raportit,» — e ndreqi diskutanti. Po njerëzit përsëri e pritën me gaz. «Jam dakord edhe me vërejtjet...» Salla s'u përmbajti më.

— Ky po lot teatër, — gjëmoi zëri i Nikolla Bushit. Në sallë u vendos qetësia. Vasil Kushta e pyeti për diçka diskutantin. «E kam seriozisht, — tha ai. — Për besë, nuk bëj hajgare.» Ky njeri që tani ndodhej ngushtë në podium, kishte një zakon të çuditshëm, lagte gishtin tregues në buzë dhe bënte sikur shfletonte, po në të vërtetë nuk shfletonte asgjë.

Pas tij foli një kryetar kooperative që kishte rendimente të larta në misër. Salla pushoi dhe e dëgjoi me vëmendje. Pastaj foli një punëtor nga ata të minierës së kuarcit. Një agronom i ri kishte rendimente të larta në thekër dhe patate.

— Më duket këtë do ta sjellin në seksion, — i tha Diana Skënderit.

Besimi shikoi fytyrën e zeshkët të agronomit të ri. Në vështrimin e tij kishte diçka nga shikimi i përqendruar i një skifteri. Pasi mbaroi agronomi, fjalën ia dhanë Qamilit. Ky e nisi diskutimin e vet ashtu si e kishin përgatitur me Andrean, po e ndërpreu shefi i industrisë:

— Fol për mosrealizimet e tremujorit të tretë, — tha shefi.

— Shqetësimi ynë lidhet me të ardhmen, — ia preu Qamili, pa e këputur fillin e mendimit. — Lidhet me pesëvjeçarin. Ne sot punojmë për rikonstruksionin e sektorëve të uzinës. Grupi ynë kërkimor konsultohet me librat dhe me metalurgët. Një metalurg na sugjeroi idenë e zgjatjes së afatit të rimontit vjetor, por eliminimin e një rimonti në pesëvjeçar. Ne i hymë kësaj pune, studiuam, llogaritëm.

Përsëri pati një ndërhyrje nga shefi i industrisë. Qamili u mpreh edhe më fort në fytyrë, u vrenjt dhe vazhdoi të lexonte diskutimin.

— Për rimontin, deri tani, kemi punuar me sulm, me shkelje të normave teknike e të disiplinës shkencore. Herë fitonim tri ditë, herë pesë. E për këto ditë ne fitonim flamurin. Për to kishte zhurmë, bujë! Në të vërtetë për zhurmë e për bujë luftohej në ato tri ditë, jo për bakër. Se bakër merrnim pak, fare pak në krahasim me atë që mund të marrim në rrugën tjetër. Nga ajo punë me sulm, me shkelje normash teknike, për bujë e për zhurmë vinin avaritë ndër furra, ndër sektorë, pezulloheshin punimet, binte prodhimi, kishte humbje gjatë vitit që nuk lidheshin me rimontin... Grupi ynë kërkimor ka studiuar e llogaritur humbje të tilla gjatë dhjetë vjetëve të fundit. Rezultati është ky: po të bëhet rimonti në kushte të mira teknike me një disiplinë të rreptë shkencore, nuk është nevoja që rimonti pasardhës të bëhet patje-

tër muajin e dymbëdhjetë. Ai mund të bëhet në të pesëmbëdhjetin ose edhe më vonë. Avaritë dhe ditët e humbura ose do të eliminohen fare, ose do të jenë fare të pakta. Nëse fitojmë tre muaj zgjatje të afatit të rimontit në vit, në pesë vjet kemi fituar një vit të plotë pa rimont fare. Pra, kemi fituar një vit bakër!

Qamili ngriti kokën dhe shikoi në heshtje.

— Shokë, jua thashë këto në këtë aktiv të gjerë, jo që t'ju mburrem, se kjo është punë kolektive, por që t'ju tregoj se kështu mund të punojmë të gjithë. Kaq! — Qamili bëri një lëvizje të ngathët të dorës dhe deshi të largohej nga podiumi, po Vasil Kushta e pyeti se cilët metalurgë kishin bërë sugjerime.

— Nga mjeshtrit, Frrok Zefi dhe Hekuran Përdri-
ni, kurse nga të rinjtë... — Qamili vuri buzën në gaz duke shikuar Besimin, — biraçi ynë, Besim Përdri-
ni, dhe grupi i biraçëve...

Besimi u turbullua dhe ndjeu se po i digjnin faqet. «Isha, — tha me vete, — isha. Tani s'ka më biraç.» Nënkryetari përmendi emrin e tij dhe Besimi e kuptoi se duhej të dilte për diskutim. Kaloi mes shokëve dhe ndjeu se e pushtuan emocionet e pati frikë se do t'i lidhej gjuha e do të bëhej qesharak.

Sa vështirë është t'i flasësh një sallë si kjo e jo njërëzish dosido, sekretarëve dhe drejtorëve, specialistëve më të mirë në rreth.

— Shokë, — tha dhe pa se zëri i ndryshoi çuditërisht. Vuri buzën në gaz dhe shikoi mbi kokat e njërëzve duke mos parë asnjërin, pastaj sytë i shkuan tek Andrea, vështrimi iu qartësua dhe vazhdoi: — Ne kemi të drejtë që të ëndërrojmë për të ardhmen, por duhet të luftojmë ca më shumë, duhet të nxitojmë ca më shumë. Për këtë nuk mjaftojnë vetëm muskujt. Duhet edhe drita, dituria, shkenca. Ta rrënjosësh këtë bindje te njeriu, do të thotë të kuptohet një e vërtetë e madhe.

Ai mendoi se listat e diskutantëve mund të thjesh-

toheshin dhe mund të mos dilnin ato që duheshin, prandaj ua nxori kokën pikërisht atyre kërkimeve shkencore që bëheshin drejtpërsëdrejti në prodhim brenda rrethit. Përmendi shpimin e lëngshëm.

— Vetëm kush ka qenë në galeri dhe e ka provuar vetë, e di se ç'është shpimi i thatë për minatorin. Prandaj vepra e Mustos me shpimin e lëngshëm nuk është e thjeshtë. E thjeshtë mund të jetë për atë raportin që u mbajt këtu. Për aktivin do të ishte me interes fjala e inxhinier Mustos apo e minator Flammur Oshllanit për këtë, po miniera ka edhe probleme të tjera ndër duar...

Besimi përmendi blegtorinë, agronomin e veterinerin e një kooperative malore ku kultivohej vetëm delja rudë, përmendi Dianën dhe Skënderin për dhinë mishtake dhe përhapjen e saj, për organizimin e fuzisë punëtore, për probleme që dilnin nga Bregaj.

— Të më falin shokët, se nuk desha të tregoj gjithçka bëhet në rreth. Unë them këtë: ka përvojë të mirë! Ka kërkime me shkencën nën kokë. Po nuk ka studime për to, për përhapjen e tyre, për inkurajimin e tyre, për organizimin dhe drejtimin e tyre këtu në qendër. Unë them se duhen sqaruar në këtë aktiv disa gjëra nga shokët diskutantë... Përse ta marrin dhinë e madhe mishtake rrethet e tjera si Përmeti e Saranda dhe të mos e marrin nga tufat racore fshatrat e tjera të rrethit tonë? Përse luftohet për përshtatjen e lopës laramane vetëm në fermën e Pllajës dhe jo këtu në qendër apo në kooperativat tona më të mira? Përse të merren vetëm në parcela eksperimentale deri 250 kv patate për hektar dhe jo në gjithë sipërfaqen? Përse ndryshojnë rezultatet e rendimentet ndër dy kooperativa fqinje ku pjellshmëria e tokës është e njëllajtë? Luftën për rendiment, luftën për më shumë grurë, më shumë bakër blister, për më shumë mish e qumësht, si punëtor që jam, unë e quaj rikonstruktion të vërtetë. Këtë do ta bëjmë ne vetë dhe do të fitojmë!

Vuri buzën në gaz, së vuri re që sytë çuditërisht ishin përqëndruar përsëri tek Andrea. U largua nga podiumi. Në radhën e dytë, te karrigia e tretë dy sytë mjegullt e shikonin së thelli si të topitur. Besimi e shikoi buzagaz sikur t'i thoshte: «Baca Kallush, në rregull?» Pastaj folën nënkryetari i komitetit dhe Vasil Kushta që dha konkluzionet e aktivitetit.

Besimi doli jashtë tok me Andrean, Qamilin, Dianën dhe Skënder Sulën.

Shiu kishite pushuar. Toka dukej si e përtërirë. Zhurmat e ditës ishin pakësuar. Një ajër i lehtë, i pastër, i freskët, të mbushte mushkëritë. Në qiell po dridhe-shin yjet.

KAPITULLI I NJËZETEGJASHTË

Disa ditë ra shi pa pushim. Ishte një shi i marrë e i mërzitshëm që s'të linte të bëje as dhjetë hapa larg shtëpisë. Një mëngjes, papritur qielli u hap dhe retë u shpërndanë. Ishte një ditë e trazuar dhe nuk mund të përcaktoje ç'do të vinte deri pasdite.

Ujërat e liqenit tashmë pritnin rrjedhën e vrullshme dhe zhurmëmadhe të lumit, e thithin si në gji dhe vetë fryheshin më shumë, zgjeroheshin e ngjiteshin ngadalë brigjeve të rrafshinës. Kur ujërat erdhën deri tek ura e gurtë që lidhte Pllajën me qytetën e vjetër, u ngrit i madh e i vogël dhe shkuan turmat-turma të shikonin se si vinin ujërat e liqenit. Ishte një çudi e padëgjuar: lumi po kthehej drejt rrjedhës dhe po formonte liqen. Radha e njerëzve ishte pa mbarim. Ishte një pelegrinazh i vërtetë. Vargu i gjatë i ngjante atij të thneglave në ditë lëmenjsh.

Në këto vizita ishin lejuar të shkonin edhe nëpunësit, administratat e ndërmarrjeve, kolektivat e punëtorëve. Ata zinin urbanët e lirë dhe shkonin të organizuar. Makinat ecnin ngadalë mes turmës dhe u binin vazhdimisht borive.

Në ditët që ranë shirat, vargani i madh nuk u duk më. Po ja, koha u hap dhe turmat u dukën përsëri që në mëngjes.

Kallushan Kukaj ruante rastin që, kur të shkonte shefi i tij, Fatihu të shkonte tok me të. Dhe ja, Fatihu zbriti në kadastër, ua nguli sytë e ftohtë atyre që ishin aty dhe i pyeti kush dëshironte të shikonte li-

qenin. Po të gjithë kishin qenë. Vetëm ai, baca i kadastrës, nuk kishte qenë. Fatihu ia nguli sytë bacës. Kaq shumë të ka rrëmbyer puna, more baca Kallush? — donin të thoshin sytë e tij. E mori. Shkuan. Ndenjën nja një orë te gryka ku ishin ndaluar ujërat e lumit dhe u kthyen me xhips deri në rrafshinë. Aty Kallushani i tha:

— Më ther zemra, kur mendoj se këtu kalova një jetë. Të rri pakëz, shoku Fatih?

Fatihu e lejoi. Kallushani pa sa andej-këtej rrafshinën e shkretuar. Një pishë e lartë e vetmuar me kurorë të dendur ishte lënë në periferi si e harruar, pranë saj një mur i gërmadhës të ish-çikërrimtarit Augustin që e thërritnin Cin, zoti Cin. Zoti Cin mban-te syze të errëta dhe kravatë. Fitonte para dhe, po t'i bëje ndonjë shërbim të vogël, të shpërblente mirë.

Kallushani u end sa andej-këtej i hutuar. Dielli digjte si saç. Ai u djersit dhe u lodh. Mendoi të shkonte në breg të lumit e të freskohej, por e ndjeu veten të këputur dhe u ul të pushonte pranë një shtylle prej betoni. Ndezi një cigare. Aty gjeti prehje.

«Si ikëm kështu»? — tha me vete. Iu kujtua mbrëmja kur dikush foli në telefon me hidrocentralin dhe tha se ujërat përparonin me shpejtësi çdo orë e çdo ditë. Kallushani, sapo e dëgjoi këtë, u largua nga zyra. Në shtëpi i tha Sanijes të mblihdnin teshat e t'i çonin lart me çtë mundnin. Po atë pasdite në muzg dolën si rastësisht nga porta e oborrit çantat sportive me qelqurina, sixhade, qilima, enët dhe gjithë plaçkurinat që mbarteshin me duar. Ato dilnin nga porta gati hajdutërisht, sepse baba Brah nuk donte të shikonte ikjen, ndonëse tashmë nuk thoshte «unë nuk shkoj», «unë do të vdes qetu», por thoshte «unë do të shkoj i fundmi». Baba Brah po dorëzohej, nuk ishte më i pari. Ethet e fisit kishin rënë, nuk ishin më si më parë. Kallushani porositi Emirin të faturonte skodën e komunalet dhe për babën Brah, e nënën Rashë do t'i lutej Fatihut për xhipsin. E dinte që Fatihu nuk do t'ia prishte. Natën e fundit shtë-

pia u zbraz për tri orë. Edhe vetë Kallushani u habit, kur pa dengjet dhe raftet e boshatisura që pritnin makinën. Sofra ishte shtruar në kënd. Sanija kishte përgatitur meze dhe pak raki. Krevati ende rrinte i montuar. Kur erdhi Kallushani në dhomë, Sanija po rregullonte të linjtat në sepete.

— E, si thua? — e pyeti ai. — Baba e mbushi tarllabuqin e vet. S'kam pse qëndroj më. E, Sanë?

— Ashtu, ashtu.

— Neve Kukajve na ka hyrë djalli në bark e na gudulis, — i tha ai. — O të fundit, o s'ka. Ja, të fundit po shkojmë. Ë, Sanë? — Atë mbrëmje ai sikur ndiente nevojën të shfajësohej, të zbrazej diku, sepse i dukej sikur po bënte faj që nisej i pari. Sana e shikoi me sytë e ndritur që gëzonin. Kuptohej, ajo mezi e kishte pritur ngjitjen. — Epo përse të mos gëzojmë edhe ne ca! — ia bëri qejfin Kallushani.

— Po don me ta ngrohë mishin? — e pyeti Sana dhe Kallushanit i shkëlqeu një rreze drite në zemrën e tij prej plaku. Ajo po e pyeste për mishin, donte ta kënaqte, kurse ai po i thoshte që të gëzonin të dy... Ajo droja e saj që dikur i pëlqente, vitet e fundit e shqetësonte Kallushanin. I vinte keq për të shoqen, por nuk dinte ta shpjegonte nga i vinte dhe përse.

— Eja, moj plakë, eja këtu, — i tha. I preku një tufë flokësh të thinjur, dalë nga lahuri i zi, dhe vazhdoi: — Ti s'je tamam plakë. Je e fortë. Eh, sa ditë të bardha do të shohim ne të dy... — Dora e tij rrëshqiti padashur mbi shpatulla dhe asaj i shpëtuan lot gëzimi. Kur e pa ashtu, atij i theri mu në zemër. I mbushi një gotë raki. — Pashë rizanë e zotit, mos ma copëto zemrën, po eja të pimë një herë një gotë bashkë në këtë shtëpi, se këto që po ndodhin, nuk kanë bërë vaki ndonjëherë. U zhbi një qytet dhe... — Sana u ul. Ajo, që s'pinte kurrë, piu. Edhe helm po t'i jepte ai, ajo do ta pinte. Ia njihte zemrën Kallushani së shoqes. Kallushani ishte burri, jeta, perëndia e saj.

Atë mbrëmje erdhi me urbanin e orës dhjetë të natës edhe Emiri. Ai u gëzua, kur i pa ashtu me gotat e rakisë përpara, dhe nisi të fliste shpejt e shpejt për shtëpinë e re. Po Kallushani e kuptoi se i biri ishte i gëzuar që po i shihte ashtu e jo nga apartamenti i ri. Ai tha se e kishte faturuar makinën për në orën pesë. Madje në atë orë do të vinin e ta ndihmonin Jetoni e Flamuri me shokë. Ai kishte qenë me ta te Përdri- nët për darkë dhe tani nuk donte të pinte. Besimi e kishte ftuar dhe të nesërmen mund të vinte edhe me Jetonin e Flamurin. Ndonëse i biri nuk ia zuri emrin në gojë, Kallushani e kuptoi. Po trashej puna me Përdrinët.

— Ai Besimi nuk është i keq, po i fut gjellës ca mish dhie dhe pastaj ec e haje, — i tha Kallushani.

— Është djalë i zgjuar dhe punëtor. Është nga ata që, si i thonë fjalës, fluturojnë lart. Jetoni më tha një ditë se ka aftësi organizative.

— Ç'do të thuash me këtë? — e pyeti Kallushani të birin.

— Partia të tillët i mbledh si floriri në rërë.

— Jo, more!! — qeshi Kallushani. — Kështu ia nisim disa derisa zënë karrigen, pastaj ku jemi parë, o djalë... U lodhen gjunjët dhe u shumohen fjalët, — i tha të birit dhe uli vetullat e rënda, por gjurmonte ç'përshtypje i la fjala e tij Emirit.

— Mua më duket djalë parimor, — tha Emiri.

— Parimor, parimor, po në darkë magjja tërheq nga vetja. Po ti përse u tëkeqe kështu, kaq mik e paske?

— E kam, baba. E kemi të gjithë... Dana, Goni, edhe Flamuri është shok me të. Jetoni po kështu. Ma merr mendja se Besimi është shok nga ata që na e do të mirën.

Kallushani e shikoi drejt në sy të birin. Ai u skuq. «Tani. — mendoj, — do ta pyes.»

— Mor bir, si i ka punët me Danën ai djalë? Unë ta kam llafin, mos ka gjë...

Emiri uli kokën i menduar.

— Danën nuk e kam pyetur, babë.

«Domethënë e ditke,» — mendoi Kallushani. Mbu-shi gotat dhe i trokitën. E ktheu të tijën njëherësh dhe thirri tërë gaz:

— Oj Sanë, e sheh me sa drojë flet ky Miri ynë? Edhe ky më kujton patriarkal... Jo, or bir, jo! Nuk jam patriarkal unë. Ato që ngjanë te ne shoshiti mirë dhe do të dalë o baba Brah, o Kurti në shteg. Kurti i bëri çorap punët, jo unë. E sa për Danën, unë s'ia prish fatin. Veç po ta them se ai Përdrini këtu zor se më futet. — Kallushani tregoi zemrën. — Po ama, kur të mbin egjri me grurin në lugë, e kapërdin o nga e mira, o nga e keqja. Ti po më thua se është djalë i mirë, parimor e ku di unë. Po mos harro atë fjalën popullore që thotë: U bëre qengj, të hanë, u bëre ujk, të vranë. Ja, i tillë më duket ai Besimi dhe e kam zor t'i jap rrugë kësaj pune...

Vërejtje se Emiri gjatë gjithë kohës sillte gotën mes gishtërinjsh i shqetësuar. Ai i mënjanohej çdo zënke me të anë. E njihte Kallushani karakterin e të birit. Kështu kishte qenë gjithnjë, vinte deri te përplasja dhe fët, mënjanohej. Gjithnjë gjente shteg për të dalë. Ndryshe ishte Agroni. Ai të kundërshtonte hapur dhe në çast. Nuk dinte ai të skuqej kështu. Edhe Diana kishte guximin e Agronit.

— Ani, arinë s'e kemi zënë akoma dhe i bëjmë llogari lëkurën. E lëmë këtë muhabet, — e mbylli Kallushani bisedën.

Kallushani shikoi rrafshinën si një realitet që na shfaqet pas përgjumjes. Rrafshina kishte marrë një ngjyrë të errët, të thellë si në muzg. Qielli ishte mbyllur papritur nga retë. Frynte erë e fortë. Ajo i shtyn-te retë me nxitim, duke i çarë vende-vende, zbulon-te copëza të kaltra, të largëta që zhdukeshin shpejt. Pas ca era e rriti forcën e saj dhe kurora e pishës së

vetmuar përkulej e kërciste me mundim. Kallushani pa se grykat ishin zënë. Retë ishin ulur dhe e kishin mbyllur horizontin pus. Mes gjithë kësaj nate ndodhej ai, fare vetëm, këtu mbi rrafshinë, përpara pishës, edhe kjo e vetmuar. Ai e ndjeu vetminë nga brenda dhe u rrëqeth.

Ca pika të mëdha shiu, pllaq-plluq, binin me zhurmë. Zhurma e ngjethi. Hodhi sytë te bregu i errët i lumit. Dy burra vraponin në rrugën këmbësore drejt qytetit të ri. Pas tyre vraponin dy vajza të rritura. Fustanet verore ua merrte era. Pas shpejtonin dy grá me dimite. Ato dredhuan rrugë për në dushkajë.

Ai u përpoq të shquante vendin ku kishin qenë përdheset e Kukajve. Kishin mbetur vetëm themelet e murit anësor që tani ishin mbushur me ujë. Pas kalimit të buldozerëve dhe pas stuhisë aty çdo gjë kishte ndërruar trajtë. Ai dalloi tubin e çezmës, gjysmë të përkulur, që shkëlqente nga vetëtimat si koka e një gjarpri që diç kërkonte. E dinte se grykën e pusit e kishin mbushur dhe mbuluar. Po gypin e çezmës përse e kishin lënë? «Tani këtu gjithçka u rropos», — tha ai me vete — Ajo që mbeti, është atje lart...»

Iku andej, duke e lënë rrafshinën mes rrebeshit. Zbriti rruginës ku ngriheshin dikur plepat kanadezë dhe ra në breg të lumit. Kokrrat e breshrit flluskonin mbi ujë.

Ktheu kokën dhe pa se rrafshina shkëlqente nën një tis të xhamtë, sidomos në rrugëzat e asfaltuara, në sheshin e qendrës dhe në rrugën që zbriste nga ura.

Kur arriti në shtëpinë e re, u fut në banjë. Hoqi të gjitha teshat, u fshi mirë me peshqirin e madh dhe u ndërrua. Në kuzhinë ziente muhabeti. Kishin ardhur Emiri me nusen dhe Batushi me Vjedën. Sanija ia la teshat e pastra aty dhe i tha të vishej shpejt se do të ftohej. Kur doli që andej, me këmbëshën

e bardhë të hekurosur, në mjedisin e ngrohtë të shtëpisë, e ndjeu veten mirë. As që donte ta mendonte atë që i kishte ndodhur. U takua me nusen e Emirit, me Batushin e Vjedën. Emiri e pyeti se ku kishte qenë.

— Në banjë, — tha me gaz. — Bëra një banjë të lezetshme. Hëngra gjithë këtë rrebesh mbi kokë. Dhe ku më zuri, thoni ju? Në rrafshe, në qytetin e vjetër. Më shpëla sa më hyri në palcë. Po ju?

— Unë të kërkova në komitet, po s'të gjeta dhe erdha këtu.

— Po hë, ç'bëhet andej?

— Ziejnë telefonat. Kjo stuhi ka bërë dëme të mëdha. Thonë se tufat e dhenve dhe të lopëve i ka zënë në bjeshkë.

— Jo, more!! Po të jetë kështu, atje qenka bërë hataja... Po Dana?

— Dana nuk ishte në sektor. E ç'rëndësi ka Dana, kur... — Emiri i tha këto pa e fshehur alarmin e katastrofës së mundshme në bjeshkë.

— Si, more, «ç'rëndësi ka Dana», — tha Kallushani dhe e shikoi të birin me qortim. — A dihen cilat tufa janë?

— Tufat e njëfarë Selman Sula. Shoku Fatih tha se në ndihmë të tyre kanë shkuar fshatarët e Rrethkurores dhe një repart ushtarak.

— Jo, more!! Bash tufat racore të Danës. Medet ç'qenka bërë!

Hyri dada Rashë, e shkurtër, e vogël, e plakur, e heshtur. Mori dicka në bufe.

— U ba kiameti, shvqyr i kofshim! — mërmëriti ajo dhe, pa pritur asnjë përgjigje, doli për në odën e pleqve, ku ishte ndezur soba.

KAPITULLI I NJËZETESHTATË

Stuhia e gjeti Dianën në dhomën e farmacisë së sektorit. Ishte ulur në karrigen pranë banakut. Përpara kishte paretin e xhamtë. Në të një gjarpër që kërkonte të pështynte në kupën e barnave. Duke shikuar tej paretit në shtrirjen e dritares, gjarpri shkëputej nga xhami, zmadhohej dhe ngrinte në përmasa të mëdha në sfondin e zi të qiellit të largët.

«Kur isha foshnjë, baba Brah më tregonte shpesh përralla me gjarpër, — mendoj ajo. — Më thoshte se gjarpri pështyu në shpirtin e gruas së parë, Evës, Havasë apo Ivës, a një emër mes tyre. Baba Brah thoshte se pas pështymës së gjarprit filluan të gjitha të këqijat në botë, se ai gjarpër i çuditshëm zbrazti në shpirtin e gruas frymën e shejtanit. Po ti, baba Brah, përse jeton me dadën Rashë? Sa fëmijë linde ti me të?»

Diana vuri buzën në gaz.

Ndjeu se zhurma gjumëndjellëse e shiut u kthye papritur në një rropamë të furishme mbi eternitet e barakës. Kokrrat e mëdha të breshrit kërcitnin mbi dritare. Në anën veriore u dëgjuan krismat e xhamave të thyer.

«Ç'është kështu?» — tha ajo me vete dhe shkoi me vrap te dritarja. Mes mjegullirës së shiut dhe të breshrit pa konturet e zbehta e të largëta të Kurorës me bjeshkët e zbardhura nga bora. Fusha e sektorit deri në Bregaj ishte mbuluar menjëherë nga një shtresë e bardhë dhe e hollë bore.

«Po unë ç'shikoj ëndrra këtu?! — tha me vete

ajo. — Ku do të m'i ketë zënë tufat kjo furtunë? Po sikur t'i ketë zënë në Rrafshë? Ndoshta jo. Baca Selë i kupton retë që nga larg. Ndoshta do t'i ketë futur në Gropa, edhe nëse nuk ka pasur kohë t'i zbresë poshtë. Po sikur ta ketë zënë furtuna papritur në Rrafshë? U përplas me vrull dera e jashtme e barakës dhe hyri Skënder Sula. Ai ishte bërë qull dhe breshri ia kishte përcëlluar faqet. Qëndroi përpara vajzës dhe nisi të fliste shatër-patrë, se po i merrej fryma;

— Dianë, tufat tona e të kooperativës së Bregajt i ka zënë furtuna në Rrafshë. Baca Selë dhe vëllezërit janë atje. Drejtori ynë... pika e kufirit... një repart ushtarak...

— Kuajt! — i tha ajo. — Shko shpejt e na gatit kuajt. Do të shkojmë bashkë. — Vajza i ktheu krahët. Mori çantat e mëdha, zgjodhi me qetësi barnat që mendoi se do t'i duheshin dhe doli. Në dhomën e saj veshi pantallonat, çizmet, golfën e leshtë, mushamanë dhe lidhi flokët mirë. Vuri kokoren, e shpalosi dhe e lidhi te qafa. Mendoi t'i vinte kalit një copë mushama nën shalë, por ndërroi mendje. Rruga do të ishte e vështirë dhe nuk i dihej. «Më mirë shala të jetë pa të,» — mendoi.

Kur ajo doli nga dhoma, Skënderi po e priste me të dy kuajt nën strehë. Ishte i zbehtë dhe nuk u rrehej fare shiut e breshrit.

— Shko e vishu, — i tha Diana. — Nuk po shkojmë në dasmë, de. Vishu mirë dhe merr ç'të mundësh për bacën Selë, për Rizanë dhe të tjerët. Shpejt!

Skënderi hyri në barakë. Ajo kontrolloi doriun e bardhë. Shtrëngoi mirë shalën, frerin, kaptellin, gjatësinë e yzengjisë. Pa se djali i kishte lënë të lira. I rregulloi edhe te doriu tjetër. Skënderi erdhi me gëzofin e madh prej lëkure qengjash, një mushama e një fëshfëshe. Me to kishte mbushur hejbetë.

— Rregulloji mirë dhe më ndiq! — i tha. Zuri frerin, vuri këmbën në yzengji e, me një kërcim të

rufeshëm, u hodh mbi shalën e kalit. I preku lehtë qafën e lëmuar që kullonte dhe tërhoqi frerin. E çoi kas mbi këmbët e para dhe «shpejt!» — i klithi djalit, i ra me kamxhik doriut që kërceu dhe e nisi fluturim me revan e me të katra në rrugën e gjerë mes fushës përballë erës së fortë të veriut. Ndiente vetëm trokëllimën mbi breshrin kokërrmadh nën thundrat e kalit. Po e ngiste pa frymë. Te kthesa nën ujëmbajtës rruga merrte në të majtë. Ajo, duke tërhequr frerin si e xhindosur, ktheu kafshën në galop e sipër dhe hodhi sytë pas. Skënderi po e ndiqte nja pesëdhjetë metra pas.

Kur doli në rrugën e Bregajt, pa në luginë stanet verore. Furtuna kishte hedhur përtokë kolibën e madhe të barinjve. Në një të përpjetë të rrugës kali e ngadalësoi hapin, por, sapo doli në rrugë të drejtë, ai e ndërroi vrapin në revan, ngriti egërsisht kokën dhe deshi ta kafshonte të zonjën në gjunjë. Si nuk ia arriti kësaj, ndehu qafën e gjatë, veshët i përkuli prapa dhe ajo pa kokrriza dëbore e akulli që shkëlqenin mbi majat e tyre. Ajo u përkul mbi kaptell, ndjeu gulçimin e kafshës, shikoi blaca shkume që i merrte era e fortë dhe i erdhi keq. Mendoj se kafsha mund të binte për të mos u ngritur më. Duhej të ecte më ngadalë, po fatkeqësia që kishte ndodhur atje sipër nuk të linte të bëje llogari.

Nisi një e përpjetë dhe ajo ndjeu trokun e Skëndërit që po i afrohej me një galop të çmendur. Sa erdhi pranë saj, e ngadalësoi ca hapin. Doriu i tij zevzek që në udhëtime të shkurtra nuk përmbahej fare, tani dukej i dërrmuar, mbytur në shkumë.

— Ke pasur donjëherë kalë në shtëpi? — e pyeti Diana. Djali e shikoi, po nuk i dha përgjigje. E la të ecte përpara dhe e ndoqi nga afër. Tani ata po ngjiteshin pjerrinës për në bjeshkë. Ajo e kishte menduar me kohë këtë rrugë. Po t'i ngjitej bjeshkës nga faqja e thepisur, do të vonohej dhe një pjesë të rrugës do të detyrohej ta bënte më këmbë, kurse këtej

vërtet rruga ishte ca më e gjatë, po do të dilte në ktraste të paktën nja një orë më parë.

Ajo vazhdoi të ecte në ngjitjen e fundit të malit. Skënderi e ndiqte fare pranë. Era i digjte fytyrën, quart dhe pjesët e gjunjëve, të cilët s'kishte si i mbronte me mushamanë që ia merrte era.

Binte borë me erë. Fjollat të ngjiteshin në fytyrë dhe nuk të linin të shikoje larg. Rasi dolën në majën e vogël, u hap përpara një lëndinë e bardhë ku bora kishte formuar një shtresë jo më të madhe se pesëmbëdhjetë centimetra. Diana mendoi se furtuna kishte qenë me shpejtësi të madhe dhe bora nuk kishte qëndruar. Ndaloi. Priti Skënderin, derisa ai i erdhi në krah. Fytyra e tij ishte nxirë nga të ftohtët, vetullat i ishin rënduar nga copa akulli, Ato i vareshin poshtë dhe ai dukej i shfytyruar. «Si qenka bërë! — tha me vete. — Po unë si jam bërë?» Ajo preku fytyrën, fshiu ballin, vetullat, sytë.

— Matanë gropës po ngjiten fshatarët! — thirri Skënderi.

— Ende s'paskan arritur ata?!

Djali e shikoi me njëfarë dhimbjeje. Nxori nga trasta një shishe konjaku dhe ia drejtoi të pinte. Ajo i tha që nuk e pinte, se i merreshin mendtë. Skënderi piu vetë, e futi shishen në trastë dhe nxori një kavanoz.

— Merr pak sheqer, se të bën mirë. E di si je nxirë?

Ajo nuk foli, futi dorën në kavanoz dhe e mbushi me sheqer.

— E dija që do të ecnim kështu, — tha djali. — Kur të lodhet kali, pak sheqer është dhuratë.

Dolën te Shkëmbinjtë e Muranave. Përpara Gropa e Madhe e thellë dhe e lartë, hijerëndë dhe e tmerrshme. Në pamjen e saj kishte diçka mes djepit dhe varrezës. Era solli krismën e një pushke. Diana mbajti frymën dhe shtrëngoi frerin. Pas pak edhe një krismë.

— Neri, — tha ajo, — ti do të shkosh brinjës, unë nga Rrafshi. Do të takohemi në Gropë. Po i gjete më parë, lësho dy krisma njëra pas tjetrës se orientohen vetë. — U ndanë. Fuqia e erës në Rrafshë ishte e përbindshme e doriu nuk i bindej më. Bora binte shkulme-shkulme. Rrafshet ishin ca livadhe të gjera kullotash të mrekullueshme për dhentë, që tani ishin bërë tas i bardhë që e lëpinte era. Në pjesën jugore të tyre ato zbritnin në vendin që quhej Gropat e Vogla e që ishin të mbrojtura nga era. Pastaj vinin honet e thella e të thepisura ku dhentë nuk futeshin dot. Nja pesëdhjetë metra larg ajo pa njësinë ushtarake që ecte në marshim. Një pjesë marshonte drejt Gropës së Madhe, kurse një pjesë po kthehej prej saj. Diana zbriti dhe e tërhoqi kalin drejt Gropave të Vogla. Kolona ushtarake e pa dhe po i vinte pas.

Si doli në breg, prej nga shiheshin Gropat e Vogla, ajo pa grumbuit e tufave që blegërinin dhe ishin struktur aty. Në faqen që zbriste teposhtë ajo pa aty-këtu dhen të ngordhura, të ngrira, që dukeshin si gurë të zbardhur. Ajo pa e tmerruar edhe tufat e strukura e të mbledhura grusht dhe u përpoq të dallonte barinitë. Pranë niërës nga tufat ishte Rizai që dicka bënte në këmbë, shikonte sa andej-këtej dhe shpesh ulej të merrte dicka. Lëviziet e tij ishin të paekuilibruara e të paqëllimshme si të nieriut që ngrihet në giunë. Aty afër rrinte ulur me kokën mes çuniëve plaku Selman. Fare pranë i rrinte çeni i madh i tufës. Kur Diana u afrua, çeni u shkund, tundi bishtin dhe përsëri çëndroi më hisht pranë të zotit. Edhe ai merrte pjesë në kobin që kishte ndodhur. Rizai na mblidhte dhentë e ngordhura. I tërhoqte zvarrë mbi dëborë, i therrte ato që i giente ende të ngordhura dhe i sillte aty në atë vend pranë tufave. Plaku po çante me ngashërim, tamam si një fëmijë. Ndoshta atëherë kur pa Dianën, ai u shkreh edhe më shumë.

— Bacë, si je? — e pyeti ajo.

— Mos qofsha! E shikon ç'na gjeti?...

Nga tufat e lopëve vetëm dy kishin rrëshqitur në honin e thellë, ndër dhen kishte mjaft ngordhje. Rizai i kishte shpëtuar vetë lopët, kurse me dhentë kishte qenë vetëm plaku. Rizai i kishte marrë me vrap tufat e lopëve dhe i kishte futur në Gropën e Madhe, pastaj, si kishte lënë njërin nga vëllezërit atje, kishte shkuar në ndihmë të plakut, por humbjet kishin qenë të mëdha.

— I numëruat, sa? — e pyeti Diana.

— Deri tani dyzet e tre, por nuk dihen me saktësi.

— Po ata të Bregajt?

— Ata i ka zënë matanë, në Përruan e Vogël. S'dihet fati i tyre.

Diana pa se disa nga dhentë, që ishin anash tufave të rrasura kokë më kokë, kishin rënë. Ajo mori çantën e madhe të barnave. Era aty nuk vinte me shumë forcë, bora binte më qetë dhe furtunës më shumë i ndihej zëri se prania. Temperatura sa vinte e zbriste.

— Nëse nuk do t'i kishit sjellë edhe këto këtu, tani nuk do të kishim asnjë, — tha Diana. — Do të kishin fluturuar të gjitha në greminë, pas së parës. Si i ka pritur baca Selë, këtë as që e marr me mend. Tufani ka qenë i tmerrshëm. A keni fishekë më, bacë?

Plaku e shikoi mospërfillës sikur vajza t'i fliste për një lodër.

— Ç'të duhet? S'hyn më në punë.

Ajo i tha Rizait të shtinte nja tri herë që njerëzit të vinin aty, se ushtarët dhe fshatarët po endeshin në Rrafshe në kërkim të tufave. Po nuk ishte nevoja. Njësitë ushtarak doli te Shkëmbinjtë e Muranave. Pas pak nga honet perëndimore të Gropës së Madhe vërshuan turmat e fshatarëve. Si erdhën dhe panë atë që kishte ndodhur, ua ngulnin sytë deleve të ngordhura të mbetura togje-togje të ngrira, ngushëllonin Selman Sulën dhe shprehnin gëzimin që njerëzit kishin

shpëtuar dhe kishin mundur të shpëtonin edhe shumicën e dhenve.

Me të ardhurit ishte edhe Tafë Danaj.

— Këto s'i lëmë, — tha ai. — Këto që na shpëtuan, do t'i çojmë shëndoshë atje poshtë. Edhe me krahë, po qe nevoja.

— Shoku Tafë, — i tha Rizai, — ju më mirë shkoni matanë te përroi ku janë tufat e kooperativës. Atje gjendja mund të jetë edhe më e keqe...

Tafë Danaj, i shkathët si gjithnjë, llogariti aty për aty forcat, i ndau më dysh. Një pjesë e mori me vete për te përroi, të tjerët do të zbritnin në fshat tufat e fermës, pa rënë muzgu. Tafë Danaj ende nuk i kishte kaluar Shkëmbinjtë e Muranave, kur doli një grup i madh njerëzish nga jugu i Gropave të Mëdha. Pas tyre, si në një zvarritje të ngadalshme, vinin lopët e fermës. Kishte nisur tërheqja e mundimshme e kafshëve.

Aty nga ora tre furtuna u fashit, qelli u çap vend-vende dhe udhëtimi u bë më i lehtë. Tani ata ishin në udhën e faqes që binte në luginë. Të gjithë mbarbnin mbi shpatulla, tok me bagëtitë e sëmura, dhimbjen e humbjes.

Plaku Selman Sula, që e bënte fajtor veten për të gjitha, nuk e ngrinte kokën. Rrinte kërrusur mbi doriun e Dianës. Vajza e tërhiqte vetë kalin për freri. Në doriun e Skënderit kishin vënë një nga lopçarët. Po Selmani rrinte kërrusur, gjëmonte e shfrynte kundër vetes.

«Medet ç'më dënoi kështu allahu! Medet! — thosh-te. — Mjerë unë, i mjeri, si e mbylla jetën... Mjerë unë ç'më gjetil!» Selman Sula tufat i quante të tijat, humbjen të tij. Kishte ruajtur tufa një jetë të tërë. Po ja, fatkobi e gjeti ditën t'i vijë... U turpërua me gjithë djem në këtë moshë. Kështu gjykonte ai. Ishte aq i dërrmuar sa nuk qëndronte dot mbi kalë.

Në një vend karvani qëndroi. Ai largoi gëzofin dhe

shikoi tufat përpara. Diana pa fytyrën e vrrarë, të zbeh-të, të hequr dhe i dha ca kokrra që t'i pinte.

Si arritën në xhade, Diana pa «Zisat» që kishin marrë kthesën dhe po pritnin me spondet ulur. Ndër to hipën gjithë bagëtinë e imët dhe i nisën për në stallet e fermës. Një pjesë e lanë karvanin e kooperativës, që po i ndiqte pas.

Selman Sula nuk pranoi ta dërgonin në spital. E çuan në shtëpi. Diana e përcolli vetë deri pranë shtëpisë dykatëshe të Druvarëve që tani përdorej për kopsht e çerdhe. Aty atë e morën djemtë. Mes grumbullit mbiu edhe Idriz Meta. Si e pa Selmanin mbi kalin e bardhë, Idrizi ia pat:

— E qullose, o i zi, qetash në pleqni. E ç't'u deshën nometë në Rrafshe, apo dole për hava?...

Plaku Selman rënkoj nga dhimbja. Fjala e Idrizit ishte më e rëndë se kafshimi i gjarprit. Trupj i tij i drobitur u mpak edhe më shumë. Diana i hipi doriut të vet dhe iu afrua Idrizit.

— E, more baca Idriz, nuk paske shkuar me shokët për tufat e kooperativës? — i tha. — Apo tani nuk të bën çapi tutje, se nuk je më kryetar!

— Ik, or çun, ik e thyej qafën, or drej! — Idrizi turfulloi me përbuzje dhe i ktheu krahët pa e njohur kalorësin me kokore e mushama.

— Ah, bacë, mor bacë, mbete rob i kryetarllëkut! — tha Diana, po ajo, ashtu si Selman Sula, e kuptonte se në fjalën tërë helm të Idriz Metës ishte e vërteta e hidhur dhe e rëndë për të gjithë. Idrizi nuk e kishte luajtur këmbën për t'u shkuar në ndihmë tufave të kooperativës dhe për tufat e fermës ia vinte fajin Selman Sulës.

— Mor po kush je ti që më gërmushesh kështu? — Idrizi u kthye dhe gati ia zuri frerin nga duart.

— Diana jam, Diana!

— Ah, ti më qenke! Shko tani e fryju tufave ra-core! Shko e yshti tani, shko!! E gjen nga perëndia atë që nuk e gjen dot nga njerëzia...

Diana i ra kalit dhe Idrizi u tërhoq mënjanë. Vajza shpejtoi të zinte tufën e gjedheve të fermës që po kalonin ujëmbajtësin drejt sektorit.

Dy ditë më vonë gazeta lokale botoi artikullin «S'ka ç'na bën breshri», ku autori e krahasonte beshrin me bllokadën imperialiste e revizioniste. Pastaj u botua në Zërin e Popullit shkrimi «Barinjtë», ku flitej për Selman Sulën, për kujdesin dhe dashurinë për tufat e fermës, për kujdesin dhe dashurinë ndaj djemve e nipave të tij barinj.

Po Selman Sula s'po kthehej më në tufat e fermës. Ai nuk po dilte as nëpër fshat. Që nga ajo ditë dergjej e vuante në shtresa. Nuk hante, nuk pinte. Po tretej plaku, brerë nga turpi e dhimbja, pa ua vënë veshin fjalëve që thoshin për të gazetatat. Le ta përshkruanin stuhinë si të donin, e dinte ai si ishte breshri e furtuna. Vetë ai e dinte si ta këput shpirtin delja që bie pikë në vend. Ato që kishte parë ai, nuk tregoheshin. Në të vërtetë ai artikulli i Zërit të Popullit që, në vend të tregonte beshrin dhe furtunën, bënte fjalë për Selmanin dhe djemtë, ishte balsam për të. Si u larguan të gjithë nga shtëpia, ai i bëri shenjë mbesës, «çikës së Rizait», dhe i tha ta lexonte edhe një herë atë gazetën se çfarë thoshte për barinjtë. Vajza ia lexoi, plaku psherëtiu dhe i tha t'i gatiste një kafe.

Një ditë Zëri i Popullit erdhi si era e ngrohtë në kullën e Selman Sulës. Një lajm me shkronja të mëdha tregonte se si tri kooperativa të Vlorës ishin zotuar t'i jepnin vëllazërisht kooperativës së Bregajt, fermës dhe dy kooperativave të tjera dhen, dhi, lopë. Ndihma do të dërgohej menjëherë në vend me mjetet e tyre. Selmani nuk dinte t'u jepte dum punëve. Në vend që ta shanin, siç bëri Idriz Meta, e lavdëronin, bile e nxirrnin në gazetë atë, djalin e madh, të voglin dhe Skënderin. Ngordhnin lopët, ngordhnin dhen-

të, pësonin gjithë atë farë humbjeje, kur «fap na ngrihen kooperativat e Vlorës dhe marrin dhentë e tyre, lopët e tyre, dhitë e tyre dhe vijnë e na i sje-llin këtu. Po kjo?».

Komiteti i Partisë i Rrethit dërgoi tok me lajmin e Zërit të Popullit edhe instruktorët që të përgatitej pritja. U krijua një atmosferë feste për pritjen e vëllezërve vlonjatë.

Ata erdhën një pasdreke. Ishte një radhë makinash ku dëgjoheshin blegërima. Disa qëndruan në sektorin e blegtorisë, të tjerët në Bregaj dhe Shkemzë.

Besim Përdri, që gjithë kohën ishte marrë me shpërndarjen e bagëtive, me ndarjen e barinjve vlonjatë nëpër familje, u kujtua vonë për Selman Sulën. Ishin përpara zyrave të Bregajt tok me Skënderin dhe Dianën,

— Po babai ku është? — e pyeti Besimi.

Skënderi i tregoi fije e për pe atë që po ndodhte me të anë. Besimi tha se donte ta takonte. U fut në zyrë dhe foli në telefon me radion lokale dhe e pyeti në e kishin transmetuar artikullin «Barinjët», u tha se e donte puna që në rubrikën e lajmeve të transmetohej ky shkrim aty nga ora shtatë e më pas.

Selman Sulën e gjetën shtrirë në shtresa. Besimi, Tafa, dy barinj vlonjatë, Diana e mbushën shtëpinë, por Selmani nuk e ngriti kokën. Tafa dhe dy pleqtë vlonjatë i thanë fjalë të ngrohta, bile i thanë se ishte zotësia e tij që kishte shpëtuar tufat nga shfarosja e plotë.

— Jo, — tha Selmani me zë të lartë e të plotë, — fajin e pata unë. Unë i vonova tufat e dhenve, se djemtë më thirrën. Ata i mblodhën me kohë tufat e tyre. Shenjat e stuhisë ata i diktuan përpara meje, por hajt...

— Baca Selë, këto që të thonë miqtë, janë të vërteta, — i tha Besimi. — Kështu mendojnë edhe shokët e Partisë, e ka thënë edhe gazeta.

Ora ishte shtatë e darkës. Besimi i tha Skënderit të hapte radion. Në dhomë u lanë bisedat një çast dhe

spikerja lexoi lajmin për ndihmat vëllazërore të kooperativave të Vlorës. U dëgjuan intervistat, pastaj u lexua artikulli. Selmani e dëgjoji deri në fund. Të gjithë heshtnin. Plakut filloi t'i çelej fytyra.

— Miqtë do të qëndrojnë, nëse ti ndihesh më mirë,
— tha Tafa. — Përndryshe, baca Selë...

Plaku ngriti kokën i shqetësuar.

— Skënder, bir, na gatit darkë. Për këso miqsh, edhe i vdekur çohem unë. Më falni, burra, por zemra e lodhka njerinë dhe e shtrika përtokë, zemra e ngri-ka fluturim... — U ngrit ndenjtur. U vesh. Lidhi brez-in. Veshi xhamadanin dhe u ul rrafsh. Skënderi i tha se darkën po e gatiste Rizai, ndërsa ai vuri xhezven për kafe.

...Të nesërmen Besimi e pa plakun Selman, kur kishte dalë të përcillte miqtë vlonjatë. Ishte tok me gjithë fshatin. Gëzonte. Qeshte, I përqafoi ata nje-rëz që nuk i kishte parë kurrë veç dy ditëve në jetë, bënte edhe ndonjë shaka. Po në shtëpi nuk u kthye. Ai qëndroi aty në kryqëzim mes një grumbulli të vogël njerëzish, pranë Dianës dhe të birit. Besimit i zuri veshi fjalët, kur plaku iu drejtua Dianës plot gëzim:

— Doktoreshë, moj bijë, si u bë puna kështu, ë?

Ajo nuk i foli. Shikoi Besimin dhe u duk sikur do të thoshte: E ngritëm bacën. Po edhe ajo ishte vrarë shpirtërisht nga katastrofa. Kur makinat u nisën, në rrugë mbeti vetëm xhipsi i komitetit të partisë me shoferin e ri flokëverdhtë, Merimanin. Diana e shikonte me frikë xhipsin. Ai do t'ia merrte Besimin. kurse ajo donte të rrinte akoma me të. Nuk arriti të çma-lllej, sepse ndenjën pak bashkë.

Ja, Besimi iu afrua. Takoi shokët dhe u tha se dō të shkonte me dy instruktorët e tjerë në Lken dhe në Shkemzë... Diana u mërzi. Ajri ishte i ashpër dhe i ngrirë. Në qiellin e mbyllur era çante retë duke zbu-luar lugina të kaltra.

— Keni shumë punë andej? — e pyeti ajo, pa ia lëshuar dorën.

— Kemi ca, — i tha Besimi, po sytë nuk ia hiqte.
— Dëbora ka zënë disa hektarë me patate nën dhe,
do të shikojmë në vend furnizimin dhe rrjetin e treg-
tisë. Po unë do të kthehem...

— Kur?

— S'e di. Do të përpiqem... — Ai vuri buzën në gaz dhe u shkëput prej saj. Xhipsi kishte qëndruar aty afër dhe Merimani po u thoshte dy instruktorëve se ia kishte frikën një dëbore të re. Xhipsi do të shkonte në fillim në Lken, atje do të linte njërin nga instruktorët, pastaj në Shkëmbë ku do të linte të dytin. Besimi do të shkonte në fshatin Brinjë për patatën. Në të vërtetë Brinja ishte vetëm një sektor i kooperativës së bashkuar, po ishte sektor që izolohej nga bora dhe duhej kontrolluar veçanërisht furnizimi i dyqaneve, masat e marra, se relacionet dhe raportet e kryesisë së kooperativës, të këshillave thoshin se çdo gjë ishte mirë, po shifrat nuk thuheshin. Bile edhe vetë ata të tregtisë nuk mund të thoshin saktësisht se si ishte gjendja e magazinave dhe e dyqaneve për periudhën dimërore në Brinjë.

Përsëri binte borë, një borë e qetë, tinëzare. Ata po ktheheshin për në qendrën e lokalitetit nëpër rrugën pyjore dhe xhipsi rrëshqiste sa andej-këtej. Shoferi ishte i shqetësuar. Qëndronte vazhdimisht i përkulur mbi timon dhe ndizte e shuante shpesh projektorët që të dallonte më mirë anët e rrugës. Nuk fliste. Ndoshta ishte penduar që u nisën, por në fillim ai vetë nguli këmbë që të niseshin natën për në qendrën e lokalitetit. Tani i trembej borës që po binte dhe rrugës së ngushtë pyjore. Po edhe faj nuk kishte, se mund të binte dhe mund të bllokohej rruga e të mbeteshin në vend. Kur drita binte mbi trungjet e lisave, flokët e borës dukeshin si tufa fluturash që të merrnin mendtë.

Kaluan një përrua dhe rruga nisi të zbriste në pjerinën e malit. Xhipsi rrëshqiste dhe shoferi e merrte me shpejtësi nga ana e malit.

— Ki kujdes, Meriman, — i tha Besimi.

— Mos u tremb. Ridotën e kam të re, — tha Merimani. Tani rruga ishte gati e drejtë, paralel me lokalitetin, por ishte pyjore, e ngushtë e disa herë e pjerrët që merrej me zor. U futën përsëri mes lisash. Degët po ngarkoheshin mirë nga bora që binte.

— Man, përse na ndodh që, kur tregojmë për diçka të bukur, mendojmë gjithnjë borën? — e pyeti ai shoferin.

— S'e di, — tha Merimani. U mendua ca, derisa mori një kthesë, pastaj tha: — Një fjalë e urtë thotë: Edhe bora është e bardhë, por e ndyjnë qentë. Për mua është e mërzitshme. Asëll-asëll... — ai qeshi, — e di që s'më pëlqejnë gjërat e bardha? Vetëm nusen dhe qelshen i dua të bardha, të tjerat jo!

— Je i martuar?

— Jo. Po ju, shoku Besim?

— Mos më thirr «shoku Besim». Unë të thërras me emër.

— Zakon, s'ke ç'i bën. Je i martuar?

— Jo.

— Qenkemi të dy për t'u kënduar. — Merimani qeshi. Po sytë nuk ia ndante rrugës së bardhë. Në ngjitjen e faqes së një përroi rruga ishte mbushur plot me dëborë. Xhipsi qëndroi dhe nisi të bënte xhiro në vend. Ridota e famshme s'bënte punë. Ata zbritën të dy. Merimani nxori lopatën dhe filloi të merrte dhé nga skarpati i rrugës. Pastaj hipi mbi timon dhe i tha Besimit ta shtynte makinën. Besimi e shtyu me të gjitha forcat, makina rrëshqiti drejt anës së rrugës dhe frenoi. Merimani zbriti përsëri. Ai tha se mund të bënin një pritë me degë lisi dhe ta shtroinin më mirë pjesën e rrugës. Shkuan të dy dhe mbushën duart me vandakë degësh lisi. I shtruan përpara rrotave dhe Merimani i tha se duhej shtyrë me kujdes nga ana e greminës që ta merrte kthesën në mes degëve të lisit. Ai e shtyu fort dhe makina, si u ndez, iku me shpejtësi dhe nuk ndaloi më deri mbi shpinën e kodrës. Besimi e ndoqi më këmbë, por u djersit. Fajin ua vinte palltos dhe dy trikove të leshta. Njërën e kishte pa mëngë si punë jeleku, tjetrën me mëngë e kishte, por mëngët ishin të holla si prej bezeje. Kështu i kishte punuar e ëma.

Merimani qeshte. Ishte më qejf.

— Po bien petulla nga qielli, — tha ai. — Bukur, ë?

Po Besimi tashmë e dinte se sa e bukur ishte bora për të si shofer, derisa i krahasonte flokët e borës me petullat.

— E shoh. Nisi erë.

— Ia kam frikën kësaj. Ta mbush rrugën dinga dhe hajde e hape pastaj.

U nisën. Tani po udhëtonin në anën e këtejme, nga binte Pllaja. Era ishte e lehtë, po bora ishte grumbulluar vende-vende, ashtu si e parashikoi Merimani. Xhipsi çante mes saj si i tërbuar duke e hedhur pa rregull si pluhur. Po ndodhte edhe që nuk e çante dot.

Atëherë kalonte mbi të, kërcente në tabanin e rrugës si karkalec, ndërsa Merimani shtrëngonte timonin me sytë katër. Mes mjegullirës së dëborës dolën konturet e Pllajës. U dukën dritat e lokalitetit në të djathtë. Ato të sektorit të blegtorisë ishin përpara. Pllaja dukej sikur flinte. Po nuk ishte kështu. Dritat elektrike të fshatrave llamburitnin sa andej-këtej.

Hynë në një përrua të thellë. Kaluan urëzën dhe Merimani e mori me shpejtësi rrugën në faqen tjetër.

— Këtu paska shtruar mirë qëneja, — tha ai.

— Ku jemi këtu? — e pyeti Besimi.

— Në Kastor. Këtu afër është një grumbull shtëpish që quhet Kastor. Ke dëgjuar për të?

— Jo.

— Unë kam miq këtu në Kastor. Po të duash ti, kthehemi sonte këtu...

— Jo, ecim.

Nuk ecën dot shumë, se nuk i la bora. Në një vend të zhveshur me ara e livadhe rruga nuk dallohej më. Ishte bërë dyst deri në skarpatet e sipërme dhe s'merrej vesh ku ishte rrugë, ku ishte arë e ku livadh. Merimani frenoi. Dritat i la ndezur. Zbritën. Në qetësinë tinëzare të natës dëgjoheshin vetëm ulërimat e qenve.

— Shoku Besim, këtu s'kalohet, — tha Merimani.

— Si t'ia bëjmë?

— Unë po gjej rrugën, ti më ndiq me xhips, — i tha Besimi. — E gjithë rruga s'do të jetë kështu.

— Këtë s'e ha dot xhipsi.

— Po ai ka ridotë, — qeshi Besimi. Po Merimani nuk qeshi. Sigurisht atij i punonte mendja për keq. Besimi u fut në dëborë dhe pati një ndjenjë kënaqësie. Sikur të mos ishte ftohtë, do të lozte ashtu në dëborë deri në mëngjes. Një qen diku ulërinte për tmerr. Pastaj një tjetër.

Si doli në cektinë, thirri Merimanin. Makina u vërsul si e harbuar mes bardhësisë. Eci ca metra, zhyti

turirin në borë dhe qëndroi. Projektorët ishin zënë nga bora dhe nata shtriu krahët e vet të zez e të padukshëm mbi të. Merimani i dha pas dhe projektorët hodhën dritën e verdhë përpara.

— Është e kotë, shoku Besim. Si do t'ia bëjmë? Është bela ta lëmë këtu. Kush më siguron se nuk ma qethin nesër? Ë, si thua?

Besimi u shkund. Përplasi këpucët me qafa te rrota dhe hyri në makinë. Tjetri i kishte varur turinj të, por nuk po shante më. Besimi nxori paketën dhe ndezi cigare. Përtej përroit ishte sektori.

— Meriman, ti the se sektori i blegtorisë nuk mban më shumë se pesëmbëdhjetë minuta, kështu? E di rrugën e përroit?

— E di, po sa para bën.

— Mbetëm se mbetëm, a shkojmë tok në sektor? Nesër vijmë herët këtu.

— Më mirë shkojmë te miqtë e mi.

— Edhe unë kam miq në sektor. E njeh zooteknikun? Atëherë po ndahemi. Ti shko te të tutë, unë te Skënder Sula. Nesër nga ora gjashtë më ke këtu.

— Si të duash. Zemra ma thotë të vish në Kastor.

— Eja e më trego rrugën deri te përroi.

Merimani e shoqëroi deri te bregu i përroit. I tregoi rrugën dhe e porositi të mos i humbiste nga sytë dritat e sektorit, sepse mund të ngatërronte rrugën e të largohej. U ndanë aty në breg.

...Rruga e përroit nuk kishte shumë borë, se era e kishte hedhur në faqen tjetër, por frynte ca dhe temperatura ishte ulur shumë. Në faqen tjetër rruga këmbësore bënte ca kthesa. Ai u përpoq t'i priste ato, por i doli më gjatë. Rrëshqiste dhe kapej në degët e dushkut. Me zor e arriti bregun. Tani përpara kishte stallat e sektorit. Dy më të afërtat i kishin ndezur dritat dhe ndriçimi i tyre i zbehtë dilte nga dritaret e derdhej mbi borën e fushës.

Ai bëri ca hapa drejt barakës së parë. Në kënd, as tridhjetë metra larg tij, mes atij ndriçimi të zbehtë

ai shqoi njolla të zeza që rrinin më bisht, më këmbë, me qafën drejt qiellit, disa hije hidheshin laradashas nëpër borë. Pastaj ai e pa më shkoqur kur njëra prej njollave u lëshua turravrap drejt tij. Ishte një grigjë e vogël ujqish, ndoshta familje, ndoshta fis.

Ai nxori pistoletën. Tërhoqi mashën dhe shënoi, por fisheku i parë shkoi kot. Ai u drodh. Vetëtimthi shqoi sytë flakërues të ujkut që po vinte drejt tij. Pa se po afroheshin edhe të tjerë me kërcënime. Po atë më të afërtin e qëlloi përsëri. Shtaza u tërhoq. Besimi qëlloi për të tretën herë. Ajo ulëriu, u rrotullua dhe u shemb mbi borë vetëm pak metra larg tij. Të tjerët, sapo ndien erën e gjakut, u vërsulën mbi të dhe e copëtuan. Një ujk i madh sa një viç po vinte me kërcënime nga krahu i majtë. Besimi drejtoi pistoletën vetëtimthi. Dalloi qafën e kreshpëruar, shtrirë përpara. Pa se edhe dy të tjerë po rrinin ballas si në pritje dhe nuk merrnin pjesë në gjellën e neveritshme që po e shijonin familjarisht. Ujku i fuqishëm kërcëu si shigjetë, Besimi pati kohë vetëm të ngrinte bërrylin e krahut të majtë dhe ta shkrehte pistoletën në gojën e tmerrshme që po i shqyente krahun. Krisma doli si ajo e një shuplake. Egërsira ra pikë në tokë, Besimi kërcëu disa hapa më tutje drejt barakës. Dy të shtëna nga dritaret e stallës së parë. Njëri nga të dy ujkit që kishte përballë u palos. Tjetri u përkul mbi të dhe pas pak ra. Grigja u lëshua mbi ta, po pushkët qëlluan përsëri. Ai qëlloi me pistoletë, ndërsa tërhiqej drejt stallës, pa ditur se ku e nga binte dera e saj. U kujtua se karikatori po sosej dhe tjetrin e kishte në xhepin e majtë. U përpoq ta nxirrte karikatorin, pa lëvizur pistoletën nga shenja, po krahu i majtë i ishte mpirë keqas. Ai nuk komandohej. Duke ecur anës murit, ai kishte arritur te dera e stallës:

— Selman! Hape derën, Selman! — thirri dhe u ngjesh te dera. Shtrëngonte pistoletën dhe padashur e shtynte aq shumë derën, saqë, kur ajo u hap, ai

nuk u mbajti dot, dhe u rrëzua brenda në korridor, pa lëshuar armën, pa ia hequr sytë derës. Dy stallierët që i kishin hapur derën, zgurdulluan sytë.

— Qyqja, si shpëtoi ky njeri! — tha njëra, një thatanike e moshuar.

— E paskan copëtuar në krah, — tha tjetra, duke i prekur krahun e majtë të mënga e shqyer, ku bora skuqte.

— Nga vjen kështu, mor i zi? — e pyeti thatanikja.

— Ku është baca Selman? Po Skënderi, Diana? — Besimi ndjeu t'i erreshin sytë.

— Shpejt, moj qyqe! Si e humbëm kështu? Shpejt të thërrasim Danën.

— Shko ti, Mynibe, e thirre Danën, unë kam frikë...

— Qyqja, moj! Pse unë s'kam frikë?

Besimi mbajti vesh, por pushkët kishin pushuar, vetëm ca hapa po afroreshin nëpër borë frrap-frrap. Kërciti dera. Hyri brenda Selman Sula, skuqur e nxirë nga acari. Pas i vinin dy barinj të tjerë të armatosur.

— Medet, kush qenka! — tha. — Si dreqin kështu?!

— Ai pa i tronditur krahun e gjakosur dhe u tha dy barinjve ta çonin te Diana. Njëri, ai më i vjetri, me peliçe të dalë ngjyre, tha që ta thërritnin Dianën aty. Po Selmani i tha ta zinin Besimin për krahësh.

— Vij vetë, — qeshi Besimi. Bariu më i ri tha:

— Qenka trim, për besë! — dhe shikoi Selmanin.

— Hë, more bir, — iu drejtua Besimit, — më duket se po të sillet rrotull miza. Dy herë të doli pushka ime në shteg, të tretën si zor të më kesh afër...

Po Besimi ishte i hutuar, i mpirë. U nisën drejt barakës së Dianës.

Hynë në një zyrë të barakës përballë. Ishte ngrohtë. Një divan dërrase që, me sa kuptohej, përdorej edhe si krevat, tavolina mbushur me libra. Erdhi Skënderi dhe tha se duhej të shkonin në «laboratorin-farmacit». Atje Skënderi e zhveshi dhe i lidhi krahun që t'i pushonte gjakun. Pastaj nisi t'ia pastronte plagën.

Kur u duk Diana te dera, Skënderi po i hidhte mbi plagë një lëng të bardhë që e bëri plagën të shku-mëzohej. Diana ngriu. Hoqi shallin e bardhë ku ende xixëllonin kristale të rralla dëbore. Deshi të thoshte diçka, të bënte një hap, por nuk mundi, se iu prenë gjunjët. Selmani e zuri për krahu dhe e la te karrigia pranë sobës. Erdhi Merimani me një grup pushka-tarësh të Kastorit. Ai u afrua, pa plagën në krah, shau fatin ose ujqit dhe shkoi e u ul pranë sobës te Diana. Ajo nisi ta pyeste për hollësira; si u ndanë, si erdhën, nga erdhën, por Merimani nuk ia kishte ngenë. I hodhi një sy Dianës, si ai që mendon a ia vlen t'i lidhësh dy fjalë me këtë vajzë dhe iu përgjigj pa qejf. Besimi e ndoqi ca çaste, ndjeu dhimbje në krah dhe nuk mori vesh se si vazhduan ata të dy.

— Vetë e pati fajin, — u dëgjua zëri nervoz i Merimanit. — Donte të vinte te barinjte. Nuk erdhi me mua në Kastor, po te zootekniku. Naa, tani! Ja ku e ke zooteknikun, i pafsh hajrin, po ta mballos mirë krahun. — Ai vazhdonte ta qortonte Besimin, por në të ndihej dashuria dhe dhimbja.

Diana u ngrit dhe nisi të ndihmonte Skënderin në pastrimin dhe lidhjen e plagës. I ndaluan gjakun dhe ia lidhën mirë.

— Te ne në uzinë bie borë gjithnjë, po ujqit s'gu-xojnë të na afrohen, veç më të rrallë. kurse këtu te ju sikur më pritnin mua, — qeshi Besimi, por Diana i kuptoi ndryshe fjalët. Kur ata të tierët u afruan dhe nisën ta pyesnin vetë se si ngjau, si luftoi me ujqit. Diana ndërhyri dhe tha se duhej ta nisnin me-njëherë për në spitalin e lokalitetit për një mjekim më të mirë e më të sigurt. Tok me të sëmurin, duhej të shkonin edhe disa nga pushkatarët, sepse ujqit e tierë po silleshin nëpër fushë dhe mund të kishin punë përsëri me ta, kurse plagën nuk mund ta linin deri në mëngjes në atë gjendje e me atë kurim që ki-shte bërë ajo me Skënderin. Ajo u nis bashkë me ta. Merimani do të shkonte në Kastor dhe, sa të hapej rruga, duhej të vinte e ta merrte Besimin me xhips.

KAPITULLI I NJËZETENËTË

Dy pushkatarët e Kastorit, Diana dhe Besimi po udhëtonin të heshtur përmes dëborës.

Kur dolën te kthesa, ku rruga merrte për në lokalitet, veriu pushoi, por bora kishte ngrirë dhe kër-ciste nën këmbët e tyre. Pas pak filloi të zbardhte. Mbi ta rëndonte qielli i hirtë, i ngrirë, që çahet aty-këtu e kullohej nga retë. Pllaja farfurinte nën një shkëlqim ngjyrë vjollce. Po të frynte jugu, mund të zbutej ca e mund të mbaroheshin parcelat e misrit mbetur në kapula.

Një nga pushkatarët, ai më i gjati, i fliste tjetrit për këtë. Tjetri ishte një shkurto truplidhur mustaqe-bigë, nga ata që e heqin veten më të madh. Pushka i dilte sipër supit si një shkop.

Diana herë-herë zgjaste dorën dhe i mbulonte gjurin Besimit me kindin e palltos.

— Kujdes dorën, se po ta kap era, — i thoshte ajo. Po ai nuk kishte mundësi ta mbronte nga era. Palltoja hapej përpara vazhdimisht.

Kur dolën në rrugën e spitalit, u dukën disa njerëz që i pritnin. E futën në sallën e mjekimeve dhe aty ia zgjidhën krahun. Besimi ndjeu dhimbje dhe të ftohtë. Diana i tregoi kirurgut si ia kishin mjekuar atje.

Kot e bëtë të madhe, — tha mjeku, — s'paska gjë me rëndësi. Megjithëkëtë duhet çuar tek i zoti i punës në qytet...

Telefoni i spitalit binte vazhdimisht. Kryeinfermie-

rja erdhi e i tha kirurgut se buldozeri ishte nisur me kohë dhe rruga po hapej. Herën e dytë në telefon kërkuan vetë mjekun. Ishte Vasil Kushta. Mjeku i tha se do ta nisin, sa të hapej rruga. Pa u kthyer mjeku në sallë, telefoni ra prapë. Ishte dikush nga uzina. Plagët ia mjekuan dhe ia lidhën mirë. Mjeku i tha Dianës se ia kishin dhënë mirë ndihmën e parë. Pastaj shkuan në dhomën e mjekut, ku ishte edhe telefoni. Derisa zbardhi mëngjesi, Besimi foli në telefon me Andrean, Demën, babanë dhe u tha se ishte bërë zhurmë e kotë. Tani priste Merimanin dhe do të zbriste poshtë në mëngjes. Aty nga ora pesë e gjysmë doli në telefon Drita. Besimi i tha të shkonte në punë dhe të mos merrej me gjepura. Ishte mirë dhe të mos bënin zhurmë kot.

Merimani arriti me xhipsin e komitetit në orën gjashtë e çerek. Dolën nga dhoma e ngrohtë e mjekut.

— Po të ketë vend në makinë, do të vij me ty, — i tha Diana me zë të pasigurt.

— Pa të shikoj mos na i ka zënë vendet me fshatarë Merimani... — Ajo qëndroi. E shikoi heshturazi.

Besimi i bëri shenjë Merimanit dhe e porositi të ruante një vend për doktoreshën.

— Akoma kujdesesh për dynjanë ti, or lumëmadh? — ia priti Merimani. Ai ishte bërë nervoz me dikë atje pranë makinës. Dy pushkatarët e Kastorit kishin zënë vend brenda. Kur dëgjuan Besimin që porosiste Merimanin, mustaqebiga sedërli hapi derën e xhipsit dhe zbriti. Nuk pranoi të hipte më në xhips. S'donte të ulej pranë Dianës.

— Do të të çoj ku të mora, — i tha Merimani. Mustaqebiga erdhi dhe u struk me zor pranë Dianës.

Në fillim xhipsi eci ngadalë, po, kur doli e përpjeta përpara, Merimani i tha Besimit të mbahej se do ta merrte me shpejtësi dhe mund të lëndonte krahun. Rruga e hapur ishte ngjeshur nga skodat dhe kishte ngrirë e bërë xham. Siç thoshte Merimani, ajo duhej të merrej vetëm me shpejtësi.

Në Kastor zbritën dy pushkatarët. Shkurtoja mu-
staqebigë rregulloi rripin e pushkës dhe ajo u duk
sikur u zgjat edhe më mbi supin e tij. Nderoi me
grusht dhe nuk lëvizi derisa u nis makina. Kur dolën
në Qafë, aty ku nisnin kthesat e zigzagët që zbritnin
tek ura e re e liqenit, Besimi ndjeu se po frynte ju-
ga. Era e ngrohtë, e lehtë bridhte rrahjeve e brigjeve,
puthte çukat e kodrave, çlodhej në lëmueshmërinë e
liqenit të ri, ndillte këngë dhe ta mbushte zemrën
plot me dashuri për jetën. Ai e mbante kokën te
dritarja dhe e ndiente ëmbëlsinë e jugës ashtu siç
ndien njeriu frymën e nënës që i rri mbi kokë. Be-
simi nuk lëvizte si i dehur prej jugës.

— Kujdes nga era, — i tha Diana. Ajo ishte pas
tij dhe ai ndjeu frymën e saj. U kthye, i buzëqeshi
dhe u çudit kur pa se ajo ishte e zbehtë, e hequr
në fytyrë. Ai u kthye pas dhe u përpoq që t'i shkon-
te sa më afër.

Xhipsi kishte kaluar mbi ujërat e liqenit dhe ki-
shte marrë rrugën e asfaltuar drejt qytetit. Doli te
një zabel, kaloi anash me shpejtësi dhe hyri në oborrin
e spitalit. I ra borisë që t'i hapnin rrugë dhe qëndroi
te shkallët e urgjencës. Kur po hynin aty, dikush e
ndaloi Dianën dhe e pyeti se ku shkonte. Diana i tha
se mjekimin e parë ia kishte bërë vetë dhe donte të
ishte aty deri në fund.

Te dera u dëgjua zhurmë. Andrea Rajta, që kishte
ardhur menjëherë aty, po i lutej infermieres që ta
linte të hynte. Një tjetër se çfarë i tha infermieres
dhe ata qeshën. Ishin shumë. Infermierja u zemërua,
u mbylli derën me zhurmë. Erdhi brenda dhe i tha
kirurgut:

— Janë punëtorë të uzinës. Kanë ardhur për këtë.

— Mos lër njeri. Ç'e bëmë këtu, miting? — tha
kirurgu.

Besimi tani ndihej keq. Krahu ishte enjtur shu-
më pa u ndier. I kishte hipur temperatura. Ai kujtoi

erën e freskët të jugës që i pëlqente dhe e fuste në ëndërrime kur po uleshin në faqen e këtejme të Qafës. Gjunjët i ndiente të prerë. Donte të shtrihej e të flinte. Përjashta po bëhej zhurmë dhe kërciste vazhdimisht dera. Më në fund Andrea ia arriti të bindte infermierën. Ai hyri brenda. Qëndroi pranë Dianës dhe e pyeti atë, ndërsa kirurgu vazhdonte punën e vet me krahun. Pastaj kirurgu u kthye nga Diana dhe i tha se Besimi kishte humbur shumë gjak, ndihma e parë i ishte dhënë me vonesë. I tha infermieres të njoftonte gjendjen e analizave, të përcaktohej grupi dhe të bëhej gati për transfuzion gjaku. Infermierja u largua menjëherë.

— Doktor, — tha Andrea, — po qe nevoja për ndonjë grup gjaku, dhurojmë ne... Jemi nja pesë-dhjetë veta. Po deshët, niseni me mua. Në mos njëri, tjetri do ta ketë grupin e Besimit.

Kirurgu e mati me sy.

— Ndoshta s'është nevoja, — tha ai. — Ju e keni bërë ndonjëherë analizën e gjakut.

— Kush punon në konverte, gjakun e ka veç një grup, zero, — tha Andrea. — Ja, provojeni tek unë, po s'më doli njësoj me të Besos.

Besimin e çuan lart në pavijon dhe Diana me Andrian shkuan tok me të.

Në sallën e reanimacionit Besimi e ndjeu veten edhe me keq, iu morën mendtë dhe kërkoi vetë ta shtrin. Diana dhe Andrea nuk u lejuan të hynin. Një infermiere erdhi dhe tha se pacienti e kishte grupin A+B dhe nga ky grup nuk kishin rezerva.

— Kontrolloni listën e dhuruesve dhe shikoni se keni atë shokun e uzinës. Më duket ai e ka zero. Po keni edhe të tjerë në oborr, — tha kirurgu. Hyri një infermiere tjetër dhe tha se në korridor kishin hyrë prindërit dhe disa nga shokët e tij të uzinës. Erdhi përsëri infermierja që merrej me analizat e gjakut dhe tha se kishte gjetur një dhuruese gjaku me grupin që kërkohet. Pas shpinës së infermieres Besimi pa De-

linën, vajzën e metalurgut Din, vajzën e kompresorëve.
Dy sytë e butë si kadife e shikonin plot dhimbsuri.
Kirurgu po i qepte muskulin, Besimi nuk ndiente gjë.
Krahu i ishte bërë si kërcu. Vetëm nga lëvizjet e mjekut,
Besimi e kuptonte se ai po vepronte me shpejtësi.
Ende pa mbaruar punë kirurgu, sollën një sasi gjaku
dhe aparatën për t'i bërë transfuzionin. Ai shikoi tej
dritares retë e largëta që shtyheshin drejt veriut. Mes
tyre e largët si ëndërr e bardhë shfaqej Delina, shoqja
e vogël e lagjes nr. 1, lagjes së metalurgëve dhe minatorëve.
Gjaku i saj po vërshonte në damarë...

KAPITULLI I TRIDHJETË

Qyteti dukej sikur flinte nën një ndriçim të bardhë, të ftohtë, të neontë. Por vetëm dukej, sepse aty-këtu qëndronin ende ndezur dhjetëra drita ku bulonte jeta e familjeve. Njerëzit rrinin zgjuar në orët e vona, sepse kështu është ndërtuar bota, me dertë e qejfe dhe dertet e qejfet s'janë njësoj.

Në vilën nr. 33 të lagjes së ngritur me punë vullnetare, në katin e parë, në kuzhinën e ngrohtë punonte plaku gjashtëdhjetëdyvjeçar Bektash Sella. Në kuzhinën komode ishte ngrohtë. Ai vazhdonte të shkruante kujtime nga lufta.

Ishte gjashtëdhjetë e dy vjeç. I lodhur. E ndiente se duart sa vinte e po i rëndoheshin më shumë. Po kishte një dëshirë: të jetonte derisa të hidhte në letër edhe kujtimet e fundit. Prandaj punonte me këmbëngulje.

Në lagjen nr. 4, banesa 13, shkalla e dytë, kati i tretë, apartamenti nr. 7 i zoti i shtëpisë, Kurtish Kukaj, kishte pirë shumë dhe tani ishte në ëndërr e në zhgjëndërr. Kishte pirë, sepse i kishin komunikuar zëvendësimin në punë me një inxhinier pyjesh. Por ëndrrat e tij nuk kishin fare lidhje me punën e re në njërin nga sektorët e komunales, jo! Ato lidheshin me përmbytjen... Ai ndodhej i shtrirë në breg të lumit, ndërsa liqeni vinte i furishëm disa metra i lartë e i llahtarshëm. Kurtishi ishte gati të ulërinte nga tmerri, por zëri nuk i dilte. Përpëlitej. Gruaja e zgjoi me zor.

Ai zgurdulloi sytë. Preku jastëkun. U siguria që ishte në krevat, në apartamentin e tij të bukur dhe i tha asaj: «Ç'të gjeti? Fli aty...» Ajo heshti. E dinte mirë artin e heshtjes. Ia kishte mësuar Kurti «i dashur» që natën e parë.

Martina e Ibishit e kishte apartamentin në katin e pestë të godinës më jugore, të atyre godinave që u ndër-tuan nga kantieri «Shkodra». Martina është nga ato gra që nuk shikojnë ëndrra, veç zhgjëndrra. Kishte disa pengje që nuk e linin të qetë dhe nuk e zinte gjumi. Nuk ia arriti ta vishte sallonin me pllaka granili kuq e blu, as gjithë sipërfaqen e banjës me majolike, nuk mundi të bënte patinimin dhe ta lyente me hidromat korridorin dhe njërën nga dhomat, siç kishte bërë Kurtishi.

Te pallatet e gjata në anën verilindore, godina e dytë, kati i parë, apartamenti nr. 3 drita e kuzhinës rrinte e ndezur. E kishin harruar. I zoti flinte përtokë mbi postiqe dashi. Ndihej aq i lumtur, sa qeshte në gjumë. Ai ishte nga ata ustallarët që u ecën zanati nën dorë e mbi dorë. Jeta i kishte rrjedhur grurë. Për këtë dimër kishte siguruar 130 litra raki, nga ajo që zihet në tenxheren e presionit. Kishte dy sheka me djathë, 120 kg mish pastërma prej një lope që mbante në qytezën e vjetër, prej një viçi që ia kishte blerë një kushëriri në fshat nga «të tepërtat», por ende nuk ia kishte shlyer pazarin. Një pjesë pastërmaje e kishte prej cjapi dhe deleje. Në një arkë të veçantë me çelës mbante mbyllur 60 kg suxhuk nga ai i cilësisë së parë, pa llogaritur dy voza me turshi, qepët, hudhrat dhe specin djegës, për të cilat i kishte bërë llogaritë një më një që të mos i mungonin derisa në treg të dilnin të rehat. Të gjitha këto mrekullira ishin në atë dhomë që kot quhej kuzhinë, se në të vërtetë nuk gatuhej kurrë në të, aty ishin zahiretë», siç i quante i zoti, dhe «jataku» ku ai flinte. Vinte një tëndë i rëndë, por e ndiente veten mirë. Gjumi e kishte zënë me këtë mendim: «Ça ka me ba

lala Drizo, ba mos me ia la pazarin e viçit? Hë, pra, çka ka me ba? Kurr gjja hiç ka me ba! E çka me ba? Me kyce përpjeta. Viçi tash u ba pastërma e suxhuk... suxhuk e po rrin ngrohtë qaty ke sunduku. Hë, le të rrijë qaty, se a mirë boll viçi. Lala Drizo tepër e ka pasë, mbi statut e ka pasë, pa të drejtë e ka pasë viçin. Allahi ma ka taks qat viç për këtë dimën, ha-ha!»

Me këtë mendim të gëzuar e kishte zënë gjumi Memish Kukajn.

Në njërën nga barakat e punëtorëve, mbuluar me eternite, në anë të lagjes nr.7 ishte strehuar përkohësisht çifti Selita. Nuk u bë dot gjë për strehimin e tyre të menjëhershëm. Por ishin në projekt sapo të shpërndaheshin godinat e reja përpara Vitit të Ri. Dhoma ku flinte çifti i ri ishte e ftohtë, por ata nuk e ndienin. Batushi ëndërronte sikur tok me Vjedën ishte në një motobarkë. Motobarka çante ujërat e liqenit nën një qiell të kaltër. Ai kishte ngritur kavaletin dhe skicone peizazhin. Mes kaltërsisë së ujërave dhe të qiellit ai fiksonte fluturimin e kumrijeve drejt qytetit të ri. Mes këtyre ngjyrave dhe këtij fluturimi ai ishte tok me të shoqen, Vjedën...

Vjeda ishte zgjuar. Ajo kishte ndier turbullirat e para dhe e kuptoi se do të bëhej nënë. Ndiente diçka të papërcaktuar dhe të panjohur në shpirt. Brenda qenies së saj kishte një dëshirë: të kishte një djalë që t'i ngjante të shoqit.

Kallushan Kukaj kishte dalë në ballkonin e katit të dytë të pallatit nr. 83. Shikonte borën që binte dhe e ndiente veten si njeriu që kthehet nga pylli me një barrë dru mbi shpinë. E shkarkon atë në oborr. Drejton trupin dhe mbush gjoksin me ajrin e ftohtë, të pastër të natës me borë.

«Si na hyri djalli në bark me fisin kështu? — mendon. — U rreka tamam si kalë. Për hiçgjë. Fisi, fisi! Po fisi nuk humb, djalli ta marrë, megjithëse nuk bëhet më siç ka qenë...»

Mbylli derën e ballkonit dhe u fut në kuzhinë, ku e priste Sanija.

— Oj Sanë, mirë-ë?

— Mirë.

Tani do të gëzojmë me Danën e me Gonin. E, si po thua, ta japim Danën apo jo?

— Nuk di. Ti di.

— Ani, do ta pyes kur të vijë vetë. S'ia prish unë asaj...

— Për ku a fjala?

— Te Përdrinët, Sanë, te Përdrinët, — tha i menduar.

Sanija ndjeu gëzim deri në dhimbje. Në shtëpi kishte hyrë ajër tjetër. Edhe tek i shogi po ndodhte diçka e pashpjegueshme. Kohët e fundit ai heshtte shumë. Ishte i zymtë. Pastaj dalëngadalë u çel. «Mos më daltë për keq gjithë ky gëzim,» — tha me vete Sanija.

Besimi doli nga ndërtesa e madhe dhe u habit kur pa se kishte rënë muzgu. I kishin dhënë detyrën e re. E kishin emëruar në vend të Vasil Kushtës. Ai e quante të pamundur, kategorikisht të pamundur. Vasil Kushta mund ta bënte, po jo ai djalë njëzet e nëntë vjeç. Po ata ia kishin ngarkuar, ia kishin besuar. Duhej ta bënte.

Qëndroi te shkallët përpara hyrjes. Shikoi fasadën e lartë, ku ishin ndezur dritat, dhe të gjithë ata brenda vazhdonin të punonin. Një mendje i tha të kthehej dhe t'i thoshte atij: «Shoku... unë nuk e bëj dot...» Po sytë tani kërkonin Dianën. E kishte lënë aty te lulishtja që në orën katër pasdite... kurse tani... Mendoj se ajo do të kishte ikur shumë e nxehur. Po jo, ajo priste më tutje, mbledhur kruspull te një stol. Ishte përkulur përpara dhe shikonte kalimtarët.

Kur e ndjeu hapin e tij, ktheu kokën dhe nuk lëvizi fare.

— Kushedi sa je mërzhitur, — e pyeti ai.

— Bes, ç'të thanë? Përse të mbajtën kaq shumë, apo kishit ndonjë mbledhje? Unë sa nuk plasa këtu vetëm... — ajo u ngrit.

— Dianë, mua më emëruan në vend të shokut Vasil që ngrihet në përgjegjësi, — tha ai i emocionuar.

Ajo e pa me habi, pastaj fytyra i rrëzëlli.

Po ecnin në bulevard. Ajo i shtrëngonte krahun pranë vetes. Perëndimi skuqte si prush në horizont. Ajri ishte i ashpër si i ngrirë. Në qiellin e bruztë era shtynte retë dhe hapeshin fusha të kaltra ku nxirrnin sytë yjtë e qeshur. Mes kaltërsisë dhe yjve atij i zuri syri Monumentin e Leninit, ku një projektor diku përballë derdhte dritë të fortë. Ai qëndroi dhe nuk ia hoqi sytë monumentit. Ajo i shtrëngoi përsëri krahun dhe i tha: «Sa bukur!» Të dy shikuan monumentin, pastaj njëri-tjetrin. Monumenti iu duk si diçka kolosale, ndërsa vetja e tyre si fëmijë.

Gjithë të ardhmen e kishin përpara.
